


“Fjalën e ke ti!”



Doracak
për Kartën e Rishikuar Evropiane
për Pjesëmarrjen
e të Rinjve
në Jetën Lokale
dhe Rajonale



FJALËN E KE TI!

**Doracak për Kartën e Rishikuar
Evropiane për Pjesëmarrjen e të
Rinjve në Jetën Lokale dhe
Rajonale**

Mendimet e shprehura në këtë publikim janë përgjegjësi e autorit/autorëve dhe jo çdoherë i paraqesin politikat zyrtare të Këshillit të Evropës.

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet ose transmetohet, në çfarëdo forme, me çfarëdo mjeti, elektronik (CD-Rom, internet, etj.) ose mekanik, duke përfshirë fotokopjimin, incizimin ose çfarëdo lloj sistemi për ruajtjen dhe rikthimin e informatave, pa lejen paraprake me shkrim nga Departamenti për informata publike dhe botime i Drejtorisë për komunikime(F-67075 Strasbourg Cedex ose publishing@coe.int).

Departamenti për të Rinj
Drejtorati për Qytetari dhe Pjesëmarrje Demokratike
F-67075 Strasbourg Cedex
Tel.:+33(0)388412300
Fax:+33(0)38841 2777
e-mail:youth@coe.int
www.coe.int/youth

Dizajni i kopertinës: Graphic Design Workshop, Council of Europe
Ilustrimi i kopertinës: Giuseppina Rossi
Faqosja: Jouve, Paris

Botim i Këshillit të Evropës
F-67075 Strasbourg Cedex
<http://book.coe.int>

ISBN 978-92-871-6239-7
©Council of Europe, nëntor, 2015
Shtypur në Këshillin e Evropës

© Council of Europe, nëntor, 2015 for the English language version
© OSCE Mission to Skopje/Council of Europe (2015) for the Albanian language version.
Text originated by, and used with the permission of, the Council of Europe. This translation is published by arrangement with the Council of Europe, but under sole responsibility of the translator.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

316.346.32-053.6(4)

"FJALËN e ke ti!" : doracak për kartën e rishikuar Evropiane për pjesëmarrjen e të rinjve në jetën lokale dhe rajonale. - Shkup : OSCE, 2017. - [144] стр. : илустр. ; 21 см

Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 139


ISBN 978-608-4788-24-9

а) Млади - Социјална инклузија - Европа б) Младинска политика - Европа
COBISS.MK-ID 103610122

osbe Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup

Përkthimi i këtij botimi nga gjuha angleze u sigurua nga Misioni i OSBE-së në Shkup.
Përbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimin apo qëndrimin e Misionit të OSBE-së në Shkup.





Përmbajtja

FALËNDERIM	5
PARATHËNIE	7
HYRJE	9
KAPITULLI 1: NJOFTIM ME Pjesëmarrjen	
1.1. Përkufizimet themelore dhe qasjet për pjesëmarrjen e të rinjve.....	11
1.2. Përfitimet nga pjesëmarrja e të rinjve dhe pengesat për pjesëmarrjen e të rinjve.....	16
1.3. Parimet e pjesëmarrjes së të rinjve.....	20
1.4. Parakushtet për pjesëmarrjen e të rinjve.....	23
1.5. Format e pjesëmarrjes së të rinjve.....	25
KAPITULLI 2: KARTA E RISHIKUAR EVROPIANE PËR Pjesëmarrjen e të rinjve në jetën LOKALE DHE RAJONALE	
2.1. Hyrje	27
2.2. Përmbajtja e Kartës	31
2.3. Grupet e synuara të Kartës.....	35
KAPITULLI 3: QASJA E KARTËS NDAJ Pjesëmarrjes	
3.1. Njoftim me qasjen e Kartës ndaj pjesëmarrjes së të rinjve	37
3.2. Korniza DMHMM.....	38
KAPITULLI 4: KARTA NË PRAKTIKË	
4.1. Karta e rishikuar si mjet praktikë për aktorët e ndryshëm	45
4.2. Si ta përdorni Kartën në praktikë?.....	51
a. Modeli me gjashtë hapa	51
b. Qasja DMHMM.....	53
c. Qasja pjesëmarrëse për planifikimin e projekteve për të rinjtë	53



KAPITULLI 5: PROJEKTET PËR PJESËMARRJEN E TË RINJVE

5.1. Menaxhimi i projekteve për pjesëmarrjen e të rinjve.....	55
5.2. Hap pas hapi: planifikimi dhe menaxhimi i një projekti për të rinj	57
5.3. Kriteret për kualitet për projektet pjesëmarrëse.....	64

KAPITULLI 6: BASHKËPUNIMI NË NIVEL VENDOR

6.1. Përgatitja për bashkëpunim.....	69
6.2. Bashkëpunimi në fushën e vendimmarrjes – Modeli i konsultimit.....	71
6.3. Bashkëpunimi në fushën e vendimmarrjes – Modeli i komitetit	76
6.4. Bashkëpunimi në fushën e vendimmarrjes – Bashkë-menaxhimi	79
6.5. Format e tjera të bashkëpunimit në fushën e vendimmarrjes	83

KAPITULLI 7: KARTA DHE POLITIKAT VENDORE PËR TË RINJTË

7.1. Njoftim me politikën vendore për të rinjtë.....	85
7.2. Karta e rishikuar dhe politika rinore vendore	88
7.3. Procesi i formulimit të politikës rinore vendore	92
7.4. Përfaqësimi (Avokatësia) – Rrjetëzimi për ndryshim të politikës	94

KAPITULLI 8: SEKSIONI I EDUKIMIT

Rombi me politika	100
Sandviçët me njerëz	102
Thika dhe pirunët	103
Shkalla e pjesëmarrjes.....	106
Takimi me kryetarin e komunës	109
Rrjeti i pjesëmarrjes	112
Orteku i pjesëmarrjes.....	113
Boshti kohor i pjesëmarrjes.....	115
Të drejtat dhe pjesëmarrja.....	116
Maskarada “DMHMM”	117
Luajtja e roleve sipas Kartës	118
Ushtrimi me deklarata.....	121
Trekëndëshi i bashkëpunimit	123
E saktë ose e pasaktë?.....	126
Çka mund të bësh për mua?.....	128
Vizita në Rinizi	129
Çka do të ndodhë nëse nuk ndodh?.....	130
Ushtrim për simulim “Të rinjtë në aksion”	131

BIBLIOGRAFIA	139
---------------------------	-----

KONTAKTET	141
------------------------	-----





Falënderim

Ky doracak është shkruar nga Zhaneta Gozxhik – Ormel (Žaneta Goździk-Ormel).

Është përgatitur nën udhëheqjen dhe mbështetjen e grupit konsultativ (të ekspertëve) të përbërë nga:

Sundus Al-Hasani (SundussAl-Hassani)

Ditrih Benziger (Dietrich Baenzinger)

Ajris Baundaman (Iris Bawidamann)

Xhejms Durlli (James Doorley)

Viktorija Karçenko (Viktoria Kharchenko)

Nadin Liamuri Baja (Nadine Lyamouri-Bajja)

I shprehim falënderim Xhuzepina Rosit (Giusepinna Rossi) për përgatitjen e piktogrameve.





Parathënie

Qëllimi i politikës rinore të Këshillit të Evropës është që t'u jepen mundësi dhe eksperiencë të njëjtë të rinjve të cilat do t'u mundësohet ta pasurojnë dijeninë, shkathhtësitë dhe kompetencat, që të mund ta gjejnë vendin e tyre në të gjitha aspektet e shoqërisë. Programi i Qendrave Rinore Evropiane në Budapest dhe Strasburg, dhe projektet e përkrahura nga Fondacioni Evropian Rinor janë shembull për përfshirjen e të rinjve me qëllim përbushjen e të drejtave dhe detyrave të tyre si qytetar. Shpesh në nivel lokal si për shembull në shkolla, qendra rinore dhe kulturore, këshille rinore lokale, projekte me buxhet me pjesëmarrje, projekte nga fusha e kulturës dhe sportit, pjesëmarrja rinore ka ndikim të madh mbi jetën e shumicës së të rinjve.

Kongresi i Pushteteve Lokale dhe Rajonale, kuvend politik i përfaqësuesve të zgjedhur nga nivelet më bazike të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, në mënyrë të gjithanshme përpiqet që të promovojë pjesëmarrje më të madhe të të rinjve në strukturat dhe proceset demokratike të shoqërive tona, veçanërisht në nivelet në të cilat ato të rinj punojnë.

Duke kërkuar përgjigje për sfidat e shoqërisë moderne, Kongresi jep rekomandime për politikën dhe i inkurajon pushtetet lokale dhe ato rajonale që t'i zbatojnë këto rekomandime. Që të jenë këto politika të suksesshme dhe t'i përmbushin nevojat e të gjithë qytetarëve, Kongresi beson se qytetarët, veçanërisht të rinjtë, duhet në mënyrë aktive të përfshihen në proceset e sjelljes së vendimeve dhe krijimit të politikave. M'u në nivel lokal dhe atë rajonal, kultura e pjesëmarrjes qytetare mund të rrënjohet në mënyrë më efektive.

Kongresi e përkrah sistemin e bashkë-menaxhimit të Këshillit të Evropës, në përputhje me parimet e vendimmarrjes, të përgatitura dhe të miratuara nga sektori rinor në ekzistimin e tij më tepër se dyzet vjeçar. Ky sistem, i cili përfshin miratimin kolektiv të të gjitha vendimeve nga ana e pushteteve lokale në partneritet me përfaqësuesit rinor dhe organizatat e tyre, me shumë seriozitet i kupton të rinjtë në të gjitha çështjet, brengat e tyre dhe aftësitë e tyre për të sjellë vendime dhe për të pranuar përgjegjësi. M'u përmes sistemeve të bashkë-menaxhimit të rinjtë më së miri mund të inkurajohen për të bashkëpunuar me pushtetet dhe për t'u angazhuar në shoqëri. Kjo veçanërisht është e rëndësishme në një kohë kur hulumtimet tregojnë se të rinjtë gjithnjë e më shumë i refuzojnë metodat tradicionale përmes të cilave mund të thuan atë që e mendojnë.

Karta e Rishqyrtuar Evropiane për pjesëmarrjen e të rinjve në jetën lokale dhe rajonale është një element kyç për promovimin e bashkë-menaxhimit në nivel rajonal dhe atë lokal. Vetë Karta është vepër i një grupi të rinjsh dhe të përfaqësuesve të pushteteve lokale dhe rajonale të cilët bashkëpunonin në mënyrë të barabartë dhe në nivel partneriteti. Karta para së gjithash u dedikohet pushteteve lokale dhe rajonale, dhe paraqet udhëzues për zbatimin e politikave sektoriale të cilat do të jenë në dobi si për të rinjtë, po ashtu edhe për qytetarët të tjerë.

Karta në të njëjtën kohë është edhe mjet i cilin të rinjtë mund ta shfrytëzojnë për t'i inkurajuar pushtet lokale dhe ato rajonale që t'i zbatojnë politikën në konsultim të plotë me ta, por edhe për bashkëpunim të të rinjve, organizatave rinore dhe pushteteve lokale dhe rajonale.

Të rinjtë duhet ta kenë të drejtë, mjete, hapësirë, mundësi dhe përkrahje për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe në krijimin e politikave. Qëllimi i Kartës është të promovohet mu ky proces. Ekzistojnë shumë shembuj përmes të cilëve shihet rëndësia e pjesëmarrjes së konsiderueshme të të rinjve në nivel lokal dhe atë rajonal, mirëpo duhet ende shumë punë që të arrihet ky qëllim anëmbanë Evropës, kurse doracakun "Fjalën e ke ti!" padyshim se do të shërbejë për avancimin e këtij procesi.



Botimi i parë i këtij doracaku është një nga botimet më të suksesshme të sektorit rinor në kuadër të Këshillit Rinor. Kjo dëshmon edhe për faktin se Evropa shkon vazhdimisht përpara dhe e njuh rëndësinë e pjesëmarrjes rinore. Ky doracak është një mjet i rëndësishëm dhe i vlefshëm në këtë proces, prandaj dhe i ftojmë të gjithë, në veçanti pushtetet lokale dhe ato rajonale, ta përdorim doracakun për të promovuar një shoqëri e cila më së miri do t'i pasqyrojë nevojat e të rinjve në tërë Evropën.

Andreas Kifer,
Sekretar gjeneral,
Kongresi i Pushteteve Lokale
dhe Rajonale i Këshillit të Evropës

Snezhana Samarxhiq – Markoviq,
Drejtor gjeneral,
Drejtorja Gjenerale për Demokraci
e Këshillit të Evropës



Hyrje

Mirë se vini në Fjalën e ke ti! – Doracak për Kartën e Rishikuar Evropiane për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale e Rajonale.

Pjesëmarrja e të rinjve nuk është qëllim në vete, por mjet për arritjen e ndryshimeve pozitive në jetën e të rinjve dhe përdorimin e një shoqërie më të mirë. Gjatë viteve të fundit, ka pasur një numër gjithnjë e më të madh të iniciativave për promovimin dhe përforsimin e përfshirjes së të rinjve në nivele të ndryshme – ndërkombëtare, rajonale, kombëtare e vendore. Po ashtu, janë krijuar edhe mjete të reja për të punuar në këtë fushë. Një mjet i tillë është edhe Karta e Rishikuar Evropiane për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale (në vazhdim të tekstit Karta), që është miratuar muajin maj të vitit 2003 nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës.¹

Pjesëmarrja e të rinjve, po ashtu ishte njëra nga tri temat kryesore të Fushatës evropiane rinore për shumëllojshmëri (diversitet), të drejtat e njeriut dhe për pjesëmarrje, të organizuar nga Këshilli i Evropës, në partneritet me Komisionin Evropian dhe Forumin Rinor Evropian (2006/2007). Ky doracak është njëra nga iniciativat që u ndërmorën në kuadër të këtyre fushatave.

Karta e rishikuar është dizajnuar si mjet për t'i mbështetur të rinjtë, punëtorët që punojnë me të rinjtë, organizatat e autoritetet vendore, në nxitjen dhe avancimin e pjesëmarrjes së rëndësishme të të rinjve në nivel vendor anembanë Evropës dhe ajo mund të përdoret në mënyra të ndryshme. Disa shfrytëzues mund ta zbatojnë atë menjëherë, ndërsa të tjerët mund të kenë nevojë për mbështetje që të mësojnë se si ta shfrytëzojnë sa më mirë Kartën e rishikuar në mjedisin e tyre. Pyetjet "Çka të bëj me kartën?"; "Si mund ta përdor atë në praktikë?" ose "Pse duhet të më interesojë ky dokument?", janë parashtruar shpesh nga ata që punojnë në pjesëmarrjen e të rinjve në nivel vendor. Qëllimi i këtij doracaku është ndihmë të gjenden përgjigjet e vërteta për kontekstet e ndryshme evropiane.

Doracaku nuk është një udhëzues i gatshëm që mund të përdoret menjëherë për zbatimin e Kartës në nivel vendor – situata në pjesë të ndryshme të Evropës dallojnë shumë. Ai paraqet një përmbledhje të mendimeve dhe të çështjeve që mund ndihmojnë atyre që punojnë në nivel vendor për t'i gjetur mënyrat e veta për të arritur pjesëmarrje të rëndësishme të të rinjve. Publikimi është i ndarë në tetë kapituj, me ç'rast secili prej tyre përqendrohet në aspekte të veçanta që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e të rinjve dhe vetë Kartën.

Në Kapitullin 1 bëhet hyrja me informata themelore për pjesëmarrjen e të rinjve, me ç'rast janë prezantuar definicionet e parimet dhe faktorët që ndikojnë në pjesëmarrje. Kapitulli 2 përmban detaje për Kartën, përmbajtjen e saj dhe grupe synuara, si edhe disa informata që kanë të bëjnë me Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës. Kapitulli 3 e sqaron qasjen e Kartës ndaj pjesëmarrjes rinore, që është e bazuar në pesë fjalë kyçe – e drejta, mjet hapësira, mundësia dhe mbështetja. Kapitulli 4 i prezanton mundësitë për përdorimin e Kartës në praktikë, duke përqendruar në qasjen hap pas hapi që mund të shfrytëzohet në nivel vendor.

1. Emri i Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës është ndërruar më 14 tetor 2003 në Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës. Emri i dytë do të përdoret në këtë publikim.



Projektet e të rinjve luajnë një rol shumë të rëndësishëm në promovimin dhe përfundimin e pjesëmarrjes së të rinjve dhe Kapitulli 5 i shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me organizimin e projekteve rinore. Karta mund të shfrytëzohet më mirë në qoftë se aktorët vendor që janë të interesuar për pjesëmarrjen e të rinjve, bashkëpunojnë dhe punojnë në partneritet. Prandaj, Kapitulli 6 ofron ide për atë se si të zhvillohet bashkëpunimi i mirë në nivel vendor, veçanërisht ndërmjet organizatave rinore dhe autoriteteve vendore. Karta, po ashtu mund të shihet si mjet për krijimin e politikës vendore për të rinjtë, ndërsa Kapitulli 7 sqaron se si mund të përdoret ky dokument për t'i përpiluar ose për t'i rishikuar politikat për të rinjtë në nivel të komunitetit ose në nivel rajonal. Në fund, në Kapitullin 8 janë prezantuar disa aktivitete edukative që mund të përdoren si mjete mësimore në lidhje me pjesëmarrjen e të rinjve, e veçanërisht në lidhje me Kartën e rishikuar. Po ashtu, çdo kaptinë përmban edhe seksione të quajtura "Mendoni". Ato janë përmbledhje pyetjesh që mund t'i ndihmojnë lexuesit t'i zbulojnë mënyrat më të mira për shfrytëzimin e Kartës në kontekstin e tij/saj.

Ky doracak është rezultat i bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë për Rininë dhe Sportin (DRS) dhe Kongresit, që filloi shumë vite më parë. Në fakt, themeli i asaj që më vonë do të bëhej Karta Evropiane për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale u hodh në konferencën e parë dhe të dytë për politikën rinore, të organizuara nga Konferenca e atëhershme e Përhershme e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës, në Lozanë (qershor 1988) dhe në Llangollen (shtator 1991). Karta e rishikuar, të cilën e shoqëron ky doracak, ishte si rezultat i konferencës për festimin e dhjetëvjetorit të Kartës origjinale të vitit 1992. Kjo konferencë, me titull "Të rinjtë – aktorë në qytetet dhe rajonet e tyre", u organizua nga Kongresi, në partneritet me DRS-në, në Krakov të Polonisë, më 7 dhe 8 mars të vitit 2002. Përveç vlerësimit për përparimin e arritur në fushën e pjesëmarrjes së të rinjve gjatë dhjetë viteve të ekzistencës së Kartës, pjesëmarrësit po ashtu kërkuan të bëhet një rishikim i Kartës, në mënyrë që të merren parasysh sfidat e reja me të cilat ballafaqohen të rinjtë në shoqërinë bashkëkohore. Pas miratimit të Kartës së rishikuar, Kongresi dhe DRS-ja kanë bashkëpunuar në disa iniciativa për promovimin e zbatimit të saj. Kongresi vazhdon të punojë në çështjet që janë me rëndësi për të rinjtë, në nivelet vendore dhe rajonale, nëpërmjet strukturave dhe teksteve të ndryshme të tij.

Ky doracak nuk do të mund të përgatitej pa kontributin e disa njerëzve. I shprehim falënderim të veçantë Zhaneta Gozhik - Ormelit (Žaneta Goździk-Ormel), për punën e saj të përkushtuar si autore e këtij doracak. Fjalë miradije u takojnë edhe anëtarëve të grupit konsultativ (ekspertëve) për përfshirjen, mbështetjen dhe këshillat e tyre.





Kapitulli 1

Njoftim me pjesëmarrjen

→ 1.1 Definicionet themelore dhe qasjet për pjesëmarrjen e të rinjve

Kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen e të rinjve, mund të vërehen një sërë praktikash, si dhe lloje të ndryshme të qasjeve dhe të teorive. Punëtorët që punojnë me të rinjtë, organizatat rinore dhe autoritetet vendore i qasen konceptit të pjesëmarrjes nga kënde të ndryshme për shkak të sfondeve dhe përvojave të tyre të ndryshme. Po ashtu, shpeshherë dallon edhe motivimi për punën e tyre në fushën e pjesëmarrjes së të rinjve: disa mund të jenë të motivuar nga ndryshimi shoqëror dhe ndërtimi i shoqërive më demokratike, ndërsa të tjerët mund të jenë të interesuar për zhvillimin e të rinjve ose thjesht mund të jenë të motivuar nga qëllimet e tyre politike. Debati në lidhje me aspektet e ndryshme të pjesëmarrjes së të rinjve është një debat i vazhdueshëm dhe mund të jepet përgjigje të ndryshme për pyetjet e njëjta.

Mendoni

1. *Si definohet rinia në komunitetin/organizatën tuaj (kufiri i moshës, kriteri psikologjik ose ndonjë kriter tjetër)?*
2. *Cilët janë të rinjtë me të cilët ju punoni? Sa homogjene është përbërja e atij grupi?*
3. *Si kuptohet termi “pjesëmarrja e të rinjve” në organizatën/institucionin tuaj?*
4. *Prej nga e dini këtë? A ka definicion/qasje të pranuar apo bëhet fjalë për supozimin dhe perceptimin tuaj?*
5. *Çfarë dëshiron të arrijë organizata juaj në fushën e pjesëmarrjes së të rinjve?*

Nëse pyetjet e mësipërme do t’u parashtroheshin punëtorëve që punojnë me të rinjtë, drejtuesve, përfaqësuesve të autoriteteve ose njerëzve të tjerë që janë të interesuar për pjesëmarrjen e të rinjve anembanë Evropës, si përgjigje do të fitoheshin po aq ide sa është numri i personave që janë pyetur. Nuk është reale të pritët se mund të përpilohet një definicion ose një qasje, me të cilën do të pajtohen të gjithë. Më poshtë janë dhënë disa shembuj për atë se si disa organizata ose grupe e kuptojnë pjesëmarrjen e të rinjve:

- “Shkurt thënë, pjesëmarrja nënkupton të marrësh pjesë, të kryesh detyra, të ndash dhe të mbash përgjegjësi. Do të thotë të kesh qasje dhe të jesh i përfshirë.”²

2. Lauritzen, P., fjalimi hyrës për pjesëmarrjen, i prezantuar në Trajnimin për zhvillimin dhe zbatimin e projekteve pjesëmarrëse në nivel vendor dhe rajonal, Qendra evropiane për të rinj, Strasburg, qershor 2006.



- Pjesëmarrja do të thotë “të ndihmosh në orientim dhe në formësim”.³
- “Pjesëmarrja nënkupton të flasësh dhe të dëgjosh, t’i shprehësh pikëpamjet personale dhe t’i dëgjosh të tjerët kur i shprehin pikëpamjet e tyre. Mund ta nënkuptojë edhe punën e përbashkët për të gjetur ndonjë zgjidhje ose për ta caktuar mënyrën e veprimit. Pjesëmarrja nuk do të thotë të bëhesh vetëm aktivist i ri, por po ashtu mund të nënkuptojë edhe shfrytëzimin e mundësive që ofrohen, si për shembull bashkëngjitjen ndonjë klubi për të mësuar ndonjë shkathtësi të re, ose ndonjë grupi që e mbështet fuqimisht ndonjë çështje.”⁴

Mendoni

1. *Cilat janë ngjashmëritë ndërmjet asaj se si ju e kuptoni pjesëmarrjen e të rinjve dhe definicioneve të prezantuara më lartë?*
2. *Cilat janë dallimet kryesore?*

Për qëllimet e këtij doracak, pjesëmarrja e të rinjve do të kuptohet ashtu siç është definuar në preambulën e Kartës së Rishikuar për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale.⁵

“Pjesëmarrja e një komuniteti në jetën demokratike nënkupton diçka më tepër se votimi ose kandidimi në zgjedhje, edhe pse këto janë elemente të rëndësishme të pjesëmarrjes. Pjesëmarrja dhe qytetaria aktive nënkupton të kesh të drejtë, mjete, hapësirë, mundësi dhe aty ku është e nevojshme, mbështetje për të marrë pjesë, për të ndikuar në vendimmarrje si dhe për t’u angazhuar në veprime dhe aktivitete për të kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më të mirë.”

Përkufizimi i mësipërm e tejkalon kuptimin e ngushtë të pjesëmarrjes së të rinjve vetëm si përfshirje politike ose si pjesëmarrje në këshillat rinore. E potencon faktin se të marrësh pjesë do të thotë të kesh ndikim dhe përgjegjësi mbi vendimet dhe veprimet që ndikojnë në jetën e të rinjve ose thjesht janë të rëndësishme për ta. Prandaj, në praktikë kjo mund të nënkuptojë votimin në zgjedhje vendore, si dhe krijimin e një organizate rinore, ose të një forumi në internet për këmbimin e informatave për hobi dhe interesat, ose mënyra të tjera kreative për kalimin e kohës së lirë. Përkufizimi i pjesëmarrjes sipas Kartës, po ashtu tregon se ka një ndryshim në qasjen ndaj të rinjve dhe përfshirjes së të rinjve. Të rinjtë nuk trajtohen si viktimë ose si grupe të rrezikuara që kanë nevojë për mbrojtje dhe ndihmë (e ashtuquajtura “qasja e bazuar në problem”). Ata nuk trajtohen si objekte të intervenimit të të rriturve, ku të rriturit supozojnë se e dinë se çka është më mirë për të rinjtë. Tani të rinjtë shihen si lojtarë aktivë nëpër organizata ose në jetën e komunitetit; ata shihen si partnerë me shumë potencial, talente dhe anë të fuqishme. Atyre duhet t’u ofrohen mundësi që t’i shprehin nevojat e tyre dhe të gjejnë mënyra për t’i kënaqur ato. Një fjalë e urtë afrikane thotë “ai që i ka të veshura këpucët e di saktë se ku dhembin ato”. Kjo është arsyeja se pse të rinjtë duhet të përfshihen në trajtimin e çështjeve që ndikojnë mbi ta dhe pse ata duhet të mbështeten nga të tjerët, e jo të marrin urdhra prej tyre.

3. Jans, M. dhe De Backer, K. *Youth and social participation. Elements for a practical theory*, Flemish Youth Council JeP!, Bruksel, 2002, fq. 2.

4. *Discussing global issues :what is participation?* UNICEF, Mbretëria e Bashkuar, 2004, faq.1.

5. *Karta e Rishikuar Evropiane për pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale*, Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, maj 2003.



Mendoni

1. A konsiderohen të rinjtë në komunitetin/organizatën tuaj::

- si grup që ka nevojë që problemet e tyre t’i zgjidhë dikush tjetër?
- si grup që nuk dëshiron të marrë përgjegjësi?
- si grup që ka nevojë për mbrojtje?
- si klientë që kanë nevojë çdo gjë t’u ofrohet si e gatshme?
- si njerëz që kanë anë të fuqishme dhe talente?
- si grup që është i aftë të kontribuojë për zgjidhjen e problemeve të veta?
- si grup që dëshiron vetë t’i bëjë gjërat (nuk pranon ndihmë)?
- në ndonjë mënyrë tjetër?

2. A ka diçka që duhet të ndryshohet në mënyrën se si shihen të rinjtë në komunitetin/organizatën tuaj? Nëse po, çka?

Në dekadën e fundit, pjesëmarrja e të rinjve shpeshherë është konsideruar si e drejtë (e ashtuquajtura “qasja e bazuar në të drejta” për pjesëmarrjen e të rinjve). Për shembull, UNICEF-i e sheh pjesëmarrjen si e drejtë e njeriut dhe për këtë arsye, Konventa e KB-ve për të drejtat e fëmijëve e thekson të drejtën e fëmijëve për të marrë pjesë. Roxher Hart (Roger Hart, autori i konceptit të quajtur “shkallët e pjesëmarrjes”) thotë se pjesëmarrja është e drejtë fundamentale e qytetarit për shkak se është mënyrë për të mësuar se ç’do të thotë të jesh qytetar. Në Këshillin e Evropës, pjesëmarrja e të rinjve perceptohet si “e drejtë e të rinjve për t’u inkuadruar dhe për t’i marrë përsipër detyrat dhe përgjegjësitë në jetën e përditshme në nivel vendor, si dhe e drejtë për të ndikuar në mënyrë demokratike mbi proceset e jetës së tyre”⁶. Pjesëmarrja si e drejtë, po ashtu nënkupton se të gjithë të rinjtë mund ta ushtrojnë këtë të drejtë pa diskriminim – pa marrë parasysh se prej nga vijnë ose çfarë gjuhe flasin.

Pjesëmarrja e të rinjve po ashtu mund të shihet edhe si formë e partneritetit ndërmjet të rinjve dhe të rriturve. “Partneritet do të thotë të bëhen punët së bashku. Do të thotë të dëgjohet zëri i secilit dhe të merren seriozisht idetë e ndryshme”⁷. Në praktikë kjo do të thotë se qëllimet, objektivat, rolet, përgjegjësitë, vendimet etj., bisedohen dhe arrihet pajtim për to dhe se të rinjtë dhe të rriturit e dinë saktë se:

- çka duan të bëjnë;
- çka pritët prej tyre;
- çka presin ata prej të tjerëve;
- si do ta bëjnë këtë;
- çfarë lloji të mbështetjes marrin dhe prej ku.

Përparësia e partneritetit ndërmjet të rinjve dhe të rriturve është se i bashkon shkathtësitë dhe talentet e të rinjve me përvojën dhe urtësinë e të rriturve. Po ashtu, me partneritetin e këllillë pranohen dhe vlerësohen të gjitha kontributet individuale, dhe në këtë mënyrë motivohen partnerët që të ndërmarrin më tepër iniciativa dhe projekte.

6. Boukobza, E., *Keys to participation. A practitioners’ guide*, Këshilli i Evropës, 1998, faq. 10.


7. Stacey, K., “Theoretical underpinnings of youth partnership accountability”, kumtesë e papublikuar, Adelaide, 1998; e cituar në *Youth participation handbook for organizations. A guide for organizations seeking to involve young people on boards and committees*, Zyra për të rinj e Qeverisë së Australisë Jugore, 2003, faq. 15



Mendoni

Shihni organizatën ose komunitetin tuaj. A mund të thoni se atje tashmë ka një partneritet ndërmjet të rinjve dhe të rriturve?

1. Nëse po, çfarë forme ka ai?
2. Nëse jo, pse mendoni se nuk ekziston? A ka mundësi të bëhet diçka për ta promovuar atë?
Çka mund të bëni ju?



Përshtatur nga: Hart,R.,*Pjesëmarrja e fëmijëve nga tokenizmi në qytetari (Children's participation from tokenism to citizenship)*,Qendra për hulumtim Innocenti e UNICEF-it, Firencë, 1992

Nuk mjafton të thuhet se të rinjtë marrin ose nuk marrin pjesë. Ka nivele të ndryshme të përfshirjes ose të marrjes së përgjegjësishë nga të rinjtë, varësisht nga situata vendore, burimet, nevojat dhe niveli i përvojës. Roxher Harti e propozon modelin e ashtuquajtur “shkallët e pjesëmarrjes së fëmijëve”⁸, model i cili i ilustron nivelet e ndryshme të përfshirjes së fëmijëve dhe të të rinjve në projekte, organizata ose komunitete.

Roxher Harti përkufizon tetë nivele të përfshirjes së të rinjve, me ç’rast secili nivel i përgjigjet një shkallareje të shkallës:

Shkallarja 8: Vendimarrja e përbashkët

Projektet ose idetë iniciohen nga të rinjtë, të cilët i ftojnë të rriturit të marrin pjesë në procesin e vendimarrjes si partnerë.

Shkallarja 7: Të rinjtë udhëheqin dhe iniciojnë

Projektet ose idetë iniciohen dhe udhëhiqen nga të rinjtë; të rriturit mund të ftohen që të ofrojnë ndihmë po qe se ka nevojë, mirëpo projekti mund të vazhdojë pa intervenimin e tyre.

Shkallarja 6: Të iniciuara nga të rriturit me vendimarrje të përbashkët

Të rriturit i iniciojnë projektet, mirëpo të rinjtë ftohen që ta ndajnë fuqinë e vendimarrjes dhe përgjegjësitë si partnerë të përbashkët.

Shkallarja 5: Të rinjtë konsultohen dhe informohen

Projektet iniciohen dhe realizohen nga të rriturit, mirëpo të rinjtë ofrojnë këshilla dhe sugjerime dhe informohen për atë se si këto sugjerime ndikojnë në vendimet ose rezultatet përfundimtare.

Shkallarja 4: Të rinjve u caktohen detyra dhe informohen

Projektet iniciohen dhe realizohen nga të rriturit; të rinjtë ftohen të marrin përsipër role ose detyra të caktuara në kuadër të projektit, mirëpo ata janë të vetëdijshëm për ndikimin që e kanë në realitet.

8. Hart,R., Pjesëmarrja e fëmijëve nga tokenizmi në qytetari (Children’s participation from tokenism to citizenship),Qendra për hulumtim Innocenti e UNICEF-it, Firencë, 1992. Ky model është bazuar në “shkallën e pjesëmarrjes qytetare” të S.Arnstein, epublikuar si “A ladder of citizen participation”,JAIP,Vol. 35,Nr. 4, Korrik 1969, faq. 216-24.



Shkallarja 3: Të rinjtë e përfaqësuar sipërfaqësisht (të tokenizuar)

Të rinjve u jepen disa role në kuadër të projekteve, mirëpo ata nuk kanë ndikim real në asnjë vendim. Krijohet iluzioni (qoftë me qëllim ose pa qëllim) se të rinjtë marrin pjesë, e në fakt ata nuk mund të ndikojnë mbi të atë se çka bëjnë dhe si e bëjnë atë.

Shkallarja 2: Të rinjtë si zbulurim

Të rinjtë nevojiten në projekt për ta përfaqësuar rininë si grup jo i privilegjuar. Ata nuk kanë ndonjë rol domethënës (përveç se janë të pranishëm) dhe – siç ndodh me çdo zbulurim – ata vendosen në një vend të dukshëm në kuadër të projektit ose të organizatës, që të mund të shihen lehtë nga jashtë.

Shkallarja 1: Të rinjtë e manipuluar

Të rinjtë ftohen të marrin pjesë në projekt mirëpo, ata nuk kanë ndikim real në vendimet që merren dhe rezultatet e tyre. Në fakt, prezenca e tyre shfrytëzohet për të arritur ndonjë qëllim tjetër, si për shembull të fitohen zgjedhjet vendore, të krijohet përshtypje më e mirë për ndonjë institucion ose të sigurohen mjete shtesë nga institucionet që e mbështesin pjesëmarrjen e të rinjve.

Shkalla e pjesëmarrjes së të rinjve mund të jetë një mjet shumë i dobishëm për profesionistët, të cilët dëshirojnë ta shohin me sy kritik se si funksionojnë projektet ose iniciativat me pjesëmarrje në komunitetet e tyre. Mirëpo, ky model mund të sugjerojë gabimisht një hierarki të shkallëve të pjesëmarrjes së të rinjve⁹ dhe mund t'i inkurajojë përpjekjet për t'i arritur shkallaret sa më të larta, pa marrë parasysh çmimin. Prandaj, është me rëndësi të mbahet mend se shkalla në të cilën gjenden të rinjtë ose shkalla në të cilën ata duhet të përfshihen, varet nga situata vendore, nga ajo se çka duhet arritur, çfarë përvoje ekziston paraprakisht, etj. Ndonjëherë mund të jetë mjaft e vështirë të shihet saktë se cili është niveli i pjesëmarrjes në kuadër të një projekti, qoftë për shkak të nivelit të ndërlikimit të tij ose për shkak se nuk ka kufij të qartë ndërmjet shkallave të ndryshme. Niveli i përfshirjes po ashtu mund të ndryshojë me kalimin e kohës.

Mendoni

1. Në cilën shkallë të pjesëmarrjes së të rinjve gjendet projekti ose nisma juaj?
2. Prej nga e dini këtë?
3. Në cilën shkallë projekti do të ishte më efektiv? Pse?
4. Si mund ta arrijë projekti juaj këtë nivel?

Kur flitet për pjesëmarrjen e të rinjve, mund të parashtrohet një pyetje shumë e logjikshme: "pjesëmarrje në çka?" Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara i dallon këto fusha të pjesëmarrjes së të rinjve¹⁰

- pjesëmarrja ekonomike – ka të bëjë me punësimin dhe punën në përgjithësi, me zhvillimin ekonomik, eliminimin e varfërisë, krijimin e gjendjes ekonomike të qëndrueshme në një shoqëri, rajon ose për të rinjtë si grup;
- pjesëmarrja politike – ka të bëjë me autoritetet dhe qeveritë, politikat publike, ushtrimin e pushtetit, ndikimin në shpërndarjen e burimeve në nivele të ndryshme;
- pjesëmarrja shoqërore – ka të bëjë me përfshirjen në jetën e komunitetit vendor, trajtimin e sfidave dhe të problemeve vendore;
- pjesëmarrja kulturore – ka të bëjë me format e ndryshme të artit dhe të shprehjes (artet vizuale, muzika, filmi, vallëzimi, etj.).

9. Ka edhe disa modele të tjera të pjesëmarrjes së të rinjve, që nuk kanë strukturë të hierarkisë. Për shembull, mund t'i krahasoni modelet e Dejvis Driskellit (Davis Driskell)t ose të Fill Tresiderit (Phil Treseder).

10. Agjenda për të rinjtë e Kombeve të Bashkuara, Fuqizimi i të rinjve për zhvillim dhe paqe (The United Nations Youth Agenda, Empowering youth for development and peace) gjendet në: www.un.org/esa/socdev/unyin/agenda.htm (për herë të fundit e vizituar më 3 tetor 2006).



Këto fusha mund të jenë të ndërlidhura, dhe ndonjëherë, po të shihet ndonjë iniciativë ose ndonjë projekt, bëhet e qartë se ajo iniciativë përfshin më tepër se një fushë. Nuk është e lehtë të thuhet se cilat fusha të pjesëmarrjes u interesojnë më shumë të rinjve, mirëpo hulumtimet në mesin e britanikëve të rinj tregojnë se ata kryesisht janë të interesuar për prodhimin dhe konsumimin e muzikës, vallëzimin dhe format e ndryshme të artit, si dhe për aktivitetet sportive.¹¹

Mendoni

1. *Cilët mund të jenë shembuj të aktiviteteve ose të projekteve konkrete në kuadër të katër fushave të lartpërmendura të pjesëmarrjes?*
2. *Shihni aktivitetet e ndryshme të të rinjve që momentalisht janë duke u realizuar në rajonin ose në komunitetin tuaj vendor. Në cilat fusha të pjesëmarrjes së të rinjve janë duke u realizuar shumica e iniciativave? Sipas mendimit tuaj, cila është arsyeja për këtë?*
3. *Në cilën fushë të pjesëmarrjes së të rinjve është e inkuadruar organizata/institucioni juaj? Pse?*

→ 1.2. Përfitimet nga pjesëmarrja e të rinjve dhe pengesat për pjesëmarrjen e të rinjve

Mendoni

1. *Çfarë përfitimesh nga pjesëmarrja e të rinjve do të donit të shihni në komunitetin tuaj vendor ose në organizatën tuaj?*
2. *Çfarë përfitimesh keni vërejtur deri tani?*

Pjesëmarrja e të rinjve mund të sjellë përfitime konkrete dhe të dukshme, jo vetëm për të rinjtë, por edhe për organizatat/institucionet dhe komunitetet që janë të përfshira. Megjithatë, nuk duhet supozuar se pjesëmarrja gjithmonë do të sjellë rezultate pozitive. Përvoja tregon se në qoftë se ajo trajtohet në mënyrë joadekuate (për shembull, nëse është e përfaqësuar nga shkallaret më të ulëta të shkallës së pjesëmarrjes), në fakt mund të ketë ndikim negativ mbi ata që janë të përfshirë.¹²

Hulumtuesit e çështjeve rinore dhe praktikantët e punës me të rinj theksojnë se pjesëmarrja e rëndësishme e të rinjve:

– *E ndryshon pozitivisht jetën e të rinjve*

Pjesëmarrja nuk duhet të shihet si qëllim, si një cak përfundimtar që duhet të arrihet, por si mjet për arritjen e qëllimit ose si mënyrë efektive për arritjen e ndryshimit pozitiv në shoqëri. Të rinjtë mund të kontribuojnë për arritjen e këtij ndryshimi, veçanërisht kur shohin zhvillime pozitive në jetën e tyre.

– *Mundëson të dëgjohet zëri i të rinjve*

Të rinjtë sikurse edhe grupet e tjera në shoqëri dhe në komunitetin vendor, dëshirojnë ta thonë mendimin e tyre për çështje të ndryshme, dëshirojnë të dëgjohet zëri i tyre dhe pikëpamjet e tyre të merren seriozisht. Duke u përfshirë, ata mund t'i shprehin mendimet e tyre në forume të ndryshme dhe kanë mundësi që mendimet e tyre të merren parasysh.

11. Thornton, S., *Clubcultures: music, media and subcultural capital*, Polity Press, Cambridge, 1995. Cituar sipas: Griffin, C., "Challenging assumptions about youth political participation: critical insights from Great Britain", Forbrig, J.(ed.), *Revisiting youth political participation. Challenges for research and democratic practice in Europe*, Këshilli i Evropës, 2005, faq. 152.

12. Kirby, P. dhe Bryson, S., *Measuring the magic? Evaluating and researching young people's participation in publik decision-making*, Carnegie Young People Initiative, Londër, 2002.



– *I stimulon të rinjtë të zhvillojnë shkathtësi të reja, të fitojnë më tepër vetëbesim*

Duke u përfshirë në iniciativa të ndryshme, të rinjtë mund të fitojnë njohuri të reja, të zhvillojnë shkathtësi, qëndrime dhe aftësi të reja drejtuese, dhe mund t'i formojnë aspiratat e tyre për të ardhmen. Kjo mund të ndodhë nëpërmjet aktiviteteve përkatëse edukative, si dhe nëpërmjet “mësimit duke vepruar”, duke kryer disa detyra konkrete. Mundësia për t'i shfrytëzuar këto shkathtësi dhe njohuritë e reja u ndihmon të rinjve ta përmirësojnë punën e tyre, pasi që mund t'i zbatojnë ato në mjedisin ku ata veprojnë.

– *U ndihmon të rriturve t'i dallojnë talentet dhe potencialin e të rinjve*

Duke punuar me të rinjtë dhe duke i mbështetur ata për arritjen e qëllimeve të tyre, të rriturit fitojnë mundësi që t'i luftojnë stereotipat e zakonshme për të rinjtë (për shembull, se të rinjve u mungojnë shkathtësitë e nevojshme ose se ata nuk janë të interesuar për jetën e komunitetit). Më pas, të rriturit shpeshherë e shohin se të rinjtë nuk janë më pak të talentuar, se ata duhet të mbështeten dhe t'u ofrohen mundësi për t'i demonstruar talentet e tyre.

– *I stimulon të rinjtë të marrin përgjegjësi për veprimet dhe vendimet e tyre*

Të rinjtë mësojnë se ai që merr vendime po ashtu mban përgjegjësi për pasojat (dhe e kundërta – ai/ajo që ka përgjegjësi mund të marrë edhe vendime). Kjo do të thotë se nëse të rinjtë dëshirojnë të marrin pjesë në nivel vendor, ata duhet të marrin përgjegjësi për veprimet e tyre.

– *U ndihmon të rinjve ta kuptojnë se si funksionon demokracia dhe si duhet të funksionojë ajo në jetën reale*

Në një sistem demokratik, njerëzit duhet të kenë mundësi të marrin pjesë në marrjen e vendimeve që ndikojnë në jetën e tyre. Këto procese mund të zhvillohen në kuadër të institucioneve ose të strukturave të ndryshme dhe në nivele të ndryshme, duke e përfshirë edhe nivelin vendor. Pjesëmarrja në nivel vendor mund të jetë një pikënisje e mirë për të rinjtë që të mësojnë më tepër se si funksionon demokracia, për kufizimet dhe potencialet e saj, dhe të eksperimentojnë me rregullat e demokracisë në mjedis të përshtatshëm.

– *Krijon hapësirë për të rinjtë që t'i shfrytëzojnë talentet dhe anët e tyre të fuqishme në dobi të gjithë komunitetit ose të organizatës*

Të rinjtë shpeshherë janë shumë të motivuar që t'i shfrytëzojnë dhe t'i zhvillojnë talentet dhe anët e tyre të fuqishme. Prandaj, është shumë me rëndësi të krijohen mundësi që ata t'i shfrytëzojnë këto talente për të mirën e përgjithshme, në dobi të komunitetit vendor dhe të ndjejnë kënaqësi nga kontributi i tyre.

– *U ndihmon të rriturve t'i kuptojnë nevojat dhe pikëpamjet e të rinjve*

Puna e drejtpërdrejtë me të rinjtë dhe përfshirja e tyre në procesin e konsultimit mund të krijojë mundësi për të fituar informacione të besueshme për nevojat e të rinjve. Mirëpo, disa hulumtues thonë se ka shumë pak dëshmi që vërtetojnë se konsultimi me të rinjtë për pikëpamjet dhe nevojat e tyre ofron informacione me kualitet më të mirë se sa burimet e tjera (siç janë konsultimet me prindërit ose mësuesit).¹³

– *I zhvillon shkathtësitë e të rriturve që të mund të punojnë në mënyrë efikase me të rinjtë*

Kur punojnë bashkë me të rinjtë, të rriturit kanë mundësi të mësojnë se si duhet të funksionojë puna me pjesëmarrje të përbashkët. Mirëpo, mund të ketë nevojë për mbështetje të konsiderueshme (për shembull, në formë të trajnimeve ose të literaturës për mësim individual) në mënyrë që të rriturit t'i zhvillojnë shkathtësitë e nevojshme për të punuar në mënyrë efikase me të rinjtë.

– *Krijon mundësi për të rriturit që ta shpërndajnë dijen dhe përvojën e tyre duke mos i marrë nën patronazh të rinjtë*

Të rinjtë jo gjithmonë dëshirojnë t'u thuhet se çka duhet të bëjnë. Ata duan të eksplorojnë dhe të mësojnë duke eksperimentuar. Ata, po ashtu i mbajnë sytë e çelur dhe mësojnë duke i vëzhguar ata që kanë më tepër përvojë dhe njohuri. Nëse të rriturit nuk i imponojnë vendimet e tyre, të rinjtë kanë më tepër gatishmëri që të mësojnë prej tyre, e me këtë edhe të përfitojnë nga përvoja e tyre.

13. Po aty, faq. 18.



- *Bën që procesi i vendimmarrjes të jetë më përfaqësues (reprezentativ)*

Të rinjtë përbëjnë një grup relativisht të madh në kuadër të komuniteteve vendore. Nëse vendimet që merren në nivel vendor ndikojnë mbi jetën e grupeve të ndryshme, të gjithë anëtarët duhet të kenë mundësi ta shprehin mendimin e tyre dhe ta formojnë rezultatin përfundimtar, ashtu që të plotësohen edhe nevojat e tyre. Prandaj, nëse të rinjtë marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes, ka më shumë gjasa që të merren parasysh pikëpamjet e tyre dhe të plotësohen nevojat e tyre.

- *Stimulon qasje dhe ide të reja për zgjidhjen e problemeve vendore dhe rajonale*

Tradicionalisht, të rinjtë gjithmonë kanë qenë të përfshirë në proceset vendimmarrëse, mirëpo vetëm deri në një masë të caktuar, për shkak se të rriturit e kanë pasur fuqinë dhe kanë udhëhequr. Mirëpo, është vërejtur se po të ftohen të rinjtë që të bashkëpunojnë për zgjidhjen e problemeve vendore që i prekin ata, kjo mund të ofrojë perspektivë të re ose ide të reja dhe të freskëta, dhe mund ta stimulojë të menduarit për zgjidhjen e problemeve jashtë mënyrave tradicionale. Idetë dhe metodat e tilla të reja, ndoshta përputhen më shumë me zhvillimin e shoqërisë bashkëkohore.

Detyrë:

Tashmë jeni duke punuar në pjesëmarrjen e të rinjve ose planifikoni ta bëni një gjë të tillë. E kuptoni rëndësinë e identifikimit të ndryshimeve pozitive që sjell përfshirja e të rinjve për komunitetin ose organizatën tuaj. Pyetjet dhe sugjerimet e mëposhtme do t’ju udhëzojnë në procesin e planifikimit të ndryshimit në mjedisin tuaj vendor.

Vërejtje: ky ushtrim nuk është i lidhur drejtpërdrejt me planifikimin ose me zbatimin e ndonjë projekti të veçantë. Ka për qëllim t’ju ndihmojë ta bëni ndryshimin e tillë.

1. *Kur fillon projekti/iniciativa juaj për pjesëmarrjen e të rinjve?*
2. *Në çfarë mase vlerësimi i projektit do t’i identifikojë ndryshimet që kanë qenë rezultat i përfshirjes së të rinjve në mjedisin tuaj?*
3. *Çka tjetër (përveç vlerësimit) ka nevojë ose mund të bëhet për t’i identifikuar në mënyrë përkatëse përfitimet nga pjesëmarrja e të rinjve në kontekstin tuaj?*
4. *A mendoni se i keni shkathtësitë dhe burimet e nevojshme (si për shembull, kohë të mjaftueshme) për ta bërë këtë punë? Në cilat mënyra mund të zhvillohen këto shkathtësi dhe të sigurohen këto burime?*
5. *Nëse po, atëherë:*
 - *vendosni në cilat fusha të veçanta të veprimit të komunitetit/organizatës dëshironi të përqendroheni kur do të bëhet identifikimi i përfitimeve nga pjesëmarrja e të rinjve;*
 - *bëni një plan hap pas hapi për atë se si do t’i identifikoni ato;*
 - *vendosni se për çfarë lloj mbështetjeje keni nevojë dhe ku mund ta merrni atë;*
 - *vendosni se kur dëshironi ta bëni këtë.*
6. *Nëse jo, atëherë:*
 - *konstatoni se kush mund ta bëjë këtë për ju;*
 - *vendosni së bashku se në cilat fusha të veçanta të veprimit të komunitetit/organizatës dëshironi të përqendroheni kur do të bëhet identifikimi i përfitimeve nga pjesëmarrja e të rinjve;*
 - *bëni së bashku një plan hap pas hapi për atë se si do të kryhen veprimet;*
 - *vendosni së bashku se për çfarë lloj mbështetjeje keni nevojë dhe ku mund ta merrni atë; vendosni se kur duhet të kryhen veprimet.*

Realizoni këtë.



Ata që merren me pjesëmarrjen e të rinjve ndonjëherë ballafaqohen me sfida dhe pengesa. Pengesat e tilla mund të jenë si rezultat i situatës së përgjithshme në komunitet, vlerave të pranuar në komunitet, çështjeve politike, ose arsyeve kulturore, etj. Hulumtuesit¹⁴ dhe praktikantët i përmendin këto gjëra:

- vlerat dhe shprehjet e ndryshme të të rinjve dhe të të rriturve;
- oraret e ndryshme kohore të të rinjve dhe të të rriturve;
- llojet e ndryshme të komunikimit;
- nivelet dhe llojet e ndryshme të përvojës;
- mungesa e shkathtësive;
- mbështetja e pamjaftueshme që u ofrohet të rinjve dhe të rriturve;
- mungesa e njohurive për atë se si të përfshihen të rinjtë në mënyrë të dobishme;
- metodat e ndryshme të mësimi të të rinjve dhe të të rriturve;
- vendi i të rinjve në hierarkinë shoqërore (në disa kultura, të rinjtë tradicionalisht kanë pozitë shumë të ulët dhe kanë shumë pak ndikim);
- marrja nën patronazh i të rinjve nga të rriturit;
- mosbesimi ndërmjet të rinjve dhe të rriturve;
- stereotipat negative (“të gjithë të rinjtë janë...”; “të gjithë të rriturit janë ...”), keqkuptimet dhe paragjykimet e ndërsjella;
- mungesa e procedurave dhe e politikave të përshtatura për të rinjtë në kuadër të organizatave (për shembull, sasia e dokumenteve formale që duhet të lexohen, të analizohen dhe të ndërmerret diçka në lidhje me to);
- mendimi se është detyra e dikujt tjetër të punojë për pjesëmarrjen e të rinjve;
- shpenzimet që ndërlidhen me pjesëmarrjen e të rinjve;
- vendi;
- mungesa e informacioneve;
- mungesa e burimeve të tjera të nevojshme (për shembull, më tepër kohë);
- përqindja e lartë e largimit të të rinjve nga puna;
- qasja e përshtatur për njerëzit me aftësi të kufizuara;
- mbledhjet e gjata;
- obligimet shkollore;
- interesat e tjera;
- mendimi se asgjë nuk do të ndryshojë, edhe sikur të marrë pjesë ndonjë i ri;
- të rinjtë që marrin pjesë nuk janë përfaqësues të të rinjve në përgjithësi.

Mendoni

- 1. Cilat janë pengesat më të mëdha për pjesëmarrjen e të rinjve në kontekstin tuaj vendor?*
- 2. Çka mund të bëni për t'i tejkaluar këto sfida?*
- 3. Kush mund të jenë aleatët tuaj në këtë proces?*

14. Shihni bibliografinë në fund të doracakut.



Pjesëmarrja e të rinjve akoma nuk është pranuar nga të gjitha komunitetet si diçka që është e dobishme për zhvillimin dhe koherencën e tyre. Ka arsye të ndryshme për këtë, ndërsa një shembull janë normat kulturore që i favorizojnë strukturat dhe marrëdhëniet hierarkike. Në komunitetet e tilla, të moshuarit luajnë rol shumë të rëndësishëm dhe konsiderohet si mosrespektim kur të rinjtë përpriqen të përfshihen në proceset vendimmarrëse. Në një kontekst të tillë mund të mos jetë e lehtë të punohet në pjesëmarrjen e të rinjve, mirëpo përvoja e organizatave për zhvillim që punojnë në mjedise të tilla tregon se ka mënyra efikase për t'u ballafaquar me sfidat e tilla.¹⁵ Ato e theksojnë rolin e organizatave të komunitetit dhe të organizatave rinore në përfshirjen e të rinjve në aktivitetet e tyre, në ndërmarrjen e dialogut konstruktiv ndërmjet të rinjve dhe të moshuarve dhe në krijimin e mjeteve për bashkëpunim efikas. Një qëllim tjetër i rëndësishëm në komunitetet që janë të bazuara në strukturat hierarkike dhe në nënshtimin ndaj autoritetit, është të punohet në qëndrimet e njerëzve që kanë pozita me fuqi (jo vetëm përfaqësuesit e pushtetit vendor, por edhe mësuesit, prindërit, etj.) në mënyrë që të rinjtë të shihen si partnerë.

→ 1.3. Parimet e pjesëmarrjes së të rinjve

Më herët në këtë kapitull u përmend se ka mënyra të ndryshme të interpretimit se ç'është pjesëmarrja e të rinjve dhe se ka ide të ndryshme se si të mbështetet përfshirja e tyre. Ndoshta është më lehtë që të arrihet pajtim për disa parime të cilat mundësojnë që pjesëmarrja e të rinjve në organizata ose në komunitete të ketë kuptim dhe të jetë efektive.

Mendoni

1. *Përpriquni të formuloni së paku tri praktika, zgjidhje dhe rekomandime që mund ta përforcojnë pjesëmarrjen e të rinjve në kontekstin e punës suaj.*
2. *A e keni të vështirë t'i shënoni praktikatat e tilla? Pse?*

Për t'i paraqitur tre parimet e para të pjesëmarrjes së të rinjve mund ta përdorim modelin e propozuar nga Mark Jansi dhe Kurt De Bakeri.¹⁶

Ky model thotë se:

- *Pjesëmarrja duhet të bazohet në sfidë*

Me "sfidë", këtu nënkuptohet ndonjë temë e cila duhet të jetë e ndërlidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me realitetin e përditshëm të të rinjve dhe e cila duhet të jetë tërheqëse ose interesante për ta;

- *Pjesëmarrja duhet të bazohet në kapacitet*

Që të mund të përfshihen, të rinjtë duhet të kenë disa njohuri dhe shkathtësi. Projektet ose iniciativat duhet të përputhen me aftësitë e të rinjve të interesuar dhe patjetër duhet të ketë mundësi që shkathtësitë që mungojnë të mund të zhvillohen në kuadër të projektit;


15. Shihni, për shembull, Golombek, S. Çka funksionon në pjesëmarrjen e të rinjve: studime të rastit, International Youth Foundation, 2002. (Golombek S. (ed.), What works in youth participation: case studies from around the world, International Youth Foundation, 2002.

16. Jans, M. dhe De Backer, K., op.cit., faq.5.



– *Pjesëmarrja duhet të bazohet në lidhje*

“Të rinjtë duhet të ndjehen të lidhur me njerëzit, komunitetet, idetë, lëvizjet dhe të mbështetur prej tyre”.¹⁷ Në esencë, kjo do të thotë se ata nuk janë të vetmuar dhe se mund të identifikohen dhe të llogarisin në mbështetje nga ndonjë grup ose institucion (të llogarisin në to edhe në kuptimin se do ta fitojnë hapësirën e nevojshme për mbështetje).



Përveç tre parimeve të lartpërmendura, përvoja e praktikantëve që punojnë në fushën e përfshirjes së të rinjve tregon se nëse dëshirohet të arrihet pjesëmarrje e rëndësishme e të rinjve, atëherë ajo duhet të jetë:

- *Në dispozicion për të gjithë të rinjtë, pa marrë parasysh prejardhjen, kombësinë, fenë, etj.*

Karta e rishikuar thotë se “parimet dhe format e ndryshme të pjesëmarrjes të promovuar në këtë Kartë vlejnjë për të gjithë të rinjtë pa diskriminim”.¹⁸ Pra qasja në pjesëmarrje nuk mund të kufizohet në bazë të faktorëve të tillë si ç janë për shembull, prej ku vjen dikush ose cilat janë bindjet e tij/saj;

– *Vullnetare*

Kjo do të thotë se pjesëmarrja nuk është e detyrueshme dhe se të rinjtë kanë të drejtë të mos marrin pjesë nëse vendosin ashtu. Ata po ashtu mund të vendosin edhe për shkallën dhe formën e përfshirjes së tyre;

– *Të ndërlidhet me nevojat e vërteta të të rinjve*

Është me rëndësi dhe motivuese për të rinjtë që të përfshihen në çështje që ndikojnë drejtpërdrejtë mbi ta; të arrijnë ndonjë ndryshim pozitiv, të kërkojnë zgjidhje për problemet e tyre, të përfitojnë shkathtësi të reja ose t'i zhvillojnë interesat dhe hobit e tyre. Në këtë mënyrë, ata, po ashtu ndjejnë se marrin përgjegjësi për jetën dhe komunitetet e tyre;

– *E vlerësuar*

Çdokush duhet ta dijë se kontributi i tij/saj është i rëndësishëm (edhe sikur ky kontribut të jetë i kufizuar);

– *E dobishme për të gjithë aktorët e përfshirë*

Pjesëmarrja kuptimplote sjell dobi për të rinjtë, të rriturit, organizatat dhe komunitetet, për shkak se bëhen ndryshime pozitive në fusha të ndryshme – në zhvillimin personal, në shkallët e efikasitetit, ndryshimin shoqëror, etj.;

17. Po aty., fq. 6.

18. Karta e Rishikuar Evropiane për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale, Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës, maj 2003.



– *Të ofrojë forma të ndryshme të përfshirjes*

Nuk ekziston një formë e vetme e pjesëmarrjes që është e përshtatshme për të gjithë të rinjtë. Prandaj është e rëndësishme që të rinjve t’u ofrohen mënyra të ndryshme të përfshirjes ashtu që ata të mund ta zgjedhin atë që është më e rëndësishme dhe më interesante për ta;

– *E mbështetur me burimet e nevojshme*

Në qoftë se burimet nuk janë në dispozicion, atëherë qasja në pjesëmarrje bëhet e kufizuar, e për disa, edhe e pamundur. Duhet të ofrohen burimet e nevojshme, sikurse koha, burimet njerëzore, mjetet financiare, njohuritë, transporti, etj.;

– *E bazuar në partneritet të vërtetë ndërmjet të rriturve dhe të rinjve*

Partneriteti nënkupton të komunikohet për pritjet dhe frikët, dhe të ndahet pushteti dhe përgjegjësia. Kjo nuk nënkupton gjithmonë ndarjen e të gjitha fushave të punës dhe të përgjegjësive në mënyrë të barabartë, por ndarjen e këtyre fushave në bazë të asaj se çka duan, për çka kanë nevojë dhe çka mund të kontribuojnë të dyja palët;

– *Transparente*

Është e nevojshme që të gjitha palët e përfshira në proces të jenë të vetëdijshme për qëllimin e pjesëmarrjes dhe për kufizimet e saj. Ato, po ashtu duhet ta kenë të qartë se çfarë lloj ndikimi mund të kenë të rinjtë, çka mund të ndryshohet e çka jo;

– *Të vendoset si parim i politikës e jo vetëm si një teknikë e thjeshtë¹⁹*

“Pjesëmarrja nuk është një teknikë apo një formë e përfshirjes. Ajo është e ndërlikuar dhe përfshin fusha, nivele dhe dimensione të ndryshme. Prandaj, duhet të jetë element transversal²⁰ në kuadër të politikave dhe të strategjive të ndryshme të planifikuara në kuadër të organizatave ose të komuniteteve”;

– **Të jetë e këndshme**

Në përgjithësi (pa marrë parasysh moshën), ka më tepër gjasa që njerëzit të ndërmarrin aksione në bazë vullnetare nëse puna është e këndshme. Puna “e këndshme” nuk nënkupton patjetër argëtim, por thjesht diçka që sjell përmbushje ose kënaqësi nga kryerja e saj.

Mendoni

1. Cilat nga parimet e pjesëmarrjes së të rinjve që u përmendën më lartë tashmë janë të pranishme në punën e organizatës/komunitetit tuaj?
2. Cilat parime duhet të zbatohen dhe kush duhet ta ketë përgjegjësinë për ta bërë këtë?
3. Si mund të kontribuoni për futjen në përdorim të këtyre parimeve?

19. Forbrig, J., op.cit.faq.16.

20. Transversale nënkupton se ka të bëjë me aspektet dhe fushat e ndryshme të jetës.



PJESËMARRJA ËSHTË...



→ 1.4. Parakushtet për pjesëmarrjen e të rinjve

Pjesëmarrja nuk ndodh vetvetiu; nuk zhvillohet kot më kot. Duhet të plotësohen disa kushte që të mund të praktikohet pjesëmarrja kuptimplote rëndësishme. Këto, të ashtuquajtura parakushte për pjesëmarrjen e të rinjve, në mënyrë të thjeshtë mund të sqarohen si praktika ose si vlera që duhet të ekzistojnë, ose duhet të zhvillohen, në komunitetin ose në organizatën që është e interesuar ta përforcojë përfshirjen e të rinjve. Nuk ekziston një listë fikse e parakushteve që mund të përdoret si listë kontrolluese nga ata që përpiqen të arrijnë pjesëmarrje domethënëse; ato duhet të përkufizohen për çdo kontekst të veçantë nga aktorët që veprojnë në atë kontekst dhe që e njohin atë shumë mirë.



Ja disa shembuj të kushteve që e inkurajojnë pjesëmarrjen e të rinjve:

- aftësia për ta trajtuar në mënyrë konstruktive një situatë konflikti;
- qasja në pjesëmarrje për ata që nuk janë anëtarë të asnjë strukture;
- qasja në informacione;
- qasja në teknologji;
- sektori aktiv i të rinjve;
- vetëdija për vlerën e pjesëmarrjes;
- duhet të plotësohen nevojat elementare (ushqimi, pija, veshja, vendbanimi, etj.);
- barazia (mendimet e të rriturve dhe ato të të rinjve kanë peshë të njëjtë);
- partneriteti ekzistues ndërmjet të rinjve dhe të rriturve;
- burimet financiare;
- mundësia për ta zgjedhur fushën ose formën më adekuate ose më interesante të përfshirjes;
- nevojat e identifikuar lokale;
- përfshirja e aktorëve të ndryshëm;
- njohja e gjendjes, identitetit, stilit të jetës, etj. të të rinjve në komunitet;
- korniza ligjore;
- niveli minimal i arsimit;
- gatishmëria për të mësuar, qoftë edhe nga gabimet personale;
- infrastruktura për pjesëmarrje;
- politikat e përshtatshme për pjesëmarrje;
- siguria fizike dhe emocionale;
- përfaqësimi i interesave të të rinjve të pa favorizuar;
- e drejta për të marrë pjesë;
- shkathtësi dhe kompetenca për menaxhim dhe proceset e pjesëmarrjes;
- kuptim për atë se ç'është pjesëmarrja kuptimplote (për dallim nga përfaqësimi sipërfaqësor/tokenizmi);
- gatishmëria për të marrë pjesë ose për të kryer punë pjesëmarrëse;
- gatishmëria për ta ndarë fuqinë dhe kontrollin.

Për pjesëmarrje kuptimplote të të rinjve, duhet të plotësohen të gjitha parakushtet e lartpërmendura, përndryshe kualiteti i pjesëmarrjes nuk do të jetë aq i lartë sa mund të jetë në kushte të veçanta. Prandaj, kur qëllimi është të arrihet një nivel efikas i përfshirjes së të rinjve në një organizatë ose në një komunitet, ka nevojë të kontrollohet se në çfarë mase janë plotësuar këto parakushte dhe cilat mangësi duhet të shqyrtohen më pas.

Detyrë:

1. Kthehuni te lista e parakushteve për pjesëmarrjen e të rinjve.
2. Identifikoni parakushtet që tashmë janë plotësuar në organizatën, komunitetin ose projektin tuaj.
3. Përshkruani se në çfarë mënyre ose në çfarë mase janë plotësuar ato.
4. Vendosni se cilat prej tyre duhet të zbatohen edhe më tepër.
5. Mendoni së bashku me të tjerët se si mund të arrihet kjo dhe kush mund ta bëjë atë.



6. *Identifikoni parakushtet të cilat akoma nuk janë plotësuar në organizatën, komunitetin ose projektin tuaj.*
7. *Përpiquni të mendoni se cilat mund të jenë shkaqet se pse këto parakushte nuk janë plotësuar akoma.*
8. *Mendoni së bashku me të tjerët se si mund të arrihet kjo dhe kush mund ta bëjë atë.*
9. *Bëni një plan real të veprimit për veten tuaj, ku do të planifikoni se si do të kontribuoni ju personalisht në zbatimin e parakushteve që janë të nevojshme të arrihet të nxënit të rëndësishëm për të rinjtë .*

→ 1.5. Format e pjesëmarrjes së të rinjve

Ka mënyra të shumta se si të rinjtë mund të marrin pjesë në marrjen e vendimeve për çështjet që janë të rëndësishme për ta dhe për gjithë komunitetin vendor. Disa forma të pjesëmarrjes duket se janë më tërheqëse për të rinjtë se format e tjera. Disa mund të jenë më relevante në kontekst të caktuar se sa format e tjera dhe secila e ka potencialin e saj, sikurse edhe kufizimet e veta.

Format më të shpeshta të pjesëmarrjes së të rinjve që mund të vërehen në shoqëritë bashkëkohore evropiane janë këto:

- puna vullnetare;
- pjesëmarrja në format e ndryshme të arsimit joformal;
- edukimi i moshatarëve–përfshirja e të rinjve në edukimin e moshatarëve të tyre (për shembull, programet për promovim të shëndetit, fushatat për ngritjen e vetëdijes, etj.);
- pjesëmarrja aktive në një organizatë/klub dhe marrja e përgjegjësisë për disa fusha të veprimit të saj/tij;
- këshillat, parlamentet, forumet, bordet e të rinjve dhe strukturat e tjera të të rinjve – mënyra tradicionale për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes në kuadër të autoriteteve ndërkombëtare, kombëtare, rajonale ose vendore, shkollave, klubeve, OJQ-ve, etj.;
- sistemet për bashkë-menaxhim që ekzistojnë në disa institucione (për shembull, në Drejtorinë për Rini dhe Sport të Këshillit të Evropës), ku vendimet merren nga përfaqësuesit e të rinjve ose të organizatave rinore dhe nga përfaqësuesit e autoriteteve në baza të barabarta;
- konsultimet – që përdoren në proceset e vendimmarrjes për t’i shprehur nevojat dhe shqetësimet dhe për të dhënë propozime;
- nivelet e ndryshme të pjesëmarrjes së të rinjve në projekte dhe aktivitete (të organizuara, e po ashtu edhe të paorganizuara);
- aktivitetet e fushatave;
- anëtarësia në partitë politike, sindikatat, grupet e interesit;
- marrja pjesë në zgjedhje (edhe për të votuar edhe për t’u kandiduar).

Kur shihet se sa njerëz të rinj në fakt janë të përfshirë në format e lartpërmendura të pjesëmarrjes, bëhet e qartë se numrat shënojnë një rënie të vazhdueshme. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se të rinjtë janë duke e humbur interesimin për të marrë pjesë. Në fakt, “shumica tregojnë dëshirë të qartë për të marrë pjesë dhe për të ndikuar në zgjidhjet që bëhen nga shoqëria, mirëpo duan që këtë ta bëjnë më tepër në bazë individuale dhe personale, jashtë strukturave dhe mekanizmave të vjetra të pjesëmarrjes”.²¹ Ky përfundim ka pasoja shumë të rëndësishme për praktikantët që punojnë në pjesëmarrjen e të rinjve –të rinjtë duhet të kenë mundësi të eksperimentojnë dhe t’i gjejnë mënyrat më të përshtatshme për t’u përfshirë, edhe nëse kjo nënkupton përqendrimin në format jo tradicionale të pjesëmarrjes. Tani për tani nuk ka definicion të qartë për atë se çka nënkuptohet saktë me shprehjen “forma të reja të pjesëmarrjes”, mirëpo burimet e ndryshme i përmendin këto shembuj:

21. Libri i bardhë i BE-së, “Stimul i ri për të rinjtë evropianë”, COM(2001) 681 përfundimtare, faq. 10.

- rrjetet e bashkëmoshatarëve;
- forumet për diskutim;
- nënshkrimi i peticioneve;
- pjesëmarrja në të ashtuquajturat “lëvizje të reja shoqërore”;
- grupet për mbështetje;
- bojkotimi i produkteve;
- demonstratat;
- takimet ndërkombëtare;
- përdorimi i internetit për mbledhjen e informatave, shprehjen e pikëpamjeve, ose për të ndikuar në proceset e vendimmarrjes.

Individët, organizatat dhe komunitetet që e promovojnë pjesëmarrjen e të rinjve dhe që kërkojnë mënyra të reja për përfshirjen e të rinjve duhet ta kenë shumë të qartë se cilat janë motivet e tyre. A duan të arrijnë numër më të madh të të rinjve të përfshirë, ashtu që statistika zyrtare të duket më e mirë? Apo ndoshta duan t’i gjejnë mënyrat më të mira dhe më kuptimplote që të rinjtë të përfshihen dhe të kontribuojnë? Apo ndoshta ka arsye të tjera? Me sa shihet, nuk duhet përqendruar vetëm në atë që të përfshihen sa më shumë të rinj që është e mundur, por edhe në mënyrat që sigurojnë cilësi më të mirë të pjesëmarrjes.

Mendoni

1. Cilat forma të pjesëmarrjes së të rinjve janë më të shpeshta në komunitetin ose në organizatën tuaj?
2. Pse mendoni se është kështu?
3. A mendoni se krijimi i kushteve adekuate për format e tjera të pjesëmarrjes së të rinjve në kontekstin tuaj do t’i inkurajonte të rinjtë për pjesëmarrje më efikase?Pse?
4. Sipas mendimit tuaj, në çfarë mase mospjesëmarrja e të rinjve mund të konsiderohet si formë e pjesëmarrjes? Pse mendoni se disa të rinj nuk marrin pjesë dhe çka dëshirojnë ata të arrijnë me këtë?
5. A ju kujtohen forma të tjera të pjesëmarrjes nga ato që u përmendën më lartë?



Kapitulli 2

Karta e Rishikuar Evropiane për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale

→ 2.1. Hyrje

Ç'është Karta e Rishikuar Evropiane për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale?

Pjesëmarrja e të rinjve ka prioritet të lartë në punën e Këshillit të Evropës, veçanërisht në Drejtorinë për Rini dhe Sport, dhe në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës. Janë ndërmarrë iniciativa të shumta për ta promovuar pjesëmarrjen e të rinjve dhe për t'i pajisur me mjetet dhe shkathtësitë e nevojshme ata që kanë nevojë për to. Shembuj për këtë janë sistemi për bashkë-menaxhim,²² trajnimet dhe aktivitetet e tjera edukative, aktivitetet hulumtuese dhe mbështetja financiare për projektet rinore që e promovojnë pjesëmarrjen.²³

Një mjet shumë i veçantë për ta promovuar pjesëmarrjen e të rinjve në nivel vendor dhe rajonal është Karta e Rishikuar Evropiane për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale, dokument ky i miratuar nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës në maj të vitit 2003. Karta ofron ide dhe instrumente konkrete që mund të shfrytëzohen në kontekstin vendor nga ata që janë të përfshirë në punën pjesëmarrëse – të rinjtë, organizatat rinore, autoritetet vendore, etj. Megjithatë, ajo nuk ofron mostra të gatshme për t'u përdorur, për shkak se nevojat dhe rrethanat dallojnë shumë anembanë Evropës. Prandaj, Karta duhet të shihet si një burim i rekomandimeve dhe si inspirim, e jo si recetë e rreptë për promovimin e pjesëmarrjes së të rinjve në nivelet vendore dhe rajonale.

-
22. Nëpërmjet partneritetit unik ndërmjet përfaqësuesve të organizatave rinore dhe qeverive, Këshilli i Evropës, krijoi një sistem të bashkë-menaxhimit në kuadër të Drejtorisë për Rini dhe Sport, i cili u ofron të rinjve mundësinë ta thonë mendimin e tyre gjatë formulimit dhe zbatimit të politikave për të rinjtë të Këshillit të Evropës. Më tepër informata për bashkë-menaxhimin mund të gjenden në Kapitullin 7 të këtij doracaku.
23. Për çdo vit, Fondacioni evropian i të rinjve ofron mbështetje financiare për projekte të shumta që e promovojnë pjesëmarrjen e të rinjve në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar në Evropë.



Ç'është Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës?

Karta e Rishikuar Evropiane për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale është iniciuar dhe është miratuar nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, njëri nga institucionet politike të kësaj organizate. Kongresi i jep këshilla Komitetit të Ministrave për çështje të ndryshme të politikave lokale dhe rajonale. Ai i tubon të zgjedhuri e autoriteteve vendore dhe rajonale nga vendet anëtare të Këshillit të Evropës.

Roli kryesor i Kongresit është ta promovojë demokracinë në nivel vendor dhe rajonal, për shkak se demokracia fillon në qytetet dhe në fshatrat e Evropës. Siç ka thënë Halvdan Skardi (Halvdan Skard), Kryetari i Kongresit: “Kongresi është shndërruar në njërin nga organet kryesore për ruajtjen e demokracisë vendore dhe rajonale anëmbanë Evropës dhe partner kryesor politik në dialogun me qeveritë.”

Aktivitetet e Kongresi përqendrohen në:

- mbështetjen e futjes në përdorim dhe zhvillimit të vetëqeverisjes në nivelet vendore dhe rajonale;
- avancimin e dialogut konstruktiv ndërmjet autoriteteve vendore dhe rajonale dhe atyre kombëtare;
- monitorimin e demokracisë vendore në rajonet dhe komunat evropiane;
- monitorimin e zgjedhjeve vendore dhe rajonale;

Kongresi përbëhet nga dy dhoma: Dhoma e Autoriteteve Lokale dhe Dhoma e Rajoneve. 318 anëtarë dhe 318 zëvendësit e të dy dhomave i përfaqësojnë 200.000 komuna dhe rajone të Evropës dhe ata emërohen nga shoqatat e tyre kombëtare të autoriteteve vendore dhe rajonale.

Katër komitetet statusore, që trajtojnë çështje të ndryshme, përgatisin raporte dhe tekste politike për odat. Një nga ato është Komiteti për kulturë dhe arsim, i cili është përgjegjës për çështjet rinore.

Kongresi angazhohet në mënyrë aktive që të sigurojë shpërndarje sa më të gjerë të mundshme të Kartës së rishikuar. Edhe pse Karta e rishikuar është përgatitur nga Kongresi, përgjegjësinë për zbatimin e këtij dokumenti e kanë autoritetet vendore dhe rajonale.

Detyrë:

1. *Gjeni se kush janë delegatët e vendit tuaj në Dhomën e Autoriteteve Lokale dhe në Dhomën e Rajoneve (lista gjendet në ueb-faqen e Kongresit).*
2. *Kontaktoni ata dhe kërkoni më tepër informacione për atë se çka është bërë në vendin tuaj për ta promovuar dhe për ta zbatuar Kartën e rishikuar, dhe çfarë veprimesh të tjera janë planifikuar.*
3. *Pyetni se si mund të kontribuoni për promovimin dhe zbatimin e kartës.*
4. *Mendoni se si mund të përfshihen ta inkurajoni përfshirjen e organizatës suaj, komunitetit tuaj vendor ose autoriteteve tuaja vendore.*

Si dhe pse u rishikua Karta?

Karta Evropiane për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Komunale dhe Rajonale (emri origjinal i dokumentit) u miratua në mars të vitit 1992 nga Konferenca e Përhershme e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës (e cila në vitin 1994 u riemërtua në “Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Evropë”). Përkundër potencialit të tij, ky dokument as që u bë shumë i njohur, e as nuk u shfrytëzua sa duhet nga vendet anëtare të Këshillit të



Evropës.²⁴ Dhjetë vite më vonë, Kongresi dhe Drejtoria për Rini dhe Sport, e organizuan konferencën “Të rinjtë – aktorë në qytetet dhe rajonet e tyre” në Krakov (7-8 mars 2002), për ta festuar 10 vjetorin e Kartës evropiane dhe për t’i vlerësuar sukseset dhe sfidat e pjesëmarrjes së të rinjve gjatë dekadës së parë të ekzistencës së Kartës²⁵. Konferenca po ashtu u përqendrua në promovimin e mëtutjeshëm të pjesëmarrjes së të rinjve dhe në praktikën e mira në këtë fushë.

Në deklaratën e saj përfundimtare, konferenca formuloi një kërkesë për ndryshim të Kartës evropiane, për shkak se u përfundua se dispozitat e Kartës nuk i pasqyronin sa duhet zhvillimet e reja në shoqërinë bashkëkohore.

Mendoni

1. *Cilat janë zhvillimet e reja shoqërore, politike, ekonomike ose teknologjike që kanë ndikim në jetën, nevojat dhe aspiratat e të rinjve?*
2. *Cilat nga këto zhvillime mund të kenë ndikim të madh në pjesëmarrjen e të rinjve (edhe në nivel global edhe në komunitetin ose në organizatën tuaj)?*

Si rezultat i kërkesës, u formua një grup ekspertësh që përbëhej nga përfaqësues të Kongresit dhe të Këshillit Konsultativ për Çështje Rinore të Këshillit të Evropës²⁶, dhe ekspertë të tjerë, si dhe filloi puna për rishikimin e Kartës. Karta e Rishikuar Evropiane për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale u miratua nga Kongresi në maj të vitit 2003 (si Shtojcë e Rekomandimit 128).

Karta e rishikuar i trajton zhvillimet e reja që ndikojnë në jetën e të rinjve në shoqërinë bashkëkohore evropiane, siç është ndikimi gjithnjë e më i madh i internetit mbi të rinjtë, papunësia e të rinjve, ose pasojat e pasigurisë urbane. Pastaj, ajo përmban edhe një analizë të politikave vendore që i trajtojnë çështjet që janë të rëndësishme për të rinjtë dhe propozon mënyra me të cilat këto politika mund ta mbështesin pjesëmarrjen e të rinjve në nivel vendor.

Karta e rishikuar në gjuhë të ndryshme

Karta është publikuar në dy gjuhë zyrtare të Këshillit të Evropës – anglisht dhe frëngjisht – mirëpo ekzistojnë edhe përkthime në disa gjuhë të tjera evropiane²⁷. Procesi i përkthimit të Kartës në të gjitha gjuhët zyrtare të Këshillit të Evropës është duke vazhduar, ashtu që në të ardhmen në të do të mund të kenë qasje të gjitha komunitetet vendore anembanë Evropës.

24. Doorley, J., “Synthesis report on the work of the Council of Europe’s Directorate of Youth and Sport in the field of youth participation and democratic citizenship between 2003 and 2005 and an analysis of current trends in youth participation and recommendations for future action”, CDEJ (2006) 4, Strasburg, janar 2006, faq. 6.

25. Hyrje në Kartën e Rishikuar Evropiane për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale, Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, maj 2003, faq. 5.

26. Këshilli Konsultativ për Çështje Rinore është organ statusor i Këshillit të Evropës, që përbëhet nga 30 përfaqësues të rrjeteve dhe të organizatave joqeveritare rinore. Roli i tij kryesor është t’i formulojë rekomandimet për politikën dhe çështjet programore në sektorin e të rinjve të Këshillit të Evropës.

27. Përkthimet ekzistuese mund të gjenden në ueb-faqen e Kongresit në: www.coe.int/t/congress ose në ueb-faqen e Qendrës evropiane të dijes për politikën rinore në: www.training-youth.net dhe www.youth-knowledge.net/INTEGRATION/EKC/GP/charter.html.



Karta e rishikuar është dokument zyrtar i Këshillit të Evropës dhe për këtë arsye është shkruar në stil formal që mund të duket si i vështirë për t'u kuptuar nga ata që nuk janë mësuar të punojnë me dokumente ligjore e veçanërisht nga të rinjtë. Prandaj edhe është krijuar versioni i Kartës së rishikuar me "gjuhë të thjeshtë", kur parimet dhe rekomandimet janë ilustruar me shembuj dhe janë sqaruar me një gjuhë të thjeshtë "të kuptueshme nga të rinjtë". Ky version në gjuhë të thjeshtë është në dispozicion në CD dhe onlajn.²⁸ që të rinjtë të njoftohen me Kartën në një mënyrë më pak formale.

Detyrë:

1. Zbuloni se a është përkthyer Karta e rishikuar në gjuhën tuaj (edhe versioni zyrtar edhe ai në gjuhën e thjeshtë).
2. Nëse jo, a dini ndonjë organizatë, institucion ose grup që do të ishte i gatshëm ta përkthente Kartën në gjuhën tuaj? A do të ishit i gatshëm të përfshiheni në organizimin e përkthimit?
3. Kontaktoni partnerët e mundshëm dhe planifikoni procesin e përkthimit.
4. Zbatoni planin tuaj.
5. Dërgojeni versionin e përkthyer në Drejtorinë për Rini dhe Sport të Këshillit të Evropës (youth@coe.int) dhe në Sekretariatit e Kongresit (congress.web@coe.int) që të jetë në dispozicion edhe për njerëzit e tjerë.
6. Nëse ekziston përkthimi, atëherë zbuloni se:
 - ku mund të merren kopje të shtypura të Kartës në vendin tuaj;
 - a është përkthimi i Kartës në dispozicion onlajn. Nëse po, në cilat ueb-faqe?
7. Porositni aq kopje të Kartës sa keni nevojë.
8. Zbuloni sa e ekziston versioni i Kartës në gjuhë të thjeshtë në gjuhën tuaj dhe a mund të keni qasje në të.

Statusi ligjor i Kartës

Rekomandimi Rec (2004)13 i Komitetit të Ministrave që e përkrah zbatimin e Kartës së rishikuar është miratuar nga të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Evropës.²⁹ Në praktikë, kjo do të thotë se vendet anëtare kanë përgjegjësi morale ta zbatojnë Kartën e rishikuar, edhe pse rekomandimet e saj nuk paraqesin detyrim ligjor. Prandaj, Karta duhet të shihet si përmbledhje parimesh, praktikash më të mira dhe udhëzimesh për ta përmirësuar pjesëmarrjen e të rinjve në nivelet vendore dhe rajonale.

28. Gjetet në: www.youth-knowledge.net/INTEGRATION/EKC/GP/charter.html.

29. Në kohën e shtypjes së doracakut (vjeshtë 2007), Këshilli i Evropës kishte 47 vende anëtare: Shqipëria, Andorra, Armenia, Austria, Azerbajxhani, Belgjika, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Qiproja, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjeorgjia, Gjermania, Greqia, Hungaria, Islanda, Irlanda, Italia, Letonia, Lihtenshtajni, Lituania, Luksemburgu, Malta, Moldavia, Monakoja, Mali i Zi, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Rumania, Federata Ruse, San Marinoja, Serbia, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Zvicra, "Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë", Turqia, Ukraina, Mbretëria e Bashkuar. Lista e përditësuar mund të gjendet në: www.coe.int/T/e/com/about_coe/member_states/default.asp.



→ 2.2 Përmbajtja e Kartës

Karta përbëhet prej tri pjesëve që kanë të bëjnë me aspektet e ndryshme të pjesëmarrjes së të rinjve në nivel vendor.

Pjesa I – Politikat sektoriale

Pjesëmarrja aktive e të rinjve varet nga një numër faktorësh të brendshëm, siç është motivimi, nevojat dhe aspiratat, dhe faktorësh të jashtëm, siç është situata, infrastruktura dhe sistemet ekzistuese. Politikat vendore luajnë rol të fuqishëm në krijimin e kushteve dhe të infrastrukturës adekuate që të rinjtë të marrin pjesë në jetën e shkollave, organizatave ose të komuniteteve të tyre dhe për këtë arsye Karta e rishikuar përmban analizë të politikave të fushave të ndryshme dhe sugjeron një numër masash konkrete që mund ta ofrojnë mbështetjen e nevojshme për përfshirjen e të rinjve. Megjithatë, këto sugjerime mbeten të përgjithshme, në mënyrë që komunitetet anembanë Evropës të mund t'i gjejnë mënyrat më të përshtatshme për t'i futur në praktikë këto masa, duke e marrë parasysh mjedisin dhe kontekstin e tyre vendor.

Fusha e politikës	Rekomandimet për autoritetet vendore dhe rajonale
Politikat për sportin, kohën e lirë dhe jetën shoqërore	<ul style="list-style-type: none"> – të mbështeten aktivitetet që realizohen nga shoqatat dhe organizatat rinore, grupet e të rinjve dhe qendrat e komunitetit; – të mbështeten organizatat që i trajtojnë personat që punojnë me të rinjtë, ndihmësit dhe drejtuesit e klubeve dhe të organizatave rinore; – t'i inkurajojnë shoqatat që ta promovojnë pjesëmarrjen e të rinjve në organet e tyre statusore.
Politika për të nxitur punësimin e të rinjve dhe për ta luftuar papunësinë	<ul style="list-style-type: none"> – të zhvillojnë politika dhe programe për luftimin e papunësisë së të rinjtë dhe për nxitjen e mundësive për punësimin e të rinjve; – të krijojnë qendra vendore të punësimit; – ta mbështesin organizimin e aktiviteteve afariste nga të rinjtë; – ta inkurajojnë eksperimentimin me ekonominë shoqërore, iniciativat ose sipërmarrjet vetë mbështetëse në komunitet.
Mjedisi urban dhe vendbanimi, politikat e strehimit dhe transporti	<ul style="list-style-type: none"> – të krijojnë kushte për zhvillimin e politikës së mjedisit urban të bazuar në mjedis jetese më të integruar dhe më pak të fragmentarizuar; – të realizohen politika të strehimit dhe të zhvillimit urban; – të përpilojnë programe për një mjedis më të favorshëm; – të zhvillojnë shërbime vendore të informimit për strehimin; – të zhvillojnë skema vendore për t'u ndihmuar të rinjve për të pasur shtëpi; – t'i përfshijnë të rinjtë në organizimin e transportit publik; – t'i mbështesin iniciativat që kërkojnë të ofrojnë shërbime të transportit rural.



<p>Politika të edukimit dhe të trajnimit të cilat e nxisin pjesëmarrjen e të rinjve</p>	<ul style="list-style-type: none"> — ta inkurajojnë në mënyrë aktive pjesëmarrjen e të rinjve në jetën e shkollës; — të ofrojnë mbështetje financiare dhe mbështetje të tjera (për shembull, hapësira për mbledhje) që t'u mundësojnë të rinjve të themelojnë shoqata demokratike të nxënësve në shkolla; — të sigurojnë konsultimin e vazhdueshëm të nxënësve dhe të shoqatave të tyre për programet mësimore (kurrikulat) dhe zhvillimin e tyre.
<p>Politikat për mobilitet dhe shkëmbime</p>	<ul style="list-style-type: none"> — t'i mbështesin grupet dhe shoqatat që e favorizojnë mobilitetin e të rinjve; — t'i inkurajojnë të rinjtë, shkollat dhe organizatat e tyre që të marrin pjesë në rrjetet dhe shkëmbimet ndërkombëtare; — t'i përfshijnë përfaqësuesit e të rinjve në komitetet e binjakëzimit ose në organet e tjera që i koordinojnë shkëmbimet e tilla.
<p>Politikat shëndetësore</p>	<ul style="list-style-type: none"> — të krijojnë ose të zhvillojnë mekanizma institucionalë për konsultime ndërmjet të rinjve, organizatave dhe grupeve të tjera që merren me mirëqenien shoqërore dhe promovimin e shëndetit; — të paraqesin, të zhvillojnë ose të promovojnë politika vendore të informimit vendor dhe ambiente këshillimesh për të rinjtë që kanë probleme me duhanin, alkoolin ose abuzimin e drogave; — të zhvillojnë politika të veçanta për trajnim për punëtorët socialë dhe ata që punojnë me të rinjtë, si dhe drejtuesit e organizatave që janë të përfshirë në aktivitetet parandaluese dhe rehabilituese; — t'i intensifikojnë fushatat e informimit dhe masat parandaluese që kanë të bëjnë me sëmundjet seksualisht të transmetueshme.
<p>Politika të barazisë gjinore</p>	<ul style="list-style-type: none"> — t'i mbështesin meshkujt e rinj dhe femrat e reja që të marrin pozita me përgjegjësi në jetën profesionale, shoqata, politike, si dhe në autoritetet vendore dhe rajonale; — të promovojnë politikë edukative për barazi ndërmjet meshkujve dhe femrave duke hartuar plan që ka për qëllim eliminimin e pabarazive dhe duke zbatuar dhe vlerësuar masa që promovojnë mundësi të barabarta; — t'u mundësojnë vajzave dhe grave të reja të marrin informacion të veçantë mbi kurset e trajnimit; — t'u ofrojnë vajzave dhe grave të reja grante dhe kurse të veçanta; — të fusin kuota për vende të rezervuara për femrat në institucionet që merren çështjet publike — të prezantojnë masa financiare për shërbimet shoqërore
<p>Politikat e veçanta për zonat rurale</p>	<ul style="list-style-type: none"> — të sigurojnë se politikat e sektorëve të ndryshëm i reflektojnë dhe i trajtojnë nevojat e veçanta të të rinjve që jetojnë në zonat rurale; — të ofrojnë mbështetje për organizatat rinore dhe organizatat e tjera të komunitetit që janë aktive në zonat rurale.



<p>Politikat për qasjen në kulturë</p>	<ul style="list-style-type: none"> – të miratojnë politika që u mundësojnë të rinjve të bëhen aktorë të kulturës; – të miratojnë politika që do ta lehtësojnë qasjen në njohuri, realizim praktik të kulturës dhe të veprimtarisë krijuese.
<p>Politika për ta luftuar dhunën dhe krimin</p>	<ul style="list-style-type: none"> – t’i përfshijnë të rinjtë në këshillat për parandalimin e krimit; – të punojnë me të rinjtë të cilët rrezikojnë të përfshihen në krim ose të cilët tashmë janë të përfshirë në krim; – ta luftojnë dhunën raciste; – ta trajtojnë problemin e dhunës në shkolla; – të kontribuojnë në krijimin e rrjeteve ose të projekteve që e promovojnë mungesën e dhunës dhe tolerancën; – t’i mbrojnë të rinjtë nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual; – të sigurojnë struktura që ofrojnë mbështetje për viktimat e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual.
<p>Politikat antidiskriminuese</p>	<ul style="list-style-type: none"> – t’i promovojnë në mënyrë aktive të drejtat e njeriut; – t’i përmirësojnë ligjet anti-diskriminuese; – të sigurojnë qasje të barabartë për të gjithë qytetarët në vendet publike, trajnimin profesional, shkollim, banim dhe aktivitetet kulturore, etj.; – ta përfshijnë edukimin për dialogun ndërfaqor, multikulturor, antiracist dhe antidiskriminues si pjesë e programit mësimor (kurrikulës) të shkollës.
<p>Politikat mbi seksualitetin</p>	<ul style="list-style-type: none"> – ta promovojnë edukimin këshillues seksual nëpër shkolla; – t’i mbështesin organizatat dhe shërbimet që ofrojnë informacion në lidhje me marrëdhëniet dhe metodat seksuale; – ta mbështesin punën në grupe moshatarësh në këtë fushë.
<p>Politikat për qasjen në të drejtat dhe në ligj</p>	<ul style="list-style-type: none"> – të shpërndajnë informacion për të drejtat e të rinjve; – t’i mbështesin shërbimet që janë hartuar të punojnë në zbatimin e të drejtave të të rinjve; – t’u mundësojnë të rinjve të marrin pjesë në hartimin e rregullave të reja.

Pjesa II – Instrumentet për pjesëmarrje të të rinjve

Pjesa e ardhshme e Kartës fokusohet në idetë dhe në mjetet që mund të shfrytëzohen nga autoritetet vendore për ta përforcuar pjesëmarrjen e të rinjve. Ato kanë të bëjnë me fushat konkrete në të cilat pjesëmarrja e të rinjve mund të zbatohet në mënyrë kuptimplote.



Fusha1: Trajnimi për pjesëmarrjen e të rinjve

- trajnime profesionale për mësuesit dhe punëtorët që punojnë me të rinjtë në praktikën e pjesëmarrjes së të rinjve
- zbatimi i të gjitha formave të pjesëmarrjes së nxënësve në shkolla;
- futja e programeve të arsimit qytetar në shkolla (trajnim për pjesëmarrjen e të rinjve, të drejtat e njeriut, etj.);
- futja e edukimit nëpërmjet grupeve të moshatarëve, duke i ofruar burimet e nevojshme dhe duke e mbështetur shkëmbimin e praktikave të mira.

Fusha 2: Informimi i të rinjve

- mbështetja ose krijimi i qendrave të informimit ose i qendrave këshilluese për të rinjtë;
- ndërmarrja e masave të veçanta për t'i plotësuar nevojat e të rinjve që kanë probleme me qasjen në informacion (të rinjtë me aftësi të kufizuara, ata që nuk kanë qasje në internet ose nuk kanë njohuri për kompjuterët, ata që jetojnë në lagjet më pak të zhvilluara ose në zonat rurale, etj.);
- krijimi ose garantimi i standardeve që kanë të bëjnë me shërbimet për informim të të rinjve;
- shërbimet për informim t'u përmbahen këtyre standardeve.

Fusha 3: Nxitja e pjesëmarrjes së të rinjve nëpërmjet teknologjive të informacionit dhe të komunikimit

- shfrytëzimi i teknologjive të informacionit dhe të komunikimit si pjesë e politikave të informimit dhe të pjesëmarrjes së autoriteteve lokale;
- garantimi i qasjes në këto teknologji (edhe në infrastrukturë edhe në njohuri) për të rinjtë.
- Fusha 4: Nxitja e pjesëmarrjes së të rinjve në medie
- mbështetja për krijimin dhe funksionimin e medieve vendore të zhvilluara nga dhe për të rinjtë;
- ofrimi i programeve përkatëse për trajnim të të rinjve për mënyrën e organizimit të këtyre medieve.

Fusha 5: Inkurajimi i të rinjve për të bërë punë vullnetare

- mbështetja për krijimin e qendrave vullnetare;
- ofrimi i informacionit për mundësitë për punë vullnetare;
- zhvillimi i sistemeve që i njohin dhe i vlerësojnë aktivitetet vullnetare.

Fusha 6: Mbështetja për projektet dhe iniciativat e të rinjve

- lehtësimi për zbatimin e projekteve të të rinjve;
- ofrimi i ndihmës profesionale për realizimin e këtyre projekteve;
- ofrimi i ndihmës financiare, materiale dhe teknike. Fusha 7: Promovimi i organizatave rinore
- sigurimi i një buxheti të veçantë për t'i mbështetur organizatat rinore (duke u dhënë përparësi organizatave që drejtohen nga të rinjtë dhe për të rinjtë);
- zbatimi i parimit të bashkë-menaxhimit dhe i sistemit të vendimmarrjes në partneritet me të rinjtë dhe organizatat rinore në fushat relevante.

Fusha 8: Promovimi i pjesëmarrjes së të rinjve në organizatat joqeveritare dhe partitë politike

- ofrimi i burimeve (edhe financiare) për organizatat joqeveritare që e promovojnë pjesëmarrjen e të rinjve;
- promovimi i përfshirjes së të rinjve në sistemin e partive politike.



Pjesa III – Pjesëmarrja institucionale e të rinjve në çështjet vendore dhe rajonale

Pjesa e fundit e Kartës së rishikuar përmban rekomandime në lidhje me përfshirjen e të rinjve në institucionet ose në strukturat vendore. Nëse politikat sektoriale (që u shqyrtuan në Pjesën I) do të zbatohen ashtu që ta mbështesin pjesëmarrjen e të rinjve në nivel të gjithë komunitetit, duhet të krijohen edhe strukturat përkatëse që do t'i përfaqësojnë pikëpamjet e të rinjve në këtë drejtim. Karta e thekson faktin se forma përfundimtare e pjesëmarrjes institucionale duhet të zgjidhet në bazë të nevojave vendore, mirëpo gjithmonë duhet pasur si qëllim krijimin e partneritetit ndërmjet të rinjve dhe autoriteteve vendore si dhe të rinjve t'u ofrohen mundësi që të përfshihen në vendimet që ndikojnë mbi ta. Të rinjtë duhet të marrin përgjegjësi të drejtpërdrejtë për projektet dhe të luajnë rol aktiv në politikat përkatëse.

Rekomandimet për këshillat e rinisë, parlamentet rinore, forumet rinore

- duhet të jenë struktura të përhershme;
- duhet të përbëhen nga përfaqësues të zgjedhur ose të emëruar të organizatave rinore;
- anëtarësia e tyre duhet ta pasqyrojë përbërjen shoqërore të komunitetit;
- të rinjtë duhet të marrin përgjegjësi të drejtpërdrejtë për projektet dhe të luajnë rol aktiv në politikat përkatëse;
- duhet të paraqesin kornizë fizike që të rinjtë të mund t'i shprehin pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre (edhe sa i përket iniciativave të autoriteteve vendore);
- duhet të kenë mundësi të parashtrojnë propozime tek autoritetet vendore;
- duhet t'i lehtësojnë konsultimet me të rinjtë dhe organizatat e tyre për çështjet që i shqetësojnë ata;
- duhet të jenë forum prej ku zhvillohen, monitorohen dhe vlerësohen projektet që i përfshijnë të rinjtë;
- duhet ta lehtësojnë pjesëmarrjen e të rinjve në organet e tjera konsultative në nivel vendor.

Rekomandimet për mbështetjen e strukturave të pjesëmarrjes së të rinjve

- autoritetet vendore duhet t'i ofrojnë edhe strukturat formale edhe ato joformale për pjesëmarrjen e të rinjve duke e siguruar hapësirën, mjetet financiare dhe mbështetjen e nevojshme materiale (edhe pse ato e kanë përgjegjësinë që të kërkojnë edhe mbështetje shtesë nga burimet e tjera);
- autoritetet vendore duhet të sigurojnë një garantues, i cili do të jetë përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e strukturave të mbështetjes;
- garantuesi duhet të jetë i pavarur dhe emërimi i tij duhet të bëhet në marrëveshje ndërmjet përfaqësuesve të të rinjve dhe autoriteteve vendore;
- garantuesi duhet të veprojë si ndërmjetësues në mes të rinjve dhe të zgjedhurve vendor, duhet t'i përfaqësojë interesat e të rinjve në rastet kur ka ndonjë keqkuptim ose konflikt ndërmjet të rinjve dhe autoriteteve vendore dhe duhet të jetë urë komunikimi ndërmjet të dyja palëve.

→ 2.3. Grupet e synuara të Kartës

Karta e rishikuar është një dokument që u dedikohet të gjithë atyre që janë përgjegjës, të përfshirë ose të interesuar për përforcimin e pjesëmarrjes së të rinjve në kontekstin vendor. Çdo kush, me gjasë do ta shohë Kartën nga një perspektivë e ndryshme dhe do të dëshirojë ta shfrytëzojë atë në mënyrën e tij ose të saj, mirëpo qëllimi përfundimtar për secilin është i njëjtë: të sigurohet se të rinjtë e kanë të drejtën, mjetet, hapësirën dhe mbështetjen që të mund të marrin pjesë dhe të angazhohen në mënyrë domethënëse në iniciativat dhe proceset e vendimmarrjes që ndikojnë në jetën e tyre. Këto pesë fjalë kyçe – e drejta, mjetet, hapësira, mundësitë dhe mbështetja janë elementet kryesore të qasjes së Kartës ndaj pjesëmarrjes dhe ato do të sqarohen më hollësisht në Kapitullin 3 të këtij doracak.



Grupet kryesore të synuara të cilave u dedikohet Karta:

– *Të rinjtë*

Të rinjtë përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të popullatës. Ata janë grup i shumëllojshëm, grup që i ka nevojat dhe aspiratat e veta, të cilat mund të plotësohen më mirë në qoftë se të rinjve u ofrohet mundësia të shprehen dhe të luajnë rol kuptimplotë në trajtimin e çështjeve që janë të rëndësishme për ta.

– *Grupet joformale të të rinjve*

Disa të rinj kënaqen duke i shpërndarë idetë e tyre dhe duke u përzier me të rinjtë e tjerë, mirëpo ata as nuk duan të bëhen anëtarë zyrtarë të shoqatave, e as të jenë pjesë e ndonjë subjekti të strukturuar. Në vend të kësaj, ata mund t'i zgjedhin grupet joformale që nuk janë të regjistruar, që kanë rregulla shumë fleksibile dhe që i plotësojnë nevojat e tyre në mënyrë me efikase se sa që këtë do ta bënin shoqatat me hierarki ose ato që janë të organizuara. Sa për të dhënë disa shembuj, grupet e tilla joformale mund të jenë në formë të rrjeteve spontane, grupeve mbështetëse ose si komunitete virtuale.

– *Organizatat dhe shoqatat e të rinjve*

Të jesh anëtar i një organizate rinore, këshilli ose bordi të të rinjve, është njëra nga format tradicionale të pjesëmarrjes së të rinjve. Në rastin ideal, të rinjtë duhet të jenë në pozita drejtuese, mirëpo disa organizata të të rinjve drejtohen ose vetëm nga të rriturit, ose në bashkëpunim në mes të të rinjve dhe të rriturve. Organizatat ose shoqatat e të rinjve zakonisht janë të regjistruara nga autoritetet vendore ose kombëtare dhe mund të veprojnë si subjekte ligjore. Atëherë, në disa vende kërkohet që në pozitat drejtuese të ketë të rritur, në rastet kur të rinjtë nuk mund të mbajnë përgjegjësi ligjore për veprimet e organizatës.

– *Institucionet arsimore*

Shkollat janë një nga vendet kyçe ku të rinjtë mësojnë gjëra të reja për botën, i formojnë mendimet e tyre, dhe përgatiten për fazën e ardhshme të jetës së tyre. Shumica e të rinjve kalojnë një pjesë të madhe të jetës së tyre në shkollë ose në universitet, dhe për këtë arsye ato janë vende ku pjesëmarrja e të rinjve jo vetëm që duhet të promovohet, por edhe të praktikohet.

– *Organizatata e tjera*

Ka edhe organizata të tjera që punojnë në fushën e pjesëmarrjes së të rinjve, mirëpo që nuk punojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me të rinjtë ose që janë të hapura për anëtarë nga grupe të ndryshme profesionale ose të moshave të ndryshme. Për shembull, organizatat e tilla realizojnë aktivitete arsimore për punëtorët që punojnë me të rinjtë ose mësuesit, përqendrohen në hulumtim, ose janë grup ndikues për përforcimin e politikave që janë të përshtatura për të rinjtë.

– *Autoritetet vendore*

Është një praktikë gjithnjë e më e shpeshtë në kuadër të vendeve evropiane që të krijohen njësi të veçanta në kuadër të autoriteteve vendore që merren me shqetësimet e të rinjve. Pa marrë parasysh se a bëhet fjalë vetëm për një person ose për departament të tërë që punon në këtë fushë, qëllimi i tyre është të inkurajohet pjesëmarrja e të rinjve në kontekstin vendor, dhe të mbështeten aktivitetet dhe iniciativa të ndryshme të të rinjve. Mirëpo, nuk mjafton që Kartën e rishikuar ta shfrytëzojnë vetëm përfaqësuesit që kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për të rinjtë. Siç u përmend më parë, të rinjtë ndikohen nga një numër i politikave sektoriale dhe për këtë arsye edhe njësitë e tjera në kuadër të strukturës së autoriteteve vendore duhet të përfshihen në zbatimin e Kartës.

Kur shihet Karta fitohet përshtypja se ajo është një dokument që kryesisht u dedikohet autoriteteve vendore, për shkak se në masë të madhe përqendrohet në instrumentet dhe politikat vendore. Është e vërtetë se autoritetet luajnë një rol shumë të rëndësishëm në krijimin e kushteve përkatëse për pjesëmarrjen e të rinjve në nivel vendor, por ato këtë nuk mund dhe nuk duhet ta bëjnë pa bashkëpunimin dhe mbështetjen e të rinjve dhe organizatave të tyre. Prandaj, duhet të përfshihen të gjitha grupet e synuara që u përmendën më lartë, mirëpo në kapacitete ose në role të ndryshme, që parimet dhe rekomandimet e Kartës të mund të zbatohen me sukses në një komunitet të caktuar. Në kapitujt e tjerë të doracakut, do të jepen më tepër detaje për atë se si secili nga grupet mund të përfshihet në zbatimin e Kartës në nivel vendor.




KAPITULLI 3

Qasja e Kartës ndaj pjesëmarrjes

→ 3.1 Njoftim me qasjen e Kartës ndaj pjesëmarrjes së të rinjve

Karta e rishikuar u dedikohet grupeve të ndryshme që janë të përfshira në promovimin e pjesëmarrjes së të rinjve në nivel vendor. Edhe pse një pjesë e konsiderueshme e dokumentit përmban rekomandime për politikave të ndryshme sektoriale, ajo përfshin shumë më tepër se sa vetëm aspektet e politikave të pjesëmarrjes së të rinjve. Ajo propozon një qasje që mund të përdoret në të gjitha fushat e përfshirjes së të rinjve në nivel vendor, si për shembull kur realizohen projekte pjesëmarrëse për të rinjtë, kur ndërtohen partneritete ndërmjet të rinjve dhe të rriturve ose kur krijohen grupe ose organizata të të rinjve, etj.



Qasja e Kartës ndaj pjesëmarrjes është qasja e ashtuquajtur “DMHMM” dhe bazohet në pesë fjalë kyçe që janë përmendur në preambulën e dokumentit: e drejta, mjetet, hapësira, mundësitë dhe mbështetja³⁰. Ajo bazohet në parimin se pjesëmarrja kuptimplote e të rinjve mund të realizohet vetëm pasi të krijohen kushtet përkatëse dhe të gjithë aktorëve që janë të përfshirë në punën pjesëmarrëse u është dhënë përgjegjësia të sigurojnë se këto kushte janë të pranishme.

Pesë fjalët kyçe, e drejta, mjetet, hapësira, mundësitë dhe mbështetja, i paraqesin faktorët kryesorë që kanë ndikim në përfshirjen e të rinjve në nivel vendor (ato do të sqarohen më hollësisht në vazhdim të kapitullit). Secila prej tyre përqendrohet në një masë të veçantë mbështetëse, mirëpo ato janë të ndërlidhura ngushtë dhe duhet të plotësohen të gjitha që të rinjtë të kenë mundësi të marrin pjesë plotësisht në aktivitetet ose në vendimet që u interesojnë.

30. Këto fjalë kyçe janë përmendur në preambulën e Kartës dhe kanë të bëjnë me interpretimin e pjesëmarrjes ashtu siç është përdorur në dokument: “Pjesëmarrja dhe qytetaria aktive nënkupton të kesh të drejtë, mjete, hapësirë dhe mundësi dhe, aty ku është e nevojshme, mbështetje për të marrë pjesë dhe për të ndikuar në vendimmarrje, si dhe për t'u angazhuar në veprime dhe aktivitete për të kontribuar për ndërtimin e një shoqërie më të mirë.”



Qasja DMHMM mund të jetë mjet i dobishëm për të rinjtë, punëtorët që punojnë me të rinjtë ose autoritetet vendore për shkak se u ndihmon që t'i shohin me sy kritik projektet ose iniciativat e tyre dhe të konstatojnë se a janë krijuar kushtet përkatëse për pjesëmarrjen e të rinjve. Një përshkrim më i hollësishëm i kornizës që e mundëson qasja DMHMM³¹ është dhënë më poshtë.

→ 3.2. Korniza DMHMM

Korniza DMHMM është mjet për të vlerësuar se në ç'masë secili nga pesë faktorët kryesorë që ndikojnë në pjesëmarrjen e të rinjve është i pranishëm në kuadër të një projekti, iniciative, organizate ose në jetën e komunitetit.

E drejta

Të rinjtë kanë të drejtë të nënkuptuar për të marrë pjesë dhe, siç u tha tashmë në Kapitullin 1, ajo konsiderohet si e drejtë e njeriut ose e drejtë e qytetarit. Në rast ideal, duhet të ketë ligj në nivel vendor dhe/ose rajonal ku thuhet se të rinjtë duhet të konsultohen dhe se kanë të drejtë të marrin pjesë në çështjet, veprimet dhe vendimet që ndikojnë mbi ta. Mirëpo, edhe në komunitetet ku zyrtarisht nuk ekziston një ligj i tillë, të rinjtë kanë të drejtë të marrin pjesë. Me fjalë të tjera, nuk u takon autoriteteve vendore ose rajonale që ta japin këtë të drejtë, por ajo është e drejtë fundamentale që duhet ta kenë dhe ta kërkojnë të gjithë të rinjtë.

Të rinjtë duhet të jenë aktivë në promovimin e të drejtave të tyre. Në praktikë, kjo nënkupton shumë më tepër se sa vetëm të ndikohet në vendimet vendore nëpërmjet konsultimeve ose votimit. Kjo do të thotë se aktivitetet, projektet ose organizatat duhet t'i promovojnë të drejtat që i kanë të rinjtë në të gjitha fushat e jetës, dhe kjo nuk i nënkupton vetëm të drejtat qytetare ose politike, por edhe ato shoqërore, ekonomike ose kulturore.

Mendoni

Të drejtat në përgjithësi

1. Cilat të drejta i kanë të rinjtë?
2. Cilat të drejta mundohet t'i trajtojë ose t'i promovojë projekti/organizata juaj?
3. Si e dini se këto të drejta janë të rëndësishme për të rinjtë që synohen nga projekti juaj?

E drejta për të marrë pjesë


1. A kanë të rinjtë e komunitetit tuaj vendor të drejtë që të marrin pjesë? Si e dini këtë?
2. Ai kanë ata të drejtat e nevojshme për ta ushtruar pjesëmarrjen (për shembull, të drejtën për ta shprehur mendimin e tyre, të drejtën për t'u dëgjuar etj.)? Cilat janë këto të drejta konkretisht?
3. Si ka për qëllim projekti juaj që ta promovojë ose ta trajtojë të drejtën e të rinjve për të marrë pjesë në çështjet, veprimet dhe vendimet që ndikojnë mbi jetën e tyre?

31. Përshkrimi i kornizës është përshtatur nga materialet që janë përgatitur për trajnimin për zhvillimin dhe zbatimin e projekteve pjesëmarrëse në nivel vendor dhe rajonal, që u mbajt në qershor të vitit 2005 në Qendrën evropiane të të rinjve në Strasburg.



Të drejtat e të rinjve në kuadër të projektit, organizatës ose komunitetit tuaj

1. Çfarë roli luajnë të rinjtë në vendimmarrje në kuadër të projektit/organizatës ose komunitetit tuaj?
2. A janë ata të pranishëm në të gjitha nivelet e vendimmarrjes?
3. A e kanë ata autonominë dhe përgjegjësinë e nevojshme për të marrë vendime dhe për t'i zbatuar ato në kuadër të projektit tuaj?
4. Si i zhvillojnë të rinjtë e përfshirë në projektin tuaj shkathtësitë që nevojiten për vendimmarrje efektive?
5. Si dhe në çfarë mase është i hapur projekti juaj për të gjithë të rinjtë, pa diskriminim në bazë të identitetit të tyre kombëtar, etnik, fetar dhe kulturor, klasës shoqërore, burimeve ekonomike, gjinisë, orientimit seksual, aftësisë fizike etj.?



Mjetet

Jeta mund të jetë më e vështirë për të rinjtë që nuk kanë burime të mjaftueshme në jetë (për shembull, burime financiare) dhe që jetojnë në varfëri për shkak të papunësisë ose të vështirësive të tjera. Kjo mund të nënkuptojë se ata nuk mund t'i plotësojnë nevojat themelore, si për shembull ushqimin ose banimin dhe si rezultat i kësaj ata mund të ndjehen të izoluar ose të lënë jashtë shoqërisë. Është e natyrshme që në rrethanat të tilla, përparësi t'u jepet përpjekjeve për të gjetur mënyra të tjera për t'i siguruar burimet që mungojnë, dhe si rezultat i kësaj, të rinjtë mund të kenë mungesë të motivimit ose të kohës që të marrin pjesë në jetën e një organizate ose të komunitetit.

Prandaj, për t'i inkurajuar të rinjtë që të përfshihen, duhet të plotësohen nevojat e tyre themelore. Këtu bëjnë pjesë siguria e mjaftueshme shoqërore, arsimi, banimi, kujdesi shëndetësor, transporti, dija dhe qasja në teknologji.

Mendon

1. Cilat janë mjetet më të rëndësishme që u nevojiten të rinjve në kontekstin tuaj vendor që ata të mund të marrin pjesë plotësisht në projektin, organizatën ose komunitetin tuaj? A i keni identifikuar këto nevoja?
2. Cilat çështje që ndërlidhen me këto mjete (nëse ka të tilla) i trajton projekti ose organizata juaj? Në çfarë mënyre?
3. Si trajtohen çështjet, si për shembull mjetet/burimet, qasja, vendi ose distanca nga projekti, organizata ose komuniteti juaj?
4. Si ndikojnë ato mbi mundësitë e të rinjve që i synoni ju për t'u përfshirë në projektin tuaj?
5. Cilat burime praktike ose të rëndësishme i keni ose keni nevojë t'i keni që sa më shumë të rinj të kenë mundësi të përfshihen në projektin tuaj (për shembull, transporti, shpenzimet ose përkthyesit)? Si mund t'i siguron burimet që nuk i keni?
6. A mund të kenë qasje në projektin ose organizatën tuaj të rinjtë me aftësi të kufizuara ose ata që janë të pa favorizuar? Çfarë mbështetje nevojitet që t'u ndihmohet atyre të përfshihen dhe si ofrohet ajo?




Hapësira

Të rinjtë kanë nevojë për hapësirë fizike që të takohen, ta kalojnë kohën ose që t'i organizojnë aktivitetet e tyre. Sa i përket pjesëmarrjes në aktivitetet shkollore ose në aktivitetet e tjera të organizuara mësimore, zakonisht ofrohen hapësira (për shembull, klasa, salla sportive ose klubet e të rinjve). Mirëpo, është shumë më e vështirë për të rinjtë të gjejnë vend për t'u takuar nëse janë të interesuar të përfshihen në iniciativa jo të organizuara. Prandaj, shohim se interneti shfrytëzohet gjithnjë e më shumë nga të rinjtë si vend për shkëmbimin e mendimeve ose për fillimin e projekteve me njerëzit që kanë mendime të ngjashme.

Mirëpo, ky faktor i DMHMM-së nuk ka të bëjë vetëm hapësirën fizike, por shumë më tepër me hapësirën për të marrë pjesë në kuadër të kornizës institucionale të krijimit të politikave. Në esencë, kjo do të thotë se pikëpamjet, rekomandimet dhe përfundimet e të rinjve duhet të kenë ndikim real në vendimet që merren. Shumë shpesh të rinjtë ftohen të marrin pjesë në procese, mirëpo në fakt ata kanë shumë pak mundësi të ndikojnë dhe ta formojnë rezultatin përfundimtar. Ky quhet “përfaqësim sipërfaqësor”/tokenizëm.

Mendoni

1. Çfarë hapësire (fizike, virtuale, institucionale) ka në dispozicion për të rinjtë në komunitetin tuaj? Sipas mendimit tuaj, a mjafton kjo?
2. Në cilat mënyra të rinjtë mund të kenë ndikim real në rezultatin përfundimtar të vendimeve që ndikojnë mbi jetën e tyre?
3. Në çfarë mase projekti ose organizata juaj u ndihmon të rinjve që të kenë ndikim më të madh në rezultatin përfundimtar të vendimeve që ndikojnë mbi jetën e tyre?
4. Si i fuqizon projekti ose organizata juaj të rinjtë që janë të përfshirë në projekt t'i shprehin pikëpamjet, mendimet, dëshirat dhe shqetësimet e tyre për mënyrën se si zhvillohet komuniteti/mjedisi vendor ose projekti?
5. Cilat masa praktike mund t'i zbatoni në kontekstin tuaj që të siguroni se pikëpamjet e të rinjve do të kenë ndikim real?
6. Pyetje për organizatorët e projektit: a është vendi ku do të realizohet projekti i qasshëm, mirëseardhës dhe i hapur për të gjithë? Kush e ka dizajnuar hapësirën dhe në bazë të cilave kritere?



Mundësitë

Që të mund të marrin pjesë në mënyrë aktive, të rinjve duhet t'u ofrohet mundësia ta bëjnë këtë. Kjo do të thotë se, për shembull, të rinjtë patjetër duhet të kenë qasje në informacion për atë se si të përfshihen, çfarë mundësish ofrohen dhe ku gjenden ato. Kur ata e dinë se çka ndodh në komunitetin e tyre në lidhje me pjesëmarrjen e të rinjve, ata mund të marrin vendime të informuara për përfshirjen e tyre. Ndonjëherë ndodh që të rinjtë të mos marrin pjesë jo se nuk kanë interesim, por thjesht sepse nuk kanë informacion për mundësitë ekzistuese.

E dyta, ngjarjet, sistemet dhe proceset e vendimmarrjes duhet të jenë të përshtatura për të rinjtë. Jo vetëm që duhet të ketë hapësirë për të rinjtë në kuadër të këtyre proceseve dhe të strukturave, por edhe mënyra e organizimit dhe e funksionimit të tyre duhet të jetë e tillë që të rinjtë të mund t'i kuptojnë ato dhe të mund të kontribuojnë plotësisht nëse dëshirojnë. Prandaj, duhet të sigurohet se, për shembull, të rinjtë kanë mundësi të marrin pjesë në aspekt të kohës së mjaftueshme dhe të strukturave mbështetëse.

Mendoni

1. Cilat janë mundësitë për pjesëmarrjen e të rinjve në kontekstin tuaj vendor ose në organizatën tuaj?
2. Si njoftohen të rinjtë për këto mundësi? A është kjo efektive?
3. Si do të ndikojë projekti juaj mbi mundësinë e të rinjve për të marrë pjesë në nivel vendor dhe/ose rajonal?
4. Si mund të përfshihen të rinjtë në projektin tuaj? Si informohen për këtë? A është kjo e përshtatur për të rinjtë?
5. Në çfarë mënyre/ash projekti juaj u ofron mundësi të rinjve që ta praktikojnë demokracinë dhe qytetarinë?
6. Në çfarë mënyre/ash projekti juaj u ofron mundësi edukative të rinjve?
7. Cili lloj i të rinjve mund të marrë pjesë në projektin tuaj? A kanë këta të rinj tashmë pozita udhëheqëse?




Mbështetja

Të rinjtë kanë shumë talent dhe potencial për të marrë pjesë, mirëpo pa mbështetjen e nevojshme, përfshirja e tyre mund të mos jetë aq efikase sa ka mundësi të jetë. Ata duhet të kenë qasje në format e ndryshme të mbështetjes. Këtu bëjnë pjesë, për shembull, mbështetja financiare, morale dhe institucionale në disa nivele të ndryshme – në nivel personal, të organizatës ose në nivel të komunitetit vendor. Në rastin ideal, autoritetet vendore duhet të ofrojnë mbështetje përkatëse financiare për t'i mbuluar shpenzimet dhe harxhimet strukturore, mirëpo në shumë komunitete, akoma ka raste kur çështjeve që kanë të bëjnë me të rinjtë nuk u jepet përparësi në aspekt të menaxhimit financiar vendor.

Të rinjtë, po ashtu duhet të kenë qasje në këshillat dhe mbështetjen morale. Për shembull, kjo mund të ofrohet nga personi i cili në Kartën e rishikuar quhet garantues³² ose, nga punëtori që punon me të rinjtë ose ndonjë profesionist tjetër që ka përvojë dhe ekspertizë nga puna në fushën e partneriteteve në mes të të rinjve dhe të rriturve ose nga puna me të rinjtë. Në fund, institucioni ose komuniteti, si tërësi duhet ta mbështesin dhe ta njohin rëndësinë dhe kontributin e pjesëmarrjes së të rinjve, jo vetëm për të rinjtë, por edhe për autoritetet publike dhe shoqërinë në përgjithësi.

Mendoni

1. Në çfarë mënyre mjedisi i komunitetit tuaj vendor e mbështet pjesëmarrjen e të rinjve?
2. A mund projekti ose organizata juaj ta përmirësojë situatën? Si?
3. A është pjesëmarrja e të rinjve pjesë e kulturës së komunitetit ose organizatës suaj? Si mund ta dëshmoni këtë?
4. Në çfarë mënyre strukturat dhe politikat në organizatën ose komunitetin tuaj janë të përshtatura për të rinjtë?
5. Çfarë mbështetje institucionale keni për projektin tuaj? Çka nënkupton kjo në praktikë? Si e mbështet ajo pjesëmarrjen e të rinjve në projekt?
6. A është e kufizuar ndihma e të rriturve vetëm në menaxhimin indirekt të projektit tuaj (“duke e mbështetur udhëheqësin e të rinjve”) apo të rriturit janë përgjegjës të projektit? Cilat janë pasojat e kësaj (edhe përparësitë edhe kufizimet) për projektin tuaj?
7. Çfarë shkathtësish ju duhen të rinjve që të marrin pjesë në mënyrë aktive në projektin tuaj?
8. A keni në organizatën tuaj staf mbështetës (vullnetar ose profesional) që është kompetent për ta mbështetur përfshirjen e të rinjve në projektin tuaj? Nëse po, çfarë shkathtësish kanë ata?



32. Në Kartë është sqaruar se garantuesi është një person i pavarur ose grup personash që do ta garantojë ofrimin e mbështetjes së nevojshme për pjesëmarrjen e të rinjve, që do të veprojë si ndërmjetësues ndërmjet të rinjve dhe autoriteteve vendore, dhe, nëse ka nevojë, do t'i përfaqësojë të rinjtë në situata të tensionit. Shih: Karta e rishikuar, pika III. 2. 68-70.



Tashmë u tha se të gjitha pesë elementet e qasjes “DMHMM” duhet të jenë të pranishme për të pasur pjesëmarrje të rëndësishme të të rinjve. Nëse, për shembull, mohohet e drejta e tyre për të marrë pjesë, pa marrë parasysh se çfarë mjedesh, hapësire, ose mbështetje do të ofrohet, ata nuk do të kenë mundësi të përfshihen. Nga ana tjetër, nëse ekziston e drejta, mirëpo nuk ka mbështetje të mjaftueshme, kjo do të thotë se nuk mund të ushtrohet kjo e drejtë. Edhe pse çdo faktor i qasjes “DMHMM” është analizuar veçmas në këtë kapitull, megjithatë, të gjitha elementet duhet të shihen si pjesë të një sistemi të ndërlidhur, që është i balancuar dhe që funksionon mirë vetëm atëherë kur të gjitha elementet funksionojnë ashtu siç duhet.






KAPITULLI 4

Karta në praktikë



4.1 Karta e rishikuar si mjet praktik për aktorët e ndryshëm

Në Kapitullin 1 të këtij doracaku u shqyrtuan arsyet dhe motivet e ndryshme për pjesëmarrjen e të rinjve dhe u përfundua se është e pamundshme të krijohet një qasje që do t'i plotësonte nevojat e të gjithëve dhe që do të ishte e përshtatshme për të gjitha situatat dhe kontekstet.

Karta e rishikuar i përcakton politikat dhe parimet e nevojshme për pjesëmarrje të rëndësishme të të rinjve dhe e trajton një diapazon të gjerë çështjesh që ndikojnë mbi jetën e të rinjve në nivel vendor dhe rajonal në Evropë. Si dokument i Këshillit të Evropës, Karta synon të trajtojë situata nga më të ndryshmet (edhe gjeografike, ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore) anembanë Evropës dhe ofron një kornizë e cila mund të përshtatet me nevojat dhe rrethanat e veçanta të komuniteteve dhe të organizatave të ndryshme, dhe nuk është një recetë e detajuar, që është e gatshme për përdorim. Prandaj, ajo nuk duhet të shihet si një dokument statik, por si një përmbledhje dinamike e sugjerimeve që mund të shfrytëzohen në mënyrën më relevante në kontekstin e dhënë.

Tri pjesët e Kartës përbajnë udhëzime për grupet e ndryshme që janë të interesuara për pjesëmarrjen e të rinjve për atë se si të krijohen kushte adekuate për përfshirjen e të rinjve. Grupet e tilla mund ta përdorin Kartën në mënyrat që janë më të përshtatshme për ta dhe me të cilat mund të arrijnë një diapazon të gjerë qëllimesh. Në praktikë, kjo do të thotë se ata do të përqendrohen në fusha të ndryshme të cilat trajtohen në Kartë, e jo domosdoshmërisht në gjithë dokumentin përnjëherë.

Mendoni

1. *Cilat janë grupet/aktorët në kontekstin tuaj që mund të jenë të interesuar ta shfrytëzojnë Kartën si mjet për pjesëmarrjen e të rinjve?*
2. *Pse ata do të ishin të interesuar ta shfrytëzojnë Kartën?*
3. *Cilat janë lidhje tuaja (në qoftë se keni) me grupet ose institucionet e tilla?*
4. *A e dinë ata se ekziston Karta? Si e dini këtë?*

Grupe ose aktorë të ndryshëm që veprojnë në kuadër të kontekstit vendor mund t'i shfrytëzojnë rekomandimet e propozuara në Kartë, edhe atë secili në mënyrën e tij. Në këtë doracak, përqendrimi do të jetë në tre grupet kryesore që janë përgjegjëse për promovimin e pjesëmarrjes së të rinjve në nivelet vendore dhe rajonale, gjegjësisht të të rinjtë, organizatat rinore dhe autoritetet vendore.



Të rinjtë

Të rinjtë përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të popullatës në shumë komunitete vendore, mirëpo roli dhe ndikimi i tyre është mjaft i kufizuar kur bëhet fjalë për trajtimin e çështjeve vendore. Karta ofron disa ide konkrete për atë se si të përfordhet roli i të rinjve në proceset e vendimmarrjes vendore dhe, për këtë arsye, është një mjet i rëndësishëm për të rinjtë për të krijuar kushte më të mira për përfshirjen e tyre kuptimplote në jetën publike. Karta përmban disa rekomandime të cilat duhet t'i ndjekin autoritetet vendore, ndërsa të rinjtë mund t'i shfrytëzojnë ato si mjet unik për të ndikuar tek autoritetet e tyre vendore për promovimin e pjesëmarrjes së të rinjve. Të rinjtë, po ashtu mund të luajnë rol aktiv në shpërndarjen e Kartës në institucione të ndryshme në kontekstin e tyre vendor, në shkolla, në klube, etj. Potenciali i Kartës mund të shfrytëzohet vetëm në qoftë se aktorët relevantë janë të njoftuar me ekzistencën e saj dhe nëse dinë ta shfrytëzojnë atë sa më mirë për komunitetin e tyre vendor.

Të rinjtë duhet të fuqizohen që të mund ta shfrytëzojnë Kartën dhe t'i ndjekin rekomandimet e saj. Edhe pse ata mund ta kenë potencialin dhe motivimin, ka disa shkathtësi dhe qëndrime që duhet të zhvillohen, si dhe njohuri shtesë që duhet të përfitohen. Pa fuqizim, mund të jetë shumë e vështirë, nëse jo edhe e pamundur, që të rinjtë, në rrethana të caktuara, të përfshihen dhe të kontribuojnë për jetën e komunitetit të tyre.

Organizatrat

Kur bëhet fjalë për organizatat, duhet pasur parasysh se nuk është e thënë që ato të jenë të regjistruara ose të jenë shoqata ekzistuese zyrtare, por mund të jenë edhe grupe joformale, rrjete ad-hok, etj. Disa organizata që punojnë në promovimin e pjesëmarrjes së të rinjve u mundësojnë të rinjve që të bëhen anëtarë të tyre, mirëpo disa prej tyre e kufizojnë anëtarësinë vetëm për të rriturit³³. Mirëpo, të gjitha ato, mund të luajnë rol të rëndësishëm në krijimin e mundësive dhe të ambientit përkatës për përfshirjen e të rinjve, dhe mund ta shfrytëzojnë Kartën në mënyra të shumta. Pasi ndonjëherë shërbejnë si urë komunikimi ndërmjet të rinjve dhe autoriteteve vendore, ato mund ta shfrytëzojnë Kartën si mjet për ndikim, që të sigurohet se do të merren parasysh interesat dhe nevojat e të rinjve nga ana e autoriteteve. Kjo mund të jetë një metodë efikase, veçanërisht në nivel vendor, ku autoritetet janë në kontakt shumë të afërt me qytetarët dhe rrjetet vendore.

Organizatrat, po ashtu mund t'i zbatojnë parimet e Kartës në punën e tyre të përditshme, që, në praktikë, do të thotë se ato janë më të hapura për të formuar partneritete me të rinjtë dhe për t'i pranuar mendimet e tyre. Kjo nuk do të thotë se të rinjtë duhet të bëhen menaxherë ose anëtarë të bordit (edhe pse kjo është e mundur), por ka të bëjë me krijimin e partneritetit, ku të gjitha palët kanë biseduar, janë marrë vesh dhe i kanë pranuar rolet, detyrat dhe përgjegjësitë.

Autoritetet vendore

Duke i formësuar politikat vendore, duke menaxhuar me burimet vendore dhe duke kërkuar mënyra për përmirësimin e kualitetit të jetës së pjesëtarëve të komunitetit, autoritetet vendore luajnë rol vendimtar dhe unik në krijimin e kushteve të nevojshme për pjesëmarrjen e të rinjve. Po ashtu, autoritetet vendore janë ato që “janë më afër të rinjve”, prandaj është edhe përgjegjësi e tyre që të ofrojnë qasje në qytetarinë aktive dhe për pjesëmarrje në demokracinë vendore. Aq më tepër, ato kanë njohuri për rrethanat vendore dhe kanë qasje në rrjetet vendore që mund ta mbështesin përfshirjen e të rinjve të mënyra të ndryshme.

Karta ofron një kornizë për qasje vendore ndaj çështjeve rinore. Po ashtu, ajo mund të shihet si mjet për krijimin ose përmirësimin e politikave vendore për të rinjtë që do ta mbështesin përfshirjen e të rinjve në vendimmarrje dhe në zhvillimin e normave dhe të praktikave të ndryshme që ndikojnë mbi popullatën e re në një komunitet. Për këtë arsye, masat relevante që janë propozuar në kartë duhet të zbatohen sa më shumë që është e mundur (varësisht nga rrethanat, burimet që janë në dispozicion, përvoja e mëparshme, etj.). Autoritetet vendore duhet të jenë të përkushtuara që ta mbështesin pjesëmarrjen e të rinjve jo vetëm në proceset e qeverisjes në nivel vendor, por edhe në mjediset shoqërore – në shkolla, klube, organizata, etj. Prandaj, masat që i promovon karta, i trajtojnë të dyja dimensionet e pjesëmarrjes së të rinjve, për shkak se ato janë të ndërlidhura dhe me rëndësi të njëjtë për të mirën e gjithë komunitetit.

33. Shembuj janë agjencitë hulumtuese, rrjetet e ekspertëve dhe të specialistëve, institucionet arsimore, qendrat për rehabilitim, etj.



Si mund ta përdorin Kartën aktorët e ndryshëm? –Pasqyrë

Lista e mëposhtme paraqet një përmbledhje të ideve që mund t’i inspirojnë aktorët e ndryshëm të ndërmarrin veprime dhe të fillojnë ta përdorin Kartën si mjet në punën e tyre të përditshme. Ajo nuk është listë e plotë – çdokush duhet t’i zgjedhë veprimet që janë më të rëndësishme për nevojat dhe situatat e tyre vendore.

	Nëse jeni i ri	Nëse jeni përfaqësues i ndonjë organizate	Nëse jeni përfaqësues i autoriteteve vendore
Pse duhet ta përdorni Kartën?	<ul style="list-style-type: none"> – ta përmirësoni gjendjen e të rinjve në komunitetin tuaj – t’i plotësoni nevojat e të rinjve – ta kuptoni se cilat janë të drejtat tuaja – të fitoni qasje në burime – të bëni të dëgjohet dhe të merret parasysh zëri i të rinjve – të ndikoni në jetën e komunitetit tuaj vendor – të gjeni mënyra për bashkëpunim konstruktiv me autoritetet vendore – ta zhvilloni bashkëveprimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm për t’i arritur qëllimet tuaja – t’i shfrytëzoni shkathtësitë dhe talentet tuaja për të mirën e të tjerëve – të kontribuoni në jetën e komunitetit tuaj – të fitoni shkathtësi të reja – të fitoni përvojë të dobishme – të mësoni se si funksionon demokracia vendore 	<ul style="list-style-type: none"> – ta përmirësoni gjendjen e të rinjve në komunitetin tuaj – t’i plotësoni nevojat e të rinjve – t’i përfaqësoni interesat e të rinjve në mënyrë me efikase – t’i fuqizoni të rinjtë të marrin pjesë – të krijoni mënyra të reja për pjesëmarrjen e të rinjve – të krijoni mjedis më të favorshëm të punës – ta plotësoni deklaratën e misionit dhe qëllimet e organizatës suaj – të përfitoni nga bashkëpunimi me autoritetet vendore – ta zhvilloni bashkëveprimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm për t’i arritur qëllimet tuaja – të fitoni përvojë të dobishme 	<ul style="list-style-type: none"> – ta përmirësoni gjendjen e të rinjve në komunitetin tuaj – t’i kuptoni dhe t’i plotësoni nevojat e të rinjve – ta njihni dhe ta vlerësoni rolin e të rinjve – të merrni vendime më të mira dhe më të informuara – të jeni më përfaqësues – të krijoni hapësirë për të rinjtë që të kontribuojnë për të mirën e përgjithshme – të krijoni hapësirë për të rinjtë që ta praktikojnë demokracinë – të gjeni mënyra të tjera të bashkëveprimit me të rinjtë dhe organizatat e të rinjve – të përfitoni nga bashkëpunimi me të rinjtë dhe organizatat – ta zhvilloni politikën vendore për të rinjtë – ta përmirësoni imazhin tuaj publik



<p>Si mund ta përdorni Kartën?</p>	<ul style="list-style-type: none"> – t’i zbuloni fushat në të cilat mund të merrni pjesë në nivel vendor – t’i formuloni nevojat e të rinjve në komunitetin tuaj vendor, duke e përdorur Kartën si bazë – t’i informoni aktorët vendor për ekzistencën e Kartës dhe për përmbajtjen e saj – ta promovoni versionin e Kartës që është i përshtatur për të rinjtë në shkolla, klube dhe te grupet e të rinjve – të ndikoni te përfaqësuesit tuaj kombëtarë në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës që ta shpërndajnë Kartën dhe praktikatat e mira që kanë të bëjnë me Kartën – të ndikoni te organizatat e të rinjve dhe tek autoritetet vendore që t’i zbatojnë rekomandimet e Kartës – ta përdorni Kartën për të ndikuar tek autoritetet vendore për çështje të politikave – ta përdorni Kartën si “pasaportë” për ta siguruar pjesëmarrjen tuaj në projekte dhe iniciativa – të bëni hulumtim për gjendjen vendore – të inicioni dhe të zbatoni projekte për pjesëmarrjen e të rinjve duke u bazuar në qasjen “DMHMM” 	<ul style="list-style-type: none"> – t’i formuloni nevojat e të rinjve në komunitetin tuaj vendor, duke e përdorur Kartën si bazë – t’i informoni aktorët vendor për ekzistencën e Kartës dhe përmbajtjen e saj – të ndikoni tek autoritetet vendore që t’i zbatojnë rekomandimet e Kartës – të zhvilloni qëndrime për çështjet vendore – të ndikoni mbi politikën vendore për të rinjtë – ta shpërndani Kartën dhe praktikatat e mira që kanë të bëjnë te palët e interesuara – të ndërtoni partneritete me organizatat që kanë qëllime të ngjashme me tuajat, për t’i arritur qëllimet tuaja që të ndikoni te përfaqësuesit kombëtarë në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës – t’i përfshini parimet që promovohen në Kartë në fusha të ndryshme të punës, në deklaratën tuaj të misionit, te qëllimet, prioritetet dhe politikatat – t’i përfshini të rinjtë në proceset e vendimmarrjes – të inicioni dhe të zbatoni projekte për pjesëmarrjen e të rinjve duke u bazuar në qasjen “DMHMM” – ta shfrytëzoni Kartën si instrument për trajnim për pjesëmarrjen e të rinjve 	<ul style="list-style-type: none"> – të bëni hulumtim të mirëfilltë për gjendjen e të rinjve në kontekstin vendor, që të vlerësoni në mënyrë adekuate se cilat janë sfidat kryesore që duhet trajtuar – të zhvilloni shërbime që përgjigjen nevojave të të rinjve – t’i zbatoni masat e propozuara në Kartë – ta përdorni Kartën si pikë referimi gjatë zhvillimit të politikës vendore ndër sektoriale për të rinjtë – t’i përfshini vlerat dhe parimet që promovohen në Kartë në fusha të ndryshme të punës – t’i përfshini të rinjtë në marrjen e vendimeve që ndikojnë mbi jetën e tyre (për shembull, duke e praktikuar sistemin e bashkë-menaxhimit) – t’i mbështetni format e ndryshme të pjesëmarrjes së të rinjve – të krijoni organe konsultative për çështjet që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me të rinjtë – të ndërtoni sisteme dhe struktura vendore të pjesëmarrjes – ta monitoroni shkallën e pjesëmarrjes në nivel vendor
---	---	---	--



<p>Cilat janë përparësitë dhe anët e fuqishme që i keni?</p>	<ul style="list-style-type: none"> – i takoni komunitetit vendor – jeni pjesë e madhe e popullatës vendore – e njihni shumë mirë gjendjen vendore – të jeni të motivuar për ta përmirësuar gjendjen e të rinjve – të jeni të hapur për të bashkëpunuar dhe për të mësuar – të jeni të gatshëm për të eksperimentuar – të keni talent dhe potencial që duhet të shfrytëzohet për të mirën e komunitetit 	<ul style="list-style-type: none"> – të keni përvojë në kryerjen e punës pjesëmarrëse – të jeni urë për pjesëmarrje për të rinjtë – të jeni pjesë e kontekstit vendor – njohja shumë e mirë e gjendjes vendore – ndonjëherë jeni lidhje ndërmjet të rinjve dhe autoriteteve vendore – të jeni pjesë e rrjeteve vendore – të keni qasje në burime – të keni informata për atë se ku mund të siguron burime shtesë 	<ul style="list-style-type: none"> – të jeni afër të rinjve – njohja e gjendjes vendore (politike, shoqërore, ekonomike, etj.) – njohja e iniciativave dhe e rrjeteve vendore dhe të qenit pjesë e tyre – të keni qasje në burime – të keni informata për atë se ku mund të siguron burime shtesë – të keni fuqi dhe legjitimet t'i vendosni rregullat vendore – të keni fuqi për vendimmarrje për të ndikuar në gjendjen vendore
---	---	--	--



<p>Çka ju duhet që të mund ta përdorni Kartën në mënyrë sa më efikase?</p>	<ul style="list-style-type: none"> – ta dini se Karta ekziston dhe cili është statusi i saj ligjor – t’i zhvilloni njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat e nevojshme për të marrë pjesë në nivel vendor – t’i zhvilloni shkathtësitë dhe kompetencat e nevojshme për të punuar me grupmoshat e tjera – të fitoni shkathtësi për ndikim dhe avokatësi efektive – të fitoni njohuri për mekanizmat e demokracisë vendore – t’i kuptoni proceset e vendimmarrjes vendore dhe fushat e përgjegjësisë së aktorëve të ndryshëm – të dini si ta përdorni Kartën – të trajtoheni për zbatimin e Kartës – të fitoni mbështetje morale dhe praktike nga aktorët e ndryshëm – të keni qëndrim pozitiv ndaj punës me të rriturit dhe autoritetet vendore – të zhvilloni strategji për të pasur qasje te burimet e ndryshme – të keni vetëbesim 	<ul style="list-style-type: none"> – ta dini se Karta ekziston dhe cili është statusi i saj ligjor – të identifikoni dhe të zhvilloni mënyra të reja të punës dhe të funksionimit që janë më të afërta për të rinjtë – të keni politika relevante afatgjate që tashmë janë vënë në funksion – të keni qëndrim pozitiv ndaj autoriteteve vendore – t’i zhvilloni shkathtësitë dhe kompetencat e nevojshme për ta lehtësuar pjesëmarrjen në nivel vendor – t’i zhvilloni shkathtësitë dhe kompetencat e nevojshme për të punuar me të rinjtë – t’i zhvilloni shkathtësitë dhe kompetencat e nevojshme për të punuar me autoritetet vendore – të trajtoheni për zbatimin e Kartës – të gjeni shembuj se si është përdorur karta në komunitetet ose në rajonet e tjera – të zhvilloni strategji për të pasur qasje te burimet e ndryshme 	<ul style="list-style-type: none"> – ta dini se Karta ekziston dhe cili është statusi i saj ligjor – të keni gatishmëri politike për përkushtim afatgjatë për çështjet që kanë të bëjnë me të rinjtë – të jeni të vetëdijshëm për rëndësinë e pjesëmarrjes së të rinjve – të keni qëndrim pozitiv ndaj të rinjve dhe aftësive të tyre – të identifikoni dhe të zhvilloni mënyra të reja të punës dhe të funksionimit që janë më të afërta për të rinjtë – t’i zhvilloni shkathtësitë dhe kompetencat e nevojshme për të punuar me të rinjtë – të trajtoheni për zbatimin e Kartës – të gjeni shembuj se si është përdorur Karta në komunitetet ose në rajonet e tjera – të jeni të gatshëm ta ndani me të tjerët vendimmarrjen në disa fusha – të keni në dispozicion burime të ndryshme – të keni politika relevante afatgjate që tashmë janë vënë në funksion – ta pranoni si sfidë punën në pjesëmarrjen e të rinjve
---	--	--	---



Që të mund ta përdorin Kartën në mënyrë efektive, të gjitha grupet dhe aktorët kanë nevojë për shkathtësi, njohuri dhe aftësi të caktuara, si dhe për qëndrim adekuat, shembujt e të cilave u përmendën më lartë. Megjithatë, ato janë vetëm shembuj, dhe kanë për qëllim t'u ndihmojnë grupeve dhe aktorëve të identifikojnë se cilat shkathtësi ndoshta kanë nevojë t'i përfitojnë që të mund t'i përdorin rekomandimet e Kartës në mënyrën më të mirë.

Mendoni

- 1. Cilat janë përfitimet që do të dëshironit t'i shihni në komunitetin ose organizatën tuaj nga zbatimi i Kartës?*
- 2. Cilat veprime ose ide që u përmendën në tabelën e mësipërme duhet të ndërmerren në mjedisin tuaj vendor?*

→ 4.2. Si ta përdorni Kartën në praktikë?

a. Modeli me gjashtë hapa


Karta është një mjet dinamik dhe ajo mund të përdoret në shumë mënyra në mjedise të ndryshme. Nuk ka ndonjë model universal që do të funksiononte në çdo qytet, rajon dhe shtet anembanë Evropës. Prandaj, është detyrë e autoriteteve vendore, organizatave dhe e të rinjve që janë të interesuar për pjesëmarrjen e të rinjve në nivel vendor, t'i identifikojnë mënyrat e mundshme të përdorimit të Kartës në kontekstet e tyre, varësisht nga nevojat, situatat, burimet e tyre, etj.

Megjithatë, ka një model që mund të jetë i dobishëm për të ofruar një udhëzim të përgjithshëm për identifikimin e masave të nevojshme praktike për t'i zbatuar rekomandimet e Kartës së rishikuar në komunitetin vendor. Modeli përbëhet prej gjashtë hapash dhe në rastin ideal duhet të përdoret nga autoritetet vendore, organizatat dhe të rinjtë duke punuar së bashku për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve.

Procesi gjashtë hapësh që është përshkruar më poshtë, mund të iniciohet në cilindo qoftë komunitet në Evropë, mirëpo ka nevojë për përgatitje të mirë në aspekt të:

- identifikimit të grupeve ose të aktorëve që duhet të marrin pjesë;
- qartësisht të qëllimeve dhe të motiveve të aktorëve;
- informacionit për atë se çka, kur, si dhe me kë do të realizohet procesi;
- kuptimit të rëndësisë së pjesëmarrjes së të rinjve, dobive dhe kufizimeve të saj;
- zhvillimit të shkathtësive të nevojshme, gjegjësisht shkathtësive që nevojiten për të bërë analizë shoqërore, planifikim, komunikim dhe vendimmarrje, etj.;
- krijimit të partneriteteve ku secili e di se cili është roli i tij/saj dhe e di saktësisht se si mund të kontribuojë për procesin;
- sigurimit të burimeve të nevojshme, siç është koha, hapësirat për mbledhje dhe mundësisht mjetet financiare (për shembull, për kompensim të shpenzimeve për udhëtim).





Hapi 1 – Cila është gjendja e të rinjve në rajonin/ qytetin/ fshatin/ zonën tuaj?

Aktorët vendorë e njohin shumë mirë situatën në komunitetin dhe mjedisin e tyre dhe ata i dinë faktorët që ndikojnë në përfshirjen e të rinjve. Mirëpo, pasi që çdo aktor e sheh gjendjen nga këndvështrimi i tij/saj, ka nevojë për t’u ulur në tryezë që të shkëmbehen pikëpamjet dhe mendimet për atë se çka me të vërtetë është duke ndodhur në një qytet ose në fshat. Perceptimet e realitetit shpeshherë mund të dallojnë shumë dhe kjo fazë kërkon mjaft kohë dhe mjete të veçanta (si p.sh. metoda dhe teknika që përdoren për analizë shoqërore) ose madje edhe ekspertizë të jashtme, ashtu që të gjithë aktorët t’i kuptojnë më mirë pikëpamjet e të tjerëve para se të kalohet në fazën e ardhshme. Analiza e gjendjes mund të bëhet nëpërmjet vëzhgimit dhe analizës së përvojës, mirëpo ndonjëherë mund të ketë nevojë të kërkohet nga ndonjë person ose organ i jashtëm, që nuk është i përfshirë në çështjet vendorë në bazë të përditshme, të bëjë një hulumtim.

Hapi 2 – Cilat janë mundësitë, sfidat dhe pengesat me të cilat ballafaqohen të rinjtë?

Analiza e gjendjes së të rinjve në mjedisin vendor duhet bërë që të identifikohen problemet më të rëndësishme me të cilat ballafaqohen ata. Ato mund të jenë të lidhura drejtpërdrejtë me pjesëmarrjen e të rinjve (për shembull, mundësitë shumë të kufizuara për të marrë pjesë në aktivitetet kulturore ose mungesa e burimeve), ose mund të jenë faktorë të tjerë që mund të duket se nuk janë të lidhur drejtpërdrejt me pjesëmarrjen, siç janë shkurtime dhe buxheti në komunitetin vendor.

Hapi 3 – Cilat duhet të jenë prioritetet?

Në përgjithësi, të rinjtë ballafaqohen me shumë sfida dhe probleme dhe nuk ka mundësi që të gjitha ato të trajtohen në të njëjtën kohë. Prandaj, shikuar në afat të shkurtër, aktorët vendor duhet të caktojnë fusha të prioritetit, që duhet të trajtohen në fillim, veçanërisht nëse burimet me të cilat disponohet janë të kufizuara. Ky mund të jetë një proces i vështirë, për shkak se aktorët e ndryshëm mund të kenë mendime të ndryshme për atë cila çështje duhet të trajtohet e para dhe pse. Për këtë arsye, analiza e gjendjes duhet të merret seriozisht, dhe në këtë mënyrë të lehtësohet procesi i identifikimit të prioriteteve.

Hapi 4 – Çka propozon Karta?

Pasi të arrihet marrëveshje për fushat e prioritetit mund t’i referohemi Kartës për t’i gjetur masat dhe praktikatat përkatëse për t’i trajtuar problemet e veçanta. Këto rekomandime mund të gjenden në pjesë të ndryshme të Kartës dhe për këtë arsye është me rëndësi që të analizohet jo vetëm pjesa relevante për politikatat sektoriale, por edhe rekomandimet që kanë të bëjnë me instrumentet dhe pjesëmarrjen institucionale.

Hapi 5 – Si ndërlidhet Karta me prioritetet?

Në këtë fazë, aktorët duhet të identifikojnë në mënyrë të saktë se si Karta i trajton fushat e prioritetit që janë caktuar në Hapin 3. Edhe pse Karta trajton një diapazon të gjerë të fushave që kanë të bëjnë me përfshirjen e të rinjve, ka mundësi që problemet të prioritetit që janë identifikuar në Hapin 3, të mos jenë trajtuar, ose të jenë trajtuar në masë të kufizuar. Në rastet e tilla, aktorët inkurajohen që të kërkojnë mjete të tjera që mund t’i ofrojnë organizatat e ndryshme ose institucionet që janë aktive në nivelet rajonale, kombëtare ose ndërkombëtare.



Mendoni

1. Cilat sfida me të cilat ballafaqohen të rinjtë në kontekstin tuaj vendor duhet të trajtohen në fillim?
2. Pse?
3. Çfarë masash propozon Karta në lidhje me sfidat që i përmendët?
4. Cilat parime që i promovon Karta duhet të respektohen gjatë zbatimit të rekomandimeve relevante?

Sugjerim: fillimisht pyetjeve të mësipërme duhet t'u përgjigjen aktorët e ndryshëm e pastaj përgjigjet të krahasohen dhe të diskutohen. Në këtë mënyrë, më lehtë do të shihen dhe do të kuptohen ngjashmëritë dhe dallimet në perceptime, pikëpamje dhe mendime.

Vërejtje

Në këtë fazë, është me rëndësi të theksohet se ka mundësi të zbatohet edhe një qasje tjetër: në fillim të njoftoheni me përmbajtjen e Kartës, e pastaj të vendosni se cilat fusha që i trajton karta janë më të rëndësishme. Kjo do të rezultonte me një radhitje tjetër të hapave: Hapi 1 – njoftimi me Kartën dhe përmbajtjen e saj; Hapi 2 – analiza e gjendjes vendore në raport me fushat e ndryshme të pjesëmarrjes të cilat trajtohen në Kartë; Hapi 3 – identifikimi i sfidave më të rëndësishme; Hapi 4 – caktimi i prioritetëve; Hapi 5 – lidhja e prioritetëve me rekomandimet dhe masat e veçanta që propozohen në Kartë.

Hapi 6 – Si të planifikohen hapat e ardhshme për përdorimin e Kartës

Kjo është faza e fundit e modelit gjashtë hapësh, mirëpo në fakt është hapi i parë në procesin e zbatimit të Kartës për trajtimin e gjendjes vendore. Pasi të gjenden rekomandimet e veçanta të Kartës, aktorët duhet të diskutojnë si mund t'i zbatojnë këto masa në kontekstin e tyre vendor dhe duhet të planifikojnë saktë se çka duhet bërë, ku, si, kush dhe me cilat resurse. Karta le një hapësirë mjaft të madhe që aktorët vendor të vendosin si mund të caktohen praktikrat ose si mund të arrihen qëllimet, në mënyrë që të gjenden zgjidhjet më adekuate për çdo komunitet ose rajon.

b. Qasja DMHMM

Karta mund të përdoret jo vetëm në nivel të politikave vendore ose vendimmarrjes vendore, por edhe brenda institucioneve ose organizatave, si dhe në kuadër të projekteve të të rinjve, për shkak se i promovon ato vlera dhe parime që e përforcojnë pjesëmarrjen e rëndësishme të të rinjve. Qasja DMHMM paraqet mjet me të cilin vlerësohet se a janë plotësuar kushtet adekuate për pjesëmarrjen e të rinjve dhe atë tashmë e shqyrtuam në hollësi në Kapitullin 3 të këtij doracaku. Kjo qasje ofron një kornizë që mund të ndihmojë të zbulohet se a kanë të rinjtë të drejtë, mjete, hapësirë, mundësi dhe mbështetje në kuadër të komuniteteve, organizatave ose projekteve – me fjalë të tjera, a i kanë elementet e nevojshme për pjesëmarrjen e tyre kuptimplote.

c. Qasja pjesëmarrëse për planifikimin e projekteve për të rinjtë

Ndjekja e parimeve të promovuar në Kartë në fushën e menaxhimit të projekteve është edhe një mënyrë e përdorimit të Kartës në praktikë. Në Kapitullin 5 të këtij doracaku do të jepet një përshkrim më i hollësishëm për atë se si mund të organizohen dhe të zbatohen projektet për të rinjtë që të mundësohet pjesëmarrja më kuptimplote.



KAPITULLI 5

Projektet për pjesëmarrjen e të rinjve


5.1. Menaxhimi i projekteve për pjesëmarrjen e të rinjve

Njëra nga fushat kryesore të pjesëmarrjes së të rinjve është ajo e projekteve për të rinjtë³⁴, që janë të organizuara për, me dhe nga të rinjtë. Në kontekst vendor, zakonisht kjo është mundësia e parë për një të ri/re të përfshihet në ndonjë aktivitet që është i dobishëm jo vetëm për veten e tij/saj, por edhe për një grup më të gjerë ose për komunitetin. Prandaj, projektet për të rinjtë mund të jenë një hap shumë i rëndësishëm që të rinjtë ta përjetojnë në realitet se si funksionon pjesëmarrja.

Mendoni

- 1.A jeni i përfshirë në ndonjë projekt për të rinjtë? Në çfarë roli?
- 2.A është projekti juaj i organizuar PËR të rinjtë?
- 3.A është projekti juaj i organizuar ME të rinjtë?
- 4.A është projekti juaj i organizuar NGA të rinjtë?
- 5.Cilat janë pasojat për projektin tuaj nga kjo PËR/ME/NGA të rinjtë?

Projektet pjesëmarrëse



Dimensionet e pjesëmarrjes së të rinjve në projektet për të rinjtë

Projektet janë mënyrë e shkëlqyer për ta përmirësuar pjesëmarrjen e të rinjve në nivele të ndryshme, veçanërisht në atë vendor. Diagrami tregon se si përfshirja e të rinjve mund të lidhet drejtpërdrejt me qëllimet dhe/ose objektivat e projektit, mirëpo mund të jetë edhe strategji ose metodologji që është zgjedhur me qëllim që të arrihen synimet e projektit.

34. Shih definicionin e termit “projekt” në: “Pako me vegla për menaxhim të projekteve” (“Project management T-kit”), Këshilli i Evropës dhe Komisioni Evropian, nëntor 2000, faq. 27-29. Gjetet në ueb-faqen: www.training-youth.net/INTEGRATION/TY/Publications/tkits/tkit3/tkit3.pdf.

Në rastin ideal, të dyja këto dimensione duhet të jenë të pranishme që natyra e projektit të jetë me të vërtetë pjesëmarrëse.

Pjesëmarrja e të rinjve si qëllim dhe/ose objektivi i projektit

Në përgjithësi, projektet për të rinj trajtojnë çështje apo sfida nga më të ndryshmet, të cilat zakonisht janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte me pjesëmarrjen, dhe kanë për qëllim arritjen e gjendjes ku të rinjtë mund të kenë ndikim më të madh në vendimet ose veprimet që ndikojnë në jetën e tyre. Për shembull, projektet mund të përqendrohen në fuqizimin e të rinjve që të marrin pjesë (duke i zhvilluar shkathtësitë ose vetëdijen, duke ofruar disa informacione ose mjete, etj.), apo mund të përqendrohen në largimin e pengesave për pjesëmarrjen e të rinjve, në ndërtimin e strukturave ose të infrastrukturës për pjesëmarrje, ose në krijimin e partneriteteve ndërmjet të rinjve dhe të rriturve, etj. Megjithatë, mbetet pyetja se në çfarë mase projektet që përqendrohen ekskluzivisht në hobit e të rinjve (sikurse luajtja e lojërave kompjuterike ose mbledhja e gjërave të ndryshme) mund të shihen si përpjekje për promovimin e pjesëmarrjes të rëndësishme të të rinjve.

Pjesëmarrja e të rinjve si metodologji e projekteve

Në publikimin “Pako me vegla për menaxhimin e projekteve” (“Project management T-kit”) të Këshillit të Evropës, sqarohet se metodologjia e projektit është proces shoqëror, arsimor ose organizativ nëpërmjet të të cilit bëhet përpjekje për t’i arritur objektivat në mënyrë koherente; mënyra në të cilën aktivitetet e ndryshme do të plotësohen njëra me tjetrën për t’i arritur objektivat³⁵. Metodologjia mund të përshkruhet si një qasje që e udhëheq procesin e organizimit dhe të realizimit të projektit. Zgjedhja e qasjes pjesëmarrëse për një aktivitet ka disa efekte shumë të rëndësishme në atë se pse, si, me kë dhe për kë realizohet projekti. Në praktikë, kjo do të thotë se pjesëmarrësit kanë ndikim real në të gjitha elementet e projektit dhe se përgjegjësia dhe fuqia vendimmarrëse mbi aspektet e ndryshme është e ndarë me të rinjtë ose u është deleguar atyre në tërësi.

Mendoni

1. Në çfarë mënyre është i pranishëm dimensionimi i pjesëmarrjes së të rinjve si objektivi në projektin tuaj?
2. Në çfarë mënyre është i pranishëm dimensionimi i pjesëmarrjes së të rinjve si metodologji në projektin tuaj?
3. A mund projektet që përqendrohen ekskluzivisht në hobit e të rinjve (sikurse luajtja e lojërave kompjuterike ose mbledhja e gjërave të ndryshme) të shihen si përpjekje për promovimin e pjesëmarrjes kuptimplote të të rinjve? Çka mendoni?

Vlerat në projektet pjesëmarrëse

Projektet pjesëmarrëse për të rinjtë nuk janë pa vlera. Organizuesi i projektit dhe të gjithë aktorët e përfshirë duhet ta kenë të qartë se çka duan dhe duhet të sigurojnë se pjesëmarrja kuptimplote e të rinjve mund të arrihet. Vlerat kryesore që duhet t’i kenë projektet pjesëmarrëse janë këto:

- respekti i ndërsjellë: të pranohet se njerëzit e tjerë (të rinjtë, e po ashtu edhe të rriturit) kanë të drejtë të kenë mendime dhe pikëpamje të ndryshme;
- të kuptohet shumëllojshmëria kulturore: kërkimi i mënyrave konstruktive për trajtimin e dallimeve që burojnë nga prejardhjet e ndryshme etj.;



- promovimi i qëndrimeve që e luftojnë racizmin, ideologjitë ekstreme ose ksenofobinë, që të rinjtë të mund të kontribuojnë për ndërtimin e shoqërive më tolerante dhe më paqësore;
- bashkëpunimi: aktorët e ndryshëm që janë të interesuar për pjesëmarrjen e të rinjve duhet të punojnë së bashku për t'i arritur qëllimet e përbashkëta dhe duhet të ofrojnë mbështetje të ndërsjellë;
- përgjegjësia: të gjithë aktorët duhet të marrin përgjegjësi për bashkëpunim dhe për rezultatet e arritura;
- pavarësia e të rinjve: të rinjtë duhet të kenë një lloj autonomie në kuadër të projektit;
- përfshirja e grupeve që kanë më tepër vështirësi për të marrë pjesë në jetën publike për shkak të prejardhjes së tyre, aftësive të kufizuara ose pengesave të tjera;
- barazia gjinore: qasja e barabartë në pjesëmarrje duhet t'u ofrohet edhe burrave edhe grave;
- njohja e rolit të edukimit joformal si mjet për t'u ndihmuar të rinjve për të marrë pjesë;
- qasja me respekt ndaj të drejtave të njeriut;
- qasja jo diskriminuese.

Qasja pjesëmarrëse në menaxhimin e projekteve

Menaxhimi i projekteve thjesht mund të sqarohet si proces i plotë i inicimit, planifikimit, zbatimit, vlerësimit dhe në fund, përmbylljes së projektit. Kur organizuesi i projektit zgjedh një metodologji që është e bazuar në parimet e pjesëmarrjes të rëndësishme, kjo nënkupton se të rinjtë janë të përfshirë në aspektet e ndryshme të menaxhimit të projektit; se ata kanë fuqi të ndikojnë mbi vendimet dhe proceset dhe se atyre u është ofruar mundësia t'i shprehin mendimet dhe pikëpamjet e tyre. Të rinjtë mund të përfshihen në menaxhimin e projekteve në role dhe cilësi të ndryshme, varësisht nga ajo se si janë marrë vesh të dyja palët.

Mendoni

1. Cilat vlera janë të pranishme në projektin tuaj?
2. Kush i ka caktuar ato?
3. Si i dallojnë këto vlera aktorët e projektit dhe publiku i jashtëm?
4. A ju kujtohen vlera të tjera që nuk janë përmendur këtu, por të cilat janë të rëndësishme për ju?

→ 5.2. Hap pas hapi: planifikimi dhe menaxhimi i një projekti për të rinj

Ekzistojnë lloje të ndryshme të modeleve që e ilustronë ose e strukturojnë procesin e përgatitjes, realizimit dhe të vlerësimit të projekteve. Është përgjegjësi e personit apo ekipit që e udhëheq projektin ta zgjedhë modelin më të përshtatshëm për kontekstin e dhënë, duke i marrë parasysh burimet që janë në dispozicion. Në vitet e fundit, modeli që është përdorur shumë shpesh në punën me të rinjtë është modeli i propozuar në "Pakon me vegla për menaxhimin e projekteve"³⁶. Prandaj, do të përdoret ky model si pikë fillestare për shqyrtimin e mëtejshëm.

36. Po aty.,faq. 43.

Detyrë:

1. Njihuni për së afërmi me publikimin “Pako me vegla për menaxhimin e projekteve”.
Në veçanti, lexojeni Kapitullin 3, me titull “Projekti: hap pas hapi”.
2. Mendoni një projekt që doni ta realizoni.

Hapi 1 – Njohja me komunitetin vendor dhe gjendjen

Projektet për të rinj realizohen në komunitete të caktuara dhe kanë për qëllim të krijojnë ndryshim shumë konkret dhe të dukshëm shoqëror. Prandaj, para se të fillojë një projekt, duhet të merren sa më tepër informata për gjendjen dhe sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen të rinjtë e komunitetit. Është shumë e dobishme të njihen shqetësimet dhe mundësitë potenciale të popullatës vendore në një komunitet të caktuar për t’i vlerësuar nevojat e të rinjve që jetojnë atje, si dhe nevojat e komunitetit në përgjithësi.

Mendoni (në lidhje me Hapin1)

1. Cila është gjendja e të rinjve në kontekstin tuaj vendor (përqindja e popullatës, mjedisi, gjendja financiare, shkollimi, aktivitetet e kohës së lirë, etj.)?
2. Çfarë lloji i politikës për të rinj ekziston dhe zbatohet në komunitetin tuaj?
3. Çfarë mundësish kanë të rinjtë për të marrë pjesë në jetën e komunitetit tuaj?
4. Çfarë iniciativash ose projektesh për të rinj janë duke u realizuar momentalisht në komunitetin tuaj? Prej kujt?
5. Cila është lidhja juaj me të rinjtë në komunitetin tuaj (a jeni udhëheqës i të rinjve, punëtor social, person përgjegjës për çështjet e të rinjve në autoritetet vendore etj.)?

Hapi 2. a – Analiza e nevojave

Projektet për të rinj mund të organizohen për arsye të ndryshme, mirëpo në masë të madhe ato duhet të jenë të lidhura për nevojat e të rinjve dhe nevojat e komunitetit vendor në përgjithësi. Nuk mjafton vetëm dëshira për të organizuar diçka! Në qoftë se projekti dëshiron të bëjë ndryshim të mirëfilltë, duhet t’i trajtojë problemet e veçanta ose mangësitë që janë vërejtur në nivel vendor, dhe është detyrë e udhëheqësit të projektit t’i identifikojë këto sfida dhe të vendosë se cilat prej tyre do të trajtohen nga projekti. Që të njihen nevojat vendore duhet të bëhet “analizë e nevojave”, e cila “i përfshin kushtet shoqërore, politike dhe ekonomike që ekzistojnë në zonën e projektit që e bëjnë projektin të nevojshëm”³⁷ Edhe pse organizuesit e projekteve ndonjëherë e nënvlerësojnë ose bile edhe e anashkalojnë këtë hap, në fakt, ai është njëri ndër hapat më të rëndësishëm në gjithë procesin e përgatitjes së projektit, për shkak se bën me dije se cili duhet të jetë qëllimi i projektit. Ekzistojnë metoda dhe teknika të shumta që ndihmojnë për t’i identifikuar nevojat vendore. Shembuj të tyre janë vëzhgimet, intervistat, anketat, grupet e fokusit, analizat e skenarëve dhe shumë të tjera, dhe është detyrë e organizuesit të projektit që ta zgjedhë metodën më adekuate në bazë të llojit të informacionit që nevojitet dhe burimeve dhe ekspertizës që janë në dispozicion. Në rastin e projekteve vendore për të rinjtë, kur burimet zakonisht janë shumë të kufizuara, organizuesit e projekteve shpeshherë i përdorin metodat më të thjeshta për t’i analizuar nevojat vendore dhe, në shumicën e rasteve, këto janë më se të mjaftueshme, përderisa në gjithë procesin janë të përfshira disa palë.



Mendoni (në lidhje me Hapin 2. a)

1. *Cilat janë sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen të rinjtë në komunitetin tuaj, veçanërisht në fushën e pjesëmarrjes në jetën vendore? Cili është shkaktari/ët e tyre?*
2. *Si e dini se ato janë sfidat kryesore? Cili është burimi juaj i informacionit?*
3. *Çka është bërë deri tani për ta përforcuar pjesëmarrjen e të rinjve në nivel vendor? Cilat janë rezultatet?*
4. *Çka tjetër duan të bëjnë të rinjtë për ta përforcuar pjesëmarrjen e tyre në jetën vendore?*
5. *Në çfarë mase është i interesuar komuniteti juaj vendor për ta mbështetur këtë?*
6. *Çfarë ka për qëllim të ndryshojë projekti juaj për të rinjtë e synuar?*
7. *Pse projekti juaj është i rëndësishëm për të rinjtë dhe për gjithë komunitetin?*

Hapi 2. b – Analiza institucionale

Projektet për të rinj zakonisht i përgatisin dhe i realizojnë grupet, organizatat ose institucionet që në një mënyrë ose në tjetrën janë të lidhura me punën për të rinjtë. Edhe pse projektet duhet t'i trajtojnë nevojat lokale dhe duhet të kontribuojnë për ndryshimin shoqëror, ato duhet të jenë adekuate edhe për institucionin e përfshirë, për vlerat dhe prioritetet e tij. Realizimi i projektit në kuadër të një institucioni mund të sjellë shumë dobi, siç është shfrytëzimi i përvojës, hapësirave dhe infrastrukturës ose burimeve të tjera ekzistuese, mirëpo nga ana tjetër mund të shkaktojë dhe shumë vështirësi. Prandaj, para se të fillohet një projekt është me rëndësi të parashtrihen disa pyetje që mund të ndihmojnë të shihet se sa përputhen projekti dhe institucioni njëri me tjetrin. Kjo quhet “analizë institucionale”.

Mendoni (në lidhje me Hapin 2. b)

1. *Cila është lidhja ndërmjet të rinjve dhe institucionit që e realizon projektin?*
2. *A është pjesëmarrja e të rinjve një vlerë e rëndësishme për këtë institucion? Si e dini këtë?*
3. *Si mund të rinjtë të përfshihen në punën e këtij institucioni (jo vetëm në kuadër të projektit të propozuar, por edhe në fusha të tjera)?*
4. *Cili do të ishte roli i institucionit në projekt?*
5. *Çfarë dobish dhe rreziqesh i sjell projekti juaj këtij institucioni?*

Hapi 2. c – Motivi personal

Në organizimin e një projekti për të rinjtë përfshihen motive të ndryshme. Tashmë u përmend se motivi më i rëndësishëm duhet të jetë i lidhur me ndonjë nevojë vendore ose me nevojat e të rinjve, mirëpo edhe motivi i njerëzve që punojnë në një projekt luan një rol shumë të rëndësishëm, duke pasur parasysh se organizuesit e projekteve kanë ndikim shumë të madh në aspektet e ndryshme të projektit të tyre.



Mendoni (në lidhje me Hapin 2. c)

1. Pse pjesëmarrja e të rinjve është e rëndësishme për ju?
2. Pse ju personalisht jeni i interesuar ta organizoni këtë projekt? Çka mendoni se do të përfitoni?
3. A përputhet motivi juaj për realizimin e këtij projekti me motivin e institucionit tuaj?
4. Cila është përvoja dhe ekspertiza juaj në fushën e pjesëmarrjes së të rinjve?

Hapi 3 – Përkufizimi i qëllimeve

Hapat e mëparshëm e sqarojnë gjendjen në komunitetin vendor dhe pse është i nevojshëm projekti në atë kontekst të veçantë. Hapi i ardhshëm është të përkufizohet qëllimi i projektit dhe çka shpresohet të arrihet, veçanërisht në afat të gjatë. Qëllimet zakonisht përbëhen nga një situatë ideale në të cilën projekti arrin absolutisht gjithçka që pritet prej tij dhe ndryshimi i planifikuar shoqëror ndodh me të vërtetë. Për nga natyra, qëllimet zakonisht janë të përgjithshme, kështu që në fund të projektit është shumë e vështirë ose madje edhe e pamundur të matet se në ç'masë janë arritur ato. Sidoqoftë, ato japin një ide për drejtimin në të cilin shkohet gjatë gjithë projektit. Disa menaxherë projektësh thonë se përshkrimi i mirë i qëllimeve të projektit, në fakt, është sikur një përmbledhje e shkurtër e projektit që i thekson aspektet më të rëndësishme të tij. Qëllimet janë një element i projektit që nuk mund të ndryshojë – nëse ndryshojnë ato atëherë kjo do të thotë se është krijuar një projekt i ri. Mirëpo, ato që mund të ndryshojnë janë objektivat ose metodat e veçanta të projektit.

Mendoni (në lidhje me Hapin 3)

1. Çka ka për qëllim të ndryshojë projekti juaj në fushën e pjesëmarrjes së të rinjve në komunitetin tuaj vendor?
2. Kush duhet të përfshihet në projekt (cilët aktorë)?
3. Kush do të përfitojë nga projekti dhe në çfarë mënyre/ash?
4. Cili është diapazoni gjeografik i projektit?
5. Fakultative: si do ta bëni këtë? (Kjo nuk është pyetje për aktivitetet ose metodat, por për metodologjinë.)

Hapi 4 – Formulimi i objektivave

Për shkak se qëllimet e projektit janë kryesisht të përgjithshme, dhe jo gjithmonë ka mundësi të maten se në ç'masë janë arritur ato, duhet të formulohen objektiva më konkrete. Ato u tregojnë organizuesve të projektit dhe aktorëve se çka duhet të bëjnë që ta arrijnë ndryshimin shoqëror që e kanë për qëllim. Objektivat duhet të jenë sa është e mundur më konkrete, ashtu që të gjitha palët e përfshira ta kenë të qartë se cilat veprime duhet të ndërmerren dhe të mund të kontrollohet lehtë se a është përfunduar ndonjë veprim ose jo. Ka mënyra të ndryshme për formulimin e objektivave të projektit, ndërsa njëra nga metodat e ka akronimin "SMART". Objektivat janë SMART në qoftë se janë:

- Specifike (Specific): theksohet në mënyrë precize se çka dëshirojmë të bëjmë ose të arrijmë;
- Të matshme (Measurable): ka mundësi të kontrollohet se a janë plotësuar ato dhe në çfarë mase;
- Të arritshme (Achievable): projekti nuk përpiqet ta arrijë të pamundurën;
- Reale (Realistic): mund të arrihen në kontekstin ekzistues dhe me burimet ekzistuese;
- Të kufizuara në kohë (Timed): theksojnë se kur do të realizohen objektivat.



Mendoni (në lidhje me Hapin 4)

1. Çka do të bëhet saktë që të plotësohen nevojat e të rinjve që synohen në projektin tuaj?
2. Sa reale janë këto objektiva?
3. Si dhe kur mund ta kontrolloni se a janë realizuar veprimet e planifikuara?
4. Si do të kontribuojnë këto veprime në arritjen e qëllimit të përgjithshëm të projektit?
5. Si do t'i fuqizoni të rinjtë që të marrin rol aktiv në projektin tuaj?

Hapi 5 – Zgjedhja e metodologjisë

Tashmë u sqarua se çka është metodologjia e projektit dhe sa e rëndësishme është ajo gjatë organizimit të një projekti për pjesëmarrjen e të rinjve. Mirëpo, nuk duhet ngatërruar “metodologjinë” dhe “metodat”, për shkak se metodat janë mjete ose mënyra konkrete për të bërë ndonjë gjë (si për shembull, disa lloje të aktiviteteve ose të ushtrimeve). Kur planifikohet metodologjia e një projekti pjesëmarrës, është shumë me rëndësi të sigurohet se:

- të rinjtë e ndjejnë projektin si të vetin;
- të rinjtë e kuptojnë se cili është qëllimi i projektit dhe çka dëshirohet të arrihet me të;
- të rinjtë mund të ndikojnë në elementet e ndryshme të projektit;
- të rinjtë kanë përgjegjësi në kuadër të projektit;
- të rinjtë kanë detyra të rëndësishme për të kryer;
- të rinjtë kanë hapësirë për t'i shprehur mendimet dhe pikëpamjet e tyre për projektin;
- të rinjtë kanë mundësi t'i mësojnë shkathtësitë e nevojshme për të marrë pjesë në projekt;
- të rinjtë trajtohen si partnerë të projektit, e jo si objekt ose si viktimë;
- llojet e aktiviteteve që realizohen në kuadër të projektit janë të përshtatshme për të rinjtë.

Mendoni (në lidhje me Hapin 5)

1. Si do ta përshkruanit metodologjinë e projektit tuaj?
2. Në çfarë mase kjo metodologji krijon hapësirë për pjesëmarrje të rëndësishme të të rinjve?
3. Cila është përvoja juaj e punës me metodologjinë që është e fokusuar në pjesëmarrjen e të rinjve?
4. A ka nevojë të zhvilloni shkathtësi ose kompetenca të veçanta për të punuar në mënyrë më efikase me një metodologji të tillë?
Cilat janë ato?
5. Ku mund ta merrni mbështetjen e nevojshme për t'i fituar këto shkathtësi dhe kompetenca?

Hapi 6 – Përgatitja e planit të aktiviteteve

Ky është momenti në procesin e përgatitjes së projektit kur mund të përpilohet plani i të gjitha aktiviteteve që do të zhvillohen në kuadër të projektit. Në këtë fazë, është e dobishme të përgatitet një listë me detyra që duhet të kryhen për çdo aktivitet, ashtu që të gjitha palët e interesuara ta kenë të qartë sa punë duhet të bëhet. Kjo, po ashtu mund të ndihmojë të bëhet një vlerësim real i kohës (dhe i burimeve të tjera, si për shembull i mjeteve financiare) që do të nevojitet. Vendi i aktiviteteve në kuadër të një projekti ndonjëherë krahasohet me një ajsberg, sepse vetëm kjo pjesë e projektit është e dukshme për syrin publik. Megjithatë, i gjithë procesi i përgatitjes së projektit është shumë më i gjerë, dhe përfshin shumë detyra dhe hapa që mund të jenë të dukshme vetëm për palët që janë të përfshira në mënyrë të drejtpërdrejtë.





Ajsbergu i projektit

Mendoni (në lidhje me Hapin 6)

1. Cila është rrjedha e aktiviteteve në projektin tuaj?
2. Kur saktësisht realizohen ato? Ku dhe me kë realizohen ato? A është gjithçka e planifikuar në atë mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja e rëndësishme e të rinjve?
3. Kush duhet të jetë përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve të veçanta?
4. Në çfarë mënyre aktivitetet ndërlidhen njëri me tjetrën?
5. Si ndërlidhet çdo aktivitet me objektivat e gjithë projektit?
6. A janë të gjitha objektivat të lidhura me aktivitetet e projektit tuaj?
7. A është plani juaj i arritshëm dhe real? Pse mendoni ashtu?

Hapi 7 – Zbatimi i aktiviteteve

Pasi të përfundohet planifikimi, është koha të fillohet me punë dhe të ecet përpara që të arrihen rezultatet e dëshiruara. Kur flitet për “zbatimin e aktiviteteve” nuk nënkuptohet vetëm menaxhimi i projektit, por edhe kryerja e të gjitha detyrave të ndryshme që nevojiten për t’i përgatitur aktivitetet dhe për t’i përmbyllur ato. Detyrat e tilla përfshijnë:

- menaxhimin e njerëzve të përfshirë dhe të sigurohet se talentet dhe anët e tyre të fuqishme shfrytëzohen në mënyrë efikase;
- inkurajimin e të rinjve të marrin përgjegjësi dhe detyra në kuadër të projektit;
- menaxhimin e burimeve të tjera që janë dispozicion (mjeteve financiare, infrastrukturës, njohurive, kohës, etj.);
- marrjen e vendimeve të përditshme në lidhje me aspektet e ndryshme të projektit;
- të sigurohet se gjërat zhvillohen sipas planit;
- vlerësimin e aspekteve të ndryshme të projektit në baza të rregullta;
- të sigurohet bashkëpunimi mirë me të rinjtë dhe ndërmjet tyre;
- përshtatjen e projektit ndaj rrethanave të reja nëse ka nevojë;
- ballafaqimin me situatat dhe faktorët e paparashikuar që nuk mund të kontrollohen nga menaxheri i projektit.



Mendoni (në lidhje me Hapin 7)

1. Kush do të jetë përgjegjës për zbatimin e gjithëmbarshtëm të projektit?
2. Cilat janë rolet e aktorëve të ndryshëm (për shembull, të rinjve të përfshirë)? A e kanë ata të qartë gjithçka që ka të bëjë me rolet e tyre dhe çka pritet prej tyre?
3. A kanë aktorët kompetenca dhe shkathtësi për ta zbatuar projektin? Për çfarë lloj të mbështetjes ata kanë nevojë dhe si mund të sigurohet kjo mbështetje?
4. Cilat burime nevojiten për ta zbatuar projektin tuaj?
5. Ku do t'i siguroni këto burime?

Hapi 8 – Vlerësimi

Para se të përmbillet një projekt, duhet të bëhet vlerësimi që të shihet se në çfarë mase janë plotësuar objektivat dhe si ka funksionuar procesi i projektit, që të mund të jepen rekomandime për iniciativat e ngjashme në të ardhmen. Shpeshherë vlerësimi shihet si diçka negative – si listë e gjërave që nuk kanë funksionuar. Prandaj, është me rëndësi që ai të planifikohet me kujdes, që të shndërrohet në mundësi për të bërë një vlerësim me cilësi të mirë, që do t'i potencojë arritjet e projektit, si dhe dobësitë e tij. Të rinjtë duhet të jenë pjesëmarrës aktivë të vlerësimit dhe kjo mund të arrihet duke e zbatuar qasjen pjesëmarrëse në vlerësimin e projektit.

Vlerësimi pjesëmarrës duhet të bazohet në këto parime:

- procesi i vlerësimit duhet të ofrojë hapësirë për të rinjtë që të marrin përgjegjësi për detyra të rëndësishme;
- të rinjtë duhet ta kenë të qartë rolin e tyre në vlerësim;
- të rinjtë e kanë të qartë se ç'është vlerësimi;
- vlerësimi planifikohet së bashku me të rinjtë;
- të rinjtë duhet ta kenë mbështetjen e nevojshme për të luajtur rol të rëndësishëm në procesin e vlerësimit;
- mendimet dhe pikëpamjet e të rinjve kanë vlerë të njëjtë sikurse ato të të rriturve;
- vlerësimi është i dobishëm për të rinjtë;
- vlerësimi përqendrohet në të tashmen, të kaluarën dhe të ardhmen e projektit.

Mendoni (në lidhje me Hapin 8)

1. Cili është qëllimi i vlerësimit të projektit tuaj?
2. Cilat aspekte dhe dimensione të projektit planifikoni t'i vlerësoni?
3. Si do ta bëni këtë? A planifikoni të shfrytëzoni ndonjë teknikë dhe metodë të veçantë për vlerësim?
Cilat dhe pse ato?
4. Në çfarë mase të rinjtë kanë marrë pjesë në planifikimin e vlerësimit?
5. Cili është roli i të rinjve në procesin e vlerësimit? A është caktuar ky rol në marrëveshje/biseda me ta?
6. Cilat janë nevojat e të rinjve në lidhje me kompetencat për vlerësim dhe si do t'i plotësoni këto nevoja?
7. Cila është përvoja dhe ekspertiza juaj në realizimin e vlerësimit pjesëmarrës?



Hapi 9–Vazhdimi

Projektet për të rinjtë kanë për qëllim krijimin e ndryshimit pozitiv në kontekstin vendor, ashtu që pasi të përfundohet projekti me sukses, komuniteti vendor dhe/ose të rinjtë mund ta shohin në mënyrë të qartë zhvillimin ose ndryshimin në jetën e komunitetit. Në rastin ideal, kjo do të thotë se rezultatet e projektit do të jenë të qëndrueshme në afat të gjatë.

Mendoni (në lidhje me Hapin 9)

1. Si do të siguroheni se rezultatet e projektit tuaj do të jenë afatgjate?
2. Kush duhet të jetë i përfshirë te vazhdimi dhe si do ta siguronit këtë përfshirje?
3. Cili do të jetë roli i të rinjve në sigurimin e vazhdimësisë së arritjeve të projektit?

→ 5.3 Kriteret për kualitet për projektet pjesëmarrëse

Nuk ka recetë të gatshme që ofron udhëzime hap pas hapi për atë se si duhet të organizohet një projekt i përkryer pjesëmarrës, për shkak se situatat në pjesët e ndryshme të Evropës ose madje edhe brenda një shteti, dallojnë shumë. Megjithatë, një recetë e tillë mund të krijohet nga dhe për komunitetet, grupet ose organizatat e veçanta, ashtu që të përshtatet me situatat e veçanta dhe t’i trajtojë nevojat e tyre më të rëndësishme. Në praktikë, përgatitja e një recete nënkupton të caktohet se çfarë sasive nga secili përbërës duhet përdorur dhe si duhet përdorur, në mënyrë që të përgatitet ushqimi i dëshiruar. Në rastin e projekteve pjesëmarrëse, “kriteri për kualitet” e luan rolin e përbërësve, të cilët mund të përzihen në kombinime të ndryshme. Më poshtë, është dhënë një listë me kritere që mund të ndihmojnë për ta udhëzuar organizuesin e projektit në procesin e krijimit të një projekti plotësisht pjesëmarrës. Kjo listë nuk është e mbyllur dhe kuptohet, në të mund të shtohen edhe kritere të tjera.

Duhet vendosur se në çfarë mase janë plotësuar kriteret nga projekti – me ç’rast 0 nënkupton se kriteri nuk është plotësuar fare, dhe 5 nënkupton se kriteri është plotësuar në tërësi. Pastaj, nëse ka nevojë, mund të planifikohet se si këto kritere mund të plotësohen në masë më të madhe. Ky ushtrim ka për qëllim të ndihmojë në vlerësimin e projekteve ekzistuese dhe të jetë një mjet për vetëvlerësim.

Kriteri që ndërlidhet me qëllimin e projektit	Nota (0-5)	Arsyetimi i notës
Projekti ka për qëllim t’i plotësojë nevojat e të rinjve		
Qëllimet dhe objektivat e projektit janë biseduar dhe janë miratuar me të rinjtë		
Të rinjtë janë vetëdijshëm për dobritë e mundshme nga pjesëmarrja në projekt		



Kriteri që ndërlidhet me qëllimin e projektit	Nota (0-5)	Arsyetimi i notës
Të rinjtë e kuptojnë se cili është qëllimi i projektit		
Të rinjtë që mund të jenë të interesuar të përfshihen kanë qasje të lehtë në informacionin për projektin		
Ekziston infrastruktura e nevojshme për ta mbështetur pjesëmarrjen e të rinjve		
Aktivitetet zhvillohen në vend ku kanë qasje të rinjtë		
Aktivitetet zhvillohen në kohë që është e përshtatshme për të rinjtë (për shembull, jo gjatë orëve të mësimi)		
Procedurat dhe politikat e projektit janë të kuptueshme për të rinjtë		
Dokumentet që kanë të bëjnë me projektin janë të kuptueshme për të rinjtë		
Shpenzimet për pjesëmarrje në projekt kompensohen		
Dizajni i projektit është fleksibil		

Kriteri që ndërlidhet me qëllimin e projektit	Nota (0-5)	Arsyetimi i notës
Të rinjtë kanë qenë të përfshirë në inicimin e projektit		
Të rinjtë janë të përfshirë në përgatitjen e projektit		
Të rinjtë janë të përfshirë në shpërndarjen e informacionit për projektin		
Të rinjtë janë të përfshirë në zbatimin e projektit		
Të rinjtë janë të përfshirë në vlerësimin e projektit		
Të rinjtë janë të përfshirë në vazhdimin e projektit		



Kriteri që ndërlidhet me qëllimin e projektit	Nota(0-5)	Arsyetimi i notës
Projekti është i hapur për të gjithë të rinjtë, pa marrë parasysh gjininë, klasën shoqërore, burimet etj.		
Projekti është i hapur për të rinjtë që nuk janë anëtarë të ndonjë strukture formale të të rinjve		
Projekti krijon mundësi të barabarta për pjesëmarrje për burrat dhe gratë		

Kriteri që ndërlidhet me qëllimin e projektit	Nota (0-5)	Arsyetimi i notës
Të rinjtë e dinë se çka pritet prej tyre		
Të rinjtë janë të vetëdijshëm për përgjegjësitë që i kanë		
Rolet dhe detyrat në kuadër të projektit janë caktuar në biseda dhe në marrëveshje në mes të rinjve dhe të rriturve		
Të rinjtë e dinë identitetin dhe rolet e aktorëve të përfshirë në projekt		
Të rinjtë e dinë se si funksionon procesi i vendimmarrjes në kuadër të projektit		
Të rinjtë janë të pranishëm në nivele të ndryshme të vendimmarrjes në projekt		
Të rinjtë informohen rregullisht për përparimin, sukseset, sfidat dhe zhvillimet më të rëndësishme të projektit		
Mendimet dhe pikëpamjet e të rinjve kanë vlerë të njëjtë sikurse mendimet dhe pikëpamjet e të rriturve		
Të rinjtë kanë detyra dhe role të rëndësishme që duhet t'i realizojnë		
Të rinjtë kanë autonomi në realizimin e detyrave të tyre		
Kontributi i të rinjve njihet dhe vlerësohet		
Të rinjtë kanë fuqi vendimmarrëse në kuadër të projektit		



Kriteri që ndërlidhet me qëllimin e projektit	Nota (0-5)	Arsyetimi i notës
Institucioni që e realizon projektin e mbështet plotësisht përfshirjen e të rinjve		
Mentori ose garantuesi është në dispozicion në qoftë se të rinjtë kanë nevojë për të		
Për të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe ata që janë nga grupet e rrezikuara ofrohet mbështetje speciale		
Të rinjve u jepet mbështetje për zhvillimin e shkathtësive për menaxhim të projekteve		
Të rinjve u jepet mbështetja e nevojshme për përfshirjen e tyre në vendimmarrje		
Të rinjtë kanë mundësi të mësojnë nga gabimet e veta		
Të rinjtë e dinë se çfarë shkathtësish dhe kompetencash duhet të zhvillojnë që të mund të marrin pjesë plotësisht në projekt		

Mendoni

1. Cilat nga kriteret e mësipërme duhet të plotësohen që të mund të flasim për “projekt pjesëmarrës”?
2. Cilat nga kriteret e mësipërme do t’i konsideroni si “të pëlqyeshme” (për dallim nga ato esenciale) për një projekt pjesëmarrës?





Kapitulli 6

Bashkëpunimi në nivelin vendor

→ 6.1 Përgatitja për bashkëpunim

Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve vendore, të rinjve dhe organizatave të tyre është një hap i domosdoshëm për të ndërtuar komunitete të fuqishme dhe demokratike. Siç tregon përvoja, bashkëpunimi i tillë mund të jetë mjaft sfidues, mirëpo ka shumë shembuj të mënyrave konstruktive të bashkëpunimit, ku aktorët e ndryshëm nga skena vendore mund të punojnë së bashku për t'i arritur qëllimet e përbashkëta.

Palët e ndryshme kërkojnë të bashkëpunojnë kur kanë interesa të ngjashme dhe kur shohin se kanë dobi nga puna e përbashkët, dhe për këtë arsye është esenciale të zbulohet se në cilat fusha ka interes të përbashkët ndërmjet autoriteteve vendore dhe të rinjve ose organizatave të tyre. Në rastin ideal, të gjithë partnerët do t'i shprehin nevojat dhe qëllimet e tyre në mënyrë të hapur dhe të sqartë, në mënyrë që të arrihet pajtim për bazën e bashkëpunimit të mëtutjeshëm. Nëse identifikohen qëllime kundërshtuese, ato duhet të trajtohen sa më parë, sepse në të kundërtën, bashkëpunimi mund të pengohet ose madje edhe të bllokohet në fazë të mëvonshme. Mund të përdoren metoda të ndryshme për t'i zbuluar interesat e secilës palë. Në disa komunitete, organizohen mbledhje ku diskutohen këto çështje ndërmjet partnerëve shoqërorë, në disa të tjera përgjegjësia për identifikimin e interesave në bazë të hulumtimit u jepet ekspertëve. Kjo mund të jetë analizë e prioriteteve dhe e politikave të komuniteteve dhe të organizatave, duke i marrë parasysh raportet e ndryshme dhe dokumentet e tjera politike, dhe mund të jetë analizë e veprimeve dhe e projekteve.

Shembuj të interesave të rinjve për të bashkëpunuar me aktorët e tjerë janë:

- përmirësimi i gjendjes së të rinjve në komunitet;
- dhënia e kontributit për përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në komunitetin vendor;
- përfaqësimi i interesave të të rinjve në procesin e vendimmarrjes;
- ndikimi në vendimet dhe politikat vendore;
- dëgjimi i mendimeve të tyre;
- fitimi i qasjes në burime;
- fitimi i mundësi të reja në jetë;
- vendosja e kontakteve të reja;
- fitimi i qasjes në rrjete;
- shfrytëzimi i potencialit, talenteve dhe shkathtësive të tyre;
- shfrytëzimi i kohës së tyre në mënyrë të dobishme;
- fitimi i përvojës së re.



Shembuj të interesave të organizatave rinore për të bashkëpunuar me aktorët e tjerë janë:

- përmirësimi i gjendjes së të rinjve në komunitet;
- dhënia e kontributit për përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në komunitetin vendor;
- përfaqësimi i interesave të të rinjve në procesin e vendimmarrjes;
- ndikimi në vendimet dhe politikat vendore;
- ndërtimi i marrëdhënieve të mira me palët që kanë fuqi vendimmarrëse;
- të jenë të njohur në kontekstin vendor;
- krijimi i përshtypjes së mirë për organizatën në kontekstin vendor;
- reklamimi i aktiviteteve të tyre;
- fitimi i qasjes në burime;
- fitimi i qasjes në shërbime;
- shpërndarja e përvojës së tyre për të mirën e të tjerëve;
- plotësimi i qëllimeve dhe i objektivave të organizatës;
- krijimi i kornizave dhe i strukturave pjesëmarrëse në nivel vendor;
- edukimi, ofrimi i përvojës dhe përgatitja e të rinjve për jetën e tyre në të ardhmen;
- fitimi i përvojës së re.

Shembuj të interesave të autoriteteve vendore për të bashkëpunuar me aktorët e tjerë janë:

- dhënia e kontributit për përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në komunitetin vendor;
- identifikimi më i saktë i nevojave të të rinjve;
- ofrimi i shërbimeve më të mira për të rinjtë;
- përmirësimi i gjendjes së të rinjve në kontekstin vendor;
- parandalimi i problemeve shoqërore;
- zbatimi i planeve të tyre dhe i prioriteteve politike;
- krijimi i pronësisë mbi vendimet te ata që janë të ndikuar nga ato vendime;
- marrja e informatave kthyesë për propozimet dhe idetë;
- përgatitja e të rinjve për përgjegjësitë e ardhshme (për shembull, në aspekt të menaxhimit të komunitetit);
- të jenë të njohur në kontekstin vendor;
- krijimi i përshtypjes së mirë për autoritetet vendore në komunitet
- arsytet politike (të rizgjidhen?).

Kur të arrihet pajtim për interesat e përbashkëta, palët mund të fillojnë t'i kërkojnë fushat e mundshme për bashkëpunim. Për shembull, Karta e rishikuar përmend fushat e papunësisë së të rinjve, arsimin, shëndetësinë, barazinë gjinore dhe zhvillimin e qëndrueshëm, etj. Po ashtu, përmban shembuj konkretë të iniciativave ose të veprimeve që mund të ndërmerren bashkërisht nga aktorët e ndryshëm të skenës lokale.

Bashkëpunimi mund të realizohet në fusha të ndryshme, e po ashtu edhe në nivele të ndryshme. Në disa komunitete, partneritetet krijohen për të trajtuar probleme të veçanta vendore (për shembull, qasja e kufizuar në kulturë) ose për të zbatuar politika të veçanta (siç është politika vendore për ta luftuar alkoolin dhe varësinë nga drogat).



ashtu që të rinjtë dhe organizatat e tyre ftohen të marrin pjesë në mbledhjet qeverisëse që kanë ndikim mbi politikën ose ku merren vendime që ndikojnë mbi ta. Niveli i fundit në të cilin vendoset bashkëpunimi është rezultat i bisedimeve, ashtu që të plotësohen nevojat dhe interesat e secilës palë. Prandaj, edhe pse bashkëpunimi ndërmjet aktorëve vendor mund të ketë forma të ndryshme, qëllimi kryesor mbetet i njëjtë – partneritetet e fuqishme kontribuojnë për ndërtimin e jetës më të mirë në komunitetet vendore.

Mendoni

1. *Çfarë interesash do t'ju motivonin që të filloni bashkëpunim me ndonjë palë tjetër? (Nëse e përfaqësoni ndonjë organizatë rinore, ky do të ishte bashkëpunimi me autoritetet vendore, dhe e kundërta);*
2. *Cilët do të ishin shembuj të interesave kundërshtuese të autoriteteve vendore dhe të organizatave rinore? A keni qenë ndonjëherë në situatë ku janë paraqitur interesa kundërshtuese? Si u trajtuan ato?*
3. *Cilat fusha të bashkëpunimit që përmenden në Kartë do të ishin më të rëndësishme në komunitetin tuaj vendor? Pse? (Shiheni Pjesën I të Kartës që i trajton politika sektoriale).*

Në pjesën e mbetur të këtij kapitulli do të jepen detaje për format e veçanta të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve vendore dhe organizatave rinore dhe të rinjve.

→ **6.2 Bashkëpunimi në fushën e vendimmarrjes – Modeli i konsultimit**

Konsultimi është njëri nga mekanizmat që mund të përdoret në mënyrë efektive për t'i përfshirë të rinjtë në vendimmarrjen në nivel vendor. Ekzistojnë përkufizime të ndryshme për atë se çka nënkupton konsultimi, varësisht nga forma që e merr, qëllimet që dëshiron t'i arrijë, shpërndarja e kompetencave ndërmjet palëve të ndryshme, etj. Konsultimet me të rinjtë mund të sqarohen si mënyrë për t'i mbledhur mendimet dhe pikëpamjet e tyre, ose për të marrë informacion kthyes në lidhje me veprimet ose propozimet që ndikojnë mbi ta. Konsultimi kuptimplotë është proces me dy kahje dhe realizohet atëherë kur akoma ka mundësi të ndikohet në rezultatin përfundimtar ose në atë që duhet të ndodhë.

Konsultimi perceptohet si proces në të cilin fuqia dhe fjala e fundit u takojnë të rriturve. Kjo do të thotë se edhe pse të rinjve u ofrohet mundësia të kontribuojnë dhe t'i shprehin mendimet e tyre, në fund të rriturit kanë fuqi për të vendosur se a do të merren parasysh këto kontribute dhe nëse po, në çfarë mase.

Ka një debat të vazhdueshëm ndërmjet praktikantëve dhe hulumtuesve për përfitimet dhe kufizimet e konsultimit. Është diskutuar se a është adekuate përfshirja e të rinjve në procesin e vendimmarrjes në domenin publik, dhe është sugjeruar se ka rrezik real për qasje të "pjesëmarrjes sipërfaqësore" (tokenizmit) ndaj konsultimit në disa kontekste.

Pasqyrë e argumenteve për dhe kundër konsultimit të të rinjve:³⁸

38. E përshtatur nga: McAuley, K. dhe Brattman, M., Hearing young voices. Executive summary, Open Your Eyes to Child Poverty Initiative, Irlandë, 2002, faq. 13.

Në favor të konsultimit	Kundër konsultimit
Të rinjtë kanë të drejtë të dëgjohe mendimi i tyre dhe të ndikojnë në vendimet që janë të rëndësishme për ta	Të rinjtë duhet ta mësojnë se ç'është përgjegjësia para se t'u jepen të drejtat
E drejta e lartpërmendur për t'u dëgjuar mendimi i të rinjve mund t'i mbrojë ata, për shkak se të rriturit jo gjithmonë e thonë atë që është në interesin më të mirë të të rinjve	Të rriturit e dinë se çka u duhet të rinjve dhe duhet ta ushtrojnë të drejtën e tyre që të flasin në emër të të rinjve
Të gjitha institucionet, puna e të cilave ka ndikim në jetën e të rinjve, duhet të vendosin dialog me të rinjtë	Interesat e të rinjve përfaqësohen nga organizatat që punojnë me të rinjtë, prandaj nuk ka nevojë për kontakt të drejtpërdrejtë
Mosdhënia e mundësisë për të rinjtë që t'i shprehin mendimet e tyre tregon mungesë respekti dhe pranimit ndaj të rinjve dhe aftësive të tyre	Të kërkohet nga të rinjtë që t'i shprehin idetë e tyre për çështjet serioze do të thotë se të rinjtë detyrohen ta luajnë rolin e të rriturve para se të jenë të gatshëm ta bëjnë këtë
Të rinjtë e kanë lirinë të vendosin se a duan ta ushtrojnë të drejtën për t'i shprehur mendimet e tyre ose jo	Të rinjtë nuk dëshirojnë që të konsultohen
Konsultimi me të rinjtë çon në vendime më të mira, për shkak se të rinjtë mund të japin kontribut të rëndësishëm kur u lejohe ta bëjnë këtë	Të rinjve u mungon pjekuria, njohuritë dhe shkathtësitë për të dhënë kontribut kuptimplotë të rëndësishëm, veçanërisht në aspekt të vendimmarrjes në nivel të politikave publike
Strukturat ekzistuese të vendimmarrjes duhet të përshtaten që ta përfshijnë edhe konsultimin me të rinjtë	Nuk ka mundësi të përfshihet konsultimi me të rinjtë në kuadër të strukturave ekzistuese të vendimmarrjes
Shprehja e ideve dhe e drejta t'u dëgjuar është pjesë e edukimit të çdo qytetari dhe e përforcon përkushtimin ndaj demokracisë	Po t'u jepet të rinjve mundësia për të folur dhe për t'u dëgjuar mund të dëmtohet respekti i tyre ndaj autoritetit të të rriturve
E drejta për të folur dhe për t'u dëgjuar do t'i inkurajojë të rinjtë që të jenë qytetarë aktivë në të ardhmen	Të rinjtë nuk janë të interesuar për politikën dhe politikat publike
Ka më shumë gjasa që të rinjtë t'i respektojnë dhe t'i ndjekin vendimet nëse janë të përfshirë në marrjen e tyre	Nuk ka burime të mjaftueshme në dispozicion
	Nuk ka struktura dhe udhëzime që do ta mbështesin konsultimin

Pa marrë parasysh se mendimet për vlerën e konsultimit dallojnë, prapë se prapë, në shumë institucione ai shihet si mënyrë e vlefshme për t'i përfshirë pikëpamjet e të rinjve në proceset e vendimmarrjes dhe si mjet për ta siguruar përfshirjen shoqërore (kur konsultohen të rinjtë e përjashtuar në aspekt shoqëror).



Mendoni

1. A keni marrë pjesë ndonjëherë në konsultim? Në çfarë konteksti?
2. Si mendoni—a duhet të rinjtë të konsultohen në domenin e vendimmarrjes publike? Pse?
3. A pajtoheni me këtë deklaratë: “Të kërkohet nga të rinjtë që t’i shprehin idetë e tyre për çështjet serioze do të thotë se të rinjtë detyrohen ta luajnë rolin e të rriturve para se të jenë të gatshëm ta bëjnë këtë”? Pse? Sqaroni mendimin tuaj.

Në rastin ideal, procesi i konsultimit duhet të bazohet në këto parime:

– *Të rriturit e kuptojnë rëndësinë dhe dobitë nga konsultimi i të rinjve*

Konsultimi duhet të iniciohet dhe të realizohet nga ata që besojnë në vlerën e kësaj forme të bashkëpunimit, dhe të cilët janë të vetëdijshëm për dobitë dhe kufizimet e tij. Përndryshe, i gjithë procesi mund të rezultojë me një iniciativë për “pjesëmarrje sipërfaqësore” (tokenizëm).

– *Të rinjtë duhet t’u mundësohet të japin kontribut*

Të rinjtë kanë shumë potencial dhe talent, mirëpo mund të kenë mungesë të njohurive ose të shkathtësive për të dhënë kontribut kuptimplotë të rëndësishëm. Është përgjegjësi e të rriturve ta sigurojnë fuqizimin e të rinjve dhe t’u mundësojnë atyre t’i fitojnë këto njohuri ose shkathtësi.

– *Të rinjtë janë të përfshirë në përgatitjen dhe realizimin e konsultimit*

Të rinjtë janë të aftë për të marrë përgjegjësi dhe për të kontribuar në gjithë procesin e organizimit të konsultimit. Si rezultat, ata e ndiejnë se vendimet që merren pas konsultimit janë edhe vepër e tyre dhe mund të fitojnë përvojë të vlefshme në aspektet e ndryshme të demokracisë vendore.

– *Konsultimi ka qëllim të qartë dhe pjesëmarrësit janë të informuar për të*

Të rinjtë duhet ta dinë se pse bëhet konsultimi dhe çka do të ndodhë si rezultat i tij, gjegjësisht në çfarë mase këto rezultate do të ndikojnë në vendimin përfundimtar. Kjo mund t’u ndihmojë atyre të krijojnë pritje reale për atë se çka mund të arrihet.

– *Të rinjtë janë të informuar për atë se si funksionon i gjithë procesi i konsultimit*

Proceset e konsultimit mund të ndërtohen në mënyra të ndryshme dhe të rinjtë duhet ta dinë se në cilën fazë gjendet procesi i caktuar i konsultimit dhe çka do të ndodhë.

– *Të rinjtë duhet të konsultohen sa më herët që është e mundur në procesin e vendimmarrjes*

Qëllimi i konsultimit duhet të jetë të dëgjohet zëri i të rinjve në lidhje me propozimet ose vendimet që ndikojnë në jetën e tyre, në mënyrë që propozimet të mund të përshtaten me nevojat dhe pikëpamjet e tyre. Nëse procesi i konsultimit zhvillohet gjatë fazave të fundit të procesit të vendimmarrjes, ka shumë pak hapësirë për të rinjtë që të kenë ndonjë ndikim në formën e fundit të propozimit.

– *Duhet të zgjidhen metodologjitë përkatëse*

Metodologjia e konsultimit duhet të jetë përkatëse për moshën, prejardhjen, nivelin e arsimit etj. të të rinjve të synuar. Prandaj, mund të jetë ide e mirë që të përfshihen ndihmës që kanë përvojë në punën me të rinjtë, për të siguruar se gjërat do të prezantohen në mënyrë që është e kuptueshme për të rinjtë dhe ata të ndjehen të motivuar të punojnë në lidhje me to.

– *Rekomandimet e të rinjve duhet të merren parasysh seriozisht*

Konsultimi nuk duhet të zhvillohet në qoftë se rezultatet e tij do të mbeten vetëm në letër. Rezultatet duhet të analizohen dhe të diskutohen që të identifikohen mënyrat më të mira për shfrytëzimin e tyre. Konsultimi me të rinjtë vendor mund të ofrojë ide të vlefshme dhe informacion kthyes, të cilat duhet t’i shfrytëzojë pala që e organizon konsultimin. Në disa komunitete, gjatë procesit të konsultimeve është i pranishëm edhe një përfaqësues i lartë i autoriteteve vendore për t’u siguruar se rezultatet e konsultimit do të dëgjojnë në nivelin



më të lartë. Praktikantët që punojnë në këtë fushë theksojnë se të rinjtë kanë nevojë për dëshmi të prekshme se pikëpamjet e tyre do të merren parasysh dhe për këtë arsye është me rëndësi që së paku disa nga propozimet të zbatohen³⁹. Me këtë do të sigurohet përfshirja e ardhshme e të rinjve në iniciativat e ngjashme.

– *Është ndarë kohë e mjaftueshme për konsultim*

Konsultimi është proces që merr kohë. Ka nevojë për përgatitje dhe kohë të mjaftueshme që të rinjtë t'i shprehin mendimet e tyre. Prandaj, edhe planifikimi kohor i gjithë procesit duhet të bëhet në mënyrë të mirë, që të sigurohen kontribute kuptimplote. Nëse të rinjve u duhet më tepër kohë për t'i zhvilluar idetë e tyre, duhet të krijohen mundësi për konsultim të mëtutjeshëm.

– *Konsultimi zhvillohet në kohë të përshtatshme për të rinjtë dhe në vend ku ata kanë qasje*

Koha dhe vendi luajnë rol të rëndësishëm në përfshirjen e të rinjve. Në qoftë se është vështirë për të shkuar deri te vendi i konsultimit, atëherë duhet ofruar transport ose duhet të kompensohen shpenzimet e udhëtimit. Në disa raste mund të shfrytëzohen vende të caktuara për konsultim në mënyrë që sa më shumë të rinj të kenë mundësi ta shprehin mendimin e tyre.

– *Konsultimi mbahet në mjedis që i inkurajon të rinjtë të kontribuojnë*

Edhe pse çështja që do të shtrohet para të rinjve mund të jetë me rëndësi shumë të madhe, megjithatë është tepër e rëndësishme që të krijohen kushte në të cilat të rinjtë do të ndjehen të rehatshëm dhe të sigurt për t'i shprehur idetë e tyre. Për ta ndihmuar këtë proces, disa organizatorë përpiqen që konsultimet t'i mbajnë në mjedise joformale.

– *Të rinjtë informohen për rezultatet e konsultimit*

Edhe pse mund të bëhet pas një kohe pasi të jenë zhvilluar konsultimet, të rinjtë kanë të drejtë të informohen për rezultatin dhe mënyrat në të cilat kontributi i tyre ka pasur efekt (konkretisht mënyrat se si kanë ndryshuar ose jo propozimet ose vendimet, varësisht nga rasti).

– *Pikëpamjet dhe mendimet e të rinjve respektohen dhe vlerësohen*

Të rinjtë dëshirojnë të kontribuojnë dhe t'i shprehin pikëpamjet e tyre, mirëpo ata po ashtu duhet ta dinë se ky kontribut është i rëndësishëm për komunitetin vendor. Nuk mjafton që të thuhet se pikëpamjet e të rinjve respektohen. Kjo duhet të demonstron duke i incizuar/regjistruar informacionet që janë pranuar prej tyre në mënyrë që pikëpamjet e tyre të mund të prezantohen saktësisht para palëve të tjera, si dhe duke iu shmangur dhënies së komenteve ku shprehet patronazhi si p.sh. "çka dinë të rinjtë për jetën e vërtetë?", etj.

– *Kontributi i të rinjve është i pranuar dhe i njohur*

Njohja e kontributit të të rinjve është mënyrë për t'u thënë atyre "ju faleminderit" dhe për t'i motivuar ata që të përfshihen në iniciativat e ardhshme. Për këtë qëllim mund të shfrytëzohen disa metoda, si për shembull:

- artikujt ose raportet/kronikat në mediet vendore ose rajonale (gazetat vendore, radiot, etj.);
- dhënia e certifikatave;
- dhënia e letrave rekomanduese;
- dërgimi i letrave falënderuese;
- mbulimi i shpenzimeve që lidhen me konsultimin;
- dhënia e ushqimit;
- dhënia e suvenireve të vogla;
- ftesa për ndonjë ngjarje shoqërore;
- ftesa për t'iu bashkuar organeve vendimmarrëse ose atyre për konsultim në nivel vendor;
- para xhepi (edhe pse kjo konsiderohet si kontroverse).

39. McAuley, K.dhe Brattman, M.,op. cit., faq. 11.



Mendoni

1. *Sipas mendimit tuaj, cilat parime të konsultimit, janë më të rëndësishme? Pse?*
2. *Çka mund ta bëjë procesin e konsultimit më tërheqës për të rinjtë?*
3. *Çka mendoni për shpërblimin me para xhepi të të rinjve që marrin pjesë në konsultime?*
4. *A do të shtonit ndonjë parim tjetër përveç atyre që u përmendën më lartë?*

Konsultimet mund të organizohen në shumë mënyra. Konsultimi i drejtpërdrejtë nënkupton kontaktin e drejtpërdrejtë me të rinjtë që jetojnë në një komunitet ose rajon të caktuar dhe mund ta ketë formën e:

- mbajtjes së takimeve konsultuese ose ngjarjeve ku të rinjtë mund të mësojnë më tepër për çështjen ose për propozimin e dhënë, dhe ku ata mund t'i shprehin pikëpamjet e tyre;
- mbajtjes së ngjarjeve konsultuese me të rinjtë që janë më pak të përfaqësuar;
- mbajtjes së ngjarjeve konsultuese në ambient shkollor;
- kërkimit të mendimeve duke dërguar e-mail-e, letra, ese, etj.;
- kërkimit të mendimeve duke krijuar ndonjë vepër arti: vizatim, skulpturë, poezi, etj.;
- intervistave individuale ose grupore;
- pyetësorëve, anketave për plotësim;
- referendumeve, votimeve;
- anketave telefonike;
- sistemeve për dhënie të komenteve dhe/ose ankesave;
- forumeve të lagjeve. Forumi mund të jetë një grup prej një zone të definuar gjeografike që takohet rregullisht për të diskutuar dhe për të analizuar çështje, plane dhe propozime. Anëtarësia mund të jetë e përhershme ose e hapur.

Mirëpo, në disa raste, konsultimi indirekt mund të jetë më adekuat, qoftë për shkak se nuk ka burime të mjaftueshme në dispozicion ose për shkak se grupi i të rinjve është shumë i madh, që e bën të vështirë të mblidhen të gjithë. Kjo mund të bëhet nëpërmjet:

- konsultimit të grupeve të përfaqësuesve. Në rastin ideal, vetë të rinjtë duhet të vendosin se kush do t'i përfaqësojë ata për ndonjë konsultim të caktuar. Mirëpo, në realitet kjo shpeshherë vështirë mund të arrihet, dhe për këtë arsye kushti minimal për të punuar me një grup të tillë duhet të jetë se ai duhet ta përfaqësojë popullatën vendore të të rinjve. Këto grupe të përfaqësuesve krijohen vetëm për qëllim të konsultimit;
- paneleve të të rinjve. Këto janë panele të të rinjve që kanë përfaqësim të gjerë të një komuniteti. Zakonisht ka grupe më të mëdha, anëtarët e të cilave kanë mundësi të rregullt për t'u takuar (zakonisht dy herë në vit) dhe për t'i këmbyer pikëpamjet dhe idetë për çështjet që ndikojnë në jetën e të rinjve në komunitet;
- konsultimit të grupeve ekzistuese të përfaqësuesve. Të rinjtë zgjedhin përfaqësues të tyre në këshilla dhe borde të ndryshme. Pasi që supozohet se këto organe e përfaqësojnë popullatën vendore të të rinjve, prej tyre po ashtu kërkohet t'i japin pikëpamjet dhe kontributet e tyre në emër të të gjithë të rinjve në komunitet;



- krijimit të grupeve të fokusit. Këto grupe janë veçanërisht efektive në rastet kur ka pak informacion për ndonjë çështje të veçantë. Informacionet mblidhen gjatë bashkëveprimit të grupit që ndihmohet nga një moderator i cili zhvillon një lloj të intervistës grupore;⁴⁰
- konsultimit të ekspertëve. Këta ekspertë janë të rinj që kanë ekspertizë në fushë të caktuar. Ndonjëherë ata konsultohen kur kanë njohuri të mira për çështjen që është temë e konsultimit, pasi edhe vetë ata janë përfaqësues të të rinjve;
- juria e qytetarëve të rinj.⁴¹ Ato përbëhen prej 6 deri në 20 të rinjve të cilët mblidhen së bashku për të marrë vendim për ndonjë çështje apo propozim të rëndësishëm. Sikurse në gjykatën e vërtetë, ata mund t’i pyesin dëshmitarët, mund të dëgjojnë prova etj.

Mendoni

1. *Çfarë dobish dhe kufizimesh mund të shihni nga konsultimi i drejtpërdrejtë dhe ai indirekt?*
2. *Jepni shembuj të gjërave dhe të pyetjeve potencialisht të rëndësishme për komunitetin vendor që e përfaqësoni, të cilat mund të trajtohen nga të rinjtë në formë të konsultimit të drejtpërdrejtë?*
3. *Jepni shembuj të gjërave dhe të pyetjeve potencialisht të rëndësishme për komunitetin vendor që e përfaqësoni, të cilat mund të trajtohen nga të rinjtë në formë të konsultimit indirekt?*

Format e ndryshme që mund t’i marrë konsultimi në nivel vendor sigurojnë se kjo metodë e bashkëpunimit me të rinjtë mund të shfrytëzohet në kontekste dhe situata nga më të ndryshmet. Nuk është e thënë që konsultimi të jetë iniciativë e ndërlikuar (përveç nëse diapazoni i tij është shumë i gjerë dhe i ndërlikuar), ndërsa ndonjëherë edhe një takim i thjeshtë konsultimi, por i përgatitur mirë, mund të gjenerojë rezultate shumë domethënëse.

→ 6.3. Bashkëpunimi në fushën e vendimmarrjes – Modeli i komitetit

Karta e rishikuar thotë se “pjesëmarrja efektive e të rinjve në çështjet vendore dhe rajonale ... kërkon një strukturë të përhershme përfaqësuese, siç është këshilli rinor, parlamenti rinor apo forumi rinor”.⁴² Roli i një strukture të tillë mund të ndryshojë prej një komuniteti ose rajoni në tjetrin, mirëpo gjithmonë duhet të jetë forum në të cilin të rinjtë mund t’i shprehin lirshëm mendimet, shqetësimet dhe propozimet e tyre në lidhje me politikën dhe veprimet e autoriteteve vendore në fushën e punës me të rinjtë. Këshilli rinor ose parlamenti rinor duhet të jenë hapësirë ku mund të krijohet një dialog dhe partneritet domethënës ndërmjet të rinjve dhe autoriteteve vendore, ashtu që të gjithë aktorët e përfshirë të mund të vërejnë dobi të prekshme nga bashkëpunimi i tillë.

Nuk janë vetëm të rinjtë ata që kanë dobi nga këshilli rinor ose parlamenti rinor. Duke iu falënderuar këtyre strukturave, autoritetet vendore mund të sigurojnë përfaqësim të drejtë të gjithë komunitetit (të të rinjve që përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të popullatës) dhe mund të marrin vendime që janë më relevante për nevojat e banorëve. Të rinjtë ofrojnë një perspektivë tjetër kur i shohin çështjet vendore dhe kur përfshihen në proceset vendore.

40. Për më tepër informata për grupet e fokusit shihni: *Young voices. Guidelines on HOW to involve children and young people in your work*, The National Children’s Office, Irlandë, 2005.

41. Për më tepër informata për juritë e qytetarëve shihni: *People&participation. How to put citizens at the heart of decision-making*, Involve, 2005.

42. Karta e Rishikuar Evropiane për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale, Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, maj 2003 III.1.59.



Strukturat që i përfaqësojnë të rinjtë në nivel vendor ose rajonal mund të marrin forma të ndryshme dhe emra të ndryshëm, varësisht nga konteksti, për shembull, ato mund të quhen “këshilla rinorë”, “forume rinore”, “parlamente rinore” ose “borde rinore”. Për qëllimet e këtij doracak, strukturat e tilla do të emërtohen si “komitete”, dhe do të definohen kështu: “struktura të përhershme të pjesëmarrjes së të rinjve në nivel vendor, që i përfaqësojnë mendimet dhe pikëpamjet e të rinjve që jetojnë në ato komunitete ose rajone. Në veçanti, komitetet do t’i përfaqësojnë pikëpamjet e të rinjve për politikën dhe iniciativat e organeve të ndryshme vendimmarrëse, në rastet kur politikën ndikojnë mbi jetën e të rinjve që jetojnë në atë komunitet”.

Anëtarët e komitetit rinor mund të emërohen ose të zgjidhen dhe ata mund të përfaqësojnë organizata, parti politike ose mund të jenë të pavarur. Në rastin ideal, përbërja e komitetit të tillë duhet ta pasqyrojë përbërjen sociologjike të komunitetit vendor, ashtu që edhe grupet më pak të privileguara të kenë mundësi të përfaqësohen.

Kur krijohet një komitet vendor rinor, autoritetet vendore dhe të rinjtë ose organizatat e të rinjve duhet t’i shqyrtojnë së bashku këto pyetje:

Qëllimi i komitetit

- Pse nevojitet një komitet i tillë në komunitetin vendor?
- Kë saktësisht e përfaqëson ai?
- Kush është i interesuar për krijimin e tij? Pse? Cili është motivi?
- Cili duhet të jetë roli i komitetit?
- Cili duhet të jetë diapazoni i tij i interesit?
- Cilat duhet të jenë të drejtat dhe përgjegjësitë e tij?
- Si duhet të jenë raportet e tij me autoritetet vendore?
- Çfarë fuqie vendimmarrëse ka komiteti?
- Si do t’i shohin autoritetet vendore kontributet e komitetit?

Përbërja e komitetit

- Sa anëtarë duhet të ketë komiteti? Pse?
- Si mund të arrihet balancë gjinore, gjeografike ose në ndonjë aspekt tjetër?
- Si mund të arrihet deri te grupet që janë më pak të përfaqësuar në organet vendimmarrëse (siç janë njerëzit me aftësi të kufizuara, përfaqësuesit e pakicave, etj.)?
- A duhet të vendoset ndonjë sistem i kuotave (si për shembull i bazuar në moshë, gjini, përkatësinë etnike, etj.)?

Profili i anëtarëve

- Kush mund të jetë anëtar? Cilat duhet të jenë kriteret?
- Çfarë moshe duhet të kenë ata?
- Çfarë shkathtësish dhe kompetencash u nevojiten atyre që të kenë përgjegjësi të komitetit?

Zgjedhja e anëtarëve

- Si duhet të zgjidhen anëtarët e komitetit? Si duhet të funksionojë kjo në praktikë? A është reale?
- A duhet të ketë nominim formal? Prej kujt?
- Kush duhet të jetë i përfshirë në rekrutim?
- Ku mund të gjenden kandidatët potencialë?
- Si mund të motivohen kandidatët potencialë të bëhen kandidatë për anëtarë të komitetit?



Mandati i anëtarëve

- Çfarë përgjegjësish duhet të kenë anëtarët e komitetit?
- Cilat duhet të jenë të drejtat dhe privilegjet e tyre?
- Sa do të ishte kohëzgjatja e mandatit? A mund të ketë rizgjedhje?
- A ka nevojë për masa disiplinore?

Fuqizimi i anëtarëve

- Çfarë njohurish dhe shkathtësish duhet të kenë ose të zhvillojnë anëtarët e komitetit?
- Si mund ta bëjnë këtë?
- Për çfarë mbështetje do të kenë nevojë anëtarët e komitetit që t'i realizojnë përgjegjësitë e tyre?
- Kush mund ta ofrojë mbështetjen e tillë?

Struktura e komitetit

- Çfarë funksionesh dhe rolesh duhet të ketë në kuadër të komitetit?
- Çfarë organesh ose nën komitetesh do të nevojiten?
- A duhet struktura e komitetit të jetë e njëjtë me strukturën e pushtetit vendor? Pse?
- Sa formale duhet të jetë kjo strukturë?

Mënyra e punës

- Cilat do të jenë metodat e punës së komitetit (për shembull, mbledhje, konsultime, hulumtime, etj.)?
- Sa shpesh duhet të organizohen mbledhjet?
- Kush do t'i përgatisë dhe do t'i udhëheqë mbledhjet?
- Çfarë pune duhet të realizohet ndërmjet mbledhjeve?
- Si do të merren vendimet?
- Kush do të ofrojë mbështetje sekretarie ose administrative?
- A ka ndonjë rregull për të cilën duhet të arrihet pëlqim i ndërsjellë?

Bashkëpunimi me autoritetet vendore

- Çfarë forme duhet të ketë bashkëpunimi?
- Si do të shkëmbehen informacionet?
- A duhet të jetë ky shkëmbim i rregullt apo me kërkesë?
- Cili nga komiteti do të jetë përgjegjës për të qenë në kontakt me autoritetet vendore?
- Cili nga autoritetet vendore do të jetë përgjegjës për të mbajtur kontakt me komitetin?
- Çka duhet të bëhet në rast të mosmarrëveshjes ndërmjet palëve?

Mbajtja e kontakteve me të rinjtë

- Si do të përfaqësohen pikëpamjet e të rinjve në punën e komitetit?
- Si do t'u komunikohen të rinjve vendor rezultatet e punës së komitetit, sukseset dhe sfidat e tij?
- Në çfarë mënyre tjetër të rinjtë mund të ndikojnë mbi punën e komitetit?



Çështjet teknike

- Ku do të jetë i vendosur komiteti (vendi i mbledhjeve, hapësira e punës, adresa zyrtare, etj.)?
- Kush do t'i mbulojë shpenzimet?
- A duhet anëtarët të marrin para xhepi ose ndonjë shtytje tjetër?

Çështjet e tjera

- A duhet të ketë kushtetutë apo ndonjë dokument tjetër që do t'i rregullojë çështjet më të rëndësishme të procedurave të komitetit? Pse?

Lista e mësipërme e pyetjeve është e bazuar në përvojën e grupeve të ndryshme që tashmë kanë kaluar nëpër procesin e krijimit të këshillit rinor ose të parlamentit rinor në nivel vendor. Lista është mjaft e gjatë dhe me gjasë jo shumë interesante, si për të rinjtë ashtu edhe për politikanët, që e ilustron dilemën për atë se si duhet të krijohet një strukturë që do të funksionojë në mënyrë efikase nga njëra anë dhe do të jetë e përshtatshme për të rinjtë nga ana tjetër. Grupe të ndryshme kanë përdorur zgjidhje të ndryshme, siç është eliminimi i numrit të procedurave formale, sigurimi i atmosferës joformale dhe miqësore të punës dhe përgatitja e dokumenteve në gjuhë të përshtatshme për të rinjtë, mirëpo tërheqja e të rinjve për këtë formë mjaft formale të pjesëmarrjes vazhdon të konsiderohet si sfidë e vërtetë.

Mendoni

1. A ka këshill, parlament ose forum rinor në komunitetin tuaj vendor? Çka dini për mënyrën e funksionimit të tij?
2. Çfarë anë të fuqishme dhe anë të dobëta shihni në këtë formë të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve vendore dhe të rinjve?
3. Si mund të motivohen të rinjtë t'u bashkohen komiteteve në nivel vendor?

→ 6.4 Bashkëpunimi në fushën e vendimmarrjes – Bashkë-menaxhimi

Bashkë-menaxhimi (ose menaxhimi bashkëpunues) nënkupton ndarjen e fuqisë, përgjegjësisë dhe llogaridhënies në fushën e menaxhimit, ndërmjet dy ose më tepër palëve. Ky sistem mund të shfrytëzohet me sukses gjatë përfshirjes së të rinjve në proceset e vendimmarrjes në nivele të ndryshme. Këshilli i Evropës e futi në përdorim sistemin e bashkë-menaxhimit para më shumë se tridhjetë vitesh, kur krijoi një partneritet unik ndërmjet përfaqësuesve të organizatave rinore dhe qeverive në kuadër të Drejtorisë për Rininë dhe Sportin. Ky sistem u ofron mundësi të rinjve ta shprehin mendimin e tyre në formulimin dhe zbatimin e politikës për të rinj të Këshillit të Evropës.

Bashkë-menaxhimi në Këshillin e Evropës

Drejtorja për Rininë dhe Sportin (DRS) e Këshillit të Evropës ofron udhëzime dhe instrumente ligjore që e mbështesin krijimin e politikave për të rinj në nivelet vendore, kombëtare dhe evropiane. Vendimet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me programin dhe prioritetet buxhetore merren bashkërisht nga partnerët qeveritarë dhe joqeveritarë në kuadër të sistemit të bashkë-menaxhimit.

Katër organe janë të përfshira në sistemin për bashkë-menaxhim të DRS-së:

1. Komiteti drejtues evropian për të rinjtë (CDEJ). Anëtarët e tij i përfaqësojnë ministrinë që janë përgjegjëse për çështjet e të rinjve të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës, si dhe vendet e tjera që e kanë nënshkruar Konventën Evropiane të Kulturës. Ky komitet e siguron bashkëpunimin ndërqeveritar në fushën e të rinjve dhe të politikave për të rinjtë. Takohet dy herë në vit, në sesion plenar, dhe i trajton çështjet dhe sfidat që kanë të bëjnë me të rinjtë.



2. Këshilli konsultativ. Ka 30 anëtarë që i përfaqësojnë rrjetet dhe organizatat joqeveritare ndërkombëtare të të rinjve që janë të formuara në vendet anëtare të Këshillit të Evropës (të ashtuquajturat Këshilla rinorë kombëtarë) dhe strukturat e përfshira në fushat e ndryshme të punës me të rinj që janë relevante me politikën e Këshillit të Evropës për të rinjtë. Roli i Këshillit konsultativ është ta promovojë pjesëmarrjen joqeveritare në proceset e vendimmarrjes në sektorin e të rinjve të Këshillit të Evropës.
3. Këshilli i përbashkët i të rinjve Përbëhet nga të gjithë anëtarët e Komitetit drejtues evropian për të rinjtë dhe të Këshillit konsultativ dhe është organi kryesor për vendimmarrje dhe krijim të politikave për partnerët qeveritarë dhe joqeveritarë në kuadër të Drejtorisë për Rininë dhe Sportin. Roli i këtij këshilli të përbashkët është të zhvillojë qëndrim të përbashkët për aspektet kryesore të sektorit të të rinjve në Këshillin e Evropës, gjegjësisht për prioritetet dhe objektivat, si dhe për buxhetin.
4. Komiteti programues. Ky është edhe një organ i përbashkët për vendimmarrje që përbëhet nga tetë anëtarë të Komitetit drejtues evropian për të rinjtë dhe tetë anëtarë të Këshillit konsultativ. Roli i këtij komiteti është të krijojë programe në fushën e punës me të rinjtë në kuadër të Këshillit të Evropës, veçanërisht programet e Qendrave evropiane për të rinjtë në Strasburg dhe në Budapest dhe të Fondacionit evropian për të rinjtë.

Mendoni

1. A dini ndonjë shembull të sistemeve për bashkë-menaxhim që funksionojnë në nivel vendor ose të organizatave?
2. Ku gjendet? Si funksionon?
3. Cilat dobi nga sistemi për bashkë-menaxhim mund t'i përmendni?
4. Sipas mendimit tuaj, cilat janë kufizimet e sistemit për bashkë-menaxhim?

Bashkë-menaxhimi në nivel vendor

Në Kartën e rishikuar thuhet se “autoritetet vendore dhe rajonale duhet t’i zhvillojnë parimet e bashkë-menaxhimit dhe sistemin e vendimmarrjes së Këshillit të Evropës në bashkëpunim me të rinjtë dhe organizatat rinore në sferat e politikave me interes për të rinjtë.”⁴³Kjo konsiderohet si formë shumë e veçantë e bashkëpunimit për shkak se të gjitha palët, edhe të rriturit edhe të rinjtë, janë në nivel të njëjtë dhe kanë fuqi të njëjtë për të marrë vendime. Në disa komunitete, mund të jetë e vështirë që të rinjtë të konsiderohen si partnerë të barabartë me të rriturit dhe ta ndajnë fuqinë me ta. Megjithatë, përvoja e organizatave të ndryshme tregon se, “ky koncept i hap dyert për mundësi, ide dhe sfida të reja për të rinjtë dhe të moshuarit që ta zgjerojnë kreativitetin dhe përkushtimin e tyre. E zvogëlon paragjykimin, e përmirëson qartësinë dhe thjeshtësinë e komunikimit, që e bën atë të vlefshëm dhe të dobishëm në çdo sektor të jetës së përditshme – në familje, në shkollë dhe në biznes”⁴⁴.

Vendosja e sistemit për bashkë-menaxhim në nivel vendor mund të bëhet në disa mënyra dhe nuk ka ndonjë recetë universale që vlen njëlloj për të gjithë. Megjithatë, ka mundësi të ofrohet një kornizë e përgjithshme që mund të shërbejë si udhëzues gjatë gjithë procesit, dhe kjo është paraqitur më poshtë.

43. Po aty, II. 7.53. ii.

44. “Co-management. A practical guide. Seeking excellence in youth participation at a local level”, Peace Child International, 2006, faq. .9. Gjendet në:<http://co-management.info>.



Hapi 1 – Përgatitja

Përgatitja e mirë mund të kontribuojë dukshëm në suksesin e një iniciative, dhe për këtë arsye është me rëndësi që kësaj faze të procesit t'i kushtohet kohë dhe vëmendje e mjaftueshme. Para se të bisedohet me partnerët potencialë për vendosjen e sistemit për bashkë-menaxhim, duhet të sigurohemi se partneri potencial:

- e kupton se ç'është bashkë-menaxhimi. Studimi i publikimeve për këtë formë të bashkëpunimit, kontaktimi i njerëzve që tashmë kanë pasur përvojë në këtë sferë dhe dëgjimi këshillave të tyre, mund të jenë të dobishme;
- e ka të qartë se çka dëshiron të arrijë (në cilën sferë të bashkë-menaxhimit dhe në çfarë mase?);
- i di institucionet ose komunitetet ku ky sistem tashmë funksionon. Shpeshherë mund të mësohet nga përvoja e të tjerëve! Ide e mirë mund të jetë të vendoset kontakt personal me ndonjë përfaqësues të ndonjë institucioni ose komuniteti të tillë ose me sistemin për bashkë-menaxhim të komunitetit, në mënyrë pyetje që t'ia drejtoni drejtpërdrejt atij personi;
- di t'ua sqarojë bashkë-menaxhimin palëve të interesuara në mënyrë që ata mund ta kuptojnë. Koncepti i bashkë-menaxhimit mund të jetë relativisht i ri për disa njerëz dhe ata mund të kenë dyshime dhe rezerva (veçanërisht ata që do të duhej ta ndanin fuqinë me ndonjë palë tjetër). Prandaj, duhet përgatitur për të diskutuar se çka nënkupton bashkë-menaxhimi në përgjithësi, si funksionon në sferën e punës me të rinjtë, cila është përvoja e institucioneve ose komuniteteve të tjera, cilat janë dobitë dhe çfarë sfidash mund të paraqiten, etj.;
- ka përgatitur ndonjë material. Njerëzve mund t'u duhet pak kohë që të mendojnë për atë që do ta dëgjojnë dhe ndoshta mund të duan të lexojnë diçka më tepër për të, prandaj do të ishte e dobishme që t'u ofrohen materiale relevante.

Hapi 2 – Gjetja e aleatëve

Për shkak se në fazat e më tutjeshme do të ketë nevojë për shumë mbështetje, duhet kërkuar aleatë që do të ishin të interesuar të ndihmojnë dhe t'i bashkëngjiten iniciativës. Për ata që i përfaqësojnë të rinjtë vendor ose ndonjë organizatë të rinjve, mund të jetë e dobishme të gjejnë njerëz ose organizata që kanë qëndrime të ngjashme me të tyre. Ata që i përfaqësojnë autoritetet vendore, mund të kërkojnë nëpunës të tjerë që mund të ofrojnë mbështetje, ose t'i kontaktojnë institucionet që punojnë me të rinjtë në atë zonë (si për shembull shkollat, qendrat e të rinjve, etj.). Aleatët e tillë mund të ofrojnë jo vetëm mbështetje morale, por edhe mund ta marrin përsipër kryerjen e disa detyrave, mund të ndihmojnë në gjenerimin e ideve më të mira dhe të kontribuojnë me burime, etj.

Hapi 3 – Kontaktimi i partnerit potencial për bashkë-menaxhim

Ky është një moment shumë i rëndësishëm në gjithë procesin, pasi atëherë inicohet partneriteti ndërmjet palëve të cilat do t'i ndajnë përgjegjësitë dhe fuqinë e vendimmarrjes. Nëse pala tjetër nuk pajtohet të marrë pjesë në vendosjen e sistemit për bashkë-menaxhim, atëherë i gjithë procesi do të bllokohet. Kontaktimi i partnerit për bashkë-menaxhim zakonisht është proces i gjatë dhe mund të pritet që të zhvillohen disa mbledhje dhe bisedime. Disa këshilla:

- bëni një plan se si do ta kontaktoni partnerin tuaj potencial për bashkë-menaxhim. Vendosni se si dëshironi ta bëni këtë, kur, ku dhe me kë, etj. Ndani rolet dhe detyrat ndërmjet aleatëve;
- përpiquni t'i identifikoni frikët dhe dyshimet që mund t'i ketë partneri juaj për bashkë-menaxhim në lidhje me propozimin tuaj. Mendoni mënyra për qartësimin e këtyre dyshimeve;
- jini të gatshëm për të biseduar dhe për të bërë kompromis. Partneri mund të jetë i interesuar për vendosjen e sistemit për bashkë-menaxhim, por vetëm deri në një masë të caktuar (për shembull, vetëm në fushën e kujdesit shëndetësor për të rinjtë në komunitetin tuaj lokal). Një mënyrë e mirë për ta iniciuar gjithë procesin e bashkë-menaxhimit është të fillohet me trajtimin e çështjeve në përmasa të vogla dhe të shihet se si funksionon ai. Kur të fitohet më tepër përvojë, bashkë-menaxhimi mund të zgjerohet edhe në fusha të tjera;



mos pranoni përgjigjen “jo”. Vazhdoni përpjekjet (kuptohet, brenda kufijve të arsyeshëm);

- bëhuni të durueshëm. I gjithë procesi mund të zgjasë, për shkak se ndryshimi i qëndrimit të njerëzve nuk ndodh brenda vetëm një takimi.

Hapi 4 – Përkufizimi i qëllimeve, fushave të përgjegjësisë dhe mënyrave të punës

Pasi të krijohet partneriteti për vendosjen e sistemit të bashkë-menaxhimit, fillon puna e rëndë e përkufizimit të hollësive të bashkëpunimit dhe të parimeve të partneritetit. Të gjitha palët duhet të përfshihen në diskutime dhe në marrjen e vendimeve, pasi në këtë fazë krijohet një kontratë joformale ndërmjet partnerëve dhe përcaktohen udhëzimet për punën e ardhshme. Duhet të jepet përgjigje në këto pyetje:

- Kush do të përfshihet në sistemin për bashkë-menaxhim?
- A do të ketë ndonjë organ ose struktura formale në kuadër të sistemit? Nëse po, cilat janë ato?
- Si do të zgjidhen anëtarët e të dyja palëve? Si mund të sigurohet se është përfaqësuar popullata vendore? Sa përfshirëse do të jetë anëtarësia e partneritetit?
- Çfarë roli do të luajë sistemi për bashkë-menaxhim? Cilat fusha do të përfshihen dhe cili do të jetë diapazoni i vendimeve?
- Cilat do të jenë të drejtat dhe përgjegjësitë e palëve?
- Cilat metoda (ose procedura, edhe pse të rinjtë zakonisht nuk janë të motivuar nga procedurat) të punës do të përdoren?
- Cilat do të jenë parimet themelore të bashkëpunimit?
- Si do të vlerësohet sistemi? Sa shpesh? Prej kujt?

Hapi 5 – Vlerësimi i burimeve të nevojshme

Pasi të vendosen bazat e bashkëpunimit në Hapin 4, palët mund të vlerësojnë se për çka kanë nevojë në aspekt të planeve dhe të marrëveshjeve preliminare. Kur diskutohet për burimet që do të nevojiten, menjëherë mendohet për mjetet financiare, të cilat, edhe pse janë shumë të rëndësishme, nuk janë burimet e vetme për të cilat ka nevojë. Në këtë fazë, po ashtu duhet konstatuar se:

- Sa kohë do të duhet të ndajnë palët për sistemin për bashkë-menaxhim?
- Cili vend do të shfrytëzohet për mbledhjet? A është i përshtatshëm për të rinjtë? A mund të arrihet lehtë atje?
- Kush mund të ofrojë mbështetje teknike dhe sekretarie?
- Çfarë kompetencash dhe shkathtësish nevojiten për funksionimin efikas të sistemit të bashkë-menaxhimit (çfarë njohurish u nevojiten të rinjve dhe autoriteteve lokale dhe cilat shkathtësi duhet të zhvillohen)?
- Si mund të plotësohen këto nevoja?

Hapi 6 – Planifikimi i fazës hyrëse

Në këtë fazë palët janë të gatshme ta planifikojnë fazën e parë të punës së tyre. Futja në përdorim të sistemit për bashkë-menaxhim mund të marrë pak kohë, veçanërisht nëse duhet të ndryshohet rregulloret vendore, që të mund të pranohet zyrtarisht sistemi i bashkë-menaxhimit, ose nëse duhet të bëhen përgatitje teknike ose të përgatiten dokumente të reja, etj. Anëtarët e sistemit për bashkë-menaxhim, po ashtu duhet të njohohen me sistemin apo ndoshta duhet të organizohet ndonjë trajnim për ata, para se të fillojë të funksionojë sistemi pa pengesa.



Hapi 7 – Fillimi me punë i sistemit për bashkë-menaxhim

Sistemi për bashkë-menaxhim u shërben interesave të komunitetit vendor, dhe për këtë arsye komuniteti vendor, e veçanërisht të rinjtë që jetojnë aty, duhet ta dinë se ai ekziston. Disa komunitete vendosin që sistemet e tyre të bashkë-menaxhimit të fillojnë me punë duke organizuar manifestime të veçanta që i gjithë komuniteti ta kuptojë këtë dhe të jenë krenarë me të.

Hapat e ardhshëm ...

Qëllimi i sistemit për bashkë-menaxhim është që të jetë një iniciativë afatgjate dhe për këtë arsye, puna dhe aktivitetet duhet të planifikohen rregullisht. Kjo mund të bëhet çdo disa muaj, çdo vit ose çdo dy vite, varësisht nga situata. Mirëpo, është shumë me rëndësi që planet të përqendrohen jo vetëm në trajtimin e vendimeve dhe të çështjeve vendore, por edhe në vlerësimin e rregullt të asaj se si funksionon sistemi, në mënyrë që aspektet e ndryshme të tij të përmirësohen vazhdimisht.

Mendoni

1. Sa reale do të ishte të futej në përdorim sistemi i bashkë-menaxhimit në komunitetin tuaj vendor? Pse mendoni ashtu?
2. Kush do të ishte i interesuar në kontekstin tuaj vendor për vendosjen e sistemit të bashkë-menaxhimit? Si mendoni, çka do t'i motivonte ata për ta bërë këtë?
3. Në cilat fusha të jetës së përditshme, politika ose programe që i përfshijnë të rinjtë në kontekstin tuaj vendor do të ishte më e rëndësishme të futen në përdorim sistemi i bashkë-menaxhimit? Pse mendoni ashtu?

Futja në përdorim e sistemit për bashkë-menaxhim mund të fillojë në përmasa të vogla. Në disa kontekste, për shembull, nuk është reale të pritet që vendimet që kanë të bëjnë me buxhetet vendore ose çështjet e tjera të rëndësishme, të merren nga të rinjtë ose bashkë me ta. Megjithatë, kjo nuk duhet të jetë arsye që sistemi i bashkë-menaxhimit aspak të mos futet në përdorim. Sistemet me përmasa të vogla, siç është menaxhimi i qendrave për të rinj ose programet vendore për të rinj, mund të funksionojnë shumë mirë. Fillimi me gjëra të vogla, në shumë raste, është ide e mirë.

→ 6.5 Format e tjera të bashkëpunimit në fushën e vendimmarrjes

Konsultimet, krijimi i komiteteve të përfaqësuesve dhe futja në përdorim e sistemit të bashkë-menaxhimit janë vetëm disa shembuj të formave të mundshme të bashkëpunimit ndërmjet aktorëve vendor që të promovohet pjesëmarrja e të rinjve. Megjithatë, ekzistojnë edhe forma të tjera për krijimin e partneriteteve, prandaj komunitetet duhet të kenë mundësi të gjejnë së paku një formë që do të ishte adekuate për ta. Shembuj të formave të tilla të bashkëpunimit janë dhënë më poshtë.

Projektet dhe iniciativat e përbashkëta

Ndonjëherë autoritetet vendore i ftojnë organizatat joqeveritare që janë të specializuara në fusha ose në tema të veçanta, që t'u bashkëngjiten iniciativave ose projekteve të tyre. Në rastet e tilla, autoritetet vendore e mbajnë kontrollin mbi tërë iniciativën, mirëpo krijojnë një partneritet me organizatën vendore që të marrin këshilla eksperte ose që t'i shfrytëzojnë njohuritë, përvojën dhe infrastrukturën e tyre. Në këtë mënyrë, ekspertiza vendore mund të shfrytëzohet për t'i trajtuar problemet vendore.

Delegimi i detyrave të parashikuara me statut

Në disa vende, autoritetet vendore kanë liri që një pjesë të detyrave të tyre të parashikuara me statut t'ua delegojnë organizatave joqeveritare. Në bazë të marrëveshjeve speciale që i përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e të dyja palëve,

organizatat mund ta marrin përsipër zbatimin e politikave vendore , si për shembull politikës për mjedisin, politikës për qasje në kulturë, etj., ose ta marrin përsipër realizimin e programeve, si për shembull shërbimet për strehimin e të pastrehëve ose programet për ushqim. Ndonjëherë këto politika dhe programe janë të lidhura drejtpërdrejt me çështjet e të rinjve dhe ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e të rinjve vendor . Në rastet e tilla, mund të krijohet partneritet ndërmjet autoriteteve vendore dhe organizatave të të rinjve, nëpërmjet të cilin organizatat e fitojnë mbështetjen e nevojshme për ta përmirësuar jetën e të rinjve në komunitet.

Financimi strukturor

Buxhetet vendore mund të sigurojnë mjete financiare për të ashtuquajturat “financime strukturorë” të organizatave për të rinj. Ky lloj i mbështetjes financiare nuk i mbulon shpenzimet e projekteve dhe të aksioneve, por i mbulon shpenzimet që kanë të bëjnë punën e përditshme të organizatës, si për shembull shpenzimet e punësimeve ose shpenzimet administrative. Financimi strukturor mund të jetë shumë i rëndësishëm për organizatat e të rinjve që kanë pak përvojë në sigurimin e mjeteve financiare, mirëpo edhe për grupet joformale të të rinjve ose organizatat që nuk kanë të punësuar të përhershëm që janë përgjegjës për sigurimin e mjeteve financiare.

Sistemi i granteve

Organizatave mund të pranojnë mbështetje financiare nga autoritetet vendore për aktivitetet dhe programet që i realizojnë. Këto aktivitete planifikohen dhe zbatohen pavarësisht nga autoritetet vendore , edhe pse mjetet financiare zakonisht ndahen për ato aktivitete që përputhen me prioritetet vendore . Ka një debat të vazhdueshëm për atë se në çfarë mase mund të thuhet se këto programe dhe aktivitete janë me të vërtetë të pavarura nëse mbështeten vetëm ato aktivitete që përputhen me agjendën politike të autoritetit vendor.

Garantuesi

Karta e rishikuar përmend një lloj të veçantë të mbështetjes që ofrohet për organizatat që janë të përfshira në pjesëmarrjen e të rinjve – emërimin e garantuesit⁴⁵. Garantuesi mund të jetë një person apo grup që është i pavarur edhe nga strukturat politike edhe nga ato që kanë pjesëmarrje të të rinjve. Roli kryesor i garantuesit është që të veprojë si ndërmjetësues apo si urë komunikimi ndërmjet të rinjve dhe përfaqësuesve të autoriteteve vendore në raste të konfliktit ndërmjet të dyja palëve.

Format e tjera të bashkëpunimit

- shkëmbimi i informacioneve (për iniciativat, planet, zhvillimet, etj.);
- krijimi i ekipeve të përbashkëta konsultative të organeve qeveritare dhe atyre joqeveritare që do të punojnë në tema të ndryshme;
- thirrja e përfaqësuesve të palës tjetër në takime, debate të hapura, etj.

Mendoni

1. Cilat forma të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve vendore, organizatave rinore dhe të rinjve funksionojnë në komunitetin ose rajonin tuaj vendor ?
2. Si shpërndahet informacioni për këtë bashkëpunim?
3. Cilat palë janë të përfshira në këtë bashkëpunim? Cila është lidhja juaj me këto palë?
4. A është e interesuar organizata/institucioni juaj për bashkëpunim në nivel vendor me partnerë të tjerë?
5. Pse?

45. III. 1.70.





KAPITULLI 7

Karta dhe politikat vendore për të rinjtë

→ 7.1 Njoftim me politikën vendore për të rinjtë

“Politika publike synon t’i arrijë qëllimet që konsiderohen se janë në interesin më të mirë të të gjithë pjesëtarëve të shoqërisë.”⁴⁶ Shembuj për këtë janë siguria, kujdesi shëndetësor dhe social me kualitet të mirë, qasja në arsim, qasja në punësim, etj. Mirëpo, jo të gjitha politikat publike janë relevante për të gjithë pjesëtarët e shoqërisë. Disa prej tyre merren me çështjet që janë të rëndësishme vetëm për një grup të veçantë sikurse të rinjtë, për shembull për shkak se mirëqenia e të rinjve kontribuon për mirëqenien e gjithë popullatës. Në këtë kapitull, politikat publike që kanë të bëjnë me të rinjtë dhe nevojat e tyre do të quhen “politika për të rinjtë”⁴⁷.

Zhvillimi i politikës efektive për të rinjtë është bërë qëllim i rëndësishëm për një numër gjithnjë e më të madh të vendeve në Evropë dhe anembanë botës. Këshilli i Evropës i mbështet këto përpjekje duke ofruar udhëzime dhe instrumente ligjore që ndihmojnë në krijimin ose përmirësimin e politikave për të rinjtë në nivelet vendore, kombëtare dhe evropiane. Qasjet ndaj politikës për të rinj dallojnë ndërmjet vendeve të anëtare. Në disa vende, ajo konsiderohet fushë e rëndësishme për punë dhe për këtë arsye ofrohen burimet përkatëse, si dhe qasja në informacione, fuqi dhe vendimmarrje. Në vende të tjera, politika për të rinj mund të jetë një element në fushat e tjera të politikës, siç është politika për arsim, sport, kulturë, turizëm etj. Po ashtu, ekzistojnë metoda të ndryshme për zbatim të politikave – metoda e centralizuar, ku vendimet dhe veprimet koordinohen nga një pikë qendrore (për shembull, ministria ose ndonjë agjenci tjetër përgjegjëse për çështjet e të rinjve) – ose metoda e decentralizuar, ku fuqia vendimmarrëse dhe burimet janë të deleguara në nivele të tjera, duke i përfshirë rajonet dhe komunitetet vendore.

Mendoni

1. A janë çështjet rinore prioritet për qeverinë e vendit tuaj? Pse mendoni kështu?
2. Si funksionon politika kombëtare rinore në vendin tuaj? Cilat janë qëllimet dhe fushat me prioritet ?
3. Në çfarë mase është e decentralizuar politika kombëtare rinore në vendin tuaj?
4. A mendoni se politika juaj rinore ka “qasje inkluzive” ndaj të rinjve (do të thotë se i merr parasysh të gjithë të rinjtë)?

46. Torjman, S., *What is policy?* Caledon Institute of Social Policy, 2005, faq. 4.

47. Megjithatë, ky nuk është përkufizim i politikës për të rinj. Nuk ka konsensus sa i përket kuptimit të shprehjes “politikë për të rinj”.



Ky doracak përqendrohet në politikën rinore në nivel vendor . Karta e rishikuar thotë se të rinjtë janë qytetarë në komunat dhe rajonet ku jetojnë⁴⁸. dhe se, si rezultat i kësaj, duhet të ekzistojë dhe të zbatohet politika rinore në nivel vendor, ashtu që nevojat dhe aspiratat e të rinjve të mund të plotësohen në mënyrën më të mirë të mundshme.

Politika rinore në nivel vendor që funksionon mirë mund të gjenerojë shumë rezultate pozitive, duke përfshirë, për shembull:

- identifikimin e nevojave më të rëndësishme të të rinjve vendor ;
- plotësimin e këtyre nevojave në mënyrë efikase;
- përmirësimin e situatës së të rinjve;
- të sigurohet se çështjet rinore trajtohen edhe nga politikatat e tjera sektoriale;
- krijimin e bazës për arritjen e qëllimeve të përbashkëta nëpërmjet aktorëve të përfshirë në punën me dhe për të rinjtë;
- koordinimin dhe kanalizimin e iniciativave dhe aksioneve të ndryshme në nivel vendor ;
- të ofrohet shpërndarje e qartë e burimeve për t’i plotësuar nevojat e të rinjve vendor dhe të subjekteve që punojnë në dobi të të rinjve;
- njohjen e kontributit të të rinjve për zhvillimin e komunitetit vendor ;
- stimulimin e të rinjve që të luajnë rol aktiv në trajtimin e çështjeve që ndikojnë në jetën e tyre;
- të ofrohet kornizë për planifikimin e ardhmërisë së të rinjve vendor;
- përforcimin e dialogut dhe të bashkëpunimit ndërmjet gjeneratave në nivel vendor.

Rezultatet e mësipërme mund të arrihen vetëm në qoftë se zhvillimi dhe zbatimi i politikës rinore vendore është i bazuar në këto parime:

1. Politika ka qëllime të përkufizuara qartë si dhe mënyrat për arritjen e këtyre qëllimeve. Të gjithë aktorët e përfshirë, si dhe komuniteti vendor në tërësi, e dinë saktësisht se çka duhet të arrihet dhe si të arrihet atje.
2. Niveli më i lartë politik i komunitetit ose i rajonit është i përkushtuar seriozisht për t’i trajtuar çështjet rinore. Ky përkushtim, në praktikë, nënkupton se çështjet rinore janë një nga prioritetet vendore dhe se atyre u kushtohet vëmendja e duhur.
3. Burimet e nevojshme për planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikës rinore vendore janë në dispozicion. Madje edhe planet dhe strategjitë më të mira janë joefikase në qoftë se nuk janë të mbështetura me mjetet financiare, kohën dhe njohuritë përkatëse.
4. Të rinjtë luajnë rol aktiv në planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikës rinore vendore (në të gjitha fazat). Në qoftë se politika rinore është planifikuar për të rinjtë, mirëpo pa ata (qasja prej lartë-poshtë), ka rrezik që politika t’i pasqyrojë vetëm pjesërisht nevojat reale të të rinjve. Të rinjtë, politikën e tillë mund të mos e ndjejnë si të veten dhe mund të mos jenë të motivuar që të përfshihen në ndonjë aspekt të saj.
5. Të gjithë aktorët kryesorë që punojnë për dhe/ose me të rinjtë janë të përfshirë në gjithë procesin. Secili prej tyre e ka njohurinë dhe përvojën e tij unike, qasjen te burimet, pozitën në kuadër të kontekstit vendor dhe rolin që duhet ta luajë, dhe të gjitha këto vlera mund të kontribuojnë në krijimin dhe zhvillimin e politikës rinore relevante dhe me kualitet të mirë.

48. Karta e Rishikuar Evropiane për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale. Hyrje.



6. Ka një partneritet të fuqishëm ndërmjet aktorëve, ashtu që ata mund të mësojnë nga njëri tjetri dhe mund ta ofrojnë mbështetjen e nevojshme.
7. Politika rinore është ndër sektoriale. Kjo do të thotë se merret me çështje që lidhen me fusha të ndryshme, siç është arsimi, sporti, kultura, mediet, punësimi, strehimi, etj., për shkak se jeta e të rinjve përfshin shumë fusha të ndryshme.
8. Politika rinore duhet të bazohet në hulumtim. Ka mënyra të ndryshme për realizimin e hulumtimeve: duke filluar nga metodologjitë dhe analizat shumë të ndërlikuara e deri te mbledhja e thjeshtë e të dhënave. Metoda e hulumtimit duhet të zgjidhet në bazë të nevojës dhe të burimeve që janë në dispozicion, mirëpo duhet siguruar se politika nuk është bazuar në supozimet e dikujt, por në fakte dhe në analizën solide të gjendjes vendore.

Mendoni

1. Cilat nga parimet e mësipërme i konsideroni si të nevojshme për të pasur një politikë efektive rinore në nivel lokal?
2. Cilat nga këto parime mund të sjellin një vlerë shtesë, mirëpo nuk janë të patjetërsueshme për efektivitetin e politikës rinore lokale?Pse?

Qasjet e ndryshme gjenerike po ashtu mund të përshtaten me kontekstin vendor. Një qasje e tillë⁴⁹ quhet “qasje zjarrfikëse”. Mund të zbatohet kur autoritetet vendore reagojnë vetëm ndaj problemeve të veçanta që kanë të bëjnë me të rinjtë. Këto probleme nuk shihen si pjesë e një çështjeje të ndërlikuar, por si ngjarje të izoluar që duhet të zgjidhen sa më shpejtë që është e mundur (sikurse zjarret e vogla që duhet të shuhën menjëherë). Pasi të jetë zgjidhur problemi, çështja harrohet dhe trajtohet problemi i ardhshëm. Megjithatë, tani ka një zhvendosje drejt një qasjeje tjetër që i vendos të rinjtë në qendër dhe i trajton ata si burim, e jo si problem. Kur autoritetet vendore e ndjekin këtë filozofi, ato përpiqen që të rinjtë të kenë mundësi që ta zhvillojnë potencialin e tyre intelektual, social, artistik dhe fizik, dhe ata të mund të kontribuojnë me talentet e tyre për mirëqenien e gjithë komunitetit. Besohet se përqendrimi në zhvillimin e anëve të tyre të fuqishme i fuqizon të rinjtë të ndërtojnë jetë më të mirë dhe i parandalon ata nga përfshirja në aktivitetet e krimin ose sjelljet e tjera shkatërruese. Në fund, ka një qasje që quhet “menaxhimi sipas objektivave”⁵⁰. Kjo qasje e sheh politikën rinore vendore në aspekt të qëllimeve të veçanta që duhet të arrihen dhe zbatimi i këtyre qëllimeve planifikohet, realizohet dhe vlerësohet me kujdes. Kjo qasje është përqendruar në iniciimin e ndryshimeve konkrete dhe në kontrollimin e efikasitetit të gjithë procesit.


Mendoni

1. Çfarë përparësish dhe mangësish mund të shihni në këto tri qasje në kontekstin tuaj vendor?
2. Cila nga këto qasje (nëse ka ndonjë) ndaj politikës rinore vendore shfrytëzohet në komunitetin ose rajonin tuaj? Si mund ta dalloni atë/ato?

49. Qasjet e prezantuara në këtë paragraf janë cituar nga Lauritzen, P., “Essentials of a youth policy in the Council of Europe”, kumtesë e papublikuar, faq. 4.

50. Për më tepër informacione në lidhje me menaxhimin sipas objektivave, shihni Siurala, L., *European framework of youth policy*, Budapest, 2004.





Politika rinore vendore duhet të përbëhet prej dy shtyllave. Duhet t'i zbatojë dispozitat relevante të politikës rinore kombëtare dhe duhet t'i trajtojë sfidat e veçanta të komunitetit. Siç u theksua më lartë, në kornizën e politikës rinore kombëtare disa detyra ose objektiva mund t'u delegohen niveleve të tjera të vendimmarrjes, e po ashtu edhe rajoneve dhe komuniteteve. Prandaj, është esenciale që dispozitat e politikës rinore kombëtare të dihen dhe të zbatohen në nivel vendor. Ndonjëherë duhet të përmirësohet qarkullimi i informacionit ndërmjet niveleve të ndryshme të vendimmarrjes, dhe është përgjegjësi e autoriteteve vendore të marrin informata për politikën rinore kombëtare dhe të kërkojnë mënyra për zbatimin e saj në komunitetin ose rajonin e tyre. Politikat rinore mund të formulohen në mënyra të ndryshme. Në disa vende ka shumë pak dokumente të detajuara që i trajtojnë aspektet më të rëndësishme të jetës së të rinjve. Në vende të tjera, politika rinore ekziston si një numër rregullash dhe dispozitash ligjore të ndara, të cilat janë shpërndarë nëpër domene të ndryshme (për shembull, ligje të veçanta në lidhje me të rinjtë në kuadër të politikës kombëtare për punësim, ose rregulla në kuadër të politikës për luftimin e kimit, etj.).

Mirëpo, edhe në këto raste, ministritë ose institucionet e tjera qendrore që janë përgjegjëse për të rinjtë duhet të kenë mundësi të ofrojnë hollësi për politikën rinore kombëtare, si dhe informacion për atë se çka mund dhe duhet të bëhet në nivel vendor.

→ 7.2 Karta e rishikuar dhe politika rinore vendore

Karta e rishikuar përmban një numër rekomandimesh për politikat sektoriale në nivel vendor dhe rajonal. Mirëpo, është me rëndësi të mbahet mend se këto rekomandime kryesisht kanë të bëjnë me aspektet e ndryshme të pjesëmarrjes së të rinjve dhe e anashkalojnë një spektër të gjerë të çështjeve të tjera që janë të rëndësishme për të rinjtë në një komunitet vendor. Përkundër këtyre kufizimeve, Karta mund të jetë një mjet i dobishëm për krijimin e politikës rinore vendore. Më poshtë është sqaruar se si mund të bëhet kjo.

Përqaftimi i vlerave të promovuar në Kartë

Politikat për të rinjtë bazohen në vlera, po ashtu edhe i promovojnë ato. "Nuk është e vështirë të merrni vendime në qoftë se e dini se cilat janë vlerat tuaja."⁵¹ Për këtë arsye, aktorët duhet të vendosin se cilat vlera janë të rëndësishme për ta gjatë krijimit të politikës rinore vendore dhe si mund të pasqyrohen këto vlera në objektiva dhe veprime konkrete. Vlerat kryesore që theksohen në Kartë janë:

- *pjesëmarrja*: të rinjtë kanë të drejtë të përfshihen në vendimet që ndikojnë mbi jetën e tyre dhe për këtë arsye kanë të drejtë të përfshihen në zhvillimin dhe zbatimin e politikave rinore vendore;
- *liria e zgjedhjes për të marrë ose për të mos marrë pjesë*: të rinjtë duhet të kenë mundësi të marrin pjesë, mirëpo ata po ashtu mund të zgjedhin të mos marrin pjesë nëse ashtu dëshirojnë;
- *mos diskriminimi*: të rinjtë janë një grup i shumëllojshëm, mirëpo çdo individ duhet ta ketë mundësinë të luajë rol aktiv në kontekstin e tij/saj, pa marrë parasysh prejardhjen, arsimin, statusin financiar, aftësinë e kufizuar fizike, statusin e pakicës, etj.;

51. Disney, R., skenarist amerikan dhe nip i Volt Diznit (Walt Disney).

- *multikulturalizmi*: duhet të respektohen nevojat, zakonet, kulturat dhe stilet e ndryshme të jetës;
- *të drejtat*: të rinjtë janë qytetarë dhe pjesëtarë të komunitetit vendor sikurse dhe njerëzit e tjerë. Prandaj, ata duhet të kenë të drejta të ngjashme ose ekuivalente (adekuate për moshën e tyre dhe në lidhje me obligimet e tyre si pjesëtarë të komunitetit);
- *respekti*: të rinjtë duhet të trajtohen me dinjitet dhe pikëpamjet e tyre duhet të respektohen (mirëpo, ta respektosh pikëpamjen e dikujt nuk do të thotë patjetër se duhet të pajtohesh me të);
- *partneriteti*: të rinjtë duhet të trajtohen si partnerë në procesin e vendimmarrjes, e jo si klientë që presin të shërbehen;
- *përgjegjësia*: të rinjtë, sikurse çdo pjesëtar tjetër i shoqërisë, duhet të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre;
- *fuqizimi*: të rinjtë kanë talente dhe anë të fuqishme që mund t'i shfrytëzojnë për t'i trajtuar problemet dhe sfidat e tyre, mirëpo ndonjëherë ata kanë nevojë të fuqizohen dhe të mbështeten që të mund t'i zhvillojnë dhe t'i shfrytëzojnë talentet e tyre në mënyrë sa më efikase;
- *mbështetja*: të rinjtë ka fuqi dhe burime të kufizuara. Ata kanë nevojë për mbështetje që të mund të luajnë rol aktiv në komunitetin e tyre.

Shfrytëzimi i shembujve të politikave sektoriale

Karta përmban analizë të sektorëve që luajnë rol të rëndësishëm në jetën e të rinjve në nivel vendor. Kjo analizë mund të ndihmojë në strukturimin e procesit të vlerësimit të nevojave të të rinjve në një komunitet ose rajon, ose mund të shfrytëzohet si mostër për përgatitjen e politikave vendore (edhe pse kjo mostër duhet të plotësohet me elemente që janë relevante për rrethanat e caktuara). Karta, po ashtu sqaron se pse sektorët e veçantë duhet të trajtohen nga politikat rinore vendore.

Politikat sektoriale	Arsyet për zbatimin e kësaj politike në nivel vendor
Politikat për sportin, kohën e lirë dhe jetën shoqërore	<ul style="list-style-type: none"> – aktivitetet janë njëra nga shtyllat e kohezionit social në komunë ose në rajon; – kanal ideal për pjesëmarrjen e të rinjve; – kanal ideal për zbatimin e politikave rinore në fushën e sportit, kulturës, zejeve dhe formave artistike dhe formave të tjera të krijimit dhe të shprehjes, si dhe në fushën e veprimit social.
Politikat për të nxitur punësimin e të rinjve dhe për të luftuar papunësinë	<ul style="list-style-type: none"> – kushtet ekonomike dhe shoqërore me të cilat ballafaqohen të rinjtë ndikojnë në vullnetin dhe aftësinë e tyre për të marrë pjesë; – papunësia dhe varfëria e bëjnë shumë të vështirë për t'u bërë qytetar aktiv; – të rinjtë e papunësuar ka të ngjarë të jenë më të përjashtuarit në shoqëri.



<p>Politikat për mjedisin urban dhe vendbanimet, strehimin dhe transportin</p>	<ul style="list-style-type: none"> – mjedisi i jetesës që është më i integruar dhe më pak i fragmentarizuar është më i favorshëm për ndërveprim shoqëror dhe për zhvillimin e hapësirave publike me cilësi të lartë; – mjedisi më i favorshëm është më i përshtatshëm për vetëplotësimin personal dhe zhvillimin e solidaritetit ndërmjet gjeneratave; – lëvizshmëria (mobiliteti) i të rinjve është i domosdoshëm për pjesëmarrjen në jetën shoqërore dhe për të qenë qytetarë në kuptimin e plotë të fjalës; – në zonat rurale, lëvizshmëria dhe transporti janë një domosdoshmëri themelore për cilësinë e jetës dhe jo vetëm nevojë për ta lehtësuar pjesëmarrjen; – mungesa e mjeteve të transportit çon në përjashtim.
<p>Politikat e edukimit dhe të trajnimit të cilat nxisin pjesëmarrjen e të rinjve</p>	<ul style="list-style-type: none"> – shkollat janë vende ku formësohen pikëpamjet dhe perspektivat e të rinjve për jetën; – shkollat janë zakonisht vendi i parë ku nxënësit e ndjejnë demokracinë në veprim dhe ku mund ta praktikojnë pjesëmarrjen.
<p>Politikat shëndetësore</p>	<ul style="list-style-type: none"> – të rinjtë rrezikohen nga duhani, alkooli dhe abuzimi i drogave; – ka një rritje të dukshme në sëmundjet seksualisht të transmetueshme që rezultojnë me gjykime morale dhe izolim.
<p>Politikat e barazisë gjinore</p>	<ul style="list-style-type: none"> – femrat dhe meshkujt e rinj kanë vështirësi të fitojnë pozita me përgjegjësi në jetën profesionale, shoqata, politikë dhe në autoritetet vendore dhe rajonale; – në nivel vendor ka pabarazi në mes të femrave dhe meshkujve të rinj
<p>Politikat e veçanta për rajonet rurale</p>	<ul style="list-style-type: none"> – të rinjtë në zonat rurale kanë nevoja të ndryshme nga moshatarët e tyre që jetojnë në qytete sa i përket arsimit, edukimit, punësimit, banimit, transportit, etj...; – të rinjtë që jetojnë në zonat rurale kanë nivel më të ulët të shërbimeve shoqërore nga ata që jetojnë në zonat urbane; – organizatat rinore dhe organizatat e tjera të komunitetit e stimulojnë jetën shoqërore dhe kulturore në komunitetet rurale dhe mund të jenë një mjet i rëndësishëm shoqëror për të rinjtë; – të rinjtë dhe organizatat e tjera të komunitetit e inkurajojnë pjesëmarrjen e të rinjve vendor; – të rinjtë dhe organizatat e tjera të komunitetit e rrisin cilësinë e jetës dhe luftojnë probleme të izolimit rural
<p>Politikat për qasje në kulturë</p>	<ul style="list-style-type: none"> – arti dhe kultura janë pjesë e trashëgimisë kolektive dhe personale të së kaluarës, së tashmes dhe të ardhmes dhe ato janë pasqyrim i çdo shoqërie; – Të rinjtë luajnë një rol në këto zhvillime kulturore nëpërmjet zbatimit në praktik të kulturës dhe kapaciteteve të tyre për iniciativë, kërkim dhe novacion.



<p>Politikat për zhvillim të qëndrueshëm dhe për mjedisin</p>	<ul style="list-style-type: none"> – të rinjtë dhe pjesëtarët e tjerë të shoqërisë përballen me përkeqësim të mjedisit; – problemet e mjedisit janë shqetësim kryesor për të rinjtë, të cilët do të jenë të detyruar në të ardhmen që të përballen me pasojat e gabimeve të së shkuarës.
<p>Politikat për të luftuar dhunën dhe krimin</p>	<ul style="list-style-type: none"> – të rinjtë janë shpesh viktime të krimit, dhunës, shfrytëzimit seksual, abuzimit dhe formave të tjera të keqtrajtimit; – ka forma të ndryshme të dhunës në shkolla; – mungojnë përgjigjet adekuate ndaj krimit dhe dhunës në shoqërinë bashkëkohore.
<p>Politikat antidiskriminuese</p>	<ul style="list-style-type: none"> – ka diskriminim ndaj pakicave, duke i përfshirë anëtarët e rinj të grupeve minoritare; – ka diskriminim ndaj njerëzve me aftësi të kufizuara dhe grupeve të tjera të popullsisë; – në disa komunitete, nuk është e garantuar qasja e barabartë në vendet publike, në trajnim profesional, shkollim, banim, aktivitetet kulturore dhe në fushat e tjera të jetës
<p>Politikat mbi seksualitetin</p>	<ul style="list-style-type: none"> – gjatë kalimit nga fëmijëria, periudha e varësisë drejtë një jete autonome të të rriturve, të rinjtë mund të përballen me një sërë pyetjesh lidhur me marrëdhëniet e tyre personale; – ekziston një mungesë e vazhdueshme njohurish rreth çështjeve të shëndetit seksual; – ka mosbesim ndaj qëndrimeve zyrtare lidhur me rreziqet e sjelljeve të caktuara seksuale; – shfaqja dhe ushtrimi i seksualitetit të të rinjve nuk është gjithmonë i lehtë.
<p>Politikat për qasjen në të drejta dhe në ligj</p>	<ul style="list-style-type: none"> – në mënyrë që të jetojnë së bashku, shoqëritë bazohen në rregulla të cilat duhet të respektohet nga të gjithë; – në shoqëritë demokratike, këto rregulla diskutohen dhe miratohen nga përfaqësuesit e zgjedhur nga qytetarët; – duke qenë se numri i teksteve dhe i rregullave ligjore është gjithmonë në rritje, bëhet gjithnjë e më e vështirë për një individ që t'i njohë dhe t'i zbatojë ato; – numri gjithnjë e më i madh i teksteve dhe i rregullave ligjore krijon dallime ndërmjet qytetarëve (për shkak se disa janë të vetëdijshëm për të drejtat dhe detyrimet e tyre, ndërsa të tjerët jo).



Lista e mësipërme e arsyeve për futjen në përdorim të politikës rinore në disa fusha të veçanta nuk është përfundimtare dhe është e menduar si mostër dhe si pikë fillestare për analizë të mëtutjeshme. Roli kryesor i Kartës është ta promovojë pjesëmarrjen e të rinjve në përgjithësi dhe si rezultat i kësaj nuk trajton disa çështje (marrëdhëniet ndërmjet gjeneratave, parandalimin e konflikteve, etj.) dhe trajton disa të tjera vetëm në masë të kufizuar. Prandaj, u takon aktorëve vendor të përfshirë në zhvillimin e politikës vendore që t'i identifikojnë fushat që mungojnë në Kartë.

Mendoni

1. *Cilat vlera që promovohen në Kartë i konsideroni si më të rëndësishme në komunitetin tuaj vendor? Pse?*
2. *Cilat nga politikat sektoriale që u prezantuan më lartë, tashmë janë pjesë e politikave rinore vendore në komunitetet tuaja?*
3. *Cilat politika të tjera sektoriale që nuk gjenden në Kartë i përmban politika juaj rinore vendore?*
4. *Cilat politika sektoriale akoma mungojnë nga konteksti juaj vendor?*

→ 7.3 Procesi i formulimit të politikës rinore vendore

Formulimi i politikës rinore vendore është procedurë e ndërlikuar që kërkon përfshirjen e aktorëve të ndryshëm. Autoritetet vendore, si organ kryesor që merret me politikat vendore kanë ekspertizë dhe përvojë të konsiderueshme në këtë fushë dhe për këtë arsye ato duhet të luajnë rol aktiv në gjithë procesin e zhvillimit të politikës rinore vendore. Ky proces ndryshon prej vendi në vend për shkak të traditave, normave, procedurave dhe ligjeve ekzistuese, dhe nuk ka mundësi të ofrohet një model universal për të gjitha situatat e ndryshme në Evropë. Megjithatë, ekzistojnë disa sugjerime që mund të jenë të dobishme kur punohet në formulimin e politikës rinore vendore.

Ndërtimi i partneriteteve

Politika efikase rinore në nivel vendor ka nevojë për përfshirjen e aktorëve të ndryshëm: autoriteteve vendore, të rinjve, organizatave dhe institucioneve vendore. Disa komunitete e shfrytëzojnë qasje prej lartë-poshtë, që do të thotë se autoritetet vendore vendosin për politikën dhe pastaj e zbatojnë vetë atë ose përpiqen të gjejnë partnerë që do ta zbatojnë atë. Megjithatë, kjo qasje nuk është shumë pjesëmarrëse, dhe rekomandohet fuqishëm që aktorë të ndryshëm të përfshihen në gjithë procesin që në fazat e hershme.

Është e qartë se pse nevojitet politika rinore vendore në nivel vendor

Zhvillimi i politikave rinore vendore momentalisht është në modë dhe një numër gjithnjë e më i madh i komuniteteve kanë treguar interes që t'i trajtojnë çështjet rinore në mënyrë më koherente dhe më efikase. Politika e mirë rinore në nivel vendor mund të sjellë dobi dhe ndryshime reale, prandaj pasi të fillojë procesi për krijimin e politikës së tillë, është me rëndësi të identifikohet se cilat ndryshime dhe përmirësime konkrete duhet të bëhen.

Mbledhja e informacioneve për politikën rinore kombëtare dhe rajonale

sua më lartë, politika rinore vendore duhet të ndërtohet mbi dy shtylla, njëra nga të cilat është politika rinore kombëtare. Kur politika kombëtare ua delegon disa objektiva ose veprime niveleve të tjera, duhet të shihet saktësisht se cilat janë këto përgjegjësi të deleguara, dhe a ka ndonjë udhëzim që mund të ndihmojë për zbatimin e tyre, ashtu që zbatimi i tyre të planifikohet në kuadër të kornizës rinore vendore. Politika kombëtare po ashtu duhet ta trajtojë gjithë diapazonin e çështjeve që janë relevante për nivelin vendor, ashtu që politik bërësit vendor të udhëzohen dhe të inspironen për punën e tyre.



Analiza e gjendjes së të rinjve në komunitetin vendor – identifikimi i nevojave

Një shtyllë tjetër e politikës rinore vendore përqendrohet në çështjet që janë me rëndësi të veçantë për komunitetin vendor. Këto çështje mund të mos trajtohen nga politika rinore kombëtare, e cila ka një diapazon të kufizuar dhe përqendrohet vetëm në disa fusha që kanë prioritet, që janë relevante për të gjithë të rinjtë që jetojnë në atë vend. Është shumë me rëndësi të analizohet gjendja e të rinjve në komunitetin vendor dhe të vendoset se cilat fusha, probleme dhe sfida plotësuese duhet të trajtohen në politikën rinore vendore. Në atë mënyrë, mund të sigurohet se politika rinore vendore do t'i pasqyrojë nevojat dhe aspiratat e të rinjve dhe se nuk është vetëm pjesë e agjendës politike të vendimmarrësve vendor.

Identifikimi dhe vlerësimi i programeve dhe i veprimeve të ndryshme në nivel vendor e që kanë të bëjnë me të rinjtë

Edhe në qoftë se zyrtarisht nuk ka politikë rinore vendore, ka shumë të ngjarë të ketë projekte, ngjarje dhe iniciativa të ndryshme, qoftë formale ose joformale, që realizohen në komunitet. Ato kanë potencial të vërtetë për të bërë ndryshime pozitive në jetën e të rinjve dhe mund të kontribuojnë në zbatimin e politikës rinore vendore, dhe për këtë arsye, aktorët e përfshirë në krijimin e politikave duhet ta dinë saktësisht se çka është duke ndodhur dhe cilat organizata, institucione ose grupe janë të përfshira.

Caktimi i prioriteteve

Të rinjtë janë një grup i shumëllojshëm e kjo do të thotë se ata kanë nevoja dhe pritje të ndryshme. Mund të jetë e pamundur që të plotësohen të gjitha këto në kuadër të politikës rinore vendore duke i shfrytëzuar burimet që janë në dispozicion dhe për këtë arsye duhet të caktohen prioritetet. Caktimi i prioriteteve është një hap shumë i rëndësishëm e ndonjëherë edhe i vështirë, pasi duhet të vlerësohet vlera e çështjeve që shqyrtohen. Prioritetet nuk duhet të zgjidhen në bazë të preferencave personale ose të organizatës të palëve të përfshira, por në bazë të analizës së qëndrueshme të situatës.

Përkufizimi i vizionit/qëllimeve/objektivave/strategjisë/planit të veprimit/vlerësimit

Ka formula të ndryshme që mund të përdoren për zhvillimin e politikave vendore. Disa komunitete fillojnë me përshkrimin e vizionit, të tjerat preferojnë të përqendrohen në formulimin e qëllimeve dhe të objektivave. Nuk ka mënyrë të drejtë apo të gabuar për ta bërë këtë. Krijuesit e politikave vendore duhet ta kenë të qartë se çka dëshirojnë të arrijnë, në çfarë afati kohor, me cilat burime, si planifikojnë ta bëjnë këtë dhe si dëshirojnë ta vlerësojnë gjithë procesin. Politika rinore, sikurse çdo iniciativë tjetër, duhet të vlerësohet rregullisht, dhe vlerësimi duhet të planifikohet së bashku me të gjitha elementet e tjera të politikës.

Konsultimet për propozimet e politikave

Të gjitha palëve të përfshira në procesin e krijimit të politikës rinore vendore dhe që janë të interesuara për çështjet rinore në nivel vendor duhet t'u jepet mundësi të japin komente dhe t'i shprehin mendimet e tyre për propozimin përfundimtar të politikës. Kjo mund të bëhet nëpërmjet një cikli konsultimesh ose nëpërmjet takimeve, punëtorive, anketave, etj.

Miratimi i politikës

Politika për të rinjtë mund të ketë status të ndryshëm në nivel vendor Mund të mbetet në nivel të marrëveshjes ndërmjet palëve, mirëpo mund edhe të njihet zyrtarisht nga autoritetet vendore dhe të miratohet si një fushë e politikës publike vendore. Në rastin e dytë, autoritetet vendore marrin përgjegjësi politike për zbatimin e kësaj politike dhe do të japin llogari para gjithë komunitetit për rezultatet.



Shpërndarja e informacionit

Informacioni për politikën rinore vendore duhet të shpërndahet në komunitetin vendor ose në rajon ashtu që ata që janë të interesuar të mund të përfshihen. Vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet informimit të të rinjve për politikën e tillë, pasi që ata do të jenë përfituesit kryesorë të saj.

Monitorimi me pjesëmarrje i zbatimit të politikës

Duhet të ketë kontroll sistematik ose ekzaminim të aspekteve të ndryshme të zbatimit të politikës (monitorim) që të vlerësohet përparimi që është bërë në raport me objektivat e veçanta. Monitorimi ndihmon jo vetëm që të kontrollohet se sa në mënyrë efikase shfrytëzohen burimet, gjithashtu ndihmon edhe në identifikimin e sukseseve dhe të problemeve në fazë të hershme. Po ashtu siguron se politika mund të përshtatet në rast se ndryshon situata në komunitet ose në shoqëri. Monitorimi me pjesëmarrje do të thotë se monitorimi përfshin aktorë të ndryshëm vendor, e në veçanti të rinjtë.

Mendoni

1. Si do ta përshkruanit politikën rinore vendore në komunitetin ose në rajonin tuaj? Cilat janë përparësitë e tij?
2. Në çfarë mase kjo politikë e pasqyron politikën rinore kombëtare të vendit tuaj?
3. Kush ka qenë i përfshirë në hartimin e politikës vendore?
4. Kush është i përfshirë në zbatimin e saj?
5. Si monitorohet politika rinore?

→ 7.4 Përfaqësimi (Avokatësia) – Rrjetëzimi për ndryshim të politikës

Edhe pse politika rinore në përgjithësi është duke u bërë çështje e rëndësishme në nivel vendor, në disa komunitete prioritetet gjenden diku tjetër. Organizatat, institucionet dhe individët e ndryshëm përpiqen që çështjet rinore ta fitojnë vëmendjen e duhur duke u përfshirë në përfaqësim (avokatësi), e cila mund të definohet si një sërë veprimesh të orientuara kah vendimmarrësit për ta mbështetur një çështje të veçantë politike⁵², si dhe duke krijuar rrjete të përfaqësimit (avokatësisë). Përfaqësimi (Avokatësia) ka për qëllim të ndikojë mbi aspektet e ndryshme të politikës rinore, siç është perceptimi publik për çështjet e caktuara ose qëndrimet e krijuesve të politikave. Po ashtu, mund të ketë për qëllim të mbështesë zgjidhje të caktuara apo të ndalojë propozime të caktuara. Përfaqësimi (Avokatësia) mund të shfrytëzohet në nivele të ndryshme - institucionale, vendore, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Përfaqësimi (Avokatësia) bazohet të rrjetëzim – krijimin dhe mbajtjen e kontakteve me ata që mbështesin qëllime të njëjta dhe të cilët pajtohen të punojnë për arritjen e qëllimeve të përbashkëta. Në fakt, pothuajse çdokush është pjesë e ndonjë rrjeti – në punë, në shkollë, në jetën shoqërore ose në aktivitetet sportive – në përgjithësi njerëzit dinë mjaft për këtë formë të bashkëpunimit dhe e shfrytëzojnë atë me shkathtësi. Rrjetet e përfaqësimit (të avokatësisë) duhet të organizohen në atë mënyrë që koha, motivimi dhe burimet e tjera të shfrytëzohen në mënyrë sa më efikase për t’i arritur qëllimet.

Në disa raste, rrjeti i përfaqësimit (avokatësisë) evoluon në koalicion (një lloj sindikate) dhe kjo ka vlerë të paçmueshme për shkak se bashkon njerëz dhe burime nga gjithë sektorët e komunitetit dhe ofron një shenjë të dukshme të mbështetjes nga komuniteti⁵³. Puna në kuadër të koalicionit ndihmon për të bërë shpërndarjen e përgjegjësive dhe krijon hapësirë për t’u angazhuar në zgjidhjen e problemeve në grup.

52. Networking for policy change. An advocacy training manual, The Policy Project, 1999, faq. I-1.

53. “Advocacy kit”, Advocates for Youth Washington, gjendet në: www.advocatesforyouth.org/publications/advocacykit.pdf.



Megjithatë, ajo është një formë mjaft e mbyllur e bashkëpunimit, dhe ndonjëherë interesat e anëtarëve të koalicionit dallojnë, gjë që shkakton vështirësi të mëvonshme.

Gjatë krijimit të rrjetit, duhet shqyrtuar këto pyetje:

- Cili është qëllimi i rrjetit?
- Çfarë shkathtësish, ekspertizë dhe burime nevojiten për arritjen e këtij qëllimi?
- Kush mund t'i sjellë në rrjet këto shkathtësi, ekspertizë dhe burime? Cilët njerëz, organizata, dhe institucione duhet të jenë pjesë e këtij rrjeti?
- Çfarë lloj përkushtimi do të nevojitet nga anëtarët e rrjetit?
- Si mund të inkurajohen anëtarët potencialë që t'i bashkëngjiten rrjetit?
- Kush duhet ta bëjë këtë?
- Kur duhet të mbahet takimi i parë?
- Çka duhet të përmbajë agjenda?
- Si duhet të jetë struktura?
- Si duhet të merren vendimet?
- Çfarë forme duhet të ketë udhëheqësia?
- Si duhet të funksionojë bashkëpunimi?
- Si duhet të funksionojë qarkullimi i informacioneve?
- Si duhet të trajtohen konfliktet potenciale?
- Si duhet të zhvillohet plani i veprimit?
- Si mund të sigurohen burimet e nevojshme?
- Si duhet të monitorohet dhe të vlerësohet plani i veprimit?
- Çfarë lloj mbështetjeje nevojitet që rrjeti të funksionojë (për shembull, mbështetje sekretarie)? Si mund të sigurohet ajo?

Në masë të madhe, puna e përfaqësimit (avokatësisë) është e bazuar në komunikimin efektiv, dhe për këtë arsye, anëtarët e rrjetit të përfaqësimit (avokatësisë) duhet të posedojnë ose t'i zhvillojnë shkathtësitë që mundësojnë komunikim sa më të mirë. Kjo është shumë me rëndësi, jo vetëm për kontaktet me krijuesit e politikave, por edhe për mbajtjen e marrëdhënieve të mira të punës në kuadër të rrjetit. Shkathtësitë që nevojiten kanë të bëjnë me formulimin e mendimeve, shprehjen e mendimeve dhe të ndjenjave, përcjelljen e porosive, përgatitjen e prezantimeve me cilësi të lartë dhe leximin e shenjave jo verbale, si dhe dëgjimin aktiv dhe inkurajimin e të tjerëve që të flasin.

Që ekipi për përfaqësim (avokatësi) të jetë i suksesshëm, është me rëndësi të madhe të kuptohet se si funksionojnë proceset e politikës në nivel vendor. Anëtarët duhet ta dinë se si krijohen politikat (procedurat, rregullat formale dhe kushtet), kush është i përfshirë dhe në çfarë kapaciteti, çfarë pushteti ka secili nga aktorët, etj. Kur të mblidhen të gjitha këto informacione, ka mundësi të identifikohen objektiva reale dhe mënyra më efikase për t'i kontaktuar krijuesit e politikave që të arrihen këto objektiva. Anëtarët e rrjetit duhet të dinë t'i demonstrojnë këto njohuri, pasi shumë krijues të politikave konsiderojnë se organizatat joqeveritare, për shembull, kanë mungesë të njohurive dhe të përvojës së nevojshme për t'u përfshirë në procesin e formulimit të politikave. Qëndrimet e tilla i bllokojnë përpjekjet për përfaqësim (avokatësi) dhe mund të çojnë në refuzimin e bashkëpunimit.



Mendoni

1. Si do t'i vlerësonit shkathtësitë tuaja për komunikim? Cila janë anët tuaja të fuqishme dhe të dobëta?
2. Si krijohen politikat në vendin tuaj?
3. Si krijohen politikat në rajonin ose komunitetin tuaj vendor?
4. A keni qenë ndonjëherë të përfshirë në procesin e formulimit ose të zbatimit të ndonjë politike? Në çfarë roli?

Hapat e procesit të përfaqësimit (avokatësisë)⁵⁴

Hapi 1 – Përkufizimi i çështjes

Rrjeti duhet të pajtohet se cilën çështje do ta mbështesë, që ta promovojnë ndryshimin e politikës. Kjo çështje duhet të përputhet me misionin e rrjetit dhe duhet t'i plotësojë kriteret për të cilat paraprakisht është arritur pëlqim.

Hapi 2 – Caktimi i qëllimeve dhe i objektivave

Rrjeti duhet të definojë shkurtimisht se çka dëshiron të arrijë në afat të gjatë (qëllimet), e pastaj të caktojë arritje të veçanta, të matshme dhe afatshkurta që do të kontribuojnë për arritjen e qëllimeve.

Hapi 3 – Identifikimi i publikut të synuar

Publiku kryesor i synuar janë krijuesit e politikave që kanë fuqi të paraqesin ndonjë politikë të re ose ndryshim të politikës. Publiku i dytë i synuar janë të gjithë ata që kanë qasje në publikun kryesor dhe që mund të ndikojnë mbi të, siç janë krijuesit e tjerë të politikave, politikanët, të punësuarit në autoritetet vendore, mediet, udhëheqësit vendor, etj. Rrjeti duhet ta identifikojë se kush janë këta njerëz ose grupe, çfarë pushteti kanë dhe cilat janë qëndrimet e tyre ndaj ndryshimit të propozuar të politikës (gjegjësisht, a janë për të, kundër tij apo janë neutralë).

Hapi 4 – Krijimi i mbështetjes

Anëtarët e rrjetit duhet të kërkojnë mbështetje nga ato organizata, institucione, rrjete, grupe civile, koalicione, aktivistë ose individë që janë të interesuar për çështjen në fjalë dhe të cilët do të ishin të gatshëm t'u ndihmojnë në arritjen e qëllimeve të tyre. Suksesi i iniciativës në masë të madhe varet nga baza mbështetëse, kështu që duhet planifikohet kohë dhe burime të mjaftueshme për këtë detyrë.

Hapi 5 – Zhvillimi i porosisë

Porositë e përfaqësimit (avokatësisë) duhet të formulohen në atë mënyrë që publiku i synuar të bindet ta ofrojë mbështetjen e tij për propozimin e rrjetit. Prandaj, porosia duhet të përshtatet që të përputhet me profilin e publikut të synuar dhe duhet ta shprehë në mënyrë të qartë atë që pritet.

Hapi 6 – Vendosja e urave të komunikimit

Publiku juaj i synuar do t'i zgjedhë urat e komunikimit. Duhet të shfrytëzohen mënyra të ndryshme për përcjelljen e porosisë gjatë përpjekjeve për të arritur deri te vendimmarrësit, gjatë edukimit të komunitetit vendor ose kur kërkohet mbështetja e grupeve ose e individëve që kanë qëndrime të ngjashme. Në nivel vendor, urat e komunikimit mund të përfshijnë komunikata për shtyp në mediet vendore, debate vendore, takime me krijuesit e politikave dhe dokumente me fakte etj.

54. Modeli i prezantuar në *Networking for policy change. An advocacy training manual*, The Policy Project, 1999, faq. III-7-III-9.



Hapi 7– Mbledhja e mjeteve financiare

Iniciativat e përfaqësimit (avokatësisë) kanë nevojë për mbështetje financiare që t'i mbulojnë shpenzimet për materiale, udhëtime (për shembull, kur shkojnë në takime me vendimmarrësit), infrastrukturën për takime (siç është marrja me qira e vendit për takim) dhe shpenzimet për komunikim ndërmjet anëtarëve të rrjetit, etj. Për t'u mos u mbështetur vetëm në kontributet financiare të anëtarëve të rrjetit, krijimi i hershëm i strategjisë për mbledhjen e mjeteve financiare në procesin e përfaqësimit (avokatësisë) mund të ndihmojë për të siguruar mbështetje të jashtme financiare.

Hapi 8 – Zhvillimi i planit për zbatim

Rrjeti duhet të planifikojë se si do të zhvillohet e gjithë fushata e përfaqësimit (avokatësisë). Plani duhet të përfshijë një listë të të gjitha aktiviteteve dhe të detyrave dhe duhet t'i përcaktojë përgjegjësitë që do t'i jepen çdo personi apo grupi. Po ashtu, duhet të caktohet një afat kohor për përfundimin e të gjitha aktiviteteve dhe duhet të shënohen burimet e nevojshme, si dhe të sqarohet se si do të sigurohen këto burime.

Aktivitetet aktuale

- mbledhja e të dhënave në faza të ndryshme gjatë gjithë fushatës së përfaqësimit (avokatësisë). Kjo është e dobishme gjatë identifikimit të çështjeve kryesore që duhet të trajtohen kur zhvillohen objektivat përkatëse, gjatë formulimit të porosisë së përfaqësimit (avokatësisë), gjatë kërkit të mbështetjes, e po ashtu edhe gjatë ndikimit mbi krijuesit e politikave;
- monitorimi dhe vlerësimi duhet të bëhen gjatë gjithë fushatës së përfaqësimit (avokatësisë). Të dyja këto aktivitete duhet të planifikohen që më parë, që të mund të vlerësohet përparimi dhe rezultatet e arritura.

Përfaqësimi (Avokatësia) është një metodë shumë e fuqishme për të bërë ndryshime të politikave ose për ta iniciuar zhvillimin e politikave të reja në kontekste të ndryshme dhe në nivele të ndryshme. Mirëpo, potenciali i saj nuk shfrytëzohet sa duhet në komunitetet vendore (veçanërisht sa i përket çështjeve rinore), përkundër faktit se përfaqësimi (avokatësia) e lehtëson vendosjen e kontaktit personal me krijuesit e politikave vendore dhe krijimin e raporteve të drejtpërdrejta me aktorët e interesuar. Në masë të madhe, kjo ndodh për shkak se njerëzit që punojnë për të rinjtë dhe me ta, janë të bindur se puna e përfaqësimit (avokatësisë) kërkon shkathtësi dhe kompetenca të veçanta që ata nuk i kanë. Mirëpo, ata harrojnë se puna e përfaqësimit (avokatësisë) është e bazuar kryesisht në përkushtimin dhe në motivimin e palëve të interesuara.

Mendoni

- 1. Cilat ndryshime të politikave (në fushën e të rinjve ose në cilëndo qoftë fushë tjetër) mund të përfitojnë nga procesi i përfaqësimit (avokatësisë) në komunitetin ose rajonin tuaj?*
- 2. Kush do të ishte i interesuar ta mbështesë një ndryshim të tillë të politikës?*
- 3. Cili publik i synuar duhet të kontaktohet?*
- 4. Cilat ura të komunikimit do të ishin më efikase?*





KAPITULLI 8

Seksioni i edukimit

Puna pjesëmarrëse dhe shfrytëzimi i Kartës së rishikuar si mjet praktik kërkon një nivel të njohurisë, shkathtësive dhe të qëndrimit adekuat në lidhje me pjesëmarrjen e të rinjve. Si rezultat i kësaj, të gjithë ata që janë të interesuar për pjesëmarrjen e të rinjve në nivel vendor mund të kenë nevojë për mbështetje dhe trajnim të veçantë. Këto nevoja mund të trajtohen në mënyra të ndryshme, njëra nga të cilat është edhe organizimi i punëtorive që i shqyrtojnë dimensionet e ndryshme të pjesëmarrjes së të rinjve ose që u ndihmojnë pjesëmarrësve t'i identifikojnë mënyrat e ndryshme të shfrytëzimit të Kartës së rishikuar në kontekstin e tyre. Informacionet që ndihmojnë për përgatitjen e punëtorive të tilla mund të gjenden, qoftë në internet, qoftë drejtpërdrejt nga organizatat që punojnë në edukimin për pjesëmarrje.

Në këtë kapitull do t'i përshkruajmë aktivitetet e ndryshme edukative që mund të shfrytëzohen si pjesë e trajnimit që ka të bëjë me pjesëmarrjen e të rinjve në përgjithësi, ose me Kartën në veçanti. Këto aktivitete ose janë marrë nga burime të ndryshme edukative ose janë zhvilluar për nevojat e këtij doracaku.

Metoda e prezantuar janë:

Rombi me politika

Sandviçët me njerëz

Thikat dhe pirunët

Shkalla e pjesëmarrjes

Takimi me kryetarin e komunës

Rrjeti i pjesëmarrjes

Orteku i pjesëmarrjes

Boshti kohor i pjesëmarrjes

Të drejtat dhe pjesëmarrja Maskarada "DMHMM"

Luajtja e roleve sipas Kartës

Ushtrimi me deklarata



Trekëndëshi i bashkëpunimit
E saktë ose e pasaktë?
Çka mund të bësh për mua?
Vizita në Rinizi
Çka do të ndodhë nëse nuk ndodh?
Ushtrim për simulim “Të rinjtë në aksion”

Rombi me politika	
Titulli	Rombi me politika
Tema	Politikat vendore që e përmirësojnë pjesëmarrjen e të rinjve
Mostra	Ç’është gjëja më e rëndësishme?
Madhësia e grupit	Çfarëdo qoftë
Koha	90 minuta
Objektivat	<ul style="list-style-type: none"> – të prezantohet përmbajtja e Kartës së rishikuar; – të shqyrtohem politikat vendore që e përmirësojnë pjesëmarrjen e të rinjve; – të stimulohet diskutimi për politikat rinore vendore në kontekstin e pjesëmarrësve; – të promovohen shkathtësitë për bisedime.
Përgatitja	Të kopjohen kompletet e kartave për çdo grup të vogël që merr pjesë në aktivitetin “Rombi me politika”.
Materialet	Një komplet kartash për çdo grup të vogël.
Udhëzime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Pyetni pjesëmarrësit se çka nënkuptojnë me termin “politikë vendore”. 2. Prezantoni shkurtimisht politikat e ndryshme sektoriale që janë trajtuar në Kartën e rishikuar. 3. Ndani pjesëmarrësit në grupe të vogla prej 4 vetash që vijnë nga rajoni i njëjtë (qoftë brenda një vendi ose brenda Evropës) dhe jepni secilit grup nga një komplet kartash. 4. Sqaroni procedurën. Çdo grup duhet ta diskutojë shkurtimisht rëndësinë e politikave të shënuara në Kartë në raport me situatën e tyre. Pastaj duhet të bisedojnë se cilat janë politikat më të rëndësishme dhe ato më pak të rëndësishme për të rinjtë në rajonet e tyre, e cilat aspak nuk janë të rëndësishme. Më pas kartat me politika duhet të radhiten në formë të rombit. Karta me politikën më të rëndësishme duhet të vendoset në maje të rombit. Nën të duhet të vendosen dy karta, krahas njëra me tjetrën, dhe ato duhet t’i paraqesin politikat e tjera më të rëndësishme. Mesi i rombit duhet të ketë tri karta që i paraqesin politikat me rëndësi mesatare. Nën to duhet të ketë dy karta që i paraqesin politikat më pak të rëndësishme dhe në fund të rombit duhet të ketë një Kartë, që e paraqet politikën që aspak nuk është e rëndësishme për kontekstin e pjesëmarrësve. 5. Kërkoni nga grupet që t’i prezantojnë rombet e tyre para të tjerëve dhe t’i sqarojnë zgjedhjet e tyre.



<p>Diskutimi përmbyllës dhe vlerësimi</p>	<p>Pyetni pjesëmarrësit këto pyetje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Çka do të thotë “e rëndësishme” për ju? Si e përkufizuat këtë fjalë për nevojat e këtij ushtrimi? 2. Cilat politika u konsideruan si të më të rëndësishme për të gjitha grupet? Pse? 3. Cila janë dallimet ndërmjet rombeve? 4. Si ndikojnë politikat vendore mbi pjesëmarrjen e të rinjve? 5. A jeni të kënaqur me rezultatin e punës suaj? Pse? 6. Cili ishte ndikimi juaj në gjithë procesin e bisedimeve? 7. Çka mësuat nga ky ushtrim?
<p>Variacionet</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Në vend të prezantimit të politikave sektoriale të Kartës, moderatori mund t’i pyesë pjesëmarrësit se çfarë politikash vendore që janë të rëndësishme për të rinjtë ekzistojnë në komunitetet e tyre vendore ose në rajonet e tyre. 2. Nëse pjesëmarrësit e kanë të njohur Kartën, moderatori mund të bëjë një shqyrtim se a ju kujtohet atyre se çka thotë ajo për politikat sektoriale.
<p>Dokumentet e bashkangjytua</p>	<p>Rombi me politika–Mostra me kompletin e kartave</p>



ROMBI ME POLITIKA – Mostra me kompletin e kartave

Politikat për sportin, kohën e lirë, jetën shoqërore	Politikat për nxitjen për punësimin e të rinjve
Politikat e veçanta për rajonet rurale	Politikat e edukimit që e nxisin pjesëmarrjen e të rinjve
Politikat për zhvillimin e qëndrueshëm dhe për mjedisin	Politikat antidiskriminuese
Politikat e transportit	Politikat shëndetësore
Politikat për mobilitet dhe shkëmbime	

Sandviçët me njerëz	
Titulli	Sandviçët me njerëz <i>Burimi: Trajnimi për pjesëmarrjen aktive të të rinjve, QER, Strasburg, 2007.</i>
Tema	Njohja me njëri tjetrin dhe eksplorimi i realiteteve të pjesëmarrjes së të rinjve
Mostra	Unë dhe realiteti im për pjesëmarrjen e të rinjve
Madhësia e grupit	12-35
Koha	1orë
Objektivat	<ul style="list-style-type: none"> – njohja me njëri tjetrin; – shkëmbimi i eksperiencave për gjendjen reale me pjesëmarrjen e të rinjve në komunitetet dhe organizatat e pjesëmarrësve; – eksplorimi i përvojave të pjesëmarrjes së të rinjve.
Përgatitja	Duhet të përgatitet një dhomë e madhe ose hapësirë me katër kënde të shënuara tematike për shkëmbim të eksperiencave.
Materialet	Letër A3, shënues (marker) ose shkumësa me ngjyrë, muzikë



<p>Udhëzime</p>	<p>Përgatitja individuale – 15 minuta</p> <p>Pjesëmarrësit marrin dy fleta të formatit A3 dhe shënues (markerë) ose shkumësa me ngjyrë.</p> <p>Në secilën prej tyre ata mund të vizatojnë ose të shkruajnë për këto aspekte të jetës/eksperiencës së tyre:</p> <ul style="list-style-type: none"> – personale (familja, studimet, koha e lirë...); – organizata/puna; – komuniteti/të rinjtë - karakteristikat; – përvojat e pjesëmarrjes së të rinjve (që kanë të bëjnë me veprimet). <p>Shkëmbimi – 40minuta</p> <p>Pasi pjesëmarrësit të jenë gati, ata duhet të vishen si “sandviçë me njerëz”, ndërmjet dy letrave të formatit A3 (një letër përpara, një letër prapa).</p> <p>Pastaj ata mblidhen në mes të dhomës së madhe ose hapësirës me katër kënde tematike, të cilat duhet të jenë të njëjta me ato që janë shënuar në letrat e tyre të formatit A3.</p> <p>Pastaj sqarohen këndet dhe pjesëmarrësve u tregohet se do të ketë katër rrotullime dhe se gjatë ushtrimit ata duhet të kalojnë nëpër të gjitha këndet.</p> <p>Lëshohet ndonjë muzikë dhe pjesëmarrësit mund të përzihen dhe t’i shohin “sandviçët” e njëri tjetrit.</p> <p>Kur moderatori e ndal muzikën pjesëmarrësit duhet ta zgjedhin një kënd dhe t’i shkëmbejnë mendimet për temën që është e shënuar në “sandviç” (për shembull, organizata/puna).</p> <p>Pas 10 minutash, moderatori e lëshon muzikën dhe “sandviçët me njerëz” duhet të mblidhen në mes. Kur ndalet muzika ata zgjedhin kënd të ri.</p>
<p>Diskutimi përmbyllës dhe vlerësimi</p>	<p>Nuk ka</p>

<p>Thika dhe pirunët</p>	
<p>Titulli</p>	<p>Thika dhe pirunët Burimi: PLANotes (2001), Issue 42, faq. 66-68, IIED Londër, Josh Levene</p>
<p>Tema</p>	<p>Parimet e pjesëmarrjes</p>
<p>Mostra</p>	<p>Të merret ose të mos merret pjesë?</p>
<p>Madhësia e grupit</p>	<p>6-20</p>



Koha	60 minuta
Objektivat	<ul style="list-style-type: none"> – të njoftohen pjesëmarrësit me disa parime të pjesëmarrjes; – të eksplorohet se si fuqizimi varet nga transparenca dhe shkëmbimi; – të përjetohet situata ku pjesëmarrja është sfidë
Përgatitja	Gjeni një person brenda grupit të pjesëmarrësve të cilit do t’ia tregoni rregullën e fshehtë të lojës.
Materialet	Një thikë dhe një pirun Tabelë me letra (Flipçart), letër, stilolapsa
Udhëzime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Pjesëmarrësit ulen në rreth. 2. Tregoni secilit se rregullat e lojës do të sqarohen vetëm një herë, prandaj duhet të dëgjojnë me kujdes. 3. Sqaroni se dëshironi që secili të koncentrohet në atë se si ndjehet gjatë lojës. 4. Prej pjesëmarrësve kërkohet që thikën ose pirunin t’ia japin personit që është ulur pranë tyre, qoftë në formë të kryqëzuar ose të pa kryqëzuar. Duke e bërë këtë, ata duhet t’i tregojnë gjithë grupit se a janë thika dhe piruni “të kryqëzuara” ose “të pa kryqëzuara”. Pastaj moderatori do t’u tregojë atyre se a kanë qëlluar apo jo. 5. Mos jepni më tepër udhëzime, edhe në qoftë se ka pyetjet të tjera. 6. Moderatori e fillon gjithë aktivitetin. Rregulla e fshehtë është se pohimi “të kryqëzuara” ose “të pa kryqëzuara” nuk varet nga pozita e thikës dhe e pirunit, por nga pozita e këmbëve të folësit – se a janë ato të kryqëzuara ose jo. Thika dhe piruni mund të vendosen sido që të dëshirojë pjesëmarrësi, mirëpo pohimi i tyre do të jetë i qëlluar nëse përputhet me pozitën e këmbëve të tyre. 7. Pas rreth 10 minutash, ndërpriteni lojën, pasi kjo kohë mjafton që pjesëmarrësit të përjetojnë një sërë emocionesh. 8. Pyetni ata që nuk e kanë zbuluar rregullën e fshehtë se si ndjehen. Shkruani përgjigjet e tyre në tabelën me letra (flipçart). 9. Pyetni ata që e kanë zbuluar rregullën e fshehtë se si ndjehen. Shkruani përgjigjet e tyre. 10. Kërkoni prej ndonjërit nga grupi që t’ua sqarojë rregullën e fshehtë anëtarëve të tjerë të grupit. 11. Pyetni pjesëmarrësit që e kanë zbuluar rregullën e fshehtë se pse nuk ua kanë treguar atë të tjerëve (shumë rrallë e bëjnë këtë).



<p>Diskutimi përmblyllës dhe vlerësimi</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Pyetni pjesëmarrësit se çfarë lidhjeje shohin ndërmjet përvojave të tyre gjatë këtij ushtrimi (dhe gjërave që i kanë përjetuar gjatë këtij ushtrimi) dhe pjesëmarrjes. Cilat aspekte të pjesëmarrjes janë trajtuar në këtë ushtrim? 2. Ndani pjesëmarrësit në atë mënyrë që të punoni në grupe të vogla për diskutim (dy ose katër grupe). Secili grup duhet të përqendrohet në grupet e mëposhtme të pyetjeve: <ul style="list-style-type: none"> Grupi A <ol style="list-style-type: none"> a. Kur jam i shfuqizuar ndjehem ... b. Ndaj atyre që më shfuqizojnë ndjej... c. Ja për shembull... d. E kemi të pamundur të marrim pjesë kur... Grupi B <ol style="list-style-type: none"> e. Kur jam i fuqizuar ndjehem ... f. Ndaj atyre që më fuqizojnë ndjej... g. Ja për shembull... h. Mund të marrim pjesë kur... 3. Nëse ka më tepër se dy grupe, kërkoni prej grupeve që punojnë me Grupin A të pyetjeve të bashkohen dhe grupet që punojnë me Grupin B të pyetjeve të bashkohen. Ata duhet t'i shkëmbejnë idetë e tyre dhe t'i shënojnë ato në tabelën me letra (flipçart). 4. Kërkoni prej grupeve që t'i prezantojnë rezultatet e punës së tyre. 5. Inicioni një diskutim plenar për përparësitë e pjesëmarrjes dhe mangësitë e mospjesëmarrjes.
<p>Këshilla për moderatorin</p>	<ul style="list-style-type: none"> – personi i vetëm të cilit do t'ia tregoni rregullën e fshehtë para se të fillojë loja duhet të ulët përballë jush në rreth, ashtu që të dy të mund të kontrollojnë se a janë këmbët e pjesëmarrësve të kryqëzuara ose jo. – kini kujdes gjatë realizimit të këtij ushtrimi për shkak se njerëzit mund të bëhen shumë të druajtur dhe emocionalë.
<p>Variacionet</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Diskutimi përmblyllës mund të përqendrohet më tepër në rolin e shkëmbimit të informacioneve, fakteve dhe rregullave që u mundësojnë njerëzve të marrin pjesë. – ky ushtrim mund të shfrytëzohet për ta prezantuar qasjen e Kartës ndaj pjesëmarrjes që bazohet në të drejtën, mjetet, hapësirën, mundësinë dhe mbështetjen (DMHMM).




Shkalla e pjesëmarrjes	
Titulli	Shkalla e pjesëmarrjes Burimi: Trajnimi për zhvillimin dhe zbatimin e projekteve pjesëmarrëse në nivel vendor dhe rajonal, QER, Strasburg, 2005
Tema	Zbatimi i projekteve pjesëmarrëse
Mostra	Sa “pjesëmarrës” ka projekti juaj?
Madhësi e grupit	Çfarëdo qoftë
Koha	90 minuta
Objektivat	<ul style="list-style-type: none"> – të mendohet për shkallët e mundshme të pjesëmarrjes së të rinjve në kuadër të një projekti; – të prezantohet koncepti i shkallëve të pjesëmarrjes; – të ofrohet kornizë për ta vlerësuar shkallën e pjesëmarrjes së të rinjve në projekte; – të mblidhen ide për kriteret e projekteve pjesëmarrëse.
Përgatitja	Në letër duhet të vizatohet një fotografi e madhe e shkallës së pjesëmarrjes së Roxher Hartit (Roger Hart) (ose të bëhet prej ngjitëses në dysHEME).
Materialet	Nuk ka
Udhëzime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Prezantoni konceptin e shkallëve/niveleve të pjesëmarrjes së të rinjve dhe modelin e shkallës së pjesëmarrjes. 2. Kërkoni nga pjesëmarrësit të mendojnë se cili nivel i shkallës së pjesëmarrjes e përfaqëson më mirë nivelin e pjesëmarrjes së të rinjve në projektin ose komunitetin e tyre. 3. Kërkoni nga pjesëmarrësit që të qëndrojnë te shkallarja përkatëse e shkallës. 4. Intervistoni pjesëmarrësit: në cilën shkallare të shkallës së pjesëmarrjes gjendet projekti juaj? Prej nga e dini këtë? 5. Thirrni pjesëmarrësit të bëjnë një sesion të “shpalosjes së ideve” (brainstorm) për mënyrat e ndryshme në të cilat të rinjtë mund të marrin pjesë plotësisht në projektin tuaj. 6. Mendim individual: cilat mendime që u shprehën gjatë sesionit të “shpalosjes së ideve” mund t’i shfrytëzohj në projektin tim? Pse dhe si?
Diskutimi përmbyllës dhe vlerësimi	<p>Pyetni pjesëmarrësit këto pyetje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Sa i dobishëm është modeli i shkallës së pjesëmarrjes në punën tuaj dhe në situatën tuaj? 2. Cilat janë kufizimet e këtij modeli?



Këshilla për moderatorin	Sqaroni se qëllimi i këtij aktiviteti nuk është të arrihet shkallarja më e lartë e shkallës dhe se shkallaret më të larta nuk është e thënë se janë më të mirat! Mund të shfrytëzoni edhe shkallare pa numra ose ndonjë formë të ndryshme nga shkalla (për shembull, lulja, që është e bashkangjitur).
Variacionet	Ky aktivitet mund të ndërlihet jo vetëm me projektet e të rinjve, por edhe me përfshirjen e të rinjve në kuadër të institucioneve ose të organizatave të ndryshme.
Dokumentet e bashkangjitura	Përshkrim i konceptit të shkallës së pjesëmarrjes (burimi: Kapitulli 1 i doracakut)



SHKALLA E PJESËMARRJES – Sqarim



Përshtatur nga: Hart,R.,*Pjesëmarrja e fëmijëve nga tokenizmi në qytetari (Children's participation from tokenism to citizenship)*,Qendra për hulumtim Innocenti e UNICEF-it, Firencë, 1992

Shkallarja 8: Vendimmarrja e përbashkët

Projektet ose idetë iniciohen nga të rinjtë, të cilët i ftojnë të rriturit të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes si partnerë.

Shkallarja 7: Të rinjtë udhëheqin dhe iniciojnë

Projektet ose idetë iniciohen dhe udhëhiqen nga të rinjtë; të rriturit mund të ftohen që të ofrojnë ndihmë nëse ka nevojë, mirëpo projekti mund të vazhdojë pa intervenimin e tyre.

Shkallarja 6: Të iniciuara nga të rriturit me vendimmarrje të përbashkët

Të rriturit i iniciojnë projektet, mirëpo të rinjtë ftohen që ta ndajnë fuqinë e vendimmarrjes dhe përgjegjësitë si partnerë të përbashkët.

Shkallarja 5: Të rinjtë konsultohen dhe informohen

Projektet iniciohen dhe realizohen nga të rriturit, mirëpo të rinjtë ofrojnë këshilla dhe sugjerime dhe informohen për atë se si këto sugjerime ndikojnë në vendimet ose rezultatet përfundimtare.

Shkallarja 4: Të rinjve u caktohen detyra dhe informohen

Projektet iniciohen dhe realizohen nga të rriturit; të rinjtë ftohen të marrin përsipër role ose detyra të caktuara në kuadër të projektit, mirëpo ata janë të vetëdijshëm për ndikimin që e kanë në realitet.

Shkallarja 3: Të rinjtë e përfaqësuar sipërfaqësisht (të tokenizuar)

Të rinjve u jepen disa role në kuadër të projekteve, mirëpo ata nuk kanë ndikim real në asnjë vendim. Krijohet iluzioni (qoftë me qëllim ose pa qëllim) se të rinjtë marrin pjesë, e në fakt ata nuk mund të ndikojnë mbi të atë se çka bëjnë dhe si e bëjnë atë.



Shkallarja 2: Të rinjtë si zburim


Të rinjtë nevojiten në projekt për ta përfaqësuar rininë si grup i paprivilegjuar. Ata nuk kanë ndonjë rol domethënës (përveç se janë të pranishëm) dhe – siç ndodh me çdo zburim – ata vendosen në një vend të dukshëm në kuadër të projektit ose të organizatës, që të mund të shihen lehtë nga jashtë.

Shkallarja 1: Të rinjtë e manipuluar

Të rinjtë ftohen të marrin pjesë në projekt mirëpo, ata nuk kanë ndikim real në vendimet që merren dhe rezultatet e tyre. Në fakt, prezenca e tyre shfrytëzohet për të arritur ndonjë qëllim tjetër, si për shembull të fitohen zgjedhjet vendore, të krijohet përshtypje më e mirë për ndonjë institucion ose të sigurohen mjete shtesë nga institucionet që e mbështesin pjesëmarrjen e të rinjve.

→ **LULJA E PJESËMARRJES – Sqarim**

Burimi: CHOICEf or Youth and Sexuality Foundation, the Netherlands, e inspiruar nga shkalla e pjesëmarrjes e Roxher Hartit (Roger Har)



Takimi me kryetarin e komunës	
Titulli	Takimi me kryetarin e komunës Burimi: <i>Trajnimi për pjesëmarrjen aktive të të rinjve</i> , QER, Strasburg, 2007.
Tema	Bashkëpunimi ndërmjet OJQ-ve dhe autoriteteve vendore (AL)
Mostra	Të bashkohemi
Madhësia e grupit	12-35
Koha	120 minuta
Objektivat	<ul style="list-style-type: none"> – të përballen pjesëmarrësit me praktikatat e tyre në pjesëmarrjen e të rinjve; – të mendohet për strategjitë për komunikim dhe bashkëpunim ndërmjet të OJQ-ve rinore dhe autoriteteve vendore; – të identifikohen aspektet që duhet të përmirësohen.
Përgatitja	Të fotokopjohet dhe mundësisht të përshtatet ndonjë rasti studimi; të informohet ekipi nga autoritetet vendore; të caktohet vendit i takimit
Materialet	Veshje për përfaqësuesit e autoriteteve vendore (për shembull, kravata, xhaketa etj.)
Udhëzime	<p>1. Rast studimi në grupe të punës – 45 minuta</p> <p>Pjesëmarrësit ndahen në grupe të vogla. Çdo grup përfaqëson një qendër rinore të komunitetit (OJQ). Të gjitha grupet e pranojnë rastin e njëjtë të studimit dhe duhet të përgatiten për takim me autoritetet vendore.</p> <p>Rasti i studimit është shkruar në formë të ftesës për takim të ekipit, për t'u përgatitur një takim konsultues me kryetarin e komunës dhe përfaqësuesit e autoriteteve vendore.</p> <p>Moderatori bisedon me grupet që të sigurohet se e kanë kuptuar detyrën dhe t'i qartësojë pyetjet që mund t'i kenë pjesëmarrësit.</p> <p>Në qoftë se ka disa grupe, moderatori mund të shërbejë si koordinator i OJQ-së rinore nga shoqata e organizatave rinore, që e organizon takimin me kryetarin e komunës.</p> <p>Rasti i studimit:</p> <p>“Ftesë</p> <p>Nga koordinatori (moderatori) i shoqatës së organizatave rinore “Just do it”</p> <p>Të nderuar anëtarë të ekipit,</p> <p>Të gjithë ne punojmë së bashku në qendrën rinore të komunitetit në një lagje të qytetit të Strasburgut.</p> <p>Tashmë disa muaj, ka gjithnjë e më shumë indikatorë, që thonë se të rinjtë janë të pakënaqur me gjendjen e tyre (kushtet e jetës, gjendja me punësimin, etj.). Para do kohësh, nëpërmjet ngjarjeve të vogla dhe të izoluara, disa të rinj kanë filluar ta shprehin pakënaqësinë e tyre në mënyrë të dhunshme (dëmtimin e qendrës sportive, supermarketeve, etj.).</p> <p>Para dy javësh një grup të rinjsh dhe disa policë kanë filluar një zënkë, e cila ka përfunduar me rrahje. Si rezultat, një i ri është lënduar rëndë dhe gjendet në spital, ndërsa dy të tjerë janë arrestuar.</p>



	<p>Prej atëherë situata është duke u përkeqësuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> – disa të rinj kanë filluar t’i djegin automobilat e lagjes, dhe numri automobilave të djegur është në rritje të vazhdueshme; – pakënaqësitë e tilla kanë filluar të ndodhin edhe në lagjet e tjera të qytetit; – për çdo natë ka konfrontime me policinë; – disa të rinj të tjerë dëshiruan të tregojnë se ka edhe mënyra të tjera të shprehjes dhe filluan të organizojnë demonstrata paqësore, t’i djegin letërnjoftimet si mënyrë për të treguar se edhe pse ligjërisht ata janë qytetarë të barabartë, në realitet nuk është ashtu, dhe besojnë se nuk i kanë të drejtat dhe mundësitë e njëjta. <p>Ka ardhur koha që ne si anëtarë të qendrës rinore të komunitetit të reagojmë!</p> <p>Prandaj, do të organizojmë një mbledhje të organizatës sonë, ku do të punojmë në dy drejtime:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Plani afatshkurtër i veprimit: çka duhet të bëhet konkretisht dhe si të shmangen incidentet e mëtutjeshme. 2. Plani afatmesëm i veprimit: pas një viti do të mbahen zgjedhjet vendore, dhe duhet ta shfrytëzojmë këtë mundësi që të fillojmë të ndikojmë që tani tek autoritetet vendore, dhe të bëjmë një propozim strategjik, duke përfshirë udhëzime për punë, qasje edukative, hapa dhe veprime konkrete. <p>Ngjarjet e lartpërmendura kanë filluar të ndodhin edhe në lagjet e tjera të qytetit. Edhe degët e tjera të organizatës sonë në këto lagje e organizojnë këtë mbledhje.</p> <p>Pas mbledhjes sonë, do të organizohet një mbledhje tjetër me përfaqësuesit e komunës së Strasburgut dhe përfaqësuesit e tjetër nga strukturat rinore të lagjeve të tjera që t’i prezantojmë propozimet/strategjitë tona.</p> <p>Detyra jonë do të jetë të caktojmë dy përfaqësues tanë qo do ta prezantojnë qartë strategjinë tonë.</p> <p>Ju falënderojmë për bashkëpunimin tuaj dhe shihemi në takim.</p> <p>Koordinatori i “Just do it”.</p> <p>(Vërejtje: rasti i studimit/ftesa duhet të përshtatet me objektivat e sesionit dhe të aktivitetit.)</p> <p>Rolet dhe udhëzimet për informimin e përfaqësuesve të autoriteteve vendore</p> <p><i>Rolet</i></p> <ul style="list-style-type: none"> – kryetari i komunës; – këshilltari politik përgjegjës për çështjet e brendshme dhe të sigurisë; – zëvendëskryetari i komunës përgjegjës për çështjet rinore. <p>Rolet mund t’i luajnë edhe ata anëtarë të ekipit që nuk janë të përfshirë në prezantimin, lehtësimin dhe diskutimin përmbyllës të ushtrimit.</p>
--	---



	<p>Udhëzime për informimin</p> <ul style="list-style-type: none"> – tre përfaqësuesit e autoriteteve vendore duhet të kenë qasje të ndryshme gjatë intervenimeve të tyre. Për shembull: kryetari i komunës – kërkon zgjidhje të shpejtë dhe të mirë për gjithë qytetin (duke i marrë parasysh argumentet e kolegëve të tij/saj); këshilltari politik - i cili duhet ta mundësojë sigurinë e qytetarëve, është në favor të ligjit dhe rendit, nuk beson se të rinjtë janë të përgjegjshëm; zëvendëskryetari i komunës – është përgjegjës për të rinjtë dhe i mban kontaktet me OJQ-të, prandaj është në favor të zgjidhjes që i përfshin dhe i mbështet të rinjtë dhe OJQ-të e të rinjve edhe atë në aspekt afatgjatë. – gjatë luajtjes së roleve të tyre, aktorët janë të lirë të improvizojnë në bazë të asaj se si e paramendojnë mbledhjen në jetën reale, dhe mund të kenë nevojë që paraprakisht të ulen së bashku që t’i qartësojnë intervenimet e tyre. – kryetari i komunës e kryeson mbledhjen, për shkak se ai është nikoqiri. <p>2. Takimi ndërmjet organizatave rinore dhe autoriteteve lokale–30 minuta</p> <p>Secila nga OJQ-të rinore (grupet e punës) dërgon dy anëtarë të organizatës në takimin me kryetarin e komunës. Për fat të keq, “koordinatori” i “Just do it” nuk mund të vijë në takim.</p> <p>Kryetari i komunës e hap mbledhjen dhe njofton se kohëzgjatja maksimale e takimit është 30 minuta.</p> <p>Tema e takimit është të diskutohen propozimet e OJQ-ve rinore dhe të merren vendime për veprimet e mundshme që mund ta përmirësojnë situatën aktuale.</p> <p>Pjesa tjetër e pjesëmarrësve janë vëzhgues aktivë të takimit. Ata kanë mundësi që nëpërmjet moderatorit (koordinatorit) t’u japin shënime kolegëve që e përfaqësojnë OJQ-në e tyre në takim.</p> <p>3. Zgjidhja e situatës</p>
<p>Diskutimi përmbyllës dhe vlerësimi</p>	<p>1. Ndjenjat:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Në përgjithësi? Në grupet e punës për rastin e studimit? Në luajtjen e roleve? <p>2. Procesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> – A ishte e lehtë të përgatiten strategjitë në grupet e punës? Pse? <p>3. Rezultatet:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Çka mendoni për rezultatet?A janë propozimet relevante? Çka mungon? A identifikuat ndonjë aspekt që mund të përmirësohet në situatën tuaj praktike? <p>4. Bartja në realitet:</p> <ul style="list-style-type: none"> – A ka ndonjë lidhje ndërmjet ushtrimit dhe realitetit? – Çka keni mësuar nga ky ushtrim? Çka mund të përdorni në praktikën tuaj? – A keni ndonjë koment ose këshillë sa i përket bashkëpunimit me autoritetet vendore?



Rrjeti i pjesëmarrjes	
Titulli	Rrjeti i pjesëmarrjes Burimi: Clare Lardner, kompania Clarity, www.clarity-scotland.pwp.blueyonder.co.uk
Tema	Fuqia kundrejt pjesëmarrjes në një projekt
Mostra	Kush e ka fuqinë?
Madhësia e grupit	Çfarëdo qoftë
Koha	60 minuta
Objektivat	<ul style="list-style-type: none"> – të kuptohet ndërlikimi i dimensioneve të pjesëmarrjes; – të vlerësohet shkalla e fuqizimit që ofrohet nga format e ndryshme të pjesëmarrjes ose projektet e veçanta; – të ofrohet mjet konkret për krahasimin e formave të ndryshme të pjesëmarrjes.
Përgatitja	Duhet të bëhet një prezantim i shkurtër i modelit të pjesëmarrjes “Clarity”, në bazë të materialeve të dorëzuara për rrjetin.
Materialiet	Kopje të materialit për modelin e pjesëmarrjes “Clarity”.
Udhëzime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kërkoni nga pjesëmarrësit të mendojnë ndonjë projekt konkret për të rinj të në cilin janë të përfshirë. Duke e shfrytëzuar modelin e pjesëmarrjes “Clarity”, duhet ta vlerësojnë shkallën e fuqisë që e kanë të rriturit dhe të rinjtë në kuadër të këtij projekti. 2. Kërkoni nga pjesëmarrësit që t’i shkëmbejnë rezultatet e punës së tyre në grupe me nga katër veta. 3. Ofroni mundësi për të dhënë komente, vërejtje ose për të parashtruar pyetje. 4. Inicioni diskutim për temën: “Si ndikojnë raportet e fuqisë në kuadër të projektit mbi pjesëmarrjen e të rinjve?”
Diskutimi përmbyllës dhe vlerësimi	<p>Pyetni pjesëmarrësit këto pyetje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. A jeni të befashuar me rezultatet e vlerësimit tuaj? Pse? 2. A mësuat diçka të re për projektin tuaj? Çka? 3. Sa është i dobishëm ky model në punën tuaj me të rinjtë? 4. Çka mendoni se duhet për t’u arritur një ndarje “ideale” e fuqisë ndërmjet aktorëve?
Dokumentet e bashkangjitura	Materiali për modelin e pjesëmarrjes “Clarity”.



MODELI I PJESËMARRJES “CLARITY”

Burimi: Clare Lardner, kompania Clarity, www.clarity-scotland.pwp.blueyonder.co.uk

Të rriturit e iniciojnë idenë e projektit	← →	Të rinjtë e iniciojnë idenë e projektit
Të rriturit vendosin për agjendën (për çështjet që do të diskutohen)	← →	Të rinjtë vendosin për agjendën (për çështjet që do të diskutohen)
Të rriturit i marrin vendimet	← →	Të rinjtë i marrin vendimet
Të rriturit e kanë shumicën e informatave që nevojiten për të marrë vendim	← →	Të rinjtë e kanë shumicën e informatave që nevojiten për të marrë vendim
Të rriturit marrin veprime për t'i zbatuar vendimet	← →	Të rinjtë marrin veprime për t'i zbatuar vendimet
Struktura e pjesëmarrjes e pasqyron mënyrën se si të rriturit i bëjnë gjërat (kryesisht formale)	← →	Struktura e pjesëmarrjes e pasqyron mënyrën se si të rriturit i bëjnë gjërat (kryesisht joformale)
Të rriturit kanë fuqi	← →	Të rinjtë kanë fuqi

Orteku i pjesëmarrjes	
Titulli	Orteku i pjesëmarrja
Tema	Përkufizimi i pjesëmarrjes Pjesëmarrja në procesin e vendimmarrjes
Mostra	A nënkupton pjesëmarrja për ju të njëjtën gjë sikurse edhe për mua?
Madhësia e grupit	8, 16 ose 24 pjesëmarrës
Koha	60 minuta
Objektivat	<ul style="list-style-type: none"> – të formulohen interpretimet e ndryshme për pjesëmarrjen e të rinjve; – të mendohet për interpretimet, konceptet dhe dimensionet e ndryshme të pjesëmarrjes së të rinjve; – të mendohet për përfshirjen e pjesëmarrësve në procesin e vendimmarrjes.
Përgatitje	Nuk ka
Materiale	Tabelë me letra (Flipçarte), shënues (markerë)



<p>Udhëzime</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kërkoni nga pjesëmarrësit që në një letër ta shkruajnë përkufizimin e tyre për pjesëmarrjen e të rinjve (punë individuale). 2. Individët gjejnë një partner dhe punojnë në çifte. Secili prej tyre duhet ta japë përkufizimin e tij, e pastaj duhet të pajtohen për një përkufizim të përbashkët për të dy. 3. Pastaj çiftet formojnë grupe prej katër vetave. Çdo çift e paraqet përkufizimin e tij, e pastaj të dyja çiftet duhet të pajtohen për një përkufizim që do të jetë i pranueshëm për të katër anëtarët e grupit. 4. Grupet me katër veta tani formojnë grup prej tetë vetash. Prezantohen të gjitha përkufizimet e pastaj arrihet pajtim për një përkufizim përfundimtar që është i pranueshëm për të gjithë anëtarët e grupit. 5. Në diskutim plenar, secili grup e prezanton përkufizimin e tij, duke ndarë kohë edhe për komente dhe sqarime. 6. Prezantoni disa “përkufizime zyrtare” të pjesëmarrjes së të rinjve për të bërë krahasim.
<p>Diskutimi përmbyllës dhe vlerësimi</p>	<p>Diskutim për rezultatet (përkufizimet):</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Sa janë të ngjashme përkufizimet e grupeve të ndryshme? 2. Cilat janë dallimet kryesore? 3. Me cilat aspekte të pjesëmarrjes së të rinjve ndërlidhen këto përkufizime? 4. Sa e vështirë ishte të formulohen përkufizime të përbashkëta? Pse? 5. Sa ishit të gatshëm të bëni lëshime ose të hiqni dorë prej pjesëve të përkufizimit tuaj që të arrini marrëveshje të përbashkët? <p>Diskutim për procesin e vendimmarrjes:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Cili ishte roli juaj në formulimin e përkufizimeve në faza të ndryshme (në çifte, në grupe me nga katër veta, etj.)? Si ndjeheshit në atë rast? 2. A kishit hapësirë të mjaftueshme për të marrë pjesë aq sa dëshironit ose aq sa kishit nevojë? Nëse jo, pse jo? 3. Çka u ndihmoi të merrni pjesë? 4. Çka e pengoi pjesëmarrjen tuaj? 5. Si ndërlidhet definicioni i pjesëmarrjes që u prezantua në diskutimin plenar me përvojën tuaj të pjesëmarrjes në këtë ushtrim?
<p>Variacionet</p>	<p>Do të ishte interesante të ketë edhe disa vëzhgues që do ta ndiqnin procesin dhe pastaj do të jepnin informatë kthyesë për atë se si ecnin punët në grupe dhe çfarë strategji kanë përdorur ato. Jo gjithmonë njerëzit janë të vetëdijshëm për rolet e tyre ose sjelljen e tyre.</p>



Boshti kohor i pjesëmarrjes	
Titulli	Boshti kohor i pjesëmarrjes Burimi: i panjohur
Tema	Prezantimi i përvojave personale në pjesëmarrjen e të rinjve
Mostra	Cili është tregimi juaj?
Madhësia e grupit	4-25
Koha	30-60 minuta
Objektivat	<ul style="list-style-type: none"> – të shkëmbehen përvojat e pjesëmarrësve nga fusha e pjesëmarrjes; – të mendohet për mënyrat e ndryshme në të cilat individët mund të marrin pjesë në jetën e ndonjë organizate ose komuniteti vendor; – të krijohet një bazë për planifikimin e përfshirjes së mëtutjeshme në fushën e pjesëmarrjes së të rinjve.
Përgatitja	Nuk ka
Materialet	Një letër shumë e madhe, në mënyrë që çdo pjesëmarrës të ketë hapësirë të mjaftueshme që ta vizatojë boshtin e tij kohor. Shumë lapsa me ngjyrë, shënues (markerë), letra me ngjyrë, gërshtë, ngjites, fotografi të gazetave të vjetra, etj.
Udhëzime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Duke i përdorur materialet që janë në dispozicion, pjesëmarrësit duhet ta vizatojnë boshtin kohor ku do t'i shënojnë piketat që do t'i paraqesin përvojat e tyre më të rëndësishme në fushën e pjesëmarrjes së të rinjve, si për shembull: <ul style="list-style-type: none"> – si dhe kur kanë marrë pjesë në organizata, grupe ose komunitete; – si dhe kur kanë qenë të përfshirë në përforsimin ose promovimin e pjesëmarrjes së të rinjve. 2. Pjesëmarrësit i paraqesin boshtet e tyre kohore dhe flasin për përvojat e tyre në fushën e pjesëmarrjes së të rinjve.
Diskutimi përmbyllës dhe vlerësimi	<p>Pyetni pjesëmarrësit këto pyetje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Cili lloj i përvojës në pjesëmarrje është shënuar më shpesh? 2. Cilët janë faktorët që i inkurajojnë të rinjtë, duke e përfshirë edhe veten tuaj, që të marrin pjesë? 3. Pasi e patë boshtin kohor të secilit, a ka elemente tuaja të cilat nuk i keni shënuar, por që tani e kuptuat se keni mundur t'i shënoni? 4. A mendoni se të gjitha elementet e shënuara mund të marrin pjesë? Si?
Këshilla për moderatorin	<ul style="list-style-type: none"> – kërkoni nga pjesëmarrësit që t'i vizatojnë boshtet e tyre kohore ashtu që të gjitha të takohen në një pikë qendrore në letër (si rrezet e diellit, me diellin në mes). Atëherë kjo pikë qendrore e paraqet trajnimin tuaj; – nëse grupi ka më shumë se 16 njerëz, vizatimet dhe prezantimet mund të bëhen në grupe më të vogla.
Variacionet	Boshti kohor i pjesëmarrjes mund të fokusohet në çështje më specifike që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen, siç janë format e veçanta të pjesëmarrjes, nivelet e veçanta (evropiane, kombëtare, vendore) etj.



Të drejtat dhe pjesëmarrja	
Titulli	Të drejtat dhe pjesëmarrja
Tema	Të drejtat që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e të rinjve
Mostra	Cilat janë të drejtat e mia?
Madhësia e grupit	më së paku 8
Koha	90 minuta
Objektivat	<ul style="list-style-type: none"> – të shqyrtohen të drejtat e ndryshme që duhet t’i kenë të rinjtë që të mund ta praktikojnë pjesëmarrjen; – të shqyrtohet raporti ndërmjet të drejtave të të rinjve dhe pjesëmarrjes; – të mendohet për atë se si respektohen të drejtat e të rinjve në kontekste të ndryshme vendore.
Përgatitja	Nuk ka
Materialet	Tabelë me letra (flipçart) dhe shënues (markerë)
Udhëzime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ndani pjesëmarrësit në grupe me nga katër deri në gjashtë veta. 2. Kërkoni prej çdo grupi që të shënojnë sa më shumë shembuj të të drejtave që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen që mund t’u kujtohen brenda pesë minutave (shembuj janë të drejtat që u nevojiten të rinjve për të marrë pjesë në jetën e komunitetit të tyre vendor ose rajonit të tyre). 3. Mblidhni përgjigjet në diskutim plenar. 4. Kërkoni prej çdo grupi që të zgjedhë 10 të drejta nga lista plenare, të cilat, sipas mendimit të tyre, janë thelbësore për pjesëmarrjen të rëndësishme të të rinjve në kontekstin vendor. 5. Grupet le t’i prezantojnë listat e tyre. 6. Thirrni të gjithë në diskutimin plenar që do të mbahet në fund të sesionit plenar.
Diskutimi përmbyllës dhe vlerësimi	<p>Pyetje që kanë të bëjnë me rezultatet e punës në grup:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Cilat janë ngjashmëritë ndërmjet listave (cilat të drejta janë përmendur nga të gjithë ose nga shumica e grupeve)? 2. Cilat të drejta nuk paraqiten në çdo listë? Pse? 3. Çfarë kriteri përdorët për të vendosur se a është një e drejtë “esenciale” për pjesëmarrjen ose jo? 4. Si u pajtuan grupet tuaj për këto kritere? <p>Pyetje që kanë të bëjnë me të drejtat në përgjithësi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 5. Si ndërlidhen të drejtat e shënuara nga pjesëmarrësit me pjesëmarrjen e të rinjve? 6. A mund të konsiderohen këto të drejta si të drejta të njeriut? Pse? <p>Pyetje që kanë të bëjnë me gjendjen vendore të pjesëmarrësve:</p> <ol style="list-style-type: none"> 7. Cilat të drejta nuk respektohen në kontekstin tuaj vendor? Pse? 8. Si i kërkojnë të rinjtë këto të drejta?



Maskarada “DMHMM”	
Titulli	Maskarada “DMHMM” Burimi: Trajnimi për zhvillimin dhe zbatimin e projekteve pjesëmarrëse në nivel vendor dhe rajonal, QER Strasburg, 2005
Tema	Të fitohet përshtypja e parë për Kartën
Mostra	Ç’është DMHMM?
Madhësia e grupit	15-30
Koha	40 minuta
Objektivat	<ul style="list-style-type: none"> – të mendohet për konceptet, diapazonin dhe mënyrat e ndryshme të interpretimit të “pjesëmarrjes së të rinjve”; – të analizohet rëndësia e koncepteve të ndryshme të pjesëmarrjes për punën e pjesëmarrësve dhe jetën e përditshme; – të iniciohet debat për qëndrimet e të rinjve ndaj pjesëmarrjes.
Përgatitja	Duhet të bëhet një prezantim i thjeshtë i Kartës, gjegjësisht ç’është ajo, cili ka qenë qëllimi i saj dhe si ndikon ajo mbi njerëzit.
Materialet	Karta dhe version i Kartës i përshtatur për të rinjtë. Tabelë me letra (Flipçart).
Udhëzime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Prezantoni pesë elementet e DMHMM-së: <ul style="list-style-type: none"> a. e drejta; b. mjetet; c. hapësira; d. mundësitë; e. mbështetja. 2. Kërkoni nga pjesëmarrësit që të ndahen në grupe me nga tri deri në gjashtë veta. Secilit grup i jepet njëri nga konceptet e DMHMM-së për ta diskutuar dhe pastaj duhet të përgjigjen në këto pyetje: <ul style="list-style-type: none"> a. Çka mendoni se nënkupton ky koncept? b. Cilat janë pasojat e këtij koncepti për pjesëmarrjen? 3. Kërkoni prej grupeve që të përgatisin një shfaqje kreative (këngë, poezi, skeç, dramë, pantomimë, balet, etj.) ku do t’i prezantojnë konkluzionet kryesore të diskutimeve të tyre. 4. Thirrni grupet që ta realizojnë shfaqjen e tyre kreative. 5. Kërkoni nga pjesëmarrësit e tjerë që të zbulojnë se cilat elemente të DMHMM-së janë prezantuar dhe si e interpretojnë ata poezinë, këngën etj.



Diskutimi përmbyllës dhe vlerësimi	<p>Në diskutim plenar, nga pjesëmarrësit mund të kërkohej që ta diskutojnë çdo koncept dhe të përpiqen të propozojnë një interpretim të përbashkët për atë se si ndërlidhet ai me Kartën dhe pjesëmarrjen e të rinjve.</p> <p>Pjesëmarrësve mund t’ua parashtroni edhe këto pyetje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Çka mësuar për pjesëmarrjen e të rinjve nga ky ushtrim? 2. Sa i rëndësishëm është koncepti i DMHMM-së për situatën tuaj?
Variacionet	<p>Për ta bërë ushtrimin me interesant, pjesëmarrësit duhet ta gjejnë se cilin koncept e ka prezantuar grupi tjetër. Kjo, po ashtu do ta bënte më të qartë se në çfarë shkalle pjesëmarrësit i interpretojnë konceptet në mënyrë të ngjashme.</p>

Luajtja e roleve sipas Kartës	
Titulli	Luajtja e roleve sipas Kartës Burimi: Trajnimi për zhvillimin dhe zbatimin e projekteve pjesëmarrëse në nivel vendor dhe rajonal, QER Strasburg, 2005
Tema	Karta në realitet
Mostra	Zbatimi i Kartës në jetën e përditshme
Madhësia e grupit	10+
Koha	40 minuta
Objektivat	<ul style="list-style-type: none"> – të tregohet se si mund të ndryshohen situatat duke e përdorur Kartën; – të përjetohen aspektet e ndryshme nga jeta e të rinjve ku mund të shfrytëzohet Karta.
Përgatitja	Nuk ka
Materialet	<p>Materiale ku janë përshkruar rolet e ndryshme</p> <p>Varësisht nga imagjinata e pjesëmarrësve, mund të nevojiten edhe materiale të tjera</p>
Udhëzime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Formoni grupe me nga katër deri në pesë veta. Sqaroni atyre se do të duhet ta luajnë ndonjë situatë të caktuar. 2. Ndani rolet për grupet e ndryshme. 3. Kërkoni prej tyre që të shohin se cila pjesë e Kartës përkon me situatën e dhënë. 4. Jepuni grupeve kohë prej disa minutash që të përgatiten për lojën e tyre. 5. Kërkoni prej tyre që ta luajnë situatën para të tjerëve, duke e përdorur Kartën e rishikuar për të gjetur zgjidhje. 6. Kërkoni prej pjesëmarrësve që t’i paraqesin pikëpamjet e tyre për situatat dhe zgjidhjet e prezantuara.



Diskutimi përmbyllës dhe vlerësimi	Pyetni pjesëmarrësit këto pyetje: <ol style="list-style-type: none"> 1. Cili ishte qëllimi i këtij ushtrimi? 2. Si mund të shfrytëzohet Karta si mjet këtu? 3. Si mund t'i ndërlihdni skeçet e luajtura me situatën tuaj personale? 4. A ishte i dobishëm ushtrimi? Pse?
Variacionet	Që rolet të bëhen më të gjalla, mund të përdoren edhe karikatura për t'i demonstruar situatat (shihni shembujt e bashkangjitur).

Luajtja e roleve sipas Kartës – Materialet

Strehimi

Gjendja me strehimin në Utopi nuk është e mirë. Ka shumë pak hapësirë të lirë për strehim që është në dispozicion për të rinjtë. Komuna nuk ofron informata për strehim dhe nguron të ofrojë shërbime të strehimit për shkak të kufizimeve buxhetore. Ekipi luan rolin e një grupi të rinjsh që demonstrojnë kundër gjendjes së rëndë me strehimin në Utopi, pasi e kanë lexuar nenin për strehimin në versionin e Kartës me gjuhë të thjeshtë. Vjen një përfaqësues i autoriteteve vendore dhe pyet se ç'është puna. Përfaqësuesi i të rinjve e tregon paragrafin përkatës të Kartës.

Edukimi

Të rinjtë e Utopisë kanë qasje në edukim dhe prej tyre kërkohet që të japin mendim për ekskursionet shkollore, mirëpo nuk kërkohet asnjë koment në lidhje me udhëheqjen e shkollës (ky është një shembull i sipërfaqësisë/tokenizmit). Mësuesit dhe drejtuesit e shkollës nuk duan që ta japin pushtetin dhe thonë se të rinjtë nuk veprojnë me përgjegjësi të mjaftueshme që të merren seriozisht për çështjet e udhëheqjes së shkollës. Udhëheqësia e shkollës madje e vë në pyetje edhe të drejtën demokratike të të rinjve për t'u përfshirë në këto çështje. Bëhet një diskutim i ashpër ndërmjet një nxënësi dhe një mësuesi. Nxënësi kërkon më shumë të drejta për këshillin e nxënësve. Mësuesi nuk dëshiron t'i japë të drejtat, duke insistuar se të rinjtë nuk janë të përgatitur për të marrë përgjegjësi. Ndërhyn përfaqësuesi i autoriteteve vendore me paragrafin përkatës të Kartës që e mbështet pikëpamjen e nxënësit.

Mediet

Të rinjtë e Utopisë kanë qasje të kufizuara në medie, veçanërisht në mediet e shtypura, por nuk kanë fare qasje në televizion dhe në radio. Edhe pse stacioni vendor i televizionit udhëhiqet dhe është në pronësi të komunës, ata thonë se të rinjtë nuk kanë profesionalizëm të mjaftueshëm dhe nuk mund t'u besohet që të punojnë me pajisjet e shtrenjta. Ekipi është i ulur në mes të dhomës duke shikuar televizion, duke thënë gjëra si "pse nuk mund të ndikojmë në këto gjepura?". Një anëtar i një organizate rinore thotë se organizata e tij do ta ngrejë këtë çështje para autoriteteve vendore. Autoriteti vendor përgjigjet se mediet duhet të jenë në shërbim të të gjitha gjeneratave, dhe se të rinjtë nuk janë të besueshëm sa duhet që t'u jepet qasje në pajisjet e tilla. Organizatat rinore e potencojnë paragrafin përkatës të Kartës, që e tregon rëndësinë e autoriteteve lokale për të ofruar mbështetje dhe trajnim, etj.





Parlamenti rinor

Utopia tashmë dy vjet ka parlament rinor dhe ai ka të drejtë t'i miratojë propozimet, të cilat këshilli komunal duhet t'i pranojë dhe t'u përgjigjet. Këshilli komunal e sheh parlamentin rinor si mjet për të marrë informacion të dorës së parë për nevojat dhe dëshirat e të rinjve që jetojnë në atë zonë. Ekipi e formon parlamentin rinor që është i ulur në rrethin e brendshëm të mbledhjes plenare të këshillit komunal ku diskutohen politikat antidiskriminuese që gjenden në Kartë. Një përfaqësues ia prezanton këtë diskutim kryetarit të komunës, i cili nga ana e tij i ofron disa nga zgjidhjet që janë propozuar në Kartë.

Vërejtje: Këto janë vetëm shembuj. Në qoftë se grupi dëshiron, mund të përdoren politika të tjera sektoriale dhe shembuj të tjerë.



Luajtja e roleve sipas Kartës



Doracak për Kartën e Rishikuar Evropiane për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale



Ushtrimi me deklarata	
Titulli	Ushtrimi me deklarata
Tema	Pjesëmarrja, dilemat, rolet dhe përgjegjësitë
Mostra	Vendos, diskuto dhe ndrysho mendimin?
Madhësia e grupit	10+
Koha	60 minuta
Objektivat	<ul style="list-style-type: none"> – të ngrihet vetëdija e pjesëmarrësve për qëndrimet dhe kufizimet e tyre gjatë trajtimit të çështjeve të pjesëmarrjes; – të zgjerohen perspektivat dhe qasjet e pjesëmarrësve në trajtimin e pjesëmarrjes së të rinjve; – të shfrytëzohen dhe të zhvillohen shkathtësitë për diskutim.
Përgatitja	Deklaratat “Pajtohem” dhe “Nuk pajtohem” duhet të shkruhen në faqe të veçanta të tabelës me letra (flipçartit). Në mes të dhomës duhet të vizatohet një vijë për ta paraqitur vijën kufitare ndërmjet atyre që pajtohen dhe atyre që nuk pajtohen.
Materialet	Deklaratat në flipçart (secila deklaratë në faqe të veçantë), shënues (markerë)
Udhëzime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Filloni me një prezantim të shkurtër për pjesëmarrjen e të rinjve, rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të ndryshëm dhe sfidat e pjesëmarrjes në jetën e përditshme. 2. Sqaroni se tani do të lexoni disa deklarata, me të cilat njerëzit mund të pajtohen më shumë ose më pak. 3. Potencioni dy pozitat e skajshme “Pajtohem” dhe “Nuk pajtohem”. Kërkoni nga njerëzit të pozicionohen në njërin nga anët e vijës. Ata që nuk e dinë ku të pozicionohen mund të rijnë në mes. 4. Lexoni deklaratat me zë një nga një. Pas çdo deklarate jepuni kohë njerëzve që të pozicionohen. 5. Kërkoni nga pjesëmarrësit që të sqarojnë se pse e kanë zgjedhur atë pozitë dhe cili është mendimi i tyre për pyetjen e dhënë. Sqaroni se pjesëmarrësve u lejohej që ta ndryshojnë pozitën e tyre gjatë diskutimit. Mundohuni të ndani kohë që çdokush të përfshihet në diskutim. 6. Pas disa minutash, lexoni me zë deklaratën e ardhshme. 7. Pasi t’i lexoni të gjitha deklaratat, bashkoheni grupin përsëri për diskutimin përfundimtar të ushtrimit.



<p>Diskutimi përmbyllës dhe vlerësimi</p>	<p>Pyetni pjesëmarrësit këto pyetje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Si ndjeheshit gjatë ushtrimit? 2. A ishte e vështirë të vendosni se ku do të pozicionoheni? Pse? 3. Çfarë argumentesh u përdorën? Të bazuara në fakte apo në emocione? 4. Cilat ishin më efektive? 5. A mund të bëhet ndonjë krahasim ndërmjet asaj që njerëzit e bënë dhe e thanë gjatë ushtrimit dhe asaj që e bëjnë në realitet? 6. A janë deklaratat të vlefshme? 7. A ishte ushtrimi i dobishëm? Pse?
<p>Këshilla për moderatorin</p>	<p>Moderatori mund t'i potencojë këto pyetjeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Sa aktivisht i dëgjojmë argumentet e njerëzve të tjerë? – Sa jemi të qartë kur i shprehim mendimet tona? Sa konsekuent jemi në mendimet dhe idetë tona?
<p>Variacionet</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Në disa raste, ushtrimi mund të realizohet pa u lejuar pjesëmarrësve të flasin. Deklaratat mund të jenë qëllimisht provokuese dhe pjesëmarrësit duhet ta zgjedhin një anë pa diskutuar për mendimet e tyre. Në këtë rast, gjatë diskutimit përmbyllës, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet frustrimit për shkak të mungesës së komunikimit kur jepet ndonjë mendim. 2. Mos lejoni që njerëzit të pozicionohen në mes, thoni që të zgjedhin një anë.
<p>Sugjerime për deklarata</p>	<ul style="list-style-type: none"> – të rinjtë nuk janë të interesuar për të marrë pjesë; – të rinjtë marrin pjesë vetëm kur kanë probleme; – autoritetet vendore e mbështesin pjesëmarrjen e të rinjve kur është politikisht e dobishme për ta; – disa të rinj nuk marrin pjesë për arsye kulturore; – të gjithë të rinjtë kanë të drejtë të marrin pjesë; – autoritetet publike duhet të jenë përgjegjëse për financimin dhe zbatimin e politikave që e mbështesin pjesëmarrjen e të rinjve; – mospjesëmarrja është formë e pjesëmarrjes; <p>Deklaratat mund të zgjidhen në bazë të objektivave të sesionit dhe kontekstit të trajnimit</p>



Trekëndëshi i bashkëpunimit	
Titulli	Trekëndëshi i bashkëpunimit – Qyteti i konfuzionit Burimi: <i>Trajnimi për pjesëmarrjen aktive të të rinjve</i> , QER, Strasburg, 2007.
Tema	Pjesëmarrja e të rinjve– bashkëpunimi ndërmjet të rinjve, OJQ-ve rinore dhe pushteteve vendore
Mostra	Shqyrtimi i pikëpamjeve të ndryshme dhe bisedimi
Madhësia e grupit	3-35
Koha	90-120 minuta
Objektivat	<ul style="list-style-type: none"> – dhe të promovohet komunikimi dhe bashkëpunimi i frytshëm ndërmjet aktorëve kryesorë. – të simulohen biseda ndërmjet të rinjve, OJQ-ve rinore dhe autoriteteve publike (vendimmarrësve); – të potencohen nevojat e ndryshme të aktorëve të ndryshëm; – të shkëmbehen përvojat nga situatat e ngjashme nga realiteti i pjesëmarrësve;
Përgatitja	Rastet e studimit
Materialet	Shënues (markerë), letër A3
Udhëzime	<p>Pjesëmarrësit ndahen në tre grupe: autoriteti vendor, të rinjtë dhe përfaqësuesi i OJQ-së rinore. Nëse ka nevojë, grupi i të rinjve mund të jetë më i madh se grupet e tjera. Ky njoftim u jepet të gjithëve:</p> <p>“Në qytetin e Konfuzionit kryetari i sapozgjedhur i komunës dëshiron të bëjë një “kontratë të re sociale” ndërmjet të rinjve, OJQ-ve rinore dhe autoriteteve vendore. Arsyeja për këtë është se qyteti përballet me shumë sfida dhe kryetari i komunës dëshiron t’i përfshijë të rinjtë në jetën publike dhe ta fitojë mbështetjen e OJQ-ve. Prandaj, kërkon takim me të rinjtë dhe OJQ-të e të rinjve që janë aktive në qytet.</p> <p>Detyra juaj është të formuloni – nga perspektiva e grupit tuaj – për çka keni nevojë që ta zgjidhni problemin/et tuaj/a. Më vonë do të keni mundësi që t’ua prezantoni nevojat tuaja dy aktorëve të tjerë. Detyra juaj është të bisedoni me dy aktorët e tjerë deri sa të gjeni gjuhë të përbashkët për atë se si duhet trajtuar problemin dhe kush çka duhet të bëjë.”</p> <p>Pas përfundimit të njoftimit, një deri në tre veta nga çdo grup (varësisht nga madhësia e përgjithshme e grupeve) marrin nga një sfidë/problem. Ata kanë 10-15 minuta që të diskutojnë se çka mund t’u nevojitet prej dy aktorëve të tjerë dhe të formulojnë dy deklarata: nga një për secilin partner (për shembull, të rinjtë formulojnë një deklaratë për OJQ-të dhe një deklaratë për autoritetin vendor). Pas kësaj njerëzit që kanë punuar në sfidën/problemin e njëjtë takohen dhe i fillojnë bisedimet. Ata kanë 45-60 minuta për të arritur marrëveshje.</p>



Diskutimi përmbyllës dhe vlerësimi	Ndjenjat Në përgjithësi? Në grupet e punës që e kanë shqyrtuar rastin e studimit? Gjatë bisedimeve? Procesi – Çka ndodhi në grupe? – A ishte e lehtë të përgatiten deklaratat në grupet e vogla? Pse (nuk ishte)? – A ishte e lehtë të arrihet marrëveshje me dy aktorët e tjerë, a arritët ndonjë marrëveshje? Pse patët sukses/dështuat? Për rezultatet Çka mendoni për këto rezultate? A pajtoheni me to? Për bartjen në realitet – A ka ndonjë lidhje ndërmjet ushtrimit dhe realitetit? Nëse po, cila është ajo? – Çka mësuat nga ky ushtrim? Çka mund të shfrytëzoni/përmirësoni në punën tuaj praktike?
---	--



Trekëndëshi i bashkëpunimit – Rastet e studimit – Sfidat/problemet

Strehimi

Ka problem të madh me strehimin në qytetin e Konfuzionit, ku ka vetëm disa shtëpi të lira dhe me çmime shumë të larta të qirasë. Shumë banesa i takojnë komunës, shumica e të cilave janë shumë të vjetra dhe kanë nevojë për riparim të thellë që dikush të mund të jetojë në to. Komuna nuk ka shumë para për të shpenzuar, ndërsa aplikimi për fonde evropiane do të zgjaste edhe dy vite të tjera para se paratë të jenë dispozicion.

Arsimi

Plan programi mësimor caktohet nga Qeveria. Të rinjtë kërkojnë metoda alternative të mësimdhënies dhe më tepër hapësirë për aktivitetet jashtëmësimore. Konkretisht, ata kërkojnë më tepër metoda joformale të arsimit. Shkolla udhëhiqet nga komuna së bashku me prindërit e nxënësve.

Qasja në medie

Radio stacioni i vetëm gjysmën e ditës lëshon këngë fetare, ndërsa gjysmën tjetër të ditës ka diskutime politike, dhe pak muzikë në periudhën prej orës 1 deri në orën 5 të mëngjesit. Në këshillin drejtues të radio stacionit ka pesë vetë. Kryetari i komunës, kleriku i vetëm i qytetit, kundërshtari politik i kryetarit të komunës, drejtori i shkollës së mesme dhe drejtori i spitalit vendor.

Aktivitetet kulturore

Organizohen shumë manifestime kulturore dhe këmbime me vendet e tjera, mirëpo ka edhe shumë gjëra që mungojnë siç janë ngjarjet ndërkulturore, ekskursionet, udhëtimet dhe koncertet me këngëtarët më pak të njohur, duke i përfshirë edhe ata nga vendet e tjera. Përveç disa OJQ-ve, këto ngjarje i organizon Departamenti për çështje kulturore dhe promovim të trashëgimisë kombëtare të qytetit.

Mundësitë për punësim

Në qytetin e Konfuzionit, përqindja e papunësisë është shumë e lartë dhe kjo shkakton shumë frustrim në mesin e të rinjve. Ato pak vende pune që janë hapur, u janë dhënë miqve dhe familjarëve të kryetarit të mëparshëm të komunës. Të rinjtë nuk kanë qasje në konkurset për vendet e lira të punës, të cilat edhe ashtu janë shumë të rralla dhe nuk mjaftojnë për të gjithë të rinjtë.

Informacione për çështjet shëndetësore

Nuk ekziston vetëdija për mbrojtjen shëndetësore dhe njerëzit në shoqëritë e vogla frikësohen të pyesin për tema siç është riprodhimi seksual dhe mbrojtja nga sëmundjes seksualisht të transmetueshme. Farmacia e vetme në qytetin e Konfuzionit nuk ndihmon në këtë drejtim, për shkak se të punësuarit përhapin thashetheme për atë se kush çka ka blerë (prezervativë, pilula, etj.).

Politika për të rinj

Ka një ligj të ri kombëtar për themelimin e këshillave vendore rinore, vendimet e të cilave duhet të merren parasysh nga këshilli komunal. Qyteti i Konfuzionit e ka përqindjen më të ulët të pjesëmarrjes në votime nga të rinjtë dhe kryetari i ri mendon se kjo flet për mungesën e kulturës politike.

Konsumi i tepërt i alkoolit

Qyteti i Konfuzionit e ka përqindjen më të lartë të të rinjve që janë të varur nga alkooli. Kjo shkakton rrahje të përditshme dhe shëndet të keq të të rinjve. Ka nevojë për reagim urgjent.

Hapja e klubit rinor

Në qytetin e Konfuzionit nuk ka klub rinor që ofron hapësirë për aktivitet, qasje në internet dhe shoqërim, si dhe për aktivitete të kohës së lirë. Ka vetëm disa kafene ku të rinjtë e kalojnë kohën.

Rastet e studimit mund të përshtaten sipas kontekstit dhe sfondit të grupit.



E saktë ose e pasaktë?	
Titulli	E saktë ose e pasaktë?
Tema	Prezantimi i përmbajtjes së Kartës
Mostra	E saktë ose e pasaktë?
Madhësia e grupit	Çfarëdo qoftë
Koha	50 minuta
Objektivat	<ul style="list-style-type: none"> – të shihet se çka dinë pjesëmarrësit për Kartën; – të motivohen pjesëmarrësit ta lexojnë tekstin e Kartës; – të potencohen çështjet e ndryshme që i trajton Karta.
Përgatitja	Duhet të bëhet një prezantim i thjeshtë i Kartës, gjegjësisht ç'është ajo, ç'është qëllimi i saj dhe si ndikon ajo mbi njerëzit
Materialet	Teksti i Kartës Kopje të deklaratave e saktë/e pasaktë
Udhëzime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kërkoni nga pjesëmarrësit që të konstatojnë se deklaratat e shënuara në materialet e ushtrimit a janë të sakta ose të pasakta (pjesëmarrësve u lejohej ta përdorin tekstin e Kartës). 2. Pasi të përfundojë koha për ushtrimin, pjesëmarrësit formojnë grupe me nga tre vetë, i krahasojnë përgjigjet e tyre dhe merren vesh së bashku se cilat deklaratat janë të sakta e cilat jo. 3. Përgjigjet që janë dhënë nga grupet diskutohen në sesion plenar.
Diskutimi përmbyllës dhe vlerësimi	<p>Pyetni pjesëmarrësit këto pyetje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Çka mësuat për Kartën? 2. Cilat pyetje ishin më sfiduese? 3. Si funksionoi procesi i vendimmarrjes në grupet tuaja të vogla? Cili ishte roli juaj?
Variacionet	Një ushtrim i ngjashëm mund të krijohet në bazë të versionit të Kartës në gjuhë të thjeshtë.
Dokumentet e bashkangjitura	Materiale me deklaratat



Deklarata të sakta ose të pasakta për Kartën e rishikuar

Deklarata	E saktë?	E pasaktë?
Karta është e dedikuar kryesisht për autoritetet vendore		
Karta e ka statusin e konventës		
Karta është rishikuar nga Drejtoria për Rininë dhe Sportin e Këshillit të Evropës		
Karta e përkufizon se kush janë të rinjtë		
Karta vlen për të gjithë të rinjtë pa diskriminim		
Sipas Kartës, pjesëmarrja e të rinjve nënkupton të drejtën për të votuar dhe për t'u kandiduar në zgjedhje		
Në fushën e politikës shëndetësore, autoriteteve vendore u rekomandohet të krijojnë hapësira për këshillim për të rinjtë që kanë probleme me duhanin, alkoolin ose abuzimin e drogave		
Karta përmban rekomandime për 15 politikat e ndryshme sektoriale në nivelet vendore dhe rajonale		
Në politikën për sportin dhe kohën e lirë, Karta rekomandon që autoritetet vendore t'i financojnë ngjarje sportive vjetore për të rinjtë		
Karta propozon që të krijohen mundësi për punësim vendor për të rinjtë e papunësuar		
Karta i obligon autoritetet vendore që të gjithë të rinjve t'u ofrojë banim falas		
Karta thekson se autoritetet vendore duhet të ofrojnë mbështetje për organizatat rinore në zonat rurale		
Karta rekomandon që prioritet t'u jepet grave të reja ndaj burrave të rinj në fushën e politikës		
Karta nuk e pranon se projektet e mjedisit janë të lidhura me pjesëmarrjen e të rinjve		
Karta rekomandon se autoritetet vendore duhet ta mbështesin trajnimin për pjesëmarrjen e të rinjve në nivel vendor		
Karta propozon që autoritetet vendore t'u japin kompjuterë falas të rinjve për ta rritur pjesëmarrjen e tyre		
Karta kërkon që autoritetet vendore t'i mbulojnë shpenzimet e projekteve rinore lokale		
Karta rekomandon se këshillat rinorë duhet të përbëhet nga të rinjtë që janë anëtarë të organizatave		
Karta propozon emërimin e garantuesit në nivel vendor për t'i mbrojtur të drejtat e të rinjve		



Çka mund të bësh për mua?	
Titulli	Çka mund të bësh për mua?
Tema	Njohja me përmbajtjen e Kartës Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve vendore dhe organizatave rinore
Mostra	Si mund autoritetet vendore ta mbështesin punën time?
Madhësia e grupit	Së paku 12 veta
Koha	40 minuta
Objektivat	<ul style="list-style-type: none"> – të njihen pjesëmarrësit me përmbajtjen e Kartës; – të gjenden mundësi për përdorimin e Kartës në situatat vendore; – të shqyrtohet se si grupe të ndryshme të interesit mund ta përdorin Kartën; – të identifikohen mundësitë për kontaktimin e autoriteteve vendore në trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e të rinjve.
Përgatitja	Pjesëmarrësit duhet të kenë njohuri themelore për përmbajtjen e Kartës.
Materialet	Teksti i Kartës Tabelë me letra (flipçart), shënues (markerë)
Udhëzime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sqaroni se të gjithë pjesëmarrësit jetojnë dhe punojnë në një komunitet vendor ku Karta e rishikuar posa është futur në përdorim dhe se ata përfaqësojnë grupe të ndryshme të përfshirë në punën për pjesëmarrjen e të rinjve. 2. Kërkoni prej tyre që t'i bashkëngjiten njërit prej grupeve të interesit: <ol style="list-style-type: none"> a. anëtarët e klubit vendor rinor të volejbollit; b. mësuesit e shkollës së mesme vendore; c. anëtarë të këshillit rinor vendor; d. të rinjtë që jetojnë në zonë rurale; e. grupi i grave të pakicës etnike; f. grupi i moshatarëve që punojnë për edukimin seksual. 3. Sqaroni se çdonjëri nga grupet e interesit dëshiron ta përdorë Kartën për të formuluar disa rekomandime për autoritetet vendore që të përforcohet pjesëmarrja e të rinjve në fushën e tyre. 4. Ndani 45 minuta që grupet e vogla ta shfletojnë Kartën dhe të formulojnë më së shumti shtatë rekomandime për autoritetet vendore. 5. Thirrni grupet e interesit që t'i prezantojnë rekomandimet e tyre. 6. Hapni diskutim për komente dhe vërejtje. 7. Hapni diskutim në sesion plenar: “Si mund ky lloj i rekomandimeve t’u komunikohet autoriteteve vendore në mënyrë sa më efikase?”. Konkluzionet duhet të shënohen në tabelën me letra (flipçart).
Diskutimi përmbyllës dhe vlerësimi	<p>Pyetni pjesëmarrësit këto pyetje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. A ishte e lehtë të shihet Karta nga këndvështrimi i grupit të interesit të cilit i takonit? Pse? 2. Cilin aspekt të ri të Kartës e mësuat?



Variacionet	<p>Që ushtrimi të marrë një dozë zyrtare, moderatori mund të kërkojë që dy deri në tre pjesëmarrës (ose anëtarë të ekipit) ta luajnë rolin e përfaqësuesve të autoritetit vendor, i cili me të vërtetë i dëgjon rekomandimet dhe i cili jep komente, kritika ose vërejtje. Në këtë mënyrë pjesëmarrësit mund të identifikohen në mënyrë më të fuqishme me grupin që e përfaqësojnë.</p> <p>Mund të diskutohen reagimet e autoriteteve vendore dhe pastaj pjesëmarrësit mund të punojnë në propozimin e strategjive për bashkëpunim më të mirë me autoritetet vendore.</p>
--------------------	---

Vizita në Rinizi	
Titulli	Vizita në Rinizi
Tema	Kushtet për pjesëmarrje domethënëse
Mostra	Ta vizitohet komunitetin e përkryer të Rinizisë
Madhësia e grupit	10-30
Koha	150 minuta
Objektivat	<ul style="list-style-type: none"> – të diskutohen disa parime të pjesëmarrjes; – të shqyrtohen mundësi për krijimin e hapësirës së përshtatshme për pjesëmarrjen domethënëse të të rinjve në nivel vendor; – të mendohet për atë se si mund të përdoren këto masa në situatat e pjesëmarrësve; – të ushtrohen shkathtësitë për prezantim.
Përgatitja	Ndani pjesëmarrësit në grupe me nga pesë vetë
Materialet	Tabela me letra (flipçarte), stilolapsa, letër me ngjyrë, ngjitës, etj.
Udhëzime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sqaroni se çdo grup është një delegacion që sapo e ka vizituar komunitetin e Rinizisë, ku ata kanë parë kushte të përkryera për pjesëmarrjen e të rinjve. Tani çdo grup duhet t'ua tregojë të tjerëve për atë që e ka parë atje. 2. Jepuni grupeve kohë prej 45 minutash të përgatisin një prezantim vizual të masave, veprimeve, rregullave dhe ideve të tjera që janë zbatuar me sukses në Rinizi. 3. Kërkoni prej delegacioneve që të bëjnë një raport për vizitën e tyre. 4. Shënoni në tabelën me letra (flipçart) të gjitha idetë për masat që e mbështesin pjesëmarrjen e të rinjve në nivel vendor. 5. Mbani një sesion plenar ku pjesëmarrësit mund të japin komente, mendime, etj. 6. Kërkoni prej pjesëmarrësve të mendojnë në mënyrë individuale se cila nga këto masa mund të zbatohet në komunitetin e tyre.
Diskutimi përmbyllës dhe vlerësimi	<p>Pyetni pjesëmarrësit këto pyetje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Si ndjeheshit kur e imagjinonit vizitën tuaj në Rinizi, komunitetin e përkryer për pjesëmarrjen e të rinjve? 2. Sa janë reale masat që janë zbatuar atje? (Sa janë reale masat e propozuara dhe të prezantuara nga grupet e vogla?) 3. Si ishte cilësia e prezantimeve të bëra nga delegacionet? A mund të bëhet një prezantim i tillë për kryetarin e komunës ose autoritetet e komunitetit, apo ka nevojë për të bërë ndonjë përmirësim?
Variacionet	Aktiviteti më tepër mund të fokusohet në cilësinë e prezantimeve të bëra nga delegacionet, pasi që prezantimet mund të jenë një mjet i rëndësishëm për të përfituar aleatë dhe për të ndërtuar partneritete në nivel vendor.



Çka do të ndodhë nëse nuk ndodh?	
Titulli	Çka do të ndodhë nëse nuk ndodh?
Tema	Pengesat për pjesëmarrjen e të rinjve
Mostra	Çka do të ndodhë nëse nuk ndodh?
Madhësia e grupit	Çfarëdo qoftë
Koha	90 minuta
Objektivat	<ul style="list-style-type: none"> – të shqyrtohen pengesat për pjesëmarrje; – të kuptohen pasojat e mungesës së pjesëmarrjes; – të zhvillohet kreativiteti.
Përgatitja	Ndani pjesëmarrësit në grupe me nga 4-6 veta
Materialet	Tabelë me letra (flipçart) dhe shënues (markerë)
Udhëzime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Grupet e vogla “shpalosin ide” (brainstorm) për pasojat e mundshme të mospjesëmarrjes së të rinjve në nivel vendor (gjegjësisht, çka do të ndodhë nëse “nuk ka” pjesëmarrje?). 2. Grupet përgatisin një pjesë të shkurtër teatrore për ta ilustruar njërin nga pasojat e mundshme. 3. Secili grup e luan pjesën teatrore para të tjerëve, të cilët përpiqen ta gjejnë se për çka bëhet fjalë.
Diskutimi përmbyllës dhe vlerësimi	<p>Pyetni pjesëmarrësit këto pyetje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. A ua përkujton ndonjëra nga skenat që i patë ndonjë situatë që e keni përjetuar në komunitetin tuaj vendor? Cilën situatë? Cili ishte rezultati? 2. Cilët do të ishin faktorët ose pengesat që e bllokojnë pjesëmarrjen e të rinjve? 3. Si mund të trajtohen këto në kontekstin vendor?
Variacionet	<ul style="list-style-type: none"> – Pjesët teatrore mund të realizohen në heshtje, ashtu që aktiviteti të mund të përqendrohet më tepër në qëndrimet e pjesëmarrësve; – pjesët teatrore mund të realizohen në formë të forumit teatror. Në atë rast, aktorët do të duhet ta ri luajnë skenën ashtu që pjesëmarrësit e tjerë të mund të bashkëveprojnë dhe ta luajnë ndonjërin nga rolet. Në këtë mënyrë, të gjitha pjesët teatrore do të jenë ndërvepruese dhe do t’i përfshinin idetë për zgjidhjet e mundshme; – aktiviteti i njëjtë mund të shfrytëzohet për t’i shqyrtuar përfitimet nga pjesëmarrja e të rinjve.



Ushtrim për simulim “Të rinjtë në aksion”	
Titulli	Ushtrim për simulim “Të rinjtë në aksion” Burimi: Trajnimi për zhvillimin dhe zbatimin e projekteve pjesëmarrëse në nivel vendor dhe rajonal, QER, Strasburg, 2005
Tema	Simulimi i vendosjes së bashkëpunimit ndërmjet sektorëve qeveritarë dhe joqeveritarë në fushën e të rinjve. Kjo ka të bëjë me zhvillimin parlamentarit rinor vendor trajtimin e temave siç është pjesëmarrja, shoqëria civile, bashkëpunimi, vendimmarrja, përfaqësimi i interesave dhe gjetja e konsensusit, mirëpo edhe dinamika e takimeve, udhëheqja dhe zhvillimi i takimeve dhe fjalimet publike në përgjithësi.
Mostra	Ta krijojmë këshillin rinor në qytetin tonë!
Madhësia e grupit	15-30
Koha	20 minuta – Prezantimi i ushtrimit 120 minuta – Përgatitja dhe simulimi i takimit 60 minuta – Diskutimi dhe përmbledhja e ushtrimit
Objektivat	<ul style="list-style-type: none"> – të shqyrtohen qasjet ndaj pjesëmarrjes që i kanë aktorët e ndryshëm në nivel vendor; – të identifikohen interesat e palëve të interesuara vendore që janë të përfshira në mbështetjen e pjesëmarrjes; – të shihen mundësitë praktike për krijimin e strukturës pjesëmarrëse për të rinjtë në nivel vendor; – të trajnohen pjesëmarrësit për vendimmarrjen dhe gjetjen e konsensusit; – të përjetohet një takim zyrtar për përfaqësimin e interesave dhe shkëmbimin e mendimeve.
Përgatitja	Të kopjohen materialet e ushtrimit
Materialet	<ul style="list-style-type: none"> – kopje e skenarit për çdo pjesëmarrës; – rol personal për çdo pjesëmarrës, që është përgatitur paraprakisht me emrat e pjesëmarrësve; – një fletë me përshkrimet e roleve dhe pyetjet për çdo vëzhgues (nëse ka); – dhomë për mbledhje, me tavolina të radhitura në formë rrethi ose katrori dhe karrige; disa dhoma ose hapësira më të vogla për takim; – letër dhe stilolapsa; – kopje të të gjitha përshkrimeve të roleve për çdo pjesëmarrës në fund të ushtrimit.



<p>Udhëzime</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sqaroni grupit se do të jenë mysafirë në një qytet ku kryetari i komunës dëshiron ta iniciojë programin “Të rinjtë në aksion”, që ka për qëllim krijimin e parlamentit rinor vendor. 2. Tregojuni pjesëmarrësve se sa kohë kanë për simulimin dhe për përmbledhjen e ushtrimit. 3. Shpërndani pjesëmarrësve kopje të skenarit dhe jepuni kohë ta lexojnë me atë me vëmendje. 4. Shpërndani rolet individuale dhe udhëzoni pjesëmarrësit që të mos ua tregojnë ato askujt. Jepuni pjesëmarrësve disa minuta që ta paramendojnë personin i cili do të jenë gjatë simulimit. 5. Nëse ka vëzhgues, shpërndajuni fletët me pyetje dhe jepuni udhëzime të detajuara, nëse ka nevojë. Kërkoni nga vëzhguesit që të ulen në fund të dhomës.
<p>Diskutimi përmbyllës dhe vlerësimi</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. A e pëlqyet simulimin? 2. Cili ishte roli juaj dhe si e realizuat atë? 3. Në këtë fazë të përmbylljes së ushtrimit, mund të shpërndahen fletët me përshkrimet e të gjitha roleve. Përndryshe, nëse lejon koha, pjesëmarrësit mund ta lexojnë me zë rolin që e kanë pasur gjatë simulimit. 4. Si merreshin vendimet? 5. Cilat ishin argumentet që çuan në marrjen e vendimit? 6. A ishte vendimi demokratik? A mundësoi procesi pjesëmarrje? 7. Cilat ishin përshtypjet e vëzhguesve? 8. Çka do të bënit ndryshe nëse do të kishit mundësi që takimin ta mbani edhe një herë? 9. A ishte takimi real? A ka mundësi të ndodhë një takim i tillë në realitet? 10. A ishte rezultati përfundimtar i kënaqshëm në aspekt të qëllimit të përmirësimit të pjesëmarrjes dhe bashkëpunimit? 11. Çka mësuat/zbuluat gjatë ushtrimit? 12. Për trajnuesit dhe udhëheqësit e grupeve: nëse do ta kishit shfrytëzuar këtë ushtrim në ndonjërin nga programet tuaja, kur dhe për çfarë qëllimesh do ta shfrytëzonit
<p>Dokumentet e bashkangjitura</p>	<ul style="list-style-type: none"> – loja e simulimit; – rolet.



→ Ushtrimi për simulim “Të rinjtë në aksion”

Skenari

Qyteti i Vjetër është një qytet në shtetin e Vjetërsisë, vend demokratik që nuk ka të zhvilluar politikë për të rinjtë. Edhe pse në Qytetin e Vjetër jetojnë mjaft të rinj dhe ka më shumë se 20 organizata rinore, të rinjtë asnjëherë nuk kanë luajtur rol shumë aktiv në marrjen e vendimeve të komunitetit. Pas zgjedhjeve që u mbajtën para pesëmbëdhjetë muajsh, kryetarja e re e komunës, zonjusha Rinisa, vendosi të bëhet më proaktive në lidhje me përfshirjen e të rinjve. Ajo futi në përdorim një program krejtësisht të ri “Të rinjtë në aksion”, që kishte për qëllim përmirësimin e pjesëmarrjes së të rinjve, si dhe rritjen dhe intensifikimin e bashkëpunimit ndërmjet të rinjve dhe autoritetit vendor. Si pjesë e këtij programi ajo dëshiron ta iniciojë krijimin e parlamentit rinor vendor.

Në përgatitjet për krijimin e këtij parlamenti rinor vendor, kryetarja e komunës organizon një takim konsultues duke i përfshirë grupet e ndryshme të interesit dhe partnerët e ndryshëm për të vendosur për formatin dhe natyrën e iniciativës së kryetares së komunës.

Këta njerëz marrin pjesë në takim:

- kryetarja e komunës, e cila është edhe kryesuese e takimit të sotëm (ajo po ashtu është edhe nënkryetare e Komitetit të autoriteteve vendore dhe rajonale të shtetit të Vjetërsisë);
- udhëheqësi i opozitës politike të Qytetit të Vjetër;
- nënkryetari i kuvendit të komunës, i cili është edhe shef i Komisioni për buxhet;
- drejtori i shkollës së mesme vendore;
- nënkryetari i shoqatës së prindërve të shkollës vendore;
- zëdhënësi i grupit “Vullnetarët e rritur për fëmijët”;
- prijësi fetar;
- trajneri i ekipit të suksesshëm të futbollit të Qyteti të Vjetër;
- një hulumtues nga Instituti për hulumtime sociologjike i Universitetit të Qytetit të Vjetër;
- një anëtar i kryesisë së një organizate joqeveritare rinore ndërkombëtare;
- kryetari i këshillit rinor të Qytetit të Vjetër;
- sekretari i përgjithshëm i organizatës rinore minoritare;
- një anëtar i njëres nga organizatat rinore të Qytetit të Vjetër;
- nëpunësi për çështje rinore;
- nëpunësi për zhvillimin e komunitetit;
- shefi ekzekutiv i kompanisë vendore të biznesit dhe katër të rinj.

Në takimin e sotëm do të diskutohen këto pyetje

- A ka dëshirë dhe nevojë për krijimin e parlamentit rinor vendor?
- Nëse po, çfarë forme/karakteri duhet të ketë ai?
- Cili duhet të jetë mandat i parlamentit rinor vendor?



→ Ushtrimi për simulim “Të rinjtë në aksion”

Përshkrimet e roleve

Përshkrimi i rolit tuaj personal.

Ju lutemi lexojeni me kujdes dhe mos ia tregoni askujt.

Përpiquni ta përfytyroni se si do të vepronte ky person.

Ju jeni kryetarja e Qytetit të Vjetër

Ju i keni fituar zgjedhjet e vitit të kaluar me shumicë të madhe, duke e mposhtur PR-në (Partinë e të Rriturve), e cila ka qenë në pushtet një kohë të gjatë, dhe ish-kryetarin. Njëra nga arsytet që ju i fituat zgjedhjet ishte fokusimi i fushatës tuaj zgjedhore te të rinjtë dhe politika për të rinjtë. Jeni e vendosur që të bëni diçka për ta përmirësuar gjendjen e të rinjve, pjesëmarrjen e tyre në shoqëri dhe bashkëpunimin ndërmjet administratës suaj dhe të rinjve. Para disa javësh, e prezantuat programin tuaj të ri “Të rinjtë në aksion”, që ka për qëllim ta përmirësojë pjesëmarrjen e të rinjve, si dhe ta rrisë dhe ta intensifikojë bashkëpunimin ndërmjet të rinjve dhe autoritetit vendor. Si pjesë e këtij programi dëshironi ta iniconi krijimin e parlamentit rinor vendor. Në përgatitjet për krijimin e këtij parlamenti rinor vendor, organizoni një takim konsultues duke i përfshirë grupet e ndryshme të interesit dhe partnerët e ndryshëm. Shpresoni se ky takim do të jetë pozitiv dhe konstruktiv, për shkak se edhe pse ju e pëlqeni idenë për krijimin e parlamentit rinor, nuk keni shumë informata për atë se si duhet të funksionojë dhe si mund të formohet. Jeni shumë entuziast edhe dëshironi ta tregoni këtë.

Ju jeni anëtar i 55-vjeçar i partisë opozitare

Gjatë gjithë jetës keni jetuar në qytetin tuaj, jeni anëtar i partisë tashmë njëzet e pesë vjet dhe jeni ish-kryetar i komunës. Besoni se të rinjtë duhet të anëtarësohen në parti politike nëse duan të marrin pjesë dhe nuk shihni se ka nevojë për ndonjë strukturë përfaqësuese të të rinjve. Prandaj, ju jeni kundër idesë së kryetares së komunës dhe përpiqeni që ajo të mos realizohet.

Ju jeni nënkryetari i kuvendit të komunës

Ju jeni shefi i Komisionit komunal të buxhetit. Keni punuar me vite për të pasur një buxhet të balancuar dhe më në fund, vitin e kaluar keni arritur ta bëni këtë. Dëshironi ta ruani bilancin pozitiv me të gjitha mjetet e mundshme. Megjithatë, keni raporte të mira me kryetarin e komunës. E mbështetni iniciativën e saj pa qejf. Nuk do t’ju pengonte në qoftë se iniciativa nuk realizohet.

Ju jeni drejtori i shkollës vendore

Shumica e të rinjve që do të ndikoheshin nga parlamenti i propozuar rinor mësojnë në shkollën tuaj. Ata tashmë kanë mundësi të marrin pjesë në punën dhe udhëheqjen demokratike të shkollës nëpërmjet përfaqësuesve të klasave. Jeni të brengosur se ky parlament rinor do ta tërheqë vëmendjen e veçanërisht burimet financiare nga aktivitetet jashtëmësimore dhe rekreative që tashmë ofrohen në shkollën tuaj. Në përgjithësi, mendoni se do të ishte më mirë që paratë të investohen për riparimin e objekteve sportive të shkollës dhe nuk shihni ndonjë arsye për realizimin e iniciativës. Po ashtu, jeni të brengosur se kryetarja e komunës e ka propozuar këtë iniciativë që ta fitojë mbështetjen e OJQ-së ndërkombëtare që është aktive në zonën vendore dhe kjo, në fakt, është mashtrim politik. Nuk besoni se kryetarja e komunës është e interesuar me të vërtetë për promovimin e pjesëmarrjes së të rinjve. Jeni kundër kësaj iniciative dhe me ngulm e mbron qendrimin tuaj.



Ju jeni prindi i brengosur i njërit nga nxënësit e shkollës

Ju jeni anëtar aktiv dhe nënkryetar i shoqatës së prindërve në shkollën vendore. Keni investuar shumë kohë dhe energji në mbështetjen e përfaqësuesve të klasave dhe të këshillit të shkollës. Besoni në sistemin e vendosur dhe në pjesëmarrjen e përfaqësuesve të klasave në procesin vendimmarrës të shkollës. Shumica e të rinjve shkojnë në shkollë dhe për këtë arsye ju e shihni iniciativën si një lloj humbje kohe dhe si dyfishim i përpjekjeve. Jeni të brengosur se ajo do të shkaktojë një konkurrencë të panevojshme me demokracinë shkollore për të cilën ju punoni. Ju jeni kundër iniciativës.

Ju jeni prindi i njërit nga të rinjtë

Ju merrni pjesë në aktivitetet jashtëmësimore të cilat i organizon shkolla. Po ashtu jeni zëdhënës i iniciativës së quajtur “Vullnetarët e rritur për fëmijët”. Kohë pas kohe, drejtori kërkon prej jush që të vini në shkollë dhe të ndihmoni duke i mbikëqyrur aktivitetet jashtëmësimore. Këtë gjë e bëni me kënaqësi, mirëpo e konsideroni të vështirë që thjesht t’i vështroni dhe t’i mbikëqyrni aktivitetet, pasi që shpeshherë ndjeheni të detyruar të përfshiheni sepse të rinjtë sillen keq dhe nuk mund vetë t’i menaxhojnë detyrat e tyre. Jeni të brengosur se aktivitetet jashtëmësimore në të cilat jeni të përfshirë do të zvogëlohen (në numër) për shkak të parlamentit të propozuar rinor. Po ashtu dyshoni se mund të funksionojë cilado qoftë iniciativë që propozon t’u jepet aq shumë përgjegjësi të rinjve. Jeni skeptik për gjithë këtë iniciativë.

Ju jeni prijësi fetar

Jeni duke u brengosur gjithnjë e më shumë për faktin se të rinjtë vendor nuk janë të interesuar për të ardhur në xhami/kishë ose në aktivitetet fetare. Jeni të gëzuar që jeni ftuar në këtë takim, pasi që atje do të jenë edhe disa të rinj dhe përfaqësuesit e organizatave rinore, e ju jeni të interesuar të dëgjoni prej tyre sa çka u intereson të rinjve. Parimisht, e mbështetni këtë iniciativë, pasi që të rinjtë gjithnjë e më shumë largohen nga Zoti, dhe gjithçka që do t’i inkurajonte të rinjtë të jenë më të interesuar të përfshihen në jetën e komunitetit do të ishte e mirë për aktivitetet tuaja.

Ju jeni trajneri i ekipit të futbollit të shkollës

Ju jeni një person shumë aktiv dhe dinamik që dëshiron t’i shohë të rinjtë se si përfshihen dhe marrin përgjegjësi dhe iniciativa për gjërat që u interesojnë dhe çështjet që i brengosin ata. Megjithatë, ekipi juaj i futbollit ka pasur vështirësi për shkak të mungesës së mbështetjes financiare dhe ju pajtoheni me drejtorin se ndoshta do të ishte më mirë që paratë të investohen në objektet sportive të shkollës, për shkak se të rinjtë janë më shumë të interesuar për këto aktivitete. Ju keni një dilemë. E mbështetni çdo iniciativë që e promovon pjesëmarrjen e të rinjve, mirëpo jeni të brengosur për konkurrencën që do ta krijojë parlamenti për burime financiare.

Ju jeni hulumtues në Institutin për hulumtime sociologjike në Universitetin e Qytetit të Vjetër

Në këtë moment, tema juaj kryesore e hulumtimit janë studimet për të drejtat qytetare, mirëpo pasioni juaj i vërtetë është hulumtimi për çështjet rinore. Kjo iniciativë ju ka gjetur në befasi dhe jeni të motivuar të përfshiheni për shkak se njëra nga fushat tuaja kryesore të interesit janë mënyrë mënyrat e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrjen dhe krijimin e politikave vendore. Ju mund të ofroni shumë këshilla në këtë mbledhje sa i përket qasjeve “pjesëmarrëse” në procesin e konsultimit dhe të krijimit të politikave, duke pasur parasysh se para do kohësh keni marrë pjesë në një konferencë ndërkombëtare në këtë temë, të organizuar nga Këshilli i Evropës në Strasburg. Në konferencë, parlamentet rinore janë përgëzuar si shembuj të pjesëmarrjes së mirë në praktikë, veçanërisht kur të rinjtë janë të përfshirë në krijimin e tyre prej fillimit. Jeni në favor të kësaj iniciative dhe ofroni argumente “të bazuara në fakte” nga hulumtimet tuaja për ta argumentuar me ngulm qëndrimin tuaj.



Ju e përfaqësoni një OJQ ndërkombëtare të studentëve

OJQ-ja juaj merret me politikat arsimore, përfaqësimin e të drejtave të studentëve dhe organizimin e shkëmbimeve ndërkombëtare të të rinjve. Ju besoni në idenë e kryetares së komunës si një gjë që do të sjellë ndryshim të mirëfilltë dhe pozitiv në komunitetin vendor. Jeni i bindur se iniciativa do të jetë e suksesshme për shkak se të gjitha vendet e tjera demokratike kanë struktura vendore që ndihmojnë në përfaqësimin e mendimit të të rinjve dhe në zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme me autoritetet vendore. Qyteti i Vjetër deri tani nuk ka pasur ndonjë strukturë serioze funksionale (ekziston këshilli rinor vendor, mirëpo ai vetëm i bashkon disa organizata rinore dhe është amator në inkurajimin e të rinjve).

Ju jeni kryetari i këshillit rinor vendor

Këshilli juaj rinor është krijuar qëmoti dhe ka funksionuar me efektivitet. Të gjitha organizatat rinore janë të kënaqura me aktivitetet tuaja dhe punën tuaj. Ju mendoni se ideja e kryetares së komunës nuk është e rëndësishme për Qytetin e Vjetër, për shkak se këshilli rinor të cilin e përfaqësoni ju tashmë bën gjithçka që do ta bënte parlamenti rinor. Fuqimisht e kundërshtoni këtë ide dhe besoni se organizatat rinore dhe të rinjtë në përgjithësi nuk kanë nevojë për parlamente rinore. Besoni se ato janë elitare dhe jo përfaqësuese, prandaj nuk kanë legjitimitet. Si strukturë në hije, ato nuk kanë fuqi vendimmarrëse dhe vazhdimisht keqpërdoren nga politikanët, që i shfrytëzojnë ato për t'i arsyetuar vendimet e tyre jo të popullarizuara. Po ashtu, nga përvoja juaj besoni se parlamenti rinor është strukturë tepër e madhe për të qenë efektive dhe efikase dhe për këtë arsye fuqimisht e kundërshtoni këtë iniciativë.

Ju e përfaqësoni organizatën rinore të minoritetit vendor

Organizata juaj i bashkon tre minoritete kombëtare që jetojnë në qytet. Aktivitetet e organizatës suaj janë jashtëzakonisht të rëndësishme për shkak se ju ndihmoni në ruajtjen e kulturave dhe të traditave. Organizata juaj i përfaqëson të rinjtë minoritarë para autoriteteve vendore, si dhe para organizatave dhe strukturave të tjera. Keni vendosur marrëdhënie të mira me komunën dhe organizata juaj ka punuar me ta në disa projekte të përbashkëta. Nuk keni gjë kundër idesë së kryetares së komunës, mirëpo dëshironi të jeni absolutisht të sigurt se parlamenti rinor me të vërtetë do t'i përfaqësojë të rinjtë e Qytetit të Vjetër, duke i përfshirë edhe minoritetet. Prandaj, përpiqeni ta bindni kryetaren e komunës se duhet të ketë një kuotë me të cilën do të sigurohet pjesëmarrja e të rinjve të minoritetit.

Ju jeni anëtar i klubit rinor vendor

Klubi juaj ju ka dërguar në këtë takim të merrni me tepër informata për idenë e kryetares së komunës. Në përgjithësi e pëlqeni idenë për krijimin e parlamentit rinor, mirëpo dëshironi të jeni të sigurt se klubi juaj do të luajë një rol të rëndësishëm në krijimin dhe funksionimin e parlamentit, për shkak se ju jeni klubi më i madh rinor në qytet.

Ju keni diplomuar vitin e kaluar në fushën e punës me të rinjtë

Jeni entuziast dhe të motivuar për t'i mbështetur të rinjtë në çdo mënyrë që mundeni. Ju e mbështetni iniciativën e kryetares së komunës, mirëpo keni frikë se kryetarja e shfrytëzon këtë iniciativë për qëllimet e saja politike. Kuptohet, nuk mund ta thoni këtë haptazi në takim, mirëpo dëshironi të jeni i sigurt se me këtë iniciativë do të krijohet një strukturë e qëndrueshme për pjesëmarrjen e të rinjve. Kurdo që mundeni, ju parashtroni pyetje duke e pasur parasysh këtë gjë, dhe duke u siguruar se e gjithë kjo nuk do të jetë vetëm një mashtrim reklamues.

Ju punoni me komunitete të ndryshme në qytet tashmë shtatë vjet

Në përgjithësi, bashkëpunoni mirë me punëtorin që merret me të rinjtë, mirëpo jeni i brengosur se iniciativa e kryetares së komunës do ta zhvendosë fokusin prej punës suaj kah puna e kolegut tuaj. Zyrtarisht e mbështetni iniciativën e kryetares së komunës, mirëpo privatisht nuk dëshironi që ajo të realizohet. Në takim, përpiqeni ta potenconi vlerën e shtuar dhe ndikimin e punës së përbashkët të gjeneratave të ndryshme për zhvillimin e komunitetit.



Ju jeni pronar i biznesit vendor

Ju jeni vazhdimisht në kërkim të mundësive të reja për biznes. Dëshironi të miqësoheni me kryetaren e komunës për shkak se mendoni se kjo mund të hap mundësi të reja biznesi për ju. Prandaj, ju e mbështetni plotësisht iniciativën e kryetares së komunës. Jeni i gatshëm që ta mbështetni atë edhe financiarisht nën kushte të caktuara.

Ju jeni nxënësi/ja më i/e mirë i/e shkollës

Në këtë takim juve ju ka dërguar njëri nga mësimdhënësit tuaj. Ju nuk e kuptoni se çka është duke ndodhur në mbledhje, mirëpo jeni shumë i interesuar që ta kuptoni. Prandaj, vazhdimisht i pyetni njerëzit që t'u sqarojnë se cili është qëllimi i tyre dhe çka nënkuptojnë gjërat që nuk i keni kuptuar. Sa më shumë që pyetni, aq më mirë!

Ju jeni 17-vjeçar dhe jeni i interesuar për politikën vendore

Ju e shihni se shumë iniciativa që janë ndërmarrë në komunitetin tuaj vendor për të mirën e të rinjve kanë qenë të pasuksesshme (për shkak të mos përkushtimit ose përkushtimit të vogël nga ana e autoriteteve vendore dhe nga vetë të rinjtë). Sipas mendimit tuaj, iniciativa e re e kryetares së komunës është iniciativa e ardhshme e dështuar në këtë komunitet. Dëshironi ta pengoni realizimin e kësaj iniciative për shkak se e konsideroni si të padobishme, gjë që e theksoni qartë gjatë mbledhjes kurdo që ju jepet mundësia.

Jeni të neveritur me familjen tuaj

Po ashtu jeni të neveritur edhe me shkollën, e veçanërisht me autoritetet (të gjitha autoritetet: ato vendore, me qeverinë dhe gjithë të tjerët). Jeni të bindur se ata nuk duhet më t'i mërzhisin të rinjtë dhe se duhet t'u japin liri. Ju mendoni se ky parlament rinor është edhe një ide "gjeniale" e autoriteteve vendore për t'i mbajtur të rinjtë nën kontroll. E ajo që ju doni është liria! Nuk dëshironi të përfshihen në asgjë që ka ndonjë lidhje me autoritetet vendore, mirëpo keni vendosur që të merrni pjesë në mbledhje që të keni mundësi t'i thoni kësaj kryetareje të çmendur atë që e mendoni: se të rinjve u duhet hapësirë për pjesëmarrje pa ua imponuar ndonjë strukturë kontrolluese.

Ju jeni një 16-vjeçar/e

Miku juaj nga Qyteti i Ri ju ka treguar se sa mirë funksionon parlamenti i tyre rinor. Kur lexuat në gazetë për idenë e kryetares së komunës u gëzuat shumë. Ideja ju duket fantastike, dhe dëshironi ta mbështetni atë dhe kryetaren e komunës kurdo që mundeni. Kuptohet, ju do të kishit dashur të përfshihen edhe vetë në të.

Bibliografia

- Advocacy kit*, Advocates for Youth, Washington, DC, n.d.
- Boukobza, E., *Keys to participation. A practitioners' guide*, Council of Europe, 1998.
- Co-management. A practical guide. Seeking excellence in youth participation at local level*, Peace Child International, 2006.
- Discussing global issues: what is participation?* UNICEF, United Kingdom, 2004.
- Doorley, J., "Synthesis report on the work of the Council of Europe's Directorate of Youth and Sport in the field of youth participation and democratic citizenship between 2003 and 2005 and an analysis of current trends in youth participation and recommendations for future action", CDEJ(2006)4, Strasbourg, 2006.
- Dussap, A. and Merry, P., (eds), "Project management T-kit", Council of Europe and European Commission, 2000.
- Forbrig, J. (ed.), *Revisiting youth political participation*, Council of Europe, 2005.
- Golombek, S. (ed.), *What Works in youth participation: case studies from around the world*, International Youth Foundation, 2002.
- Hart, R.A., *Children's participation from tokenism to citizenship*, UNICEF Innocenti Research Centre, Florence, 1992.
- Jans, M. and De Backer, K., *Youth (work) and social participation. Elements for a practical theory*, Flemish Youth Council JePI, Brussels, 2002.
- Kirby, P. and Bryson, S., *Measuring the magic? Evaluating and researching young people's participation in public decision-making*, Carnegie Young People Initiative, London, 2002.
- Kovacheva, S., *Keys to youth participation in eastern Europe*, Council of Europe, 2000. Lauritzen, P., "Essentials of a youth policy in the Council of Europe", unpublished paper, 2006.
- Marx, M., Finger, W. and Mahler, H. (eds), *Youth participation guide: assessment, planning, and implementation*, Family Health International, 2005.
- McAuley, K. and Brattman, M., *Hearing young voices. Executive summary*, Open Your Eyes to Child Poverty Initiative, Ireland, 2002.
- McGachie, C. and Smith, K., *Youth participation case studies*, Ministry of Youth Affairs, New Zealand, 2003.
- Networking for policy change. An advocacy training manual*, The Policy Project, 1999.
- People & participation. How to put citizens at the heart of decision-making*, Involve, 2005.
- Torjman, S., *What is policy?*, Caledon Institute of Social Policy, 2005.
- Weaver, J., (prep.) and Woods, M. (ed.), "Jigsaw of advocacy", COMHAIRLE, 2003.
- Young voices. Guidelines on how to involve children and young people in your work*, The National Children's Office, Ireland, 2005.
- Youth participation handbook for organisations. A guide for organisations seeking to involve young people on boards and committees*, Government of South Australia Office for Youth, 2003.
- Youth policy for mulation manual*, United Nations, New York, 1999.



Kontaktet

Drejtoria për Rininë dhe Sportin Qendra

Evropiane e të Rinjve
Strasbourg 30, rue
Pierre de Coubertin
F-67000 Strasbourg
Tel.: +33 (0)3 88 41 23 00
Fax: +33 (0)3 88 41 27 77/78
e-mail: youth@coe.int
www.coe.int/youth

Fondacioni Evropian i të Rinjve

30, rue Pierre de Coubertin
F-67000 Strasbourg
Tel.: +33 (0)3 88 41 20 19
Fax: +33 (0)3 90 21 49 64
e-mail: eyf@coe.int

Qendra Evropiane e të Rinjve Budapest

Zivatar utca 1-3
H-1024 Budapest
Tel.: +36 1 438 10 60
Fax: +36 1 213 40 76
e-mail: eycb.secretariat@coe.int
www.eycb.coe.int

Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale i Këshillit të Evropës

Këshilli i Evropës
F-67075 Strasbourg Cedex
Tel.: +33 (0)3 88 41 21 10
Fax: +33 (0)3 88 41 27 51
e-mail: congress.web@coe.int



Agjentët për shitjen e publikimeve të Këshillit të Evropës

BELGIUM/BELGIQUE

La Librairie Européenne -
The European Bookshop
Rue de l'Orme, 1
B-1040 BRUXELLES
Tel.: +32 (0)2 231 04 35
Fax: +32 (0)2 735 08 60
E-mail: order@libeurop.be
<http://www.libeurop.be>

Jean De Lannoy
Avenue du Roi 202 Koningslaan B-
1190 BRUXELLES
Tel.: +32 (0)2 538 43 08
Fax: +32 (0)2 538 08 41
E-mail: jean.de.lannoy@dl-servi.com
<http://www.jean-de-lannoy.be>

CANADA

Renouf Publishing Co. Ltd. 1-
5369 Canotek Road
OTTAWA, Ontario K1J 9J3, Canada Tel.:
+1 613 745 2665
Fax: +1 613 745 7660
Toll-Free Tel.: (866) 767-6766
E-mail: order.dept@renoufbooks.com
<http://www.renoufbooks.com>

CZECH REPUBLIC/ RÉPUBLIQUE TCHÈQUE

Suweco CZ, s.r.o.
Klecakova 347
CZ-180 21 PRAHA 9
Tel.: +420 2 424 59 204
Fax: +420 2 848 21 646
E-mail: import@suweco.cz
<http://www.suweco.cz>

DENMARK/DANEMARK GAD

Vimmelskaftet 32
DK-1161 KØBENHAVN K Tel.:
+45 77 66 60 00
Fax: +45 77 66 60 01
E-mail: gad@gad.dk
<http://www.gad.dk>

FINLAND/FINLANDE

Akateeminen Kirjakauppa
PO Box 128
Keskuskatu 1
FIN-00100 HELSINKI Tel.:
+358 (0)9 121 4430
Fax: +358 (0)9 121 4242
E-mail: akatilaus@akateeminen.com
<http://www.akateeminen.com>

FRANCE

La Documentation française
(diffusion/distribution France entière)
124, rue Henri Barbusse
F-93308 AUBERVILLIERS CEDEX Tél.:
+33 (0)1 40 15 70 00
Fax: +33 (0)1 40 15 68 00
E-mail: commande@ladocumentationfrancaise.fr
<http://www.ladocumentationfrancaise.fr>

Librairie Kléber

1 rue des Francs Bourgeois F-
67000 STRASBOURG Tel.: +33
(0)3 88 15 78 88
Fax: +33 (0)3 88 15 78 80
E-mail: francois.wolfermann@librairie-kleber.fr
<http://www.librairie-kleber.com>

GERMANY/ALLEMAGNE

AUSTRIA/AUTRICHE

UNO Verlag GmbH August-Bebel-
Allee 6 D-53175 BONN
Tel.: +49 (0)228 94 90 20
Fax: +49 (0)228 94 90 222
E-mail: bestellung@uno-verlag.de
<http://www.uno-verlag.de>

GREECE/GRÈCE

Librairie Kauffmann s.a. Stadiou
28
GR-105 64 ATHINAI
Tel.: +30 210 32 55 321
Fax.: +30 210 32 30 320
E-mail: ord@otenet.gr
<http://www.kauffmann.gr>

HUNGARY/HONGRIE

Euro Info Service kft.
1137 Bp. Szent István krt. 12. H-
1137 BUDAPEST
Tel.: +36 (06)1 329 2170
Fax: +36 (06)1 349 2053
E-mail: euroinfo@euroinfo.hu
<http://www.euroinfo.hu>

ITALY/ITALIE

Licosa SpA
Via Duca di Calabria, 1/1 I-50125
FIRENZE
Tel.: +39 0556 483215
Fax: +39 0556 41257
E-mail: licosa@licosa.com
<http://www.licosa.com>

MEXICO/MEXIQUE

Mundi-Prensa México, S.A. De C.V.
Río Pánuco, 141 Delegación Cuauhtémoc
06500 MÉXICO, D.F.
Tel.: +52 (01)55 55 33 56 58
Fax: +52 (01)55 55 14 67 99
E-mail: mundiprensa@mundiprensa.com.mx
<http://www.mundiprensa.com.mx>

NETHERLANDS/PAYS-BAS

De Lindeboom Internationale Publicaties b.v.
M.A. de Ruyterstraat 20 A NL-
7482 BZ HAAKSBERGEN Tel.:
+31 (0)53 5740004
Fax: +31 (0)53 5729296
E-mail: books@delindeboom.com
<http://www.delindeboom.com>

NORWAY/NORVÈGE

Akademika
Postboks 84 Blindern
N-0314 OSLO
Tel.: +47 2 218 8100
Fax: +47 2 218 8103
E-mail: support@akademika.no
<http://www.akademika.no>

POLAND/POLOGNE

Ars Polona JSC
25 Obrońcow Street
PL-03-933 WARSZAWA Tel.:
+48 (0)22 509 86 00
Fax: +48 (0)22 509 86 10
E-mail: arspolona@arspolona.com.pl
<http://www.arspolona.com.pl>

PORTUGAL

Livraria Portugal
(Dias & Andrade, Lda.) Rua do
Carmo, 70
P-1200-094 LISBOA
Tel.: +351 21 347 42 82 / 85
Fax: +351 21 347 02 64
E-mail: info@livrariaportugal.pt
<http://www.livrariaportugal.pt>

RUSSIAN FEDERATION/ FÉDÉRATION DE

RUSSIE

Ves Mir
9a, Kolpacnhyi per.
RU-101000 MOSCOW Tel.:
+7 (8)495 623 6839
Fax: +7 (8)495 625 4269
E-mail: orders@vesmirbooks.ru
<http://www.vesmirbooks.ru>

SPAIN/ESPAGNE

Mundi-Prensa Libros, s.a.
Castelló, 37
E-28001 MADRID Tel.:
+34 914 36 37 00
Fax: +34 915 75 39 98
E-mail: libreria@mundiprensa.es
<http://www.mundiprensa.com>

SWITZERLAND/SUISSE

Van Diermen Editions – ADECO Chemin du
Lacuez 41
CH-1807 BLONAY
Tel.: +41 (0)21 943 26 73
Fax: +41 (0)21 943 36 05
E-mail: info@adeco.org
<http://www.adeco.org>

UNITED KINGDOM/ROYAUME-UNI

The Stationery Office Ltd PO
Box 29
GB-NORWICH NR3 1GN Tel.:
+44 (0)870 600 5522
Fax: +44 (0)870 600 5533
E-mail: book.enquiries@tso.co.uk
<http://www.tsoshop.co.uk>

UNITED STATES and CANADA/ ÉTATS-UNIS et CANADA

Manhattan Publishing Company 468
Albany Post Road
CROTON-ON-HUDSON, NY 10520, USA Tel.: +1
914 271 5194
Fax: +1 914 271 5856
E-mail: Info@manhattanpublishing.com
<http://www.manhattanpublishing.com>

Council of Europe Publishing / Editions du Conseil de l'Europe

F-67075 Strasbourg Cedex

Tel.: +33(0)388412581 – Fax: +33(0)388413910 – E-mail: publishing@coe.int – Website: <http://book.coe.int>

Pjesëmarrja njihet si një nga të drejtat njerëzore themelore të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe Konventës për të Drejtat e Njeriut. Pjesëmarrja është edhe parim thelbësor i të drejtave të njeriut dhe është parakusht për një jetë efektive demokratike të të gjithë qytetarëve. Pjesëmarrja rinore nuk është qëllim më vete, por mjet për arritjen e ndryshimeve pozitive në jetën e të rinjve dhe për ndërtimin e shoqërive më të mira demokratike.

Qëllimi i politikës rinore të Këshillit të Evropës është që t'u mundësohet të rinjve të kenë mundësi dhe eksperiencë të barabartë me çfarë do ta fitojnë dijet, shkathtësitë dhe kompetencat e nevojshme për ta gjetur vendin e tyre në shoqëri. Pjesëmarrja rinore ka vend qendror në politikën rinore të Këshillit të Evropës, që në të njëjtën kohë e përfshin edhe bashkë-menaxhimin si mënyrë për ta ndarë së bashku pushtetin me përfaqësuesit e të rinjve.

Pjesëmarrja rinore promovohet përmes sektorëve të ndryshme të Këshillit të Evropës. Karta e Rishikuar Evropiane për pjesëmarrjen e të rinjve në jetën lokale dhe rajonale, e miratuar në maj të vitit 2003 nga ana e Kongresit të Pushteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, paraqet instrument me të cilin vendosen standardet për pjesëmarrje rinore. Karta i përkrah të rinjtë, punëtorët rinor, organizatat rinore dhe pushtetet lokale në promovimin dhe në përfundimin e pjesëmarrjes së konsiderueshme të të rinjve në nivel lokal dhe në atë rajonal në Evropë.

Sipas Kartës, pjesëmarrja nënkupton ekzistimin e të drejtës, mjeteve, hapësirës dhe mundësive, dhe atje ku është e nevojshme, edhe përkrahje për të marrë pjesë dhe për të ndikuar mbi vendimet, mirëpo edhe të merret pjesë në veprimet dhe aktivitetet me qëllim që të kontribuohet në ndërtimin e një shoqërie më të mirë. Doracaku "Fjalën e ke ti!" është një mjet edukativ dhe praktik me të cilin përkrahen të gjithë ata të cilët angazhohen që ta bëjnë atë realitet për sa më shumë persona në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës.

www.coe.int

Këshilli i Evropës është organizata kryesore për të drejtat e njeriut në nivel kontinental. Përbëhet nga 47 shtete anëtare, 28 nga të cilat janë anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës e kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i krijuar për t'i mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe qeverisjen e të drejtës. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e mbikëqyr zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.

